

Bashkia Shkodër
Biblioteka «Marin Barleti»

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

6 -2018
Vjeti III i botimit,
Shkodër

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

5 -2018

Vjeti III i botimit,

Shkodër

Redaksia:

Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija,

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e bashkisë Shkodër dhe
bibliotekës “Marin Barleti”**

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

▪Në vend të editorialit ▪	5
Anton HARAPI (o.f. m) <i>Idealista po ideal</i>	5
▪ Albanologji ▪	8
Gegnia, si grup i vogël krahinash etnografik	9
Erzen KOPERAJ “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i prof. Kolec topallit arritje madhore në gjuhësinë shqiptare	23
▪ Kritikë letrare ▪	
Ermira ALIJA <i>Personazhet fëmijë te migjeni në funksion të beletristikës a utopisë sociale?</i>	28
▪ Histori&Arkeologji▪	
Helidon SOKOLI <i>Fortifikime mesjetare në rajonin e Shkodrës</i>	39
Zamir TAFILICA <i>Tradita muzeore në Shkodër</i>	49
▪ Trashëgimi kulturore▪	
Ridvan KARAKAÇI <i>Karakteristikat e ahengut shkodran</i>	64
Arben PRENDI <i>Kanga popullore shkodrane me motivin e dashnisë</i>	69
TONIN ÇOBANI <i>Një tekst poetik i vjetër sa vetë melodija që e ka përcjellë si këngë</i>	73
▪Filateli▪.....	78
Hysen S.DIZDARI <i>Dom Ndre Mjeda në filatelinë shqiptare</i>	78
▪Bibliofili▪	81
Gjovalin ÇUNI	81
<i>Kultura islame në kontekstin e periodikëve shqiptarë</i>	81
▪Letërsi-Art-Kulturë▪	87
Gjergj FISHTA <i>LAHUTA E MALESISE</i>	87
Gjergj Jozef KOLA <i>Mrekullia e heshtun e Nanë Terezës</i>	141
Manjola BRAHAJ <i>Melankonia</i>	183

▪Ese▪.....	191
Sami REPISHTI Ph.D <i>100 vjetori i revolucionit bolshevik- meditime të një viktime</i>	191
Skender DRINI (1935-2014) <i>Rekujem per Karlo Ljarjen</i>	199
▪Reçensione▪.....	202
Gëzim PUKA “ <i>Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore</i> ”	202
Njazi KAZAZI “ <i>Perashi- krenaria e kujtesës</i> ”, <i>foto-album nga Brahim Miloti</i>	207
▪Arkiv▪.....	210
Gjon KAMSI (1894-1992) <i>Banka dhe monedha shqiptare 1913 – 1944</i>	210
▪Drejtshkrimet e shqipes▪ <i>Otografija e gjuhës shqipe (1964)</i> ...	236
▪Nekrologji▪ Kolec TOPALLI (1938-2018)	244

▪Në vend të editorialit ▪

Anton HARAPI (o.f. m) *)

IDEALISTA PO IDEAL

Qe se i a mrrijtem edhe ksajë. Politika shtrini nder gjire të veta-po thuej-të gjitha lamijet e jetës njerezore. Sod nuk kemi vetëm politikë shtetnore e kombtare, politika ka depertue në jetën shoqnore, ekonomike etj. etj.hini dér në kulturë e mâtet t'a bâjë per veti edhe jeten morale.

Shka don me thanë politikë? Shfrytsim i rasës, i ndolljes, i çasit. Kshtû nemose tash së voni shkruete, e, -me shumicën e shkrimtarve t'onë -kuptote një shqyptár në shêj per ideologji nierzore e atdhetare. Ksajë sod i thonë politikë reale. Ktij parimi i ktij sistemi na shqyp i thomi me e qitë ujin në mulli të vet, me çë do mndyrë e me çë do mjet, pâ marrë parasysh as parim as drejtsí, por vetëm e vetëm si t'a levertisë e si të del mâ mirë per veti a për çâshtje qi ké marrë mbî veti. Në ket mndyrë politika bâhet një farë avokature, por me ket ndryshim, se prej avokati kërkohet ligjë e drejtsí, me sá nieri i politikës, në themel të ktij parimi, po desht verte të bâjë politikë, e xên vetin të liruem prej çë farë do ligje, edhe të nderës e të moralit. *Suprema lex* e tija âsht dobija reale e konkrete qi do të nxjerrë.

Kallzojn per Knjaz Nikollën e Malit të Zi, se tue ndêjë 'i ditë me një mik të vetin, paska rá bisedimi mbî politikë.

Shka asht politika ?- e pvetka mikun Knjazi

Tue pasë ngurrue aj në të përgjegjun, më lën t'a kallzoj Madhní, thâнка miku : politikë don me thanë, po të rrêjsh ti, un me duertrokítje të brohoris: Të lumtë ! E po rrêjta un, të më burgosish si fajtuer, pá pasë të drejtë të lypi arsyë.

*) *Shiko në: Anton Harapi. Shqyptari dhe bota e tij. Prishtinë, 2003. ff. 201-205*

Në perjudhën t'onë kemi vojtë përnjiherë në kulmin e përparimit e në kulmin e krizave. Kemi kriz menduer edhe në lamën politike. Nierzit e kohës, nierzit e politikës nuk po dijn t'u apin dum problemeve të mdhá qi u kan rá mbi krye; e kta jo aq prej nevojve të reja shoqnore, të cillat, kah ditë për ditë shtohen, kapërthyeshëm, kapërthyeshëm ngatrrohen, por sidomos pse, kan xânë të nisin prej disá parimeve të gabueme, si t'ishte në dorë të tyne t'i ndrrojn natyrë njerit e punve; sá mâ haptë duen të shohin, nierzit e politikës, aq mâ teper janë të ngushtuem të kufizohen në dobí e në levertí; kndej kerkesat e tyne gjithher të paplotsueme, dishiret e vullndesa e tyne gjithmonë të pangishme. Kjo âsht një punë e vertetë, se nierzt sod nuk po merren vesht shoq me shoq mbí kuptimin themeluer të jetës, në daç si vehtje, në daç edhe si kolektivitet; e pra ditunija socjologike e etike ká mrríjtë në një zhvillim të mrekuellueshëm.

Qe sod, problemi i jetës âsht vÿ, por kush âsht burrë t'a zgídhë ? Kta pra don me thanë, se as shkenca, as teknika nuk mjaftojn. Ata të cillt i kan dalë zot, udhëhjeksat, organizatorët, nierzt në fuqi duen të nisin prej një parimi, prej parimit politik, kah ata vetë e dijn ase nuk hecë.

Ky âsht kontrasti rrotullues i shoqnís nierzore. Jeta moderne, koha jonë, analizue mirë, në fund të fundit âsht materjaliste padyshim. Qe ktû âsht ndeshja e krizeve: Udhëhjeksat e soçem duen të jenë *idealista materjalist*.

Dÿ idé të pashoqnueshme, dÿ punë të papershkueshme, dÿ skaje të kundërta, qi ndryshojne e rrín larg sá qiell e dhé. Idealista pa ideal, pse në fund të fundit materjalista.

Mire po edhe kësaj i duel boja: u pá e po shihet kjartë, se as kshtû nuk bân. Idealogija materjalistike njimend bâni bankrrotë teorikisht, sá m'u mbajtë e m'u thirrë si âsht njimend, e ndÿt, por praktikisht po ká në dorë gati gjithshkafen.

Nieri, si do të hecë fati i tij, nuk âsht berr, nierzimi kerkoj arsye e ksajë gjëje mendore e praktike e pveti: a ká se si mund të jemi idealsita materjalist?

Edhe ksajë i u gjet kllefi. Ideali politik, po i materjalizuem, pse i pshtetun vetem në levertí, u vesh me një formë të hijshme e të pershtatun, qi i a qorroi sÿt shumkuj. U krijue "mistika" politike. U kapercye metafizika edhe u kapen në mistikë!

S'ká mâ veshtrime e parime të ngulta e të njimendta, por

shndrrime mendimi, kapercim kuptimi, transformim jete, bâ me mâ të madhin elasticitet, sajue me mâ të hapten fantazí, tfaqë me mndyrët mâ të ndrueshmet. Ky âsht kulmi i rropameve politike nierzore të kohës s'onë.

E nieri met aj se aj, veçse u buer ekuilibri ndermjet tij e rrethit mbrenda të cillit rron: Institucionet nierzore, familja, shteti, shoqnija, organizatat etj. ata shka âsht, nuk i gjegjin aspiracioneve të kohës. Tash prá njana dýsh: a se duen ndrrue institucionet nierzore, a se duen sherue smundjet shpirtnore e rropamet e nierit modern.

Lamshi i jetës, kshtû i ngatrruem suell shumm smundje në jeten nierzore, e para nder të cillat âsht mosbesimi në politikë, qi, per rrjedhim të natyrshëm, kurrkund nuk u ndie mâ keqas se në lamen ekonomike. Dyshimi, droja, mosbesimi e kan kapë për fyti financën nderkombtare e janë më kuti t'i a marrin frymen, me sá ekonomít kombtare ndjekin një udhë fatale pa dijtë se ku do të dalin.

Vëmja e mosbesimit ndermjet kombeve shkaktoi autarkít ekonomik e po krijon një "ekonomí per luftë"; kredit e shpenzimet për mjete luftarake po e kapercejn kerrçikun ekonomik në secilin vend; ekonomít kombtare janë të ngushtueme të ndjekin rrjedhjen e fatin e gatimeve luftarake.....

Udhëhjeksat e popujve kan bâ një gabim të madh; kan harrue se nieri si nieri, e populli si popull, me sá mund të bâjn pa ajr e pa ushqim, aq mund të bâjn pa mirsí e drejtsí; ata rrêhen, tue kujtue se problemet e jetës nierzore mund të zhvillohen vetem me formula, pa vlerë të njimendta shpirtnore; ata e tregojn vetin të padijshëm po s'u kujtuen se e keqja s'muhet vetëm me të keq e se lufta nuk ká dert per luftë. Thue s'mrríjn nierzt të kuptoj kaq e gjâ. Po sugure veç kaq s'majftom; lypet edhe t'a dishmojn ket të vertë, e per t'a bâ ket hap shpetimtár duhet *sinceritet*, *ndergjegje e guzim*. Pa ktâ, të gjitha rropamet tjera janë fjalë n'erë, qi nierzit e errët perdorin per të lujtë gurt e vet në korríz të jetës nierzore. Tash dý pvetje: A e dijm na shqyptarët se në çë parim themelohet e mbas cillit system rrjedh jeta e jonë vehtjake, shoqnore, morale, ekonomike e politike. E po patem diejnin a jemë të paisun me at sinçeritet, ndërgjegje e guzim, qi lypen per t'a zhvillue e perfundue problemin e jetes.

▪Albanologji ▪



Rrok ZOJZI (1910-1995)^{*)}

NDAMJA KRAHINORE E POPULLIT SHQIPTAR ^{**)}

Gegnia ose Gegëria, si grup i madh krahinash etnografike

Me emnat “Gegë” dhe Gegni”, si e quejnë vehten dhe vendin e tyre banorët e veriut të Shqipnisë kuptojmë ma të madhin grup nga dy grupët e krahinave etnografike që morën pjesë në

*) Rrok Zojzi u lind në Shkodër më 16 nëndor 2016. Mbasi kreu arsimin e mesme në vendlindje filloi punën si arsimtar në fshatnat malore të Shkodrës dhe në Kosovë, ku krahas profesionit të mësuesit iu rrit dashtunia edhe për sportin e alpinizmit, (mjajt i përhapun në atë kohë mes të rijve), eksplorimit të zonave të thella malore, studimeve gjeografike dhe mbi të tana studimeve në fushën e etnografisë dhe të etnologjisë. Një pjesë të botimeve në rininë e hershme i publikoi në revistat e shqueme të kohës, si: “Hylli i Dritës”, “Drini”, “Vatra shqiptare” etj. Në vjetin 1942 shkroi disa ligjerata që u transmetuan në radiot kohës: “Tirana”, “Korça”, “Kosova”.

Në vjetin 1947, ndonëse me “cene biografike”, në sajë të përgatitjes së naltë në fushën e etnografisë, filloi punën në Institutin e Shkencave, ku krijoi bërthamën e parë etnografike e një vjet më vonë në 1948-n, ndihmoi në ngritjen e Muzeut Arkeologjik –Etnografik.

Gjatë vjetëve të punës deri sa doli në pension (1976), ai la të botueme në revistat shkencore brënda dhe jashtë vendit një seri artikujsh të lidhuna me fushat e traditës, të drejtës kanunore, veshjeve tradicionale, artit popullor, studimeve gjeografike të krahinave të ndryshme shqiptare, albume tematike etj. La në dorëshkrim edhe një monografi për F. Nopçën.

Rrok Zojzi ishte një nga themeluesit dhe kryeredaktor i revistës “Etnografia Shqiptare”; bashkërealizues i Muzeut Kombëtar të Armëve i ekspozitës etnografike Kultura Popullore Shqiptare, etj. Vdiq në vjetin 1995, tuj lanë mbrapa shumë punë të pabotueme fati i të cilave është mbulue me një hije pakjartësie.

Studimi i shkurtuem që po paraqesim (pjesa e parë) titulluem :”Ndamja krahinore e popullit shqiptar” është ndër ma të veçantit e studimeve personale. Shkrimi është botue në numrin e parë të revistës “Etnografia Shqiptare”, Tiranë, 1962, ff. 16-47.

***) Artikulli i nxjerrun nga revista *Etnografia Shqiptare I*, Tiranë 1962, ff. 16-47, botohet me shkurtime.

formimin e kombëtar të popullit shqiptar. Ky grup përmbledh të gjithë veriun e Shqipnisë, tue u nisë nga lumi Shkumbin dhe tue u shtri në veri përtej kufijve politikë deri në kufinin etnik të popullit shqiptar thellë në Jugosllavi. Ky emën nuk u përgjithësue menjëherë, por shkoi tue ndjekë kambë-kambë zhvillimin ekonomik - shoqnor, aq sa në periferi porsa kishte arritë.

Nga mbeturinat që ruen populli mund të gjurmojmë ma thellë tue ndjekë edhe krahinat ma të lashta që deri në një farë shkalle u shkrinë në mes tyne për me formue grupin e madh të krahinave etnografike të quejtun Gegni.

Këto krahina paraardhëse të Gegnisë qenë:

Gegnia, që i dha emnin këtij grupi të madh dhe që ndodhet në jugë të tij gjatë bregut verior të Shkumbinit .

Leknia ose Dukagjini, që shtrihet si një brez i gjanë gjatë bregut jugor të Drinit.

Malësia mbi Alpet e Veriut, në bregun verior të lumit Dri

Fushat bregdetare të Shqipërisë së Veriut, të cilat nuk formojnë një unitet etnografik, por paraqiten si njësi të vogla e të shkëputuna në mes tyne

Fushat lindore (Rrafshi i Dukagjinit dhe fusha e Kosovës)

Gegnia, si grup i vogël krahinash etnografik

Në gojën e popullit dëgjojmë në përdorim të përditshmë tri forma të këtij emni. “Gegët”, “Gjegë” dhe “Malet e Gege”

Që të tre këta emna kanë një burim të përbashkët nga emni “Gegë” që përdoret dendun në veriun e Shqipnisë si emën njeriu.

Ky emën mendohet se paraqet formën e shkurtueme të emnit “Gregor”, por kjo mund të jetë ndonjë përshtatje kristiane mbasi emni Gegë ka mundësi të jetë pagan^{*)}

Edhe në qoftë se si emën njeriu ky emën mund të jetë i vjetër, si emën fisi apo krahine nuk asht shumë i vjetër. Ndër dokumentat e materialet mesjetare nuk përmendet në asnjë rast krahinë me këtë emën. Për herë të parë më 1570 përmendet “Giuro Gegovich” si i parë i një krahine në mes Budues e Pastrovicqe (Mal i Zi), por edhe ky emën ka gjasë të jetë ma tepër emën familjeje ose vëllaznie se sa krahine...

*) Shuflay e ven në lidhje këtë emen me emnin “gogë” që mendon se u jepet vllchëve dhe etimologjinë e tij e lidhë me thirrjen e patave ‘ga-ga-ga’ tue e konsiderue si fjalë onomatopeike me kuptimin rojtës patash (shi. Biologjia e popullit shqiptar)

Emni "Gegni" sot përdoret më një kuptim të gjanë për të gjithë veriun, por nuk përdoret me fuqi të njajtë në të gjithë vendin, p.sh Malësia në skajin ma verior shumë pak e njeh të vetin këtë emën, kurse Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit thuejse aspak.... Gjithnjë pleqtë thonë me krenarinë e atij që don të dallohet nga të tjerët se: "na nuk jemi gegë, gegët janë përtej maleve (e kanë fjalën për Malin e Shenjtë)... ndërsa në Mat Dibër, Martanesh ose në Çermenike thonë vetvetiu na jemë gegë dhe vendi ynë quhet Gegni.

Emni "Malet e Gegëve" ose "Malet Gegë" na e vërteton edhe ma qartë bazën e vjetër të emnit Gegni. Ma fort se Gegni krahinat e Matit, Dibrës, Çermenikës, Martaneshit etj. e njohin vendin e tyre me emnin "Malet Geg ose Gegëve". Me kalimin e kohës "Malet e Gegëve" humbi si shprehje etnografike, por ngeli si shprehje gjeografike, ku qëndron mjaft i fortë. Të mbështetun në fuqinë e emnit Gegni dhe në shprehjen gjeografike që muer emni Malet e Gegëve mund të jemi të sigurtë se baza e vjetër e Gegnisë shtrihej mes Dukagjinit dhe Tosknisë.

Qe të përcaktojmë ma me saktësi kufijtë e shtrimjes së këtij grupi të vjetër të njoftun me emnin Gegët ose "Malet e Gegëve", po gjurmojmë ma tutje në të dhanat e popullit në lidhje me të dhanat historike.

Mbi territorin e Maleve të Gegëve ose të Gegnisë në mesjetë shtrihej principata e Arbnit. Familja e Topiajve, me ndeje në Krue, mbante titullin "Principes Albanie", "Gospodin Rabanski", "Dominus Albanie" etj.)* Ma vonë këtë principatë me titullin e saj trashëgoi familja e Kastriotëve, e cila e mbajti deri më pushtimin turk. Pas rrimarrjes se fuqisë nga Kastriotët, del rishtas principata e Arbërit me Skanderbegun si princ të saj. Me pushtimin e ri nga turqit zhduket kjo principatë për të mos u përmendë ma. Kujtimi i saj ka ngelë vetëm në administratën kishtare "Chiesa Albanese", e cila vazhdon edhe për disa shekuj ma vonë, dhe në popullin e saj që vazhdon të thirret "arbnesh" dhe për disa kohë. Nga të dhenat historike shohim se principata e Arbnit nën Kastriotët shtrihej mes Shkumbinit dhe kthesës nga perëndimi të lumit Mat dhe se kjo përputhej plotësisht me grupin e krahinave etnografike të Gegnisë ose Maleve të Gegnisë.

Popullsia e Gegnisë përbahet edhe prej mjaft të ardhunve, por

*) SUFFLAY, M. "Serbët dhe Shqiptarët", f.40

numri i tyre pak a shumë balançohet edhe me anas të vjetër ose autoktonë. Anas ku ma pak e ku ma shumë kemi në çdo fshat. Si anas mbahet edhe krahina bullgaro-maqedone që gjëndet në Gollobordë e cila nuk njih prejardhje të veten dhe e quën vehten autoktone. Të ardhunit në pjesën ma të madhe janë nga Leknia ose Dukagjini, i cili ndikoi shumë në traditat e krahinës; në numër shumë të kufizuem pat edhe të ardhun nga Malësia; ndërsa ardhjet nga jugu, Tosknia ose Myzeqeja mungojnë fare.



2. Dukagjini ose Leknia

Në përdorimin e përditshëm të popullit dëgjojmë tre emna të ndryshëm: "Lekët", "Lekni", dhe "Dukagjin", të cilët herë përdoren si etnonime, herë si toponime, herë përdoren njeni mbi tjetrin etj. Emni "Lekët" asht mjaft i dëgjuem përgjithësisht në veri, por diku ma i fuqishëm e diku ma i dobët. Në zonën mes Shkodrës (ma tepër Lezhës dhe Tiranës), dëgjoher me fuqi ma të madhe se gjetiu. Tue vazhdue në jugë, gjithnjë dobësoher deri në Elbasan, ku zhduket fare.

Ky emën vjen nga emni i njeriut "Lekë" që në shqipe asht forma e shkurtueme e emënit "Aleksandër". Emni "Lekë", si emën njeriu asht mjaft i përdorun veçanarisht në grupin e Malësisë, si "Lekët e Hotit", por nuk ka fare gjasa të jetë i tyre, pse asgja nuk e lidh me atë vend dhe me atë grup njerëzish : as toponomia,

as etnomia, as gojëdhanat , as gjenealogjitë e vjetra të fiseve. Emni “Lekë” ose “Lekët” në shumësin e caktuem ka ma tepër një kuptim etnomik se sa toponomik.

Emni “Dukagjin” që asht shumë ma i përhapun, e sqaron ma tepër problemin e bazës etnike të këtyne emnave. Emni “Dukagjin” ka gjasë që rrjedh nga Duka e mesjetës Gjin Tanushi (1281) “Ducam Ginium Tanischum”^{*)}. Ky emën la gjurmë të shumta si toponime të vogla vendesh dhe fshatesh, por me një kuptim shumë të gjanë krahinor ngeli vetëm krahinë e Pukës, si një emërtim i së kaluemes, si kujtim i një krahinë të vjetër që tashma nuk ekziston.

Nga dokumentat që kemi prej shek. XII shohim se emëni Dukagjin nuk përmendet as si emën etnomik as toponomik. Nga dokumentat bizantine ma parë dhe sllave ma vonë, deri në shek. XII krejt zona ku përshkohet rruga e madhe Shkodër-Prizrend, zona ku ma vonë shfaqet principata e Dukagjinëve, quhet me emnat Pulatum, Pulat, Pilat etj.^{***)} kurse në jug të saj shtrihej Arbunia që kishte të vetin edhe Oroshin e Fandin.^{****)} Kufini midis këtyne dy principatave shtrihej në malet e Pukës; e të Mirditës.


... po të ndjekim shtrimjen e kanunit të Lekë Dukagjinit, arrijmë të përcaktojmë kufinj të këtij grupi krahinash që u trashëgue nga mesjeta; nga jugu ky grup ndahet prej Gegnisë, tue fillue nga kreshta Shar, Korab, ku buron ujët e Veleshicës, afluent i djathtë i Drinit, dhe zbret gjatë këtij lumi deri në Drin; ndjek teposhtë rrjedhjen e Drinit, deri ku derdhet në Dri lumi i Mallës, afluent i majtë; ndjek në përputhje me rrjedhjen e Mallës deri në qafë të Drajësm dhe ngjiteti gjithnjë në kreshtën e maleve Kunorë-Dejë; nga kjo kreshte zbret ku merr ujët e parë lumi i Urakës dhe, tue ndjekë rrjedhjen e tij, bie në Mat; lumi i Matit i bahet si vijë kufini gjatë gjithë rrjedhjes së tij që nga ky afluent derisa derdhet ne det. Nga veriu ky grup veçohet prej Malësisë, nëpër një vijë që përshkon rranzat e Alpeve të Veriut, nga lindja dhe jugu, ose, tue i përcaktue ma me saktësi, tue fillue nga kufini i Shqipnisë, ndjek rrjedhjen e Drinit deri në Va të Dejës ; prej këtej kalon mbi kreshtën Shita e Hajmelit-Velje e Lezhës dhe zbret prap në Dri (afër Lezhës) dhe ndjek rrjedhjen e tij deri në det . Nga përendimi kufinin e bante bregu i detit që nga gryka e Drinit deri në grykë të Matit.

*) *Sufflay, M. Serbët e shqip. , f.180*

***) *Sufflay, M. Serbët e shqip. , f.40, 43*

****) *Cordignano, F. Geog., eccles f.37.*

Nga lindja ky grup shtrihet deri në qafën e Duljes në mes të Metohisë dhe Kosovës, tue përfshi mbrendë fushën e Metohisë që ende sot e quen populli "Rrafshi i Dukagjinit". Mbi kufijtë lindorë të këtij grupi Griesebah dhe Hanh*) njohim si Dukagjin edhe Prizrendin, Gjakovën e Pejën që shtrihen në Rrafshin e Dukagjinit. Në kohën e sulltan Sulejmanit , sanxhaku u Dukagjinit kishte si qendër Pejën dhe Koroneli ven Pejën si qendër të sanxhakut të Dukagjinit.



Populli i këtij grupi në të gjithë shtrimjen e tij territoriale, ruen kujtimin se janë të një fisi nga një babë i largët i përbashkët. Po të pyesim çdo plak nga Mirdita, të tregon si babë të parë një farë "Murr Dedi"; po ashtu pleqtë e bajrakëve të Ohrit njohin të parë të tyre "Murr Dedin"; po të kalojsh në Berishë (në veri të Pukës), edhe ata të thonë se janë pasardhësit e "Murr Dedit"; po të ngjitemi ma nalt, në Mertur të Gurrit, gjithnjë e lidhin prejardhjen e tyre me këtë babë të përbashkët; po ashtu edhe krahinat e tjera të këtij grupi. Për ma teëpr Mirdita, Shala e Shoshi tregojnë se Murr Dedi pat një djalë që quhej Dit Murri dhe se ky pat tre

*) Griesebach- vol. II, f. 325, citue nga Habn-Alb.St.

djelm që quheshin Mir Diti, Zog Diti dhe Mark Diti që formuen njeni Mirditën, tjetri Shalën e i treti Shoshin.

Populli i kësaj krahine përveç prejardhjes, ruen edhe kujtimin e vendbanimit të parë të tij. Ata tregojnë me bindje të plotë edhe vendin prej kah u shpërngulen. Të gjithë një goje thonë: na jemi të ardhun prej kah lindja; vendi ynë ka qenë “Rrafshi i Dukagjinit” “si thotë populli ose “fusha e Metohisë”, siç thirret në letersi. Atje kemi pasë vendin tonë që e lëshuam të ndjekun prej luftash dhe u futëm në këto male.

Se këto janë të ardhun nga lindja e jo nga veriu, si Malsia, e tregojnë edhe kangët e kreshnikëve, e cila ka si pellg të ngjarjeve të saja krahinën e Bosnjës.

Se kjo popullsi asht e ardhun nga fusha, e vertetojnë edhe traditat e saja. Në përgjithësi Dukagjini, megjithëse sot banon në një zonë malore, nuk e quan vehten malësorë as vendin e tij malësi. Kjo popullsi, megjithëse rron në një vend malor, të përshtatshëm për blegtori, ruen tradita të forta jete bujqësore. Këtë e vrejti edhe populli që la fjalën “malësori shkon mbas bishtit të dhenit dhe dukagjinasi pas bishtit të shatit” .

Si Malësia ashtu edhe Gegnia, në të dy krahët e Dukagjinit trashëguen grupimin shoqnor në “male” të lidhun më kullotën dhe jetën blegtorale, kurse Dukagjini që ndodhet në mes tynë nuk njih këtë grupim të jetës blegtorale as nuk trashëgoi tradita nga ky organizim ekonomiko-shoqëror. Populli i Dukagjinit paraqitet si trashëgimtarë i principatës mesjetare të Dukagjinëve bazuar në ekonomi dhe territor të përbashkët krijoi edhe kulturën shoqnore që shprehet në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Por edhe mbasi u vendos në këto male popullsia pëson një emigrim të dytë nga represioni turk. Gojëdhanat popullore flasin për një emigrim të dytë. Popullisa, për t’i shpëtuar egërsisë së pushtuesit pjesërisht iku nga veriu dhe u rrjeshtu gjatë Drinit , ku u vendos , siç kemi sot Berishën, Merturin e Gurit etj. kurse pjesërisht iku nga jugu, tue ndjekë luginën e Fandit dhe u vendos në vendin e Mirditës, Bajrakëve të Ohrit, të Malësisë së Lezhës etj., ku i kemi edhe sot. Banorët e sotshëm të Shalës, të Shoshit, të Gimajve, të Lekajve të Merturit etj. kapërcyen Drinin dhe u futën nga veriu në tokën e Malësisë, ku zunë vend, kurse pjesërisht Luma zbriti ma në jugë dhe vëllaznia e Pëshkashit kaloi Matin dhe u vendos në tokën e Gegnisë. Me këtë emigrim lidhen legjendat e

bukura të ndamjes së tre vëllazënve në Midhë të Pukës, legjenda e Shalës së shkjeptë në Puke etj.

Me këtë emigrim të dytë, veçanarisht në drejtim të jugut, tue shty ma tej kufijtë e Arbnisë, përveç gojëdhanës popullore që e paraqet me legjenda të bukura kemi edhe gojëdhana të tjera në lidhje me grindjet në mes familjes së Kastriotëve dhe Dukagjinëve për çashtje kufinjsh. Këto grindje pasqyron ma vonë për 12 famulli që i përkisnin episkopatit të Krujës (Arbnisë) dhe tashti i quen të vetat ai i Lezhës (i Dukagjinit). Grindja u trashëgue edhe në shekullin tonë në mes Matit e Dibrës, nga një anë, e të Mirditës, nga tjetra, për krahinën e Lurës.

Por migrimit kemi edhe emigrim, hyrje nga malësia brenda vendit të Dukagjinit. Nga lindja fiset malësore të Gashit dhe Bytyçit kapërcyen lumin e Tropojës u shtrinë mbi pllajat e nalta deri te lumi i Skatinës, tue e shkeputë këtë krahinë nga Dukagjini e tue u bamë pjesë e Malësisë. Po kështu fisi i Thaçit kapërceu Drinin dhe u vendos pranë Iballës; mirëpo nuk arriti ta bënte këtë vend pjesë të Malësisë, por u ba vetë pjesë e Dukagjinit. Sipas relatoreve të shek. XVII, Iballa e quan Dukagjin vendin, por jo dukagjinas popullin.

Populli i Dukagjinit gjithnji nga vend i ri ku u vendos pësoi lëvizje të reja... drejt fushave bregdetare (Zadrimë) dhe shumë familje të tjera në fushat lindore (veçanarisht në Rrafshin e Dukagjinit); mjaft familje u vendosen në Gegni dhe ma pak në malësi. Lëvizjet u shoqënuan me humbjen e emnva të përbashkët, si Dukagjini, Lekët ose Lekët dhe lindën mbi këtë vend një tok njësisish të vogla me emena të veçantë që përfaqsojshin krahina te reja që lindën mbi këtë territor.

Me kalimin e kohës sidomos gjatë pushtimit turk rishtasi filloi përqëndrimi i krahinave të Dukagjinit, por në këtë rasë vetëm ata që ndodheshin nga jugu. Bërthëmë e parë u bë Mirdita me tri vëllaznitë e saja: Oroshin, Spaçin, e Kushmenin. Qe të shpetojshin nga detyrimet turke dhe të gëzojshin lirinë iu mbështetën Mirditës edhe Fandi e Dibri, tue u ba Mirdita me 5 bajrakë. Ma vonë iu mbështetën edhe 3 bajrakët e Ohrit, tue e ba Mirdita me 8 bajrakë. Nga fundi i shekullit XIX iu mbështetën Mirditës edhe 4 bajrakët e Malësisë së Lezhës, tue u ba Mirdita me 12 bajrakë të pavarur nga pushtuesi. Nga ky përqëndrim nisi një afërsi kulturore mes grupit të quejtun Mirditë, kuse grupet e tjera që nuk arritën të

bashkoheshin me këtë grup, si Berisha, Merturi, Hasi, Luma etj., vazhduen të zhvillojshin ma tutje veçoritë kulturore të veçanta që krijuen, kurse grupet e tjera u shkëputen, si Dukagjini i Ri, Merturi etj. në Malësi të madhe dhe në Palabardhë në Mal të Zi etj. i ikën larg bazës së vjetër të traditave të përbashkëta.

3) Malësia

Me emnin “Malësi” ose “Malci” për vendin dhe malësorë ose malcorë për banorët e tij kuptojmë të tretin grup krahinash etnografike që u shkri me të tjerët për të formue grupin e madh të veriut të Shqipënisë.

“Malësi” ose “Malci” është një emër i përveçshëm që i jepet vetëm krahinës së njohun në gjeografi me emnin “Alpet e Veriut”, por emëni nuk asht një emën gjeografik që ka kuptimin fizik të disa malëve, por asht emen me kuptimin etnografik ku fjala “mal” ka kuptimin e një grupi njerëzish dhe fjala “malësi” ka kuptimin e disa grupeve të tilla. Ky grup krahinash etnografike ka si bazë vetëm zonën që në gjeografi njifet me emnin “Alpet e Veriut”: Alpet e Veriut kanë si vijë kufini lumin e Tropojës, Drinin, dhe rranzat e maleve nga perëndimi. Po Malësia si grup etnografik u përfshin nga jugu edhe pllajën e naltë mes lumit të Tropojës dhe të Skatinës dhe nga perëndimi fushat gjatë liqenit të Shkodrës. Kështu kufijtë e këtij grupi mund të përcaktohen: nga jugu lumi i Skatinë dhe Drini deri në Va Dejës, që e ndajnë nga Dukagjini; nga lindja një vijë që ndjek rranzën e Cukalit deri në Shkodër dhe prej Shkodre nëpër liqe deri në kufinin politik të atdheut tonë, ku shtyhej ma thellë, tue përfshi edhe një pjesë të mirë të Malit të Zi. Mbi këtë territor shtrihej principata mesjetare që në dokumenta historike quhet “Pulatum”, “Pilot” etj., nën familjen e Shpanëve. Kjo principatë, simbas dokumentave bizantine e sllave të shek. XII, shtrihej që nga kufini verior i Malësisë dhe deri në rrugën e madhe Shkodër-Pukë- Prizrend në jugë, ku puqej me Arbninë në një vijë të përbashkët kufini që i humbi gjurmat ndër malet e Pukës*)

Me daljen në skenë të principatës së Dukagjinëve, filloi të përmbli dhej Pulati nga veriu dhe Arbnia nga jugu, tue shkëputë nga njeni-tjetri dhe tue lëshue vend në mes tyne principatës së Dukagjinëve ose Leknisë. Kjo e fundit me zhvillimin e plotë të saj, shtyni kufijtë e saj në veri deri në Drin dhe në jug deri në Has

*) *Sufflay, M. -rep. e cit., , f. 40-43.*

në verilindje e në Bishkash në jugperëndim.

Nga kjo ngjarje Pulati i vjetër në shek. XVI-XVII nga një territor shumë i gjanë paraqitet i përmbledhun deri ku shtrihet sot Malësia, Kelmendi, Hoti, Shkreli që quhen në vj. 1635 Pulat*) dhe ma poshtë Kopliku në vj. 1416 i përkiste Pulatit***) kurse nga jugu në një document të vj.1570 thuhet se në veri të Drinit shtriheshin malet e familjes Shpan ose Pulat***), në një document të vj. 1634 P. Bonaventura thotë: qeshë afër Pulatit, një të shtime altilierie këndeje Drinit****). Bardhi në relacionin e tij të vj.1638 thotë nga Aripa e keqe kalova Drinin e hyna në tokën e Pulatit, dhe prapë ma poshtë thotë: 7 milja larg Gashit kalova dhe dola nga toka e Pulatit****). Sospello në relacionin e vj.1650 thotë: Gashi në Pulatin e sipërm*****). Malësia e sotshme, me gjithë se trashëgoi pjesërisht territorin e Pulatit të hershëm, përveç toponimeve që lidhen me të, nuk ruen asnjë kujtim as lidhje tjetër me Pultin e lashtë jashtë kufijve.

Përbamja etnike e popullsisë së këtij grupi paraqitet shumë e thjeshtë; në luginat e thella ku natyra fali në prehen të maleve sheshe të papunueshme, banonte një shtresë e vjetër popullsie, e cila kujtohet sot nga gojëdhanat dhe legjendat popullore, nga toponimet e ndryshme nga mbeturinat e vendbanimeve, si dhe mbeturina popullsisie që e mbajnë vendin të të rrjedhun, nga kjo shtresë e lashtë. Kjo popullsi paraqet mbeturinat e banorëve të mesjetës të krahinës që quhej Pulat. Mbi vendin dhe popullin e këtij grupi mesjetar u derdh një popullsi e re e ardhun në formë valësh të njëpasnjëshme, si blegtorë nomadë me forma të organizueme të rendit fisnor. Këta quheshin: fisi i Kelmendit, i Shkrelit, i Kastratit, i Hotit, i Grudës etj. që paraqiteshin si grupe të veçanta popullsisish me dukuri jetese dhe zakone të ndryshme. Për vendin e prejardhjes të gjithë dëshmojnë anën e veriut, dhe pikërisht rrethet e Bosnjës . Në lidhje me këtë, këto fise trashëguen ciklin e madh të rapsodisë së Qeto-Basho Mujit që si fushë të zhvillimit të episodëve të saja kishte rrethin Bosnjës. Asnjë grup tjetër historiko-etnografik i Shqipnisë nuk e trashëgoi

*) *Cordignano, F. – vep. e cit., f.28*

**) *Cordignano, F. – vep. e cit., f.28*

***) *Sufflay, M. , vep. e cit., f. 43.*

****) *Cordignano, F. – vep. e cit., f.22*


*****) *Cordignano, F. – vep. e cit., f.22-23*

*****) *Cordignano, F. – vep. e cit., f.41*

këtë rapsodi, përveç fiseve që e quajnë plotësisht të veten. Këto fise ka gjasë që zbritën këtu ndër shekujt e parë të mijëvjeçarit që sapo kaloi, pse ndër shekujt XII-XIV fillojnë të përmenden ndër dokumenta historike në këtë vend.

Anasit dhe të ardhunit kaluen një kohë harmonie mes tyre; të parët shfrytëzojnë sheshet e ulta, brigjet e luginave për bujqësi, kurse të dytët shfrytëzojshin kullotat e nalta për blegtori.

Kushtet e reja të jetës së ngulun ndikuen edhe në jetën ekonomike, shoqnore dhe politike. Mbi sistemin fisnor, që mbështetej në lidhjen e gjakut në mes të njerëzve lindi një sistem i ri me lidhje territoriale në mes tyre. U formuen grupe të reja popullsie që nuk u thirrën ma fise, por "male". Popullsia e Malësisë u përmbledh në 12 male që janë Tripsh, Pipri, Kuçi, Vasojeviçi, Kelmendi, Hoti, Gruda, Shkreli, Kastrati, Krasniqja, Gashi, Bytyçi. Në disa raste fisi u përmbledh me malin, si në Kelmend, në disa të tjera një fisi u nda në 2-3 male, si p.sh. Shkreli e Bytyçi etj., në disa raste një mal u formue nga pjestarët e dy fiseve, si, p.sh Gashi etj. Termi përmbledhës krahinor Malësi për vendin dhe malësorë për banorët zevendësoi të vjetrin Pulat, që nga shekulli XVII



Mes këtij grupi çfaqet e drejta kanunore e përbashkët për të gjithë që quhet "Kanuni i Maleve", që paraqitet i ndryshëm nga ai i Lekë Dukagjinit. Drejtimi i përbashkët politik gjen shprehje në "kuvendin e pleqve të maleve" përfaqësuar nga 12

pleqtë (tradita e 12 pleqve u trashëgue deri në kohë të afërme në Kosovë e Metohi). Asht qartësisht e dukshme se vetëm kjo shtresë popullsie asht trashigimtare e drejtpërdrejtë e rapsodisë së madhe shqiptare të “Kangëve të Kreshnikëve” të “valleve me shpata”, “lahutës” etj.

Malësia pësoi dhe ushtroi ndikime reciproke mbi grupet e afërme, dhe veçanarisht mbi atë të Leknisë ose të Dukagjinit. Fise malësore Gash dhe Bytyç kapërcyen lumin e Tropojës që formon kufinin e Alpeve të Veriut nga jugë lindja dhe zbritën deri në lumin e Skaticës dhe u vendosen me banim të përhershëm në këtë vend që i takonte Dukagjinit, tue e shtri kufinin e Malësisë mbi këtë zone. Nje grop tjetër malësorësh, fisi i Thaçit, kaloi ma poshtë Drinin dhe nguli banimin në tokën e Dukagjinit, por këto humbën të drejtën e kullotës verore në Malësi, u shkëputën krejtësisht nga grupi i vet dhe u banë pjesë e popullsisë së grupit të Dukagjinit. Edhe nga perëndimi zbritën grupe malësorësh në fushat gjatë liqenit të Shkodrës, tue i popullue edhe ata dhe tue u ba pjesë e Malësisë megjithë se janë fusha të ulta.

Anasjelltas popullsia nga Dukagjini u dyndën në territorin e Malësisë. Në shekullin XVII tri grupe popullise nën presionin e turqëve gjetën strehim në tokën e Malësisë, nga jugu Merturi kaloi Drinin dhe u vendos në luginën e lumit Nikaj, një grup tjetër i përbamë nga dy vllazni” Shoshi dhe Shala u vendos në luginën e lumit Leshnicë; një grup i tretë Gimaj-Lekaj prapë nga jugu u fut në territorin e Malësisë dhe zuni vend pranë të dytëve në luginën e Leshnicës. Banorët e rij të ardhun pa lufta në tokën e Malësisë, sollën traditat dhe emnin e Dukagjinit në zemër të Malësisë. Kjo popullis e ardhun nuk u shkri me popullisinë e Malësisë, por ruejti traditat e veçanta të veta dhe formoi një krahinë të re etnografike në zemër të Malësisë, tue u nda atë në dy grupe : 9 male në veri, që u quejtën “Malësi e Madhe” dhe 3 male në jugë që u quejtën “Malësi e Vogël” kurse në mes tyne si një pykë u formue grupi i tretë, i quejtun “Dukagjin” , që për me u dallue nga baza e tyne filluen ta quejnë Dukagjini i Ri, kurse bazën Dukagjini i Vjetër. Nga kjo ndamje u shkatuan shumë keqkuptime:

Disa mejtuen se Malësia e Madhe dhe e Vogël u cilësuen prej strukturës gjeografike të maleve, tue mendue se në Malësi të Madhe kemi male ma të mëdha e në Malësi të Vogël ma të vogla,

kurse në të vërtetë asht e kundërta Malësia e Vogël paraqet karakter alpin ma të egër e ma të vrazhdë se Malësia e Madhe. Emni Malësi e Madhe i ngeli pse ajo përfshin 9 male, kurse Malësia e Vogël përfshin vetëm 3 male.

Disa të tjerë, veçanarisht albanologë të huej që nuk u thelluen në fenomenin e zhvillimit të ngjarjes, nuk e muernë më mend se si mund të ishte Malësia e Madhe larg asaj të Voglës dhe me një krahinë tjetër etnografike, në mes tyne prandaj emnin Malësi e Vogël e vunë mbi Dukagjin tuj bashkue Malësinë e Madhe me Malësinë e Vogël (Dukagjini)

Me këtë ranë në një gabim ma të madh. Populli Dukagjinit, në zemër të Malësisë, që ruen traditat e prejardhjes se vet nga Leknia ose Dukagjini i vjetër, nuk e quen vendin e tij: "Malësi" as vehten 'malësorë', pse ai nuk e njih organizimin shoqnor të "Maleve" (shih Lekninë) dhe për ma tepër trashëgoi një lloj urrejtjeje për malësi dhe malësorë. Prandaj vendosja e emnit "Malësi e Vogël" mbi Dukagjinin asht krejt arbitrare.

Disa të tjerë e cilësuaen ma drejtë tue e quejtë Malësinë e Madhe "Malësi e Shkodrës" dhe Malësinë e vogël "Malësi e Gjakovës", kurse në mës vendosën Dukagjinin.

Si përfundim kemi se popullsia e Malësisë përbahet nga tri grupe etnografike që quhen:

- Malësia e Madhe ose e Shkodrës
- Dukagjini ose Dukagjini i Ri
- Malësia e Vogël ose e Gjakovës.

Asnjë njësi ndonësë bashkëjetuan për 3 shekuj nuk arrijtë të formojnë një unitet. Secila prej tyhne ruajtën veçoritë e tyne etnografike dhe zhvillune një jete të pavarun në çdo aspekt. Malësia e Madhe ose e Shkodrës ruajti ma të pastra traditat fillestare të kulturës, kurse Malësia e Vogël ose e Gjakovës e ndjeu ma fuqishëm ndikimin oriental. Kështu këto dy pjesë shkuen tuj u largu njena-tjetrës. Dukagjini megjithëse rujti traditat fillestare, ra mjaft nën ndikimin e dy blloqeve të Malësisë, gja që u çfaq në kanun, në doke dhe zakone, në kulturën materiale etj... Dukagjini ra nën ndikimin edhe të folmes së Malësisë. Pulti ra krejtësiht nën ndikimin e Dukagjinit, ashtu edhe Toplana, Temali, Nikaj pjesërisht. Nga ky proces unifikimi në zhvillim e sipër, pa u krijue një unitete i mbrëndshëm i plotë Malësia i kaloi unitetit të madh të Gegnisë.

Fushat bregdetare të veriut të Shqipërisë

Shtrihen mes vargut të maleve nga lindja dhe të bregut të detit nga perendimi, tue fillue që nga bregu i majtë i liqenit të Hotit në veri dhe deri në bregun e djathtë të Shkumbinit në jugë.

Popullsia e këtyre zonave nuk formoi asnjehere një njësi etnografike, por u paraqit kurdoherë me krahina të vogla etnike. Banorët e fushave bregdetare bane pjesë në një krahinë me banorët e maleve ma të afërta. Gegnia llogariste të veten fushat midis Matit e Shkumbinit; Dukagjini fushat midis Matit, Drinit dhe Lezhës. Malësia fushat gjatë bregut të majtë të liqenit të Shkodrës.

E marrun në përgjithësi popullsia që banon sot ndër fushat bregdetare të veriut të Shqipërisë, simbas kujtimeve që ruen vetë populli, asht një popullsi krejtësisht e re dhe e ardhun gjatë 3 shekujve të fundit. Vetëm fushat e Zadrimës, në mes Lezhës dhe Shkodrës dhe në ato në mes të Shkumbinit dhe të Ishmit kemi një sasi të vogël popullsie që e quan vehten vendas e hershme dhe gjithë të tjerët janë të ardhun. I njajti fenomen paraqitet edhe në fushat lindore të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës, ku edhe atje e tanë popullisa po ashtu asht e ardhun. Malësorët bazu në gojëdhana ndryshuan edhe peisazhet e fushave ku u vendosen. Në shek. XVIII malësorët hapen pyjet e Ishullit të Lezhës, Ishullit të Shëngjinit, të Bregut të Matës etj. E njejta gja edhe me fushat e Rrafshit të Dukagjinit që qenë ballkane (të pabanueshme).

Gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX filluen të vendoseshin me banim të përhershëm sa në fushat e bregut të liqenit të Shkodrës, aq gjatë fushave mes Drinit e të Ishmit, malësorët e Malësisë së Madhe që u dhanë tiparet etnografike të Malësisë këtyne dy fyshave.

Nga këto lëvizje popullise që pësuen fushat bregdetare morën 4 shprehje të ndryshme etnografike: fushat e liqenit të Shkodrës, pa pullsi vendase, të popullueme dendun me të ardhun nga Malësia e Madhe; fushat mes Shkodrës dhe Lezhës me një sasi vendasish të hershëm, por më shumë banorë të ardhun nga grupe të ndryshme etnografike; fushat mes të Drinit dhe të Ishmit, pa banorë të vjetër, por të popullueme dendun nga malësorë që zbritën nga Malësia e Madhe; fushat në mes Ishmit dhe të Shkumbinit me banorë vendas dhe të ardhun nga Gegnia. Nga këto 4 grupe ato gjatë bregut të liqenit të Shkodrës në veri do t'i quejmë si një grup të përbashkët me Malësinë e Madhe, mbasi paraqiten si një unitet traditash; gjithashtu atë të fushave në mes

Ishmit dhe të Shkumbinit do ta quejmë një grup të përbashkët me Gegninë. Ndërsa fushat në mes dy Drinave (Shkodër -Lezhë) do t'i quejmë si krahinë etnografike e veçantë, mbasi nuk lidhen me asnjërin nga grupet e tjera; gjithashtu fushën në mes Drinit dhe të Ishmit, me gjithë që me tradita lidhet me Malësinë e Madhe, po e quejmë krahinë etnografike të veçantë.

Kështu nga fushat bregdetare të Shqipërisë së Veriut kemi dy krahina etnografike:

- Fushat mes dy Drinave
- Fushat në mes Drinit dhe Ishmit

(vijon në numrin e ardhshëm, me "Toskënia" ose "Toskëria")

Erzen KOPERAJ

**“FJALORI ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE”,
I PROF. KOLEC TOPALLIT ARRITJE MADHORE NË
GJUHËSINË SHQIPTARE**

“Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i prof. Kolec Topallit, i cili u nda nga jeta pak muaj më parë, vjen si një prej arritjeve më të mira në punimet etimologjike në gjuhësinë tonë. Studimet në fushën e etimologjisë mbi shqipen, si njëra nga degët më të rëndësishme të historisë së gjuhës, pavarësisht disa sprovave që fillojnë që me Pjetër Mazrekun dhe Lajbnicin, mirëfilli zanafillën e tyre e kanë në mesin e shekullit XIX, atëherë kur u hodhën themelet e gjuhësisë krahasuese, dhe shqipja, si një gjuhë e veçantë brenda familjes gjuhësore indoevropiane, zgjoi vëmendjen e gjuhëtarëve të huaj fillimisht e më pas dhe vendës. Madje në pajtim me interesin që paraqiste kjo gjuhë në planin indoevropian, etimologjia, si disiplinë që shërbente më shumë për krahasim të jashtëm, që ndër të parat fusha të albanologjisë që u prekën dhe u lëvruan nga mjeshtrit e mëdhenj të indoevropianistikës, si *Franc Bopp, Karl Brugman, Gustav Majer, Nobert Jokl e Holger Pedersen*. Ndërsa ndër shqiptarë mund të përmendet arbëreshi i njohur Dhimitër kamarda. Por duke përjashtuar fjalorin etimologjik të Gustav Majerit të vitit 1891, ku bën analizën etimologjike të 5500 fjalëve të shqipes, studimet etimologjike njohin një zhvillim cilësor në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Ku krahas këtyre aspekteve të rëndësishëm të marrëdhënieve të jashtme me gjuhët e tjera, studimet e kësaj fushe, sidomos me veprën e Çabejt, Studime etimologjike në fushë të shqipes, u përqendruan më shumë në zhvillimin e brendshëm të gjuhës shqipe, ku rezultatet e kësaj pune janë lidhur e bashkërenduar me ato të fushave të tjera, si me fonetikën historike, dialektologjinë, leksikologjinë, onomastikën etj. Krahas Çabejt, padyshim ia vlen të përmendet kontributi i gjuhëtarëve të tjerë si Erik Hamp, Bardhyl Demiraj, David Luka, Vladimir Orel e shumë të tjerëve, të cilët sollën jo vetëm etimologji të reja, por edhe metodologji të re në këtë fushë.

Duke i parë me një vështrim kritik hulumtimet e kryera në këtë disiplinë të rëndësishme të gjuhësisë historike, vihet re se krahas zgjidhjeve të sakta etimologjike, mbetën ende probleme të pazbërthyera e të pasqaruara si duhet, ku hipotezat dhe dyshimet, pikat e errëta nuk kanë qenë të pakta. Dhe kjo mëse e kuptueshme për një gjuhë të tillë si shqipja e cila ka kaluar një rrugë shumë të gjatë zhvillimi, por është e dokumentuar shumë vonë. Në këtë vazhdë, Fjalori etimologjik, i prof. Kolecit, nuk vjen papritmas. Që në artikujt e parë të botuar të tij këtu e 45 vite më parë ai prek këtë fushë.

Dhe mirëfilli, hartimi dhe kurorëzimi i këtij fjalori duhet parë që nga monografite e para të prof. kolecit.

E fillon me fushën e *fonetikës historike*, ku realizon së pari 8 monografi, 4 për sistemin zanor dhe 4 për sistemin bashkëtingëllor, si: Theksi në gjuhën shqipe, 1995; Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe, 1996; Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes, 1998; dhe Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe, 2000; pastaj për bashkëtingëlloret, Sonantet e gjuhës shqipe, 2001; Mbylltoret e gjuhës shqipe, 2002; Fërkimoret dhe afrikatat në gjuhën shqipe, 2003; Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe, 2004; për ta përmbyllur me një prej kryeveprave të kësaj fushe, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, 2007, vepër e vlerësuar me çmimet *ekselenca shqiptare 2007* dhe me *Çmimin e albanologjisë 2008*.

Pas plotësimit të studimeve në fushën e fonetikës, monografite e prof. Kolecit vijojnë me gramatikën historike, duke filluar me : Evolucionin historik i përemrave të shqipes, 2008; Nyjat e shqipes, 2009; Sistemi foljor i gjuhës shqipe, 2010; për të përfunduar me "*Gramatikë historike në gjuhën shqipe*, më 2011, padiskutim një prej veprave më të arrira në këtë fushë studimi.

Padyshim që mbi këto kolona mbështetëse, *fonetikën historike* dhe *gramatikën historike*, mund të ngrihej dhe Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Një bazë e tillë patjetër që do të jepte logjikshëm këtë vepër, e cila për nga volumi i punës si dhe nga cilësia e analizës burimore të fjalëve, zor se mund të besohej që t'i dilej mbanë nga një njeri i vetëm.

Për këtë arsye, ky fjalor është sot një pikë referimi për gjuhësinë shqiptare, sidomos në studimet historiko-krahasuese. Kjo jo vetëm në saj të rezultateve që kanë dhënë studimet e gjuhëtarit

të mirënjohur, por edhe përmes përcimit të filozofisë gjuhësore të ndjekur, si dhe orientimit metodologjik.

Leksiku i shqipes shfaqet jo vetëm në shtresëzimin historik, kalimi nga format më të vjetra tek ato më të reja, por jepet edhe shtrirja e tij. Mund të themi se fjalori dashur-padashur bën edhe hartën e shqipes historike dhe bashkëkohore. Nga krahasimi i rrënjëve të fjalëve me gjuhët e tjera indoevropiane, bëhet përcaktimi i elementit të trashëguar indoevropian. Po ashtu përqsja me gjuhët e lashta që janë folur në Gadishullin Ballkanik, ndihmojnë në përcaktimin e shtegtimeve të fjalëve, kuptimet e reja që kanë krijuar në rrjedhën e shekujve. Madje nga qëmtimi që mund t'i bësh fjalësit të fjalorit mund të shohësh sesi jepet analiza e fjalëve duke treguar pjesmarrjen dhe rolin e shqipes në formimin e njësisë ballkanike edhe në fushën e leksikut. Këtu kemi parasysh që në fjalor gjen analiza dhe shpjegime etimologjike për fjalë që janë zhdukur nga përdorimi i shqipes, fjalë që ndeshen vetëm tek Buzuku, autori ynë i parë i shqipes së shkruar, e deri tek fjalë që kanë hyrë vitet e fundit në gjuhën shqipe, përmes teknologjisë apo kulturës globaliste.

Po t'i referohemi fjalësit të listuar në fjalor rezulton që në të kemi rreth 43 000 fjalë të analizuara. Një fjalor, që autori mjeshtërisht ka arritur ta hartojë jo vetëm për interesin e studiuesit të ngushtë të fushës, por edhe për një rreth të gjerë lexuesish, duke mos e rënduar në shtjellime të imta, por pa humbur asnjëherë logjikën e argumentit shkencor. Një vepër e tillë, e ciladel edhe si një sintezë e rezultateve të arritura në këtë fushë studimesh, sigurisht, nuk mund të merret me paraqitjen e tezave të shumta të studiuesve për probleme të caktuara dhe as me historikun e studimit të etimologjive të veçanta.

Në përputhje me karakterin e fjalorit, në të janë paraqitur etimologjitë më të pranueshme, që janë të mbështetura në fakte gjuhësore, qofshin këto edhe të tërthorta, duke lënë jashtë hipotezat e supozimet që nuk janë të argumentuara sa duhet dhe nuk gjejnë mbështetje në të dhëna gjuhësore.

I jepet prioritet çështjeve të tilla si territori fillestar i shtrirjes së elementit gjuhësor, shkaqet dhe veçoritë e përhapjes së tyre, përcaktimi i kronologjisë të përhapjes dhe marrjes së kuptimeve të reja, të cilat përbëjnë ndër karakteristikat themelore të metodës shkencore bashkohore në etimologji.

Gjithashtu, janë mënjanuar referencat e shumta për çështje

të veçanta në etimologjitë e disa fjalëve, për të cilat lexuesi i interesuar mund t'i gjejë në literaturën e përzgjedhur.

Një pjesë e mirë e analizave etimologjike mbajnë mirëfilli vulën e prof. Kolecit, duke sjellë qëndrime të reja, ose të pandeshura. Duke qenë se këtë promovim e bëjmë në Shkodër do të veçoja dy etimologji fjalësh:

Ban, Banë, emër i gjinisë femërore, në kuptimin banesë, kasolle, në fq.168 të fjalorit. Fjalë e gegërishtes, e vjetëruar. Karakterin gegë e dëshmon ruajtja e zanores -a- para sonantes hundore. Sikurse e dëshmon edhe mungesa e një trajte me zanoren -ë të theksuar në toskërishte, siç është në rastin bëj/ bën. Por mbi bazën e kësaj fjale janë ndërtuar shumë fjalë të tjera që janë bërë më pas si *banoj*, *banor*, etj.

Profesor Koleci e lidh etimologjikisht me foljen *baj*, ashtu si Çabej, ndryshe nga Majeri, Ëalde-Pokorni, Jokli e tjerë. Por sipas tij kjo formë *ban* nuk është pjesorja *ban*, por paskajorja që duhet të ketë pasur gegërishtja dhe mbarë shqipja, sepse ka qenë vetëm kjo formë e pashtjelluar foljore që ka krijuar emra. Sipas K.Topallit, nga një pjesore e shkuar pjesore *ba/bërë* është e pamundur të ndërtohen forma analitike më kuptimin e paskajores dhe përcjellores. Kjo bie në kundërshtim me ndërtimin e sintagmave parafjalore, të cilat mund të ndërtohen vetëm me emra, si rrjedhim edhe me forma foljore me karakter emëror, por jo me pjesore që kanë karakter të shkuar pjesor dhe tipare mbiemërore, prandaj kur janë formuar format analitike, elementi i dytë ka pasur kuptim emëror, siç ka ndodhur me formën e paskajores së gegërishtes e tipit *me ba*. Këtu evidentohen tri forma të pashtjelluara që duhet të kenë pasur një kuptim të tillë: Format me prapashtesën -ë, që reflektojnë rasën kallëzore, ku mbaresa -om > -on ka përfunduar në -ë. Këtë qëndrim që profesor Koleci e jep që në stidimet e tij mbi gramatikën historike reflektohen padyshim edhe tek analiza të tilla etimologjike, ku përveç kësaj fjale do t'i shtonim edhe plot të tjera si (*vdek-ë, vesh-ë, mbath-ë, rras-ë etj. që tregojnë jo vetëm koherencën në studimet e profesorit, por për mendimin tim, edhe etimologjinë më të saktë*). Prandaj tek shqipja, më saktë në dialektin verior të saj, ashtu si shumë gjuhë të tjera indoevropiane tek të cilat ndërtimi i paskajores përmban një parafjalë dhe formën themelore të foljes, funksionon dhe po ashtu e ka origjinën nga një paskajore e mirëfilltë, forma e tipit *me punu*.

Etimologjia e dytë që kam zgjedhur është Etimologjia e emrit zdrale, në fq.1650, që është ndër të tjera edhe një prej mikrotoponimeve në Shkodër, emër lagjeje. Prof. Koleci e analizon si një formim i brendshëm i gjuhës me parashtesën **z**, rrënjën **dra-** dhe prapashtesën **-lë**. Në gegërishte del edhe në trajtat tjera si **zdramë**, në kuptimin e plagës që i bëhet kafshës kur e vret samari. Të gjitha këto shpjegohen me rrënjën indoevropiane **der-**, e krahasueshme me greqishten *dero, derma*, lituanishten *dederv-inë*, apo sllavishten e vjetër *derp*. Pra, me një fjalë emri që e mban dhe lagjja pak më tutje nga e ka burimin nga një prej fjalëve të fondit të trashëguar indoevropian të shqipes, analizë etimologjike e pandeshur më parë.

Po ashtu shihet qartë se profesor Koleci ka lënë jashtë karakterin kritik e polemizues duke bërë që vepra të pasqyrojë tiparet e vetë autorit, qetësinë e fisnikërinë edhe në shkenca të tilla të ftohta, si gjuhësia me disiplinat e saj, si etimologjia në rastin konkret. Normalisht një Fjalor i tillë , nuk mund të dilte veçse nga puna me pasion dhe këmbëngulje, me durimin e pikës së ujit që shpon edhe gurin.

Ashtu siç thotë dhe vetë prof. Koleci, në këtë fushë asnjëherë s'mund të ketë gjëra të përsosura e zgjidhje përfundimtare; se problemet e pazgjidhura e çështjet e mbetura pezull do të vijojnë të plotësohen e të saktësohen në të ardhmen me shtimin e materialit gjuhësor e të literaturës shkencore, apo dhe me përsosjen e mëtejshme të metodave të punës dhe me bashkërendimin më të mirë të rezultateve nga fusha të ndryshme të gjuhësisë.

Por padyshim, në saj të kësaj filozofie gjuhësore prej së cilës është mbrujtur dhe metodikës së qartë dhe rreptësisht shkencore, vepra e prof. Kolecit, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, që pason dy veprat e tjera madhore, *Fonetikën historike* dhe *Gramatikën historike*, janë sot e kësaj dite, protagonistet kryesore në gjuhësinë historiko-krahasuese mbi shqipen.

▪ **Kritikë letrare** ▪

Ermira ALIJA

**PERSONAZHET FËMIJË TE MIGJENI NË FUNKSION
TË BELETRISTIKËS A UTOPISË SOCIALE?**

ABSTRAKT

Artikulli bën fjalë për rolin e personazheve fëmijë në veprën e Migjenit, rol që shihet në dritën e dilemës mes beletristikës dhe notave sociale. Duke gjurmuar komponenten estetike dhe duke e vënë atë në raport me komponenten sociale, si dhe duke e parë krijimtarinë mbi një metodologji ontologjike estetike e mbi koncepte semiologjike e strukturaliste letrare, artikulli përpigjet të argumentojë këndvështrime të reja duke tejkaluar të vështruarin dogmatik, por edhe duke plotësuar e thelluar mendimin më të mirë kritik shqiptar.

Duke realizuar këtë, mendojmë se ky artikull kontribuon në diskutimet aktuale për rishikimin e letërsisë në kuadrin e modelit të ri letrar, diskutime që synojnë ta pavarësojnë artin nga shikimi social i letërsisë, kontribuon në specializimin e studimit të artit si sistem autonom si dhe në rishikimin e vendit të protagonistëve të saj në të, një prej më të rëndësishmëve të të cilëve është Migjeni.

Shpeshherë, kur ndeshemi me dukuri të reja komplekse të letërsisë, përpigemi të kuptojmë thelbin e bukurisë, të cilën në fillim e perceptojmë si “nuk e di çfarë” dhe pastaj, përsëri ne si studiues, me aftësinë tonë interpretuese, (aftësi që ndryshon dhe zhvillohet së bashku me ne), duke ditur se shpirti e drejton frymën aty ku do ai, përpigemi të kuptojmë atë “nuk e di çfarë”. Kjo është një ndër arsytet që nuk ndihemi rehat me atë që është thënë, i kthehemi dhe i rikthehemi shkrimtarëve të mëdhenj, pasi mendojmë se kemi akoma të reja për të zbuluar tek ata, nganjëherë edhe u kërkojmë të falur se i kemi zvogëluar, përdorur, ndoshta edhe falsifikuar, dhe e gjithë kjo, mbase, ngaqë nuk i kemi kuptuar si duhet, por, meqë, siç thotë Stravinski, *dashakeqësia nuk ngurron asnjëherë ta përmendë injorancën*

si rrethanë lehtësuese”), atëherë është mirë ta luftojmë injorancën si aleate të dashakeqësisë.

Migjeni është përcaktuar si uragan dhe vërtet gjithkush që ka ndjekur zhvillimin e letërsisë shqiptare, ka kuptuar se uragani i tij ka rezonuar në gjithë letërsinë dhe e ka ridimensionuar atë me një portret krejtësisht të veçantë, të pa cekur më parë, ku shpesh kritika ideore nuk pa efektin e bukurisë. Por, do të ishte mëkat nëse artin e Migjenit do ta reduktonim në ide, të çfarëdolloji qofshin ato: përparimtare, revolucionare, komuniste, ateiste, demokratike etj. Ne kemi nevojë të shohim brenda bukurisë së artit të Migjenit, për të kuptuar emocionin që ngjall, kemi nevojë të kuptojmë ç’ bukuri ndien një fëmijë që nuk di ç’është mjerimi, kur zgjedh për të recituar “Zotni, zotni, të lutem zotni, ma fal një send”. Është fakt se një objekt i rëndësishëm i shkrimeve të Migjenit është mjerimi, objekt që parë në një këndvështrim të caktuar, nuk ka lidhje me të bukurën, përkundrazi, paraqet dukuri të shëmtuar, shëmti që shtohet kur gremis brenda saj edhe fëmijët, por shëmti që nuk pengon bukurinë e shkrimit, përkundrazi. Ky relacion i së shëmtuarës me të bukurën të kujton thënien e Kantit se .. *arti i bukur tregon shkëlqimin e vet pikërisht tek fakti se ai përshkruan në mënyrë të bukur gjëra ... të shëmtuara, ose të papëlqyeshme..**** A mund të themi se me këtë shkrimtar bukuria fitoi dinjitetin e vet të mëvetësishëm nga e mira dhe dija? ... Le të kujtojmë edhe prirjen graduale të letërsisë shqiptare drejt së bukurës, që vjen e fuqizohet gradualisht nëpërmjet përfaqësuesve më të mëdhenj të letërsisë së kësaj kohe: Fishtës, Mjedës, Koliqit, Kutelit e veçanërisht Poradecit. Gjithsesi, përgjigjja e kësaj pyetjeje nuk është objekt i punimit tonë, por është këndvështrimi i tij. Çështja jonë lidhet me pyetje të tilla, si: ç’bukuri krijon në veprën e Migjenit inkuadrimi i personazheve fëmijë? Ç’peshë kanë ata në poezinë dhe prozën e Migjenit? Personazhet fëmijë fuqizojnë elementët socialë, apo janë në funksion të bukurisë së krijimit?

Por nuk mund të mos konstatojmë se përgjigjet e këtyre pyetjeve i shërbejnë rishikimit të çështjes se nga anon letërsia e Migjenit: nga komponentja ideore (qëllimi social), apo nga komponentja estetike. Kështu, në mënyrë të tërthortë, i shërbejnë edhe rishikimit të letërsisë në këndvështrimin e modelit letrar dhe rishikimit të vendit të Migjenit në të.

*) Igor Stravinski: *Poetika muzikore*, “Asmus”, Tiranë, 2009, fq 12.

***) *Kanti i cituar tek Umberto Eco: Historia e bukurisë*, “Dituria”, Tiranë, 2011, fq 135.

Nëse vërejmë rolin e fëmijëve në objektivismin artistik të mjerimit nga Migjeni, shohim se skamja tek fëmijët paraqitet në thelb si fuqi madhore që përcakton cilësinë e “jetës së jashtme e të brendshme të tyre” qysh në bark të nanës, (kur ajo *prap shtatzanë mallkon Zot e dreq*), që vazhdon të përcaktojë mënyrën e jetës gjatë të qenit foshnja (që *qajnë si shpirt i keq*), kur vazhdojnë të rriten si fëmijë *rrugaça, lypësa, barkjashtë e me hundë të ndyta*, e kur *..shtrijnë duert e mpita...* e deri në destinacionin final kur *ashtu t’shtrime ... mbesin/ të tanë jetën e vet deri sa të vdesin*.

Duke pasur përpara një objektivism të tillë, është e vështirë të mos rrëshqasësh në këndvështrime sociale, është e vështirë që këto pamje të mos i shohësh si shfaqje të intencionalitetit në letërsi, por duke i parë këto fenomene nën një dritë të re, mund të themi se ky konceptim është rezultat jo thjesht i këtij këndvështrimi, por i faktit që gjithë letërsia e viteve ’30 në Shqipëri, (që kishte përshkuar drejtime dhe rryma letrare për një kohë relativisht të shkurtër në krahasim me simotrat e saj), reflekton perëndimin e ideve të Humanizmit dhe Rilindjes lidhur me mundësinë e krijimit të një bote të paqtë e të harmonishme, e cila ndien se zhvillimi i shoqërisë shoqërohet me krizë, që zbulon se *ligjet qiellore nuk u përmbahen harmonive të thjeshta klasike, por kanë nevojë për një kompleksitet gjithnjë e më të madh dhe se përparimi i shkencave sjell zbulimin e ca harmonive më të ndërlikuara dhe më shpirttrazuese se zakonisht.... që përparimi i njohjes së botës e heq njeriun nga qendra e saj dhe e flak në një pikë çfarëdo të rrethinës së gjithësisë të krijuar nga Zoti**.

Ndoshta, duke e parë kështu, mund ta interpretonim bukurinë e artit të Migjenit si bukuri të dhembjes së flakjes të qenies (*t’kenit*). Dhembja e mohimit, e një mohimi shumëplanësh përcillet nga një pjesë e madhe e personazheve të rritur të Migjenit, të cilët ai i quan *vullnete të ndrydhuna, vullnete të shtypuna*; Mjafton të kujtojmë: tridhjetëvjeçarin e papunë që don të nxitojë, por s’ka se ku, (askush *s’e do djersën e tij*), përgjigjen “*Zoti të dhashtë*” të celulave të ndryshme të shoqërisë ndaj lypësit, pyetjen: “*A do qymyr, zotni?*” të malësores së bukur, monologun e lypësit “*Në kishë*”: *si do të jetoj unë, këtë kurrë s’ma the, etj.*

Futja e personazhit fëmijë në kuadrin e mjerimit, i jep dhembjes përmasa tejet interesante. Ky personazh ndihmon të ndriçohet

*) Umberto Eco: *Historia e bukurisë*, “Dituria”, Tiranë, 2011, fq. 215.

deri në skutat më të thella të qenies dhembja e mohimit që tek fëmija shfaqet edhe në mënyrën si ngjizet ...me *epshin kapërthyes kur mbytet vetvetja*, edhe në mënyrën se si e ndjek gjithë jetën duke i përsëritur në forma të ndryshme se *nuk asht as bira e mbrame e kavallit*.

Asnjë figurë tjetër nuk mund ta bënte dhembjen më të thellë dhe më komplekse sesa personazhi fëmijë. Asnjë figurë tjetër nuk mund të joshte me bukurinë e dhembjes aq sa ky personazh. Ndoshta kjo lidhet me faktin se Migjeni ka guxuar që edhe nëpërmjet këtij personazhi të eksplorojë honet e efekteve të së keqes atje ku ajo ka qenë gjithnjë tabu: te familja, nëna, morali apo besimi. Në lidhje me këtë Bodler thotë: *E bukura është gjithnjë e çuditshme. Nuk dua të them që është vullnetarisht, me arsye të ftohtë e tillë, pasi në një rast si ky do të ishte një përbindësh që del nga binarët e jetës.*^{*)}

Gjithashtu mund të themi se nga njëra anë, personazhi fëmijë i jep përmasa të përbindshme mjerimit në veprën e Migjenit, por nga ana tjetër, përshkrimi i mjerimit është refleksion i “dhimbës” së Migjenit, të cilën ai vetë e përcakton si: .. *dhimbë krenare e shpirtit që vuen/ dhe shpërthen ndër vargjet e lira...*”, kurse ne mund ta përkthejmë si vuajtje nga ndjeshmëria karshi së vërtetës që shpaloset vetëm përpara shikimit të poetit dhe pezmit të fortë qytetar e civil të tij,^{**)} kështu që mund të themi se raporti i pezmit si mjet apo si intencion social është si raporti “veza-pula”, një raport i ndërlikuar.

Fëmija te Migjeni është figurë që plazmohet në mënyra dhe forma të ndryshme. Po t’i referohemi përdorimeve të saj në krijimtarinë e Migjenit, kjo gjë mund të na ndihmojë për të kuptuar më mirë konceptimin artistik të tij, raportin e koshiencës e subkoshiencës të Migjenit në krijimtari. Kështu, në një poezi, Migjeni i përshkruan të mjerët si: *“fëmitë e jetës së vorfën”*, gjë që të bën të mendosh se fëmija shikohet si produkt, si fryt, apo si pasqyrë e një realiteti të caktuar. Nga ana tjetër, (p.sh.: në poezinë për rininë), kur shkruan *“qeshu si fëmi”* ..., duket qartë se fëmija shikohet në këndvështrimin e qenies më të pafajshme dhe më të pastër të botës. Duket se mbi bazën e këtyre dy këndshikimeve të bazuara në marrëveshje të gjata dhe të mirëkuptuara psiko-

*) Bodler, cituar në Umberto Eco: *Historia e bukurisë*, “Dituria”, Tiranë, 2011, fq. 331.

***) *Po aty*, fq. 53.

sociale, Migjeni (apo lexuesi?) ndërton intencionin: fëmija është (apo lexohet?) si pjesë e metonimisë së përgjithshme, si shfaqje e pasojës për shkakun, e pjesës për të tërën, e konkretes për abstrakten, gjë që përcjell një lloj intencioni social që i thënë thjesht mund të merret: Qenia më e pastër dhe më e pafajshme e shoqërisë bëhet pasqyra e viktime e saj. Nga ana tjetër, në mënyrën sesi operon Migjeni me të, figura e fëmijës përveçse subjekt, është edhe objekt, përveçse protagonist, është edhe pjesë e peizazhit. Beletristikë apo qëllim social?

Është interesant edhe fakti që në rekuizitën e peizazhit, ndjeshmëria e Migjenit për fëmijën shkrihet në një trinom me ndjeshmërinë e tij për dritën dhe ngjyrën, tipar tjetër sa klasik, aq edhe modern i letërsisë. Kjo gjë sikur vë më shumë në pah bukurinë e tablosë me gjithë detajet që duket se presin gjithnjë për t'u shijuar, apo kuptuar edhe një herë. Kështu, e bardha, e kuqja dhe e zeza janë ngjyrat që autori përdor tek *"Bukuria që vret"*: I kuq asht zjarrmi i votrës, gjaku dhe rubini; i zi rrethi, të zeza skutat; e bardhë asht bora, agimi dhe shtatorja e ftohtë. Jeta në kasolle kristalizohet duke ngjyrosur relievin e skicës së Migjenit me ngjyrën e bardhë, të kuqe e të zezë, shumë domethënëse për çdo artist, ndoshta pak më shumë për shqiptarët. Prekja e rrethit të zi me qendrën e zjarrit të kuq dhe me të kuqen e gjakut të fëmijës që në terrin e të zezës kthehet në rubin brenda shtatores së bardhë, zgjon qindra fantazi Ky përshkrim i ambientit, hapësirës e kohës plotësohet në krijimtari përmes *jeshiles së syve që ndjekin, errësinës së skajeve e hijeve të shtëpive të nalta, të mykut të pecave, të së verdhës të mishnave, dangave e njollave dhe të lustruemeve të faqeve me të cilat fëmijët mësohen të jetojnë ("Parakalim vjeshte")*.

A është rastësi fakti që Migjeni i vendos personazhet e tij, veçanërisht fëmijët, në terr, kur drita përkufizohet si *sendërtim në varësi të qëndresës së ndryshme që i bën asaj lënda* *)?

Shpesh personazhet fëmijë të Migjenit nuk sendërtohen nga raportet me dritën, por tek ai... *ngjyrët e verdha losin në vallen e fundme të vjeshtës ... me gema të thamun*.

Nga ana tjetër në krijimet e Migjenit, realiteti i *mrudhtë* e shndërron personazhin fëmijë herë në hije e herë në shtatore (zhgulun nga gjini i nanës), herë në përmendore kushtuar *atij që ka ma shumë merita*, herë në rubin.... Herë e koncepton personazhin si *tokë e*

*) *Umberto Eco: Historia e bukurisë, "Dituria", 2011, fq. 127.*

plleshme ku fara dosido e hjedhun zen dhe ep fryt, herë si koncept abstrakt dhembjeje, përuljeje e nganjëherë edhe thjeshtie deri në madhështi.... E të gjitha këto duket se luajnë mes kufijve të trillit të imagjinatës dhe intencionit, pa prekur asnjërin skaj, por duke ruajtur një potencial shumëshresor të ndërlikuar të interpretimit. E përsëri beletristikë apo qëllim social?

... Askush s'e njih Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njofin. Ma mirë me thanë se e njofin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap të vet. ... Kur Luli hyn në oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, por askuj asnjë fjalë s'i thotë. Ecën ngadalë, tue shikue djathtas e majtas, por gjithnjë tue ecë, deri sa të mrrijë në cak të vet.... Mbështetet Luli për mur, grushtat e vegjël i shtje ndër xhepa, hundën picrrake të skuqun nga të ftohtit e mëngjezit ja sjell diellit dhe shikon

(“Luli i vocërr”)

Në krijimet e Migjenit, fakte të mundshme reale marrin përmasa mjeruese e vetë mjerimi kalon përmasat shoqërore e kthehet në një përmasë filozofike, etike dhe antropologjike. E, këtë që s'mund ta bëjë asnjë filozofi, e realizojnë shpesh personazhet fëmijë vetëm me pak rreshta:

- Ati i ynë, që rri.... – shqyptonte nga një rrokje e ama e Lili përsriste....

- Bukën tonë të përditshme jepna sot – vazhdonte e ama uratën. Mbas këtyne fjalve të përsrituna Lili mbet:

- Bukë të bardhë, nanë, ihaa qysh kur s'kena hangër! – dhe çoi kryet me ja pa ftyrën s'amës.

....Lili kish qitë kryet nga mbulesa dhe me sy xixëllues shikonte t'amën. Mezi e njofti.... Lili shikonte t'amën me admirim fëminor, gati ishte të rrahë shplakë nga gëzimi. Por kur i foli kjo serjozisht për ardhjen e një zotnisë në dhomën tjetër, ai s'bani za; si duket e kuptoi randësinë e çastit. U shtri ratë, u mbulue, u struk, u mblodh dyfish si krymbi dhe me sy të mbyllun shifte nanën aqë bukur të veshun e të guditun....

(“Bukën tonë të përditshme falna sot”)

Migjenin e karakterizon një mprehtësi dhe forcë fraze që po aq sa ngjan me disa prej karakteristikave stilistike të gjigandëve të letërsisë sonë (stilit bubullues të Fishtës, simboliko-alegorik të Mjedës, ironik e satirizues të Konicës, shumëshresëzues të

Koliqit, i detajit të hollë të Kutelit...) po aq i veçantë është në individualitetin e vet. Këtë ai e realizon nëpërmjet një raporti krejt vetiak të asaj që sheh, me atë që ndien dhe thotë, jashtë përsosjes morale, përkundrazi brenda së shëmtuarës e joharmonikes. Në këtë kuadër, ai bëri brumin e vet poetik me një grup të madh fjalësh të “shëmtuara” të leksikut shqiptar, të cilat më përpara kishin qenë rekuizitë në letërsi: kafshatë, kapërdihet, mjerim, opinga, peca, mejhane, potera, dobiça....

Te Migjeni kërcitja që ndihet nga e çara që merr emërtimi tradicional simbolik si zanafillë e ironisë, si shenjë zbrazëtire e ngurtësie, bazë strukturore e letërsisë moderne, realizohet përmes gjuhës naive të fëmijës:

- Pse martohet Agia? - pyet një shok vllanë e vogël, shtatëvjeçar, t’Ages.

- Baba ka thanë, - përgjigjet ky.

- Sa i marrë je ... Uf ... E di, more, se ka thanë baba, por pse martooohet?

- Po edhe nana e eme asht martue, edhe nana jote.

- Po, more, po! Uf... Por pse martooohet?

- Për me fjet me burrin - ja pret një shok i tretë, pak ma i rritshëm, nja nand vjeç.

- Po si ... Ku e din ti? - thot i vllau i Ages.

- Po, fort! Edhe nana e ime flen me babën tim - ja priti shoku i kureshtshëm.

- Mos folni fjalë të këqia, se po ju padis në shkollë - iu kërcënue nandëvjeçari dhe shkoi me gjuejtë ndoj gja për me ambëlsue gojën.

(“Studenti në shtëpi”)

Te Migjeni, shpesh mbas paraqitjes herë statike, herë blasfemuese, herë rebele e herë kontemplative të personazheve fëmijë, fshihen shtresëzime të ndërlikuara që nuk reduktohen në përmasa sociale. Ndoshta kjo është një ndër arsytet që Arshi Pipa e quan Migjenin idealisti që vdes i pakuptuem. Kështu, shumica e personazheve fëmijë, qoftë kur bëhen protagonistë, ose jo, ndikojnë në krijimin e tensionit të brendshëm nëpërmjet polivalencës, shtresave semantike që tejkalojnë simbolikën dhe rreshtojnë larmi asociacionesh befasuese:

Zeneli me sytë e tij të gështejtë, të përçëndruem mendueshëm

ndër sytë e mij.... Flet me ballë pak të rrudhun në mes të syve... Nganjihërë – ashtu tue folë – e tradhëton Zenelin fantazia fëminore, i hypë kalit imagjinar me flatra dhe fluturon nga reja në re, - por me të vumun re buzëqeshjen time, kujtohet... Nganjihërë, rrallë, i mbushet mendja Zenelit dhe thotë: s'dij Zotni.... Nganjihërë, gjithashtu rrallë, i futet Zenelit gëzimi fëminor mu në zemër, asgjasend e ban të qeshë... dhe nuk ndihmojnë as qortimet as interesi i mësimit. Mue atëherë më bahet se edhe më tall edhe më qorton...: mjaft ma, zotni mësues, mjaft na mësuet si duhet me jetue, cka asht mirë e bukur, - megjithatë na po rrojmë si rrojtën stërgjyshnit tanë, po në ato gëzime e po në ato mjerime, të lanun e të tretun ndër këto bjeshkë...

(“Zeneli”)

Kjo dukuri ndoshta e ka bërë edhe kritikën e mëparshme të mos jetë indiferente ndaj personazheve fëmijë në veprën e Migjenit, përderisa studiuesi Bala konstatonte se “... shkrimtari krijoi një galeri tipash të fëmijëve, të cilët nuk qëndrojnë pas tipave të burrave dhe grave të portretizuar në prozë dhe në poezi”.*

Nuk mund të ndahen në artin e Migjenit bukuria e dhembjes (*klithma e tmerrshme*), a riprodhimi i bukur i së shëmtuarës (shtatorja e bardhë) me nuancat sociale. Edhe atëherë kur gjuha e Migjenit është e drejtpërdrejtë, si: “*Merreni këtë shtatore e si dhuratë çojani dikujt...*”, përsëri nuk mund të gjykojmë për një anim të thjeshtë nga propaganda sociale a letërsia qëllimore. Për ne, ekzistenca e fjalëve të tilla e tejkalon deklarativizmin dhe propogandën sociale. Ajo paraqet një çështje më të ndërlikuar, që lidhet jo thjesht me organizimin e cilësitë e jetës njerëzore, bile as përmendja e perëndisë klasike nuk na çon thjeshtësisht tek ateizmi, por tek ajo që përmendëm në fillim të punimit: loja e fatit njerëzor, tek flakja e njeriut nga qendra në çfarëdokundin e gjithësisë, ose thënë ndryshe ajo na çon në spiralet e ciklit jetësor që Hamleti i Shekspirit i pa në një formë tjetër: Të rrosh a të mos rrosh.

Kritikë të kohës këndvështrimin e krijimtarisë së Migjenit e kanë lidhur me një sërë motivesh të brendshme të tij: ... *si rrjedhojë të hovit të ndjenjës ...* (Dh. Shuteriqi, Përpjekja shqiptare, 1938, fq. 400); *si rrjedhojë e melankolisë së natyrës e sëmundjes së tij, si simpati që e afron kah kta të dënuem, kah kto viktima të shoqnis, si preferencë antitradicionale, si hapje e portave të letërsisë ndaj*

*) *Vebbi Bala: Migjeni, Portret-Monografi, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1974, fq.96.*

problemeve sociale (Arshi Pipa, Për Migjenin, ese, fq 7, 33, 55, 59). Pa kërkuar t'i analizojmë apo t'u gjejmë një emërues të përbashkët interpretimeve, ato luhaten mes inspirimit social dhe caktut të të shkruarit të poezisë ... për hir të poezisë.

Ne mund të themi se kaq i brendshëm është karakteri social i krijimtarisë së Migjenit, saqë ai aludon për veten: *poet gabimisht i inspiruem*. Kjo gjë që na bën të mendojmë se karakteri social i krijimtarisë së Migjenit është jo i kërkuar, por i vetvetishëm. Nga ana tjetër, brenda vetvetishmërisë së tij nuk mund të përjashtohen ndikime a intencione të ndryshme sociale, që janë pjesë të asaj vetëdijeje që ai vetë i emërton *brenga* dhe *prush përvoëlues*, i quan shkaktarë të *frymzimit* të vet të *pafat/ që e djeg mu në gji*. Pjesë e kësaj vetëdijeje është edhe nevoja e lirisë së shprehjes në vargje që ai i quan "*Vargje të lira*" dhe me të cilat emërton botimin e vet. Nëse do t'i referohemi edhe pikëpamjeve teoriko-estetike të Migjenit të shprehura në një letër dërguar redaksisë së revistës "*Bota e re*", por që nuk u botua në këtë gazetë, do të vëmë re se ai shkruan: "... kryesorja në gjithë artin është artistikja, që me të drejtë të pakompromis të zbulojmë esencën shoqërore, morale e psikologjike të jetës intime, të njerëzve dhe të marrëdhënieve të tyre, që artin do ta pasuronte shpirtërisht dhe estetikisht. Se arti është i drejtë domosdo duhet të jetë edhe ideor.*)

Nga ana tjetër Migjeni përsëri shkruan: "Tashma është krejt e painteres që lexuesi të lidhet me farë formulash ideore, apo nuk guxojmë që te ai të ngacmojmë këtë reaksion ideor në mënyrë emocionale, përmes transformimit artistik, se këtu nuk ndihmojnë as mendimet dhe as qëllimet e mira, as deklaratat humane, as frazat e larta mbi "dobinë" ... Arti ka nevojë për shpërndërrime të ndjenjave, të nervave.**)

Pikëpamjet estetike të Migjenit i rrinë besnike shprehjes së artit të tij. Në thelb, ai i jep një rol të jashtëzakonshëm artistikes, stilin nuk e merr si instrument të mendimit dhe mendon se ideorja duhet të dalë nga artistikja.

Gjithsesi fuqia shprehëse e Migjenit shkon përtej logjikës dhe elementeve sociale, sepse paraqet thelbin e dobësisë dhe të pafuqisë njerëzore. Prandaj Migjenin e quajmë edhe modern, sepse bukuria shprehëse e tij rëndon në stil dhe jo në utopinë sociale. Nuk mund

*) Ibrahim Rugova: *Kab teoria*, "Faiik Konica", Prishtinë, 2005, fq. 95.

***) Ibrahim Rugova: *Po aty*.

të ketë qenie njerëzore pa ekzistencën e një farë mjerimi! Forca stilistike e tij dhe mençuria shprehëse, të kujtojnë fjalët e Floberit mbi raportin mes së vërtetës dhe të bukurës, për të cilin thoshte: (1868): “.. nuk ka as tema të bukura e as tema të rëndomta. Madje mund të thuhet në formë përcaktimi të palëkundur, duke i parë gjërat nga këndvështrimi i artit të kulluar, se tema nuk ekziston, pasi vetëm stili është një mënyrë absolute e të parit të gjërave.”*)

Siç duket, duhet të pajtohemi me mendimin e Rugovës, që thotë se është gjykuar gabim Migjeni, kur është folur për karakterin social të veprës së tij dhe duhet të cilësojmë se në një lloj mënyre Migjeni solli në letërsi estetikën e shkatërrimit: të shkatërrimit të idesë të së mirës duke sjellë në letërsi idenë e së keqes, apo të së shëmtuarës; Migjeni shkatërroi simbolet e mëparshme poetike ekzaltuese të malit, malësorit, torbës e malit dhe i risolli me domethënie të kundërta, duke i shërbyer me këtë shkëputjes së letërsisë nga propoganda, çlirimit të saj nga misionet e tjera dhe kthimit të letërsisë drejt autonomisë si sistem letrar-artistik.

Pavarësisht se folëm mbi disa të vërteta relative, nuk mund të mos përmendim se duke folur për bukurinë e artit të Migjenit, ne përpiqemi të zbulojmë bukuritë dhe t’i emërtojmë ato, por në këtë mënyrë rrezikojmë humbjen e thellësisë dhe gjerësisë së abstraksionizmit që është i sigurtë vetëm në forcën stilistike shprehëse të gjeniut.

Nëse i referohemi mendimit letrar që u ka rezistuar shekujve duke kujtuar thënien e Aristotelit se tragjedia, duke paraqitur ngjarje të tmerrshme, duhet të ngjallë në shpirtin e shikuesit përdëllim dhe frikë dhe të pyesim se ç’sjell përshkrimi i shëmtisë tragjike të mjerimit tek ne? Ndoshta mund të përgjigjemi se ai ngjall më shumë se përdëllim dhe frikë: ngjall rezistencën që ka fituar shoqëria njerëzore ndaj së shëmtuarës, por edhe frikën karshi saj, ndjesinë e së bukurës që shkon përtej kufizimit njerëzor gjithnjë të deritanishëm dhe hovin e pasionit të një mendimi të thellë që kërkon identifikim të ri. Dhe këtë identifikim e kërkon në rrënjët e një qytetërimi të lashtë që shkon në thellësi të kohërave, aty ku e kishin burimin muzat shqiptare..... aty ku siç duket Migjeni ynë donte të gjente *fillin e një hymni, që Ilyri e vjetër ndër kremtime këndonte.....*

*) *Flober i cituar nga Eco Umberto: Historia e bukurisë, Dituria, “Tiranë”, 2011, fq 340.*

BIBLIOGRAFI:

- Bala, Vehbi: Migjeni. Portret -Monografi, “Naim Frashëri“, Tiranë, 1974.
- Berisha, Anton Nikë: Çështje teorike të letërsisë, “Faik Konica”, Prishtinë, 2005.
- Eco, Umberto, Historia e së bukurës, “Dituria”, Tiranë, 2011.
- Grosser, Hermann: Questioni e strumenti, “Principato”, Milano, 1992.
- Hamiti, Sabri: Vetëdija letrare, “Rilindja”, Prishtinë, 1989.
- Kadare, Ismail: Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe, “8 Nëntori”, Tiranë, 1991.
- Morelli, Guglielmina; Sangalli, Roberto: Il racconto, “Mursia”, Milano, 1994.
- Peruzzi, Walter; Manazza, Anna; Naja, Silvia: Dalla fabula alla forma, “Bompiani“, Milano, 1992.
- Pipa Arshi, Kritika (esse 1940-1944), “Princi“, Tiranë, 2006.
- Rrahmani, Zejnullah: Leximi dhe shkrimi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2003.
- Rugova, Ibrahim, Kah teoria, Faik Konica, Prishtinë 2005
- Shuteriqi, Dhimitër: “Arti i Migjenit”. Rev. “Përpyekja shqiptare”, nr.18-24, Tiranë, 1938.
- Stravinski, Igor: Poetika muzikore, “Asmus”, 2009.
- Treré, Sante; Gallegati, Graziella: Strumenti, per una analisi testuale, “Bulgarini“, Firenze, 1995.

▪ Histori&Arkeologji ▪

Helidon SOKOLI

FORTIFIKIME MESJETARE NË RAJONIN E SHKODRËS

Sistemet fortifikuese të periudhës Bizantine nuk arritën të frenojnë inkursionet e fiseve avaro-sllave në shek. VI-VII^{*)}. Si shkak shumë qytete dhe kështjella u shkatërruan, por disa të tjerë arritën ti bëjnë ballë vales se dydjeve, ndërsa të tjerë u ringritën në periudhën e mesjetës së mesme duke u kthyer në qendra të rëndësishme administrative të Bizantit e në shek.XIII-XIV në qendra të principatave shqiptare.

Ajo që i dha hov të ri ndërtimit të fortifikimeve apo rindërtimit të atyre më të hershëm ishte ndarja e re administrative-ushtarake e Temës së Durrësit shek.IX-X e cila përfshinte të gjithë territorin e Shqipërisë duke arritur kulmin e tyre në shek XII-XV. Qytete si Shkodra, Danja, Sarda, Lezha, Durrësi, Kruja, Berati lulëzuan dhe u zgjeruan në aspektin ndërtimor mbrojtës të tyre, e po ashtu hov morën një seri kështjellash të tjera të vogla përmbi maje kodrash, shpatësh apo mbi lugina që kontrollonin rrugët tregtare apo vendkalime.

Fortifikimet mesjetare mund të ndahen në qytete të fortifikuara, kështjella të feudalit lokal, vendqëndrim garnizoni dhe kullë apo pike vrojtimi. Muret në fortifikimet mesjetare kanë një gjërësi që varion nga 1 deri në 4 m, por kryesisht shumica e tyre shkojnë nga 1 m, deri në 2,50 m. Duke përjashtuar muret me gjërësi deri në 1 m, pjesa tjetër e tyre përforcohen me breza druri të futur në brendësi të mureve për të rritur fuqin e tyre antisismike duke i dhënë murit elasticitet ndaj goditjeve. Në shek.XIV-XV teknika

*) S.Anamali. "Antikiteti i vonë dhe Mesjeta në kërkimet shqiptare. Iliria IX.1979-80

perparon duke rritur lartësinë e mureve deri në 10 m, a më tepër dhe përfundonin në pjesën e sipërme të tyre me një parapet të pajisur me bedena. Ndërsa kullat në fortifikimet mesjetare i ndeshim në forma të ndryshme planimtri ke si, katërkëndëshe, trekëndëshe, rrethore, poligonale në varësi dhe të relievit ku janë ngritur dhe hapësirës në shërbim të tyre.

Kalaja e Shkodrës. Ndodhet në jugperëndim te qytetit të Shkodrës, në pikën ku bashkohen lumenjtë Buna dhe Drin. Ajo është e vendosur mbi një kodër shkëmbore rreth 134 m, mbi nivelin e detit. Mendohet të jetë banuar që nga epoka e Bronzit të hershëm. Trakte muresh të periudhës së fundit ilire ruhen në hyrje të kalasë mesjetare^{*)}. Gjatë periudhës së mesjetës së hershme të dhënat për kalanë e Shkodrës janë të pakta. Nga kjo periudhë ruhen vetëm disa trakte muresh dhe kemi gjetje kryesisht qeramike dhe pak monedha. Kalaja e Shkodrës formën e plotë që ka sot e merr rreth shek.XIII-XV. Muret rrethuese të saj formojnë një planimetri të çrregullt në varësi dhe të relievit. E gjithë sipërfaqja e fortifikimit ndahet në tre oborre që kanë mes tyre mure të trasha dhe që komunkojnë mes tyre me anë të portave. Oborri i parë lidhet direkt me hyrjen kryesore. Hyrja është e vendosur në pjesën verilindore të kalasë. Ajo është e ndërtuar brenda një sistemi të fortifikuar që njihet si barbakani. Mes barbakanit dhe portës së dytë ka një oborr të vogël ku bien në sy dy kënde muresh të dalura dhe një linjë paramuresh që komunikon me hyrjen nëpërmjet një porte të vogël me qemer njëfish. Përveç hyrjes kryesore, kalaja ka edhe disa hyrje të vogla që shërbenin për manovrimin e forcave në raste rrethimi apo si dalje sekrete. Venecianët kanë kryer punime të veshjes së kullave dhe nën këto veshje ka ndërtime që i përkasin periudhës kur sundonin Balshajt. Nga ana perëndimore e kalasë, sipërfaqe të pjerrëta të kodrës shkëmbore janë veshur me gurë të skuadruar. Aty ku veshja e mureve nuk është bërë, dallohen teknikat e vjetra me vendosje copa tullash mes gurëve, ndërsa harqet e dritareve dhe frëngjive janë punuar me tulla të rrethuara me bordurë. Kullat kanë forma rrethore dhe katërkëndëshe, në një lartësi 12-20 metra. Ato janë më të larta në anën e jashtme dhe përbëhen nga një kat i mbuluar me qemer dhe tarraca me parapet të dhëmbëzuar. Hyrja në ambientet e kullave bëhej përmes një

*) *Gj.Karaiskaj.5000 vjet fortifikime ne Shqipëri.Tiranë 1981*

porte të hapur në murin e tyre të prapmë, ndërsa lidhja me tarracën bëhej përmes shkallësh të brendshme që përfundonin në tarracë katrore me mur anash, ose me shkallë të jashtme guri. Oborri i dytë është më i madhi i të gjithë Kalasë. Ka patur karakter ndërtimesh shoqërore si sterat e ujit, burgu dhe objekti kultit në origjinë, katedralja e qytetit e shek.XIII dhe më vonë pas pushtimit osman kthyer në objekt i ritit islam duke shërbyer si xhami deri në shek.XIX. Kalaja e Shkodrës, me muret dhe kullat e saj të fuqishme, arriti të përballojë dy rrethime të gjata dhe bombardime me artileri të osmanëve në vitin 1474 dhe 1478-79. Në oborrin e tretë ngrihet ndërtesa tre katëshe e Kapitenerisë, tipike e periudhës së dominimit Venedikas të shek.XV.




Planimetria e re e Kalasë së Shkodrës matur me GPS dhe TST. Misioni Arkeologjik Shqiptaro-Polak, 2011.

Kalaja e Drishtit ndodhet në verilindje të Shkodrës, mbi një kodër shkëmbore me një mbrotje të fuqishme natyrore, ku përveç faqeve të kodrës me pjerrësi të madhe ka si mbrotje dhe lumin Kir që e rrethon nga Veriu dhe Perëndimi. Nga dokumentet kishtarë Drishti përmendet qytet seli ipeshkvënore që në shek.IX. Në dokumenta përmendet shtëpia e Peshkopit në 1251. E ngritur mes këtij peisazhi natyror Kalaja plotëson një nga kushtet kryesore për të qënë një fortifikim mesjetar^{*)}. Muri rrethues i qytetit të Drishtit zë një sipërfaqe më të madhe po ta krahasojmë me Shurdhahun, rrethimi i sipërm është më

^{*)} Th. Ippen, *Denkmäler verschiedener Alterstufen in Albanien, Eissenschaftliche Mitteilungen.*

i vogël dhe nuk krijon ndarje të sipërme të qytetit por është vetëm Keshtjella siç është rasti i Danjës. Muri rrethues i Drishtit përshkrohet nga dy hyrje njëra nga lindja dhe tjetra nga perëndimi, ndërsa kështjella nga një hyrje e vetme që përshkron faqen anesore të një kulle drejtkendore. Ashtu si dhe në rastin e Shurdhahut edhe në Drisht shohim po atë tip kullash të vogla gjysmerrethore^{*)}, po atë teknik ndërtimi me mure të holla pa breza dhe me shtegun e rojeve që krijohet nga platforma druri të mbështetura mbi trarë të dale konsol. Në Kështjelle që ka formën e një katërkëndëshi, dallohen disa faza ndërtimi^{**)}. Të katër kullat e saj dallohet që kanë parë nga ana e brëndshme e Kështjellës, pasi muret periferik janë ngritur mbi një humner të thepisur. Në fillim Keshtjella ka patur tre kulla mbrojtëse dhe më vonë në një kohë të dytë është ngritur një kullë tjetër gjysëm rrethore dhe kjo është e evidentueshme nga teknika e ndërtimit të kësaj të fundit që ndryshon nga të parat. Gjithashtu një nga kullat katërkëndëshe është veshur me një kemishë rrethore dhe në përgjithësi të gjitha kullat janë, dhe kanë qenë të veshura në pjesën e poshtme nga mure që bien pjerrtaz mbi terren, siç duket për ti shtuar mbrojtjen. Njëra nga kullat katërkëndëshe, që ka qenë rrënuar me parë si duket, dhe më vonë është rindërtuar por këtë radhë me gurë të latuar mirë. Nga teknika e ndërtimit është e dukshme se i përket periudhës veneciane (1396-1478)^{***)}. Kjo kullë dhe ajo e hyrjes janë paisur me frëngji të vogla. Territori brenda Kalasë ka qenë banuar intensivisht në mesjetë.



Planimetria e Kalasë së Drishtit, P. Pushimaj IA Tiranë, 2014

Kalaja e Sapës. Dioqeza e Sapës ka një histori 950 vjeçare dhe ndodhet brenda qytetit me të njëjtin emër. Dioqeza e hershme kishte një sistem të fortifikuar mbrojtës që njihet si Kalaja e Sapës

*) K. Jireček, *Skutari und sein Gebiet im Mittelalter*; në Ludwig von Thallóczy (ed.), *Illyrisch-Albanische Forschungen*, 1916.

**) M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens, hauptsächlich während des Mittelalters*. Wien Hölder-Pichler-Tempsky, 1924.

***) A. Meksi, *Arkitektura mesjetare në Shqipëri (shek. VII-XV)*, Tiranë, UEGEN, 2004.

(Foto 1). Ky fortifikim bashkë me rrënojat e qytetit brënda saj ngrihen në lartësinë 520 m mbi nivelin e detit në rrëzë të malit të Shatit ose siç njihet ndryshe si mali i Nënshatit. Sot edhe pse ka një vegetacion të dendur mund të arrish të evidentosh muret rrethuese dhe rrënojat e banesave. Porta nga ana jugore e fortifikimit ruan vetëm portikun me gjerësi 2,5 m. Muret më të ruajtura arrijnë deri në lartësinë 3 m. Mbetjet e murit rrethues mund të ndiqen me sy të lirë dhe vërehet se muri është i ndërtuar me gurë mesatare e të lidhur me llaç. Brënda rrethimit gjenden struktura banimi që ruhen deri në lartësinë 30-40 cm. Në lindje të rrethimit ruhen ende sot rrënojat e kishës së Shën Mhillit. Ky objekt kishtar me përmasa 11,5 x 6,5 m ruhet deri në lartësinë 1,5 m, ndërsa diametri i absidës arrin 3,5 m. Ngjitur me kishën ruhet ende një strukturë banimi me gjerësi muresh 60 cm dhe që arrin lartësinë 80 cm. Terreni brenda fortifikimit ka vende-vende qeramike mesjetare të fragmentuar. Nëse flasim për qytetin mesjetar të Sapës, ai përmendet për herë të parë nga Annuali i Selisë së Shenjtë që në vitin 1062^{*)}. Qyteti ngrihej rreth 50 m pa mbërritur në majën e Malit të Shën Mhillit sot i Nënshatit në një terren tarracor dhe mbrojtje natyrore të sigurtë ndaj sulmeve. Në 1292 qyteti pëson shkatërrim nga inkursionet tartare në Ballkan në këtë kohë. Vetëm në vitin 1491 do rindërtohej një pjesë e Kalasë dhe qytetit, dioqeza e të cilit tashmë ishte zgjeruar dhe me Ipeshkëvit e Danjës dhe të Sardës të shkatërruara në këtë kohë nga invazioni osman^{**)}.

*) *Acta et Diplomata res Abaniae Mediae Aetatis illustrantia. Thalloczy, Jireček, Shuflyay. Volum I Annos 344-1343*

***) *G.Valentini. Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë.1060-1560. Plejad, Tiranë, 2010.*



Foto 1. Fortifikimi mesjetar i Sapës

Kalaja e Dejës, Danja. Kështjella del gjërisht në dokumentet mesjetare të shek. XIV-XV si *Dagnum* (Foto 2). Duke qenë e pozicionuar në kryqëzim rrugësh tregtare si ajo Shkodër-Lezhë dhe Shkodër-Prizren, qyteti ishte i pajisur dhe me zyrë doganore. Rëndësia e saj doganore u bë shpesh mollë sherri mes Balshajve dhe Raguzanëve. Ishte Gjergj Strazimir Balshaj që e dorëzon qytetin tek Venecianët në kohën kur sundimtar i kështjellës ishte Kojë Zakaria "*Dominnus Sabatensis et Dagnensis*"^{*)}. Skënderbeu arriti ti marrë me force venezianëve këtë kështjellë për ta dorëzuar sërish në 1448^{**)} kundrejt 1400 dukatësh që do merrte si provizion. Sipas dokumenteve të kohës kjo Kështjellë që në 1452 ishte e dëmtuar dhe kërkonte meremetim ndërsa në 1610, po sipas kronikave të kohës, kalaja ishte e shkatërruar dhe braktisur. Deja si qytet shkatërrohet përfundimisht në 1474 nga ekspeditat ndëshkimore osmane që kërkonin të depërtonin në brendësi të territorit. Kjo Kala për nga pozicioni i saj plotëson

*) Jireček "*Skutari und sein Gebiet im Mitteralter*" *Illyrisch-Albanische Forschungen*.1916

***) G.Valentini. *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë.1060-1560. Plejad, Tiranë 2010.*

një nga kushtet kryesore për të qënë një fortifikim mesjetar, mbrojtjen natyrore. Kështjella sot ruan hyrjen kryesore atë në jug që përshkron faqen anësore të një kulle drejtkëndore. Nuk mungojnë në këtë fortifikim ashtu si në Shurdhah apo Drisht, kullat gjysëmrrethore me mure të holla pa breza dhe me shtegun e rojeve që krijohet nga platform druri të mbështetura mbi trarë të dale konsol. Kështjella duke shfrytëzuar terrenin merr forme katërkëndshe jot ë rregullt ku ka disa faza ndërtimi. Territori brënda Kalasë ka qënë i banuar intensivisht, pasi ruhen ende gjurmë banesash, më shumë në gjendje përgjithësi si dhe një stere uji. Lartësia maksimale e mureve arrin në 2,5 m dhe gjerësia e tyre varion nga 50-60 cm, ndërtuar me gurë mesatarë të punuar pak dhe vendosur jo me shumë rregull dhe me shumë llaç.



Foto 2. Kështjella e Dejës, Danja

Sarda. Qyteti i fortifikuar mesjetar i Sardës gjendet rreth 10 km nga qyteti i Shkodrës mbi një kodër 130 m, të lartë ngritur në një pozicion kontrollues pikërisht aty ku lumi Drin zbriste dikur në fushë. Për herë të parë ky qytet vizitohet nga konsulli austriak në Janinë J.G.Hann i cili ka përshkruar atë që ka evidentuar


me sy të lire duke i lidhur rrënojat e qytetit me Ipeshkëvinë e vjetër të Sardës ^{*)}. Më vonë këto rrënoja u vizituan edhe nga A. Degrand dhe T. Ippen ku ky i fundit evidenton dhe praninë e dy rrethimeve të qytetit. Të dhëna të sakta arkeologjike mbi këtë vendbanim fillojmë t'i kemi vetëm pas vitit 1948^{**)}, dhe më të qarta në fund vitet '60 të shekullit të kaluar nga ekspedita arkeologjike-studimore^{***)} të ndërmarra për shkak të përmbytjes së territorit të poshtëm të kodrës nga Hidrocentrali i Vau - Dejës. Qyteti i Sardës në dokumentet kishtarë të shek.XII-XV përmendet me trajtën "*Sardenencis*" ndërsa Frang Bardhi në relacionin e tij dërguar Papës në shek.XVII e quan këtë qytet si "*Sardania*". Sot njihet me emrin "*Shurdhah*" që përdoret nga vendasit. Sigurisht ky emër vjen si rezultat i zhvillimit fonetik të shqipes. Duke u mbështetur në dokumentet mesjetare Sarda përmendet si qendër Peshkopale në shek.XII-XV. Në dokumentet e kohës janë të njohur dhe peshkopët të paktën që nga viti 1190 deri tek i fundit në 1428. Më 1491 Dioqeza e Sardës nuk ekzistonte më. Ajo iu bashkangjiti asaj të Sapës. Sarda përbëhej nga dy pjesë, ajo e sipërme dhe qyteti i poshtëm, ndërsa varreza shtrihej jashtë mureve. Periudha më e hershme e këtij vendbanimi i përket shek.VI-VIII. Të kësaj periudhe i përket muri i parë rrethues ku disa nga kullat kanë tiparet ndërtimore të mesjetës së hershme. Ndërsa rrethimi i dytë i përket shek.XII - XIII kohë kur qyteti merr një hov zhvillimi. Kësaj periudhe i përket dhe ringritja e një brez muri të dytë përforcues në rrethimin e parë ngjitur me brezin e murit të mëparshëm. Sarda në këtë kohë merr karakterin e një qyteti tipik mesjetar dhe në pjesën e sipërme të qytetit objektet kishtarë ndërtohen edhe mbi murin rrethues, që siç duket në këtë kohë humb rëndësinë e vet. Deri më sot njihen 10 objekte kulturi në këtë vendbanim ku tre prej tyre ndodheshin jashtë rrethimit të qytetit, sot territor i përmbytur. Të gjithë ndërtimet në këtë vendbanim janë bërë me gurë të nxjerra po aty. Muret rrethuese ndërtoheshin me gurë të thyer të përmasave mesatare. Gurët në këto mure nuk kanë formë të rregullt dhe janë të mbushur me llaç të dobët. Në zokolaturat e mureve dhe kullave janë përdorur gurë

*) J.G.V.Hann. *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*. Wien. 1867 fq.43

***) H. Ceka, J.Adami, S. Anamali. *Raport mbi ekspeditën studimore në Shkoder, Vau Dejës, Gajtan, Shurdhah*. 1948. Arkiva e Institutit të Arkeologjisë.Tiranë.

****) D. Komata. *Gjurmime në varrezën e Shurdhahut*. Studime Historike I.Tiranë,1967

të përmasave të mëdha. Ndryshe mund të themi për banesat dhe objektet e kultit ku është treguar kujdes në përdorimin e gurëve mesatarë të punuar dhe vendosur në rreshta të rregullt dhe me fuga ta holla. Sarda padyshim paraqet rastin tipik të ngritjes dhe zhvillimit të një qyteti në formë kështjelle në periudhën e mesjetës së hershme shqiptare.



Planimetria e qytetit mesjetar të Sardës. D.Komata, H.Spahiu

Ballezë. Qyteti mesjetar që në dokumentet mesjetare e gjejmë edhe si Balessio, Baleçio, Bariz përmendet për herë të parë në fillim të shek.XIII në relacionin e Presbiterit të Diocleas ku futet si një nga “zhupat” e Zetës^{*)}. Ky qytet ndodhet mbi një kodër në lindje të fshatit Reç. Kalaja zë një pozitë dominuese duke qenë e rrethuar nga dy përrej malor, në veri- perëndim nga Sheu i Rrjollit dhe nga lindja nga Sheu i Gurrës. Nga kjo kala ka një fushë-pamje të plotë të fushës së Mbishkodrës. Fortifikimi rrethon majën e kodrës dhe merr formën e një elipsi duke ndjek relievin. Muret rrethuese ruhen në një lartësi që varion nga 1,5-2 m dhe mund të ndiqen me sy të lirë edhe në dendësinë e pyllit që e rrethon. Në anën veriore të fortifikimit ruhet një kullë trekëndore thuajse e rrënuar, por që del jashtë mureve rrethuese.

^{*)} G.Praschiner. A.Schober. *Archaeologische Forschungen in Albanien und Montenegro. Wien 1919.*

Muret kanë një gjerësi rreth 1,5 m ndërtuar me gurë të vegjël e mbushur me shumë llaç. Nga teknika e ndërtimit ngjason shumë me ato të Kalasë së Danjës dhe Drishtit (Foto 3). Në pjesën më të lartë të kodrës ruhen rrënojat e një kishe njënefshe e ndërtuar me gurë të punuar dhe me përmasa të mëdha. Nga Kisha ruhet më mirë pjesa e apsidës deri në lartësinë 2 m dhe një diametër 3,5 m.



Foto 3. Muret rrethuese të Ballezës

Dakaj. Në luginën e lumit të Shalës mbi fshatin Mavriq, në një kodër shkëmbore të thepisur ruhen rrënojat e një fortifikimi i cili përbëhet nga gjurmët e mureve rrethuese, një kullë si dhe gjurmë banesash brënda perimetrit të fortifikimit.

Ky vendbanimi ka patur disa faza ndërtimi. Rreth majës së kodrës ruhen muret rrethuese të ndërtuara me gurë relativisht të mëdhej e lidhur me llaç. Ndërsa kulla dhe gjurmët e banesave që ruhen kanë një fazë më të avancuar të ndërtimit, me gurë me të vegjël dhe relativisht të punuar. Ky fortifikim më tepër për të kontrolluar kalimin në luginë, duhet të jetë ndërtuar në mesjetë nga sundimtarë të zonës dhe braktisur besohet në shek.XVI. (Foto 4)



Foto 4. Kalaja e Dakajve.

Zamir TAFILICA

TRADITA MUZEORE NË SHKODËR

-vijon nga numri i kaluar-

Kreu II

Muzeu Historik (ish muzeu Popullor)



Muzeu Historik i Shkodrës (shtëpia e atdhetarit Oso Kukës)

Në fillim të viteve 90, me rënien e regjimit komunist e vendosjen e demokracisë e të ekonomisë së tregut, filloi një periudhë e re edhe për rrjetin muzeal të Shkodrës, por që fatkeqësisht u shoqërua me disa humbje e dëmtime. Në qytetin e Shkodrës një numër muzesh u mbyllën, për dy arsye: ose lokalet iu rikthyen ish pronarëve në bazë të ligjit të ri mbi pronat (Shtëpitë-muze e L. Gurakuqit, e Degës së Shkodrës për L. Prizrendit, e Migjenit, e Tre Heronjve) ose nuk mund t'i qëndronin kohës (Muzeu Ateist, Shtëpia e Qarkorit të Partisë). Të gjitha objektet muzeale dhe materialet e tjera të lëvizëshme u përqëndruan në fondet e Muzeu Popullor, tashmë merr emërtimin “Muzeu Historik i Shkodrës”, i cili në vitin 1996 do të transferohet në Shtëpinë karakteristike të

Oso Kukës – pronë e shtetit, e cila sapo ishte restauruar. Fototeka “Marubi” qëndron, por transferohet në një lokal të ri pronë shtetërore. Qëndron gjithashtu edhe Muzeu i Kalasë “Rozafa”.

Në fillim të viteve '90, me ndryshimet e ndodhura në sistemin politik e në përshtatje të legjislacionit të ri, Muzeu Historik, merr statusin e muzeut lokal (të qytetit të Shkodrës), dhe vihet në vartësi administrative të Bashkisë, së bashku me Muzeun e Kalasë dhe Fototekën “Marubi”. Kësaj të fundit pas disa vitesh i jepet statusi “Institut i Fotografisë Shqiptare” dhe kalon në vartësi të drejtpërdrejtë të MKTRS. Muzeu Historik nuk është person juridik dhe i pavarur në vendim -marrje. Në aspektin administrativ- financiar ai, sikurse edhe institucionet e tjera kulturore të vartësisë së Bashkisë, varen nga një zyrë e quajtur Qendra administrative e Kulturës e cila është nën vartësinë e drejtpërdrejt të Bashkisë.

Personeli i Muzeut historik përbëhet nga: 1. Drejtuesi i Muzeut, i cili drejton stafin e punës në të gjitha aspektet e veprimtarive merr udhëzime dhe përgjigjet përpara pushtetit lokal (Bashkia e Shkodrës, Departamenti i Kulturës); 2. Tre historianë-shpjegues, nga të cilët dy mbulojnë sektorët e Muzeut Historik dhe një mbulon Muzeun e Kalasë “Rozafa”; 3. Dy punëtorë pastrimi dhe 6 roje që shërbejnë në të dy muzetë.

Menjëherë pas transferimit të Muzeut në lokalin e ri, filloi dhe puna paralele dhe intensive për sistemimin e fondeve, alestimin e hapsirave ekspozuese dhe skedimin e ri sipas standarteve europiane të rekomanduara si dhe inventarizimin e gjithë fondeve pranë QKIPK.



Kartelë objekti Listë inventari

Muzeu Historik përbëhet nga katër sektorë: i Arkeologjisë, i Etnografisë, i Arkivit, dhe i Bibliotekës.

1 -Sektori i arkeologjisë

a-Fondi: Pellgu i Shkodrës përfaqëson një nga zonat më të pasura e interesante të Ballkanit Perëndimor në vështrim të pozitës gjeografike, të relievit, të klimës e të resurseve të tjera natyrore. Prandaj dhe jeta njerzore, siç del nga gjetjet e Shpellës së Gajtanit, nis me periudhën e Paleolitit të mesëm (100000 vjet më parë).

Gërmimet arkeologjike të kryera nga arkeologët shqiptarë pas Luftës II Botërore dhe gjetjet e rastit në të gjithë hapësirën shkodrane, kanë pasuruar në vazhdimësi fondet tona muzeale me artefakte të të gjitha epokave historike. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të ruajtura ose të ekspozuara në muzetë e kryeqytetit.

Fondi arkeologjik përmban rreth 1500 objekte, nga të cilët rreth 300, ndër më të përzgjedhurit, janë të ekspozuar; pjesa tjetër ruhet në fond. Objektet arkeologjike-muzeale të këtij sektori përfaqësojnë të gjitha periudhat historik, nga Neoliti (6000 vjet p.e.s.) deri në Mesjetën e vonë (shek.XVI e.j.). Ato kanë një shtrirje gjeografike që përfshinë krejt pellgun e Shkodrës. Një pjesë e mirë e tyre vjen nga gjetje të rastit, por ka edhe objekte që vijnë nga gërmimet arkeologjike të ekspeditave të kryera në këtë territor.

Në aspektin funksional artefaktet mund të klasifikohen në vegla pune, enë të përdorimit shtëpiak e të transportit, objekte kulti, armë luftarake, stoli, objekte varrezore, arkitekturore, monedha e medalje. Një pjesë e tyre janë me vlera të spikatura artistike. Përsa i përket materialit të përdorur, ato janë të punuar në strall, gurë, mermer, kockë, qeramikë, metale, qelq etj.

Ndërmjet tyre ka objekte të prodhimit lokal, por edhe importi, të ardhura përmes shkëmbimeve tregtare me vende të afërta e të largëta të rajonit. Përsa i përket restaurimit, gjëndja paraqitet e kënaqëshme.

Në fondin arkeologjik ruhet dhe një koleksion i pasur numizmatik prej qindra monedhash, që përfshinë harkun kohor nga periudha helenistike deri në ditët e sotme. Ndër më të rëndësishmet e interesantet janë monedhat e vjetra greke, ilire, epirotase, maqedone, romake, bizantine, sllave, të Balshajve, veneciane e otomane.

b- Sallat ekspozuese

Në Nëntor të vitit 2002 u përrua Ekspozita permanente arkeologjike, frut i bashkëpunimit me Universitetin e Firences (Itali). Sipas një projekti të përbashkët, duke shfrytëzuar hapësirat e katit përdhes të ndërtesës, të përbërë prej dy sallash, me

elementë arkitekturorë tradicionale e me vlera origjinale të punimit të gurit e drurit, gërshetuar me panelat metalike ekspozuese, realizohet kombinimi i konstruksioneve të traditës me ato moderne. Ndriçimi individual i objekteve të vendosur brenda kubeve prej qelqi, i pasqyron mirë ato e krijon efekte emocionale duke e futur vizitorin në një mjedis të vërtetë lashtësie, siç e kërkon një ekspozitë arkeologjike.

Mbi kalldrëmin karakteristik të sallave është vendosur një pasarelë druri e mbuluar me tapet, për lehtësi qarkullimi, veçanërisht për vizitorët me aftësi të kufizuar dhe ato të moshës së tretë.

Objektet e prezantuara janë zbuluar në kohë të ndryshme rastësisht gjatë punimeve të ndryshme ndërtuese ose bujqësore si dhe përmes gërmimeve të kryera nga ekspeditat arkeologjike. Ambientet ku është ngritur ekspozita (ahuret) tradicionalisht kanë qenë përdorë si depo për rezerva ushqimore e lëndë djegëse për stinën e dimrit. Në një fazë të hershme, një nga ahuret është përdorur edhe për strehimin e kuajve të shalës. Këto ambiente, ku mbizotëron guri e druri, janë ruajtur të paprekura, ndërsa paraqitja e ekspozateve është bërë në një mënyrë bashkëkohore, duke përdorur panelet e vitrinat metalike, që simbolizojnë konstruksionet e sotme moderne, duke kombinuar kështu traditat e së shkuarës me të sotmen moderne. Ekspozita, në aspektin metodik-shkencor, është ngritur sipas parimit kronologjik-tematik. Objektet ndjekin rrjedhën e kohës, prej Neolitikut deri në fund të Mesjetës, por brenda çdo periudhe janë vendosur, kur ka ekzistuar mundësia, objekte sipas tematikës (sipas funksionit të objektit, sipas llojit të materialit), duke formuar nganjëherë edhe koleksione interesante si ai i urnave, i monedhave, i armëve, i mbishkrimeve, i skulpturave etj. Siç u tha më sipër ky klasifikim është i përafërt pasi, për arsye kriteresh tematike dhe estetike, disa objekte i shmangen këtij rreshtimi kronologjik. Vizita ndjek pikërisht këtë itinerar duke u përqendruar në objektet e koleksionet më të rëndësishme.

Kjo ekspozitë do t'u shërbejë si vizitorëve vendas, e sidomos nxënësve e studentëve, të cilët mund të shohin konkretisht historinë e lashtë e vlerat e krijuara nga brezat paraardhës, ashtu edhe vizitorëve të huaj që duan të njihen me traditat historike e kulturore të qytetit e të krahinës së Shkodrës.



Ekspozita arkeologjike - Salla A

2. Sektori i Etnografisë

a- Fondi: Ky sektor ka një fond prej rreth 1500 objektesh që u përkasin shek. XVIII - XX. Ato janë prodhime artizanale të qytetit të Shkodrës e zonave gjeo-etnografike të pellgut të tij, si të Dukagjinit, M. Madhe, Shllakut, Postribës, Zadrimës, Anamalit, Krajës si dhe të krahinave të Pukës e të Mirditës. Një pjesë e tyre janë prodhuar nga individë të familjeve qytetare apo fshatare, kurse pjesa tjetër prodhime të mjeshtërive të punishteve artizanale të qytetit të Shkodrës duke ndjekur traditën shekullore vendase, por edhe me elementë të rinj, të ndikuar nga kontaktet me kultura të huaja, në kohë të ndryshme.

Materialet e përdorura për punimin e tyre janë kryesisht të burimit vendas, por janë përdorur edhe materiale importi, kryesisht në prodhimet qytetare e më tepër në kohë të vona, me futjen në treg të materialeve të industrializuara. Objektet janë të klasifikuara sipas funksionit në: tekstile (veshje komplete ose elemente veshjesh, sende mobilimi të ambienteve shtëpiake, si qylyma, perde, mbulesa tryeze, shtretrish., strishe muri, etj.). Ruhen rreth 500 njësi, në një gjendje relativisht të mirë konservimi.

Në punimin e tyre është përdorur dendur leshi, mëndafshi natyror, pambuku, liri, duke kryer ciklin e plotë të procesit në vend, sipas teknikave tradicionale, natyrisht në një proces evolutiv të tyre. Vlen të theksohet se ato shquhen për originalitet, dekoracion të pasur, plot simbolikë e kolorit. Në mënyrë të veçantë vlera

të rralla artistike përmbajnë veshjet, ku shpesh është përdorur filigrana me nuanca të shumta ngjyrash. Po kështu qëndrisjet me dorë të të pëlhurave prej mëndafshi, liri e pambuku të shamive, këllefëve, çarçafëve etj.

Orendi druri me gdhenie si rafte, tryeza, karrige, elementë dekorativë të interiorit të banesave, me motive gjeometrike, floreale e zoomorfe. Gjithsej ruhen rreth 35 objekte të tilla; enë të përdorimit të përditshëm, si kupa, pjata, tepsi, enë uji, etj, tangarë zjarri, të punuara në dru, qeramikë, porcelan, metale etj. Ato i përkasin jetës së fshatit, kryesisht asaj baritore si dhe asaj qytetare. Prej tyre ruhen rreth 120 objekte.

Objekte prej guri, elementë të eksteriorit të shtëpive qytetare, si gryka pusi, lugje, enë masive depozitimi, pjesë arkitekturore banesash etj, të gdhendura me motive interesante e me forma origjinale; vegla pune të mjeshtrive të ndryshme, të kovaçit, argjendarit, lëkurpunuesit, bakërpunuesit, drugdhenësit, armëpunuesit, etj. Ruhen rreth 200 objekte të tilla. Vegla muzikore tradicionale si lahuta, çifteli, fyej, zumare, saze etj, ruhen rreth 50 copë. Ka edhe objekte të importuara kryesisht nga Italia e Turqia, kryesisht paisje e orendi të shtëpisë qytetare shkodrane: llampadarë, vazo, enë kuzhine e tryeze etj.

b- Shtëpia karakteristike "Oso Kuka". Është banesë karakteristike shkodrane e gjysmës së parë të shek. XIX, me vlera të veçanta arkitekturore e etnografike. Pas blerjes nga shteti e kalimit në pronësi të saj, në fillim të viteve 1980, shtëpia i është nënshtruar një procesi të plotë restaurues. Banesa qytetare shkodrane e tipit "*me çardak*", përbën një nga realizimet arkitekturore më të përkryera në tipologjinë e banesës tradicionale shqiptare. Kjo është banesë dykatëshe, kati përdhes i të cilës përbëhet prej pjesës së hapur (*hajati*) e mjediseve të mbyllura (*ahuret*). Këto të fundit shërbenin tradicionalisht si depo për mjetet e punës e rezervat ushqimore të familjes; në një fazë të hershme një nga mjediset shërbente për strehimin e kuajve të shalës. Ndërsa kati i sipërm kishte mjediset e banimit për familjarët. Nga një shkallare me harqe prej guri të një stili elegant, ngjitesh në katin e sipërm, në një mjedis të hapur e të gjërë, me konstruksion druri (*çardak*), që kryente disa funksione, sidomos për proceset e punimin e mëndafshit. Përmes këtij mjedisi bëhet komunikimi i drejtpërdrejtë me secilën prej katër dhomave. Qendrën e shtëpisë e zë kuzhina me furrën e bukës e votrën për gatim. Familja shkodrane tradicionalisht përbëhej nga shumë anëtarë dhe secili çift i martuar së bashku me fëmijët e vet

kishte dhomën e tij të paisur me nyjën sanitare. Në krah të shkallares ndodhet një dhomëz e vogël (qoshku) që shërbente si zyrë për punë tregtie dhe për të pasë nën vëzhgim portën e oborrit e mjediset përreth. Dhomat, si nga ana funksionale ashtu edhe estetike janë trajtuar me një kujdes të veçantë. Dhoma, dritaret e së cilës shohin në oborr, është zgjedhur për pritjen e miqve (oda e pritjes), në funksion të salonit. Kështu që ajo do të ishte më e kompletuara dhe e më e zbukuruar. Elementet më interesante të kësaj dhome janë: oxhaku monumental prej allçie, tavani me rozetën e gdhendur në qendër, dritaret në dy nivele, kthina në formë lozheje (*trapazani*), raftet e murit (*açikraftet*) e sirtaret përgjatë mureve (sergjitë), të gjitha të zbukuruar me motive gjeometrike e floreale.

Edhe më interesante shtëpinë e bën porta e jashtme monumentale e oborri i gjërë e i gjelbëruar, mbushur me lule të shumta. Qyteti i Shkodrës tradicionalisht ka shfrytëzuar burimet e pasura nëntokësore të ujit të pishëm, prandaj çdo shtëpi kishte pusin e vet me grykë të gurtë të punuar në vend ose të sjellë nga jashtë, kryesisht nga Venecia (Venediku) ose Ragusa (Dubrovniku). Banesa së bashku me aksesoret e jashtëm të saj rrethohet prej muresh të lartë prej guri (*avlli*) mbuluar me shermashek. Shpesh edhe pas shtëpisë shkodrane kishte një terren që shërbente si kopësht, ku kultivoheshin perime e fruta të ndryshëm për konsum familjar.

C – Mjediset ekspozuese

Në Odën (dhomën) e pritjes e përshkruar më sipër janë ekspozuar plot objekte etnografike, kryesisht të qytetit. Kostumet, me variantet e nënvariantet e veta, përbën një nga vlerat më të spikatura të trashëguara në kulturën tonë materiale. Secila zonë etnografie e pellgut të Shkodrës ka veshjen e vet tradicionale, duke trashëguar kështu brez pas brezi, një larmi të pafund formash, motivesh e ngjyrash. Janë të ekspozuara kostumet e qytetit (të komunitetit musliman, katolik e ortodoks); të zonave rurale (të Postribës, të Zadrimës, të Bregut të Bunës, të Malësisë së Madhe, të Dukagjinit), etj. Në vitrina të mbyllura prej xhami janë ekspozuar 6 kostume tradicionale origjinale që datojnë nga fundi i shek.XIX- në fillim shek.XX. Në dy radhë përballë njëri tjetrit janë kostumet e një çifti malësorësh të Dukagjinit, të një çifti qytetarësh katolikë dhe të një çifti qytetarësh muslimanë të Shkodrës.

Kostumet e ekspozuara përmes manikinëve kanë pranë nga një aksesori (furkë, bastun, çadër, lahutë, gjergjef). Ndër ata interes të

veçantë paraqet lahuta, instrument tradicional i Malësive të Veriut, por me shtrirje pothuaj në të gjithë Ballkanin. Forma e saj arkaike, kordat e harkut prej qymesh të kalit e sidomos zëri i saj karakteristik e bëjnë atë një nga veglat më interesante që prej shekujsh vazhdon të përdoret nga rapsodët. Ajo shoqëron këngët epike të këtyre malësive e veçanërisht eposin e Kreshnikëve

Aksesor tjetër interesant është gjergjeji i dorës, që përdorej nga gratë e vajzat për të dekoruar (qëndisur) veshjet dhe orenditë e shtëpisë. Në pëlhura të ndryshme qëndisnin me gjilpërë lloj lloj motivesh, duke përdorë fije mëndafshi a tertili me ngjyime të arta e të argjendta. Kishte edhe një tip tjetër gjergjeji, gjergjeji i madh prej druri, me katër këmbë. Ky shërbente për qëndisje në sipërfaqe të mëdha.

Në qendër të dhomës është vendosur sinia metalike e punuar me savat mbi sqemlën prej druri të zbukuruar me pikturim, kurse në qoshe pas derës, qëndron “arka e nuses” gjithashtu e zbukuruar me motive floreale. Kjo është një arkë të madhe, që nusja e sillte me “pajën” nga shtëpia e saj



Mjedise etnografike

3. Sektori i Arkivit

a- Fondi i dokumentave të shkruara: Përmban dokumente të shkruara që në rrjetin muzeor të Shqipërisë është ndër më të pasurit. Ai ndahet në 55 fonde. Dokumentacioni përfshin të gjithë Qarkun e Shkodrës e më gjërë. Pjesa kryesore është në origjinal dhe e shkruar në shqip, por edhe në italisht, frëngjisht, gjermanisht, serbisht etj. Lënda që përmban është e karakterit historik, ekonomik, kulturor, artistik, gjuhësor, arsimor, administrativ, muzeor, shoqëror, memorialistik. Aty ruhen edhe përkthime në shqip e botimet e bëra nga Muzeu pas vitit 1949.

Pjesë e Arkivit është edhe filmoteka me materiale historike të filmuara në Arkivin Qëndror të Shtetit e me imazhe të tjera (gjithësejt mbi 3000 njësi), evenimente, personazhe individuale ose në grup, monumente të ndryshme, personalitete të historisë etj.

b- Koleksionet: Fondi i objekteve historike të Muzeut përbëhet nga 4 koleksione kryesore që dokumentojnë periudhën nga shek.XV deri më sot :

-Koleksioni i relikteve: Lidhet me ngjarje historike e personalitete të shquara të qytetit e krahinës së Shkodrës, si flamuj kombëtarë, objektet muzeale të ish Shtëpive-muze të L.Gurakuqit, të Migjenit, të Tre Heronjve etj. si dhe objekte personale të P.Vasës, Sh. Gjeçovit, Gj. Fishtës, B. Currit, D.Boriçit, P. Jakovës, P.Gacit, të dëshmorëve të Luftës NÇL. etj.

- Koleksioni i armëve: Përmban armë të të gjitha llojeve, prodhime vendi ose importi, artileri e lehtë (topa të vegjël), shek.XIV - XV; armë zjarri, krahu ose brezi të shek.XVII e në vazhdim; armë të ftohta tipesh të ndryshëm, shek.XVIII - XX; predha furioze metalike të madhësive të ndryshme (veçohen predhat prej guri të shek.XV, më masivet - deri më 600 kg.)

- Koleksioni i Vulave : Lidhen me veprimtarinë e institucioneve shtetërore, fetare a të individëve të ndryshëm të qytetit e të krahinës së Shkodrës, por edhe të shteteve të huaja.

- Koleksioni i Kartëmonedha: Përmban kartëmonedha ose letra me vlerë të Shqipërisë e të disa shteteve të huaja që kanë patur marrëdhënie politike apo tregtare me Shkodrën apo Shqipërinë.(shek.XIX-XX). Këtu veçohen kartëmonedhat e prera e të qarkulluara në Shkodër më 1920, kur qyteti iu bashkua përfundimisht shtetit shqiptar.

Këtu përfshihen dhe: Pinakoteka me mbi 100 piktura në teknika të ndryshme të autorëve shkodranë, që nga K. Indromeno, S. Rrota deri tek piktorët bashkëkohorë, J. Keraj, S. Lulani etj.; Fonoteka me incizime të ndryshme të ahengut shkodran në pllaka gramafoni si dhe incizime bisedash të karakterit memorialistik me karakter historik, etnologjik, folklorik, kulturor; Fototeka e përbërë prej qindra foto-negativë e foto të stamposura të koleksionuara përgjatë viteve ku janë fiksuar ngjarje e personazhe të jetës së qytetit në periudha të ndryshme.

4- Biblioteka: Biblioteka e Muzeut ka karakter përgjithësisht albanologjik. Që në themelimin e saj u ka shërbyer dhe u shërben

jo vetëm punonjësve të brendshëm, por edhe bashkëpunëtorëve të tij e studiuesve të tjerë të jashtëm, gjithashtu studentëve të Universitetit e mësuesve që përgatisin tema diplome e për grada shkencore.

Ajo ka arritur të sigurojë një fond relativisht të pasur që mbulon të gjitha fushat e Albanologjisë, por edhe literaturë tjetër, të autorëve shqiptarë e të huaj, në shumë gjuhë të botës, duke numëruar rreth 15 000 tituj. Librat më të vjetër i përkasin shekullit të 17- të, ku mund të përmendim librin „Dottrina Christiana“ të P.Budit (1618), libri „Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander - Begh“ i G.Biemmit (1742). Një vend të veçantë zënë koleksionet e librave, revistave e gazetave periodike që nisin nga fundi i shek 19^{te}.

Fondi prej mbi 2000 vëllimesh i bibliotekës të familjes „Pipa“, dhuruar Muzeut Historik të Shkodrës, ia ka rritur edhe më shumë vlerat kësaj biblioteke. Përmendim këtu, veçanërisht koleksionin „Albania“ të F.Konicës dhe koleksionin „Shejzat“ të E.Koliqit^{*)}.



Arkivi. Biblioteka

Muzeu i Kalasë “Rozafa”

Ngrihet në një ndërtesë monumentale trekatëshe të shekullit XV që njihet me emrin “Kapitaneria”, rezidenca e Kapitanit (sundimtarit venedikas). Dallohet se është ndërtesë me karakter ushtarak nga trashësia e mureve (2.20 m në bazë) dhe nga dritaret e ngushta në trajtë frengjishë, për vendosjen e topave të artilerisë. Fasada e ndërtesës është e punuar me gurë të latuar, kurse çatia mbulohet me rrasa guri. Ngjitja e kateve bëhet përmes një shkallareje të brendëshme po prej guri. Përmes një hyrje të fshehtë në katin përdhes, e mbuluar me qemer masiv prej guri,

*) Guidë, MSHSH, 2010, f.11; Arkivi i MSHSH

kalohet në një tunel sekret, që përfundon jashtë mureve të kalasë. Sapo hynë në muze, përballë portës, një basoreliev në gips të fut menjëherë në vorbullën emocionale të legendës së Kalasë, gruaja e sakrifikuar në muret e kalasë, që ata të qëndrojnë, me gjiun e nxjerrë jashtë, të ushqejë foshnjën e saj. Përbri basorelievit disa vargje të legendës janë shkruar në mur. Në katin përdhes të Muzeut, përmes materialit qeramik e ilustrimeve prezantohen gjurmët e një vendbanimi prehistorik mbi kodrën e kalasë, me fillesë që nga periudha e bronzit të hershëm (2100 para Kr.).

Në vazhdim vizitori njihet me objekte të ndryshme arkeologjike që u përkasin periudhës urbane helenistike e romake. Aty janë ekspozuar edhe bustet e tre mbretërve ilirë, Agronit, Teutës e Gentit, të punuara në mermer. Në tavolinat metalike të mbyllura në xham prezantohen një koleksion monedhash që pasqyrojnë marrëdhëniet e fuqishme tregtare të qytetit me botën mesdhetare që nga prerjet e para të shek. III-II para kr. Po në këtë kat, janë ekspozuar objekte të ndryshme të periudhës së mesjetës së hershme. Ato janë kryesisht stoli prej bronzit e vegla pune prej hekuri të "kulturës së Komani" (shek. VI-IX pas Kr.). Mjaf mirë e ilustron historinë e kalasë edhe portretet e princërve feudalë të dinastisë së Balshajve, të punuara në bakër. Interes të veçantë paraqesin objektet prej guri të periudhës bizantine e asaj veneciane, ndër të cilët veçojmë një gur masiv kuadratik me një mbishkrim latin të shoqëruar me simbole heraldike. Vizita në këtë kat mbyllet me një koleksion të madh gjylesh me dimensione të ndryshme (më të mëdhenjtë mbi 400 kg.) të topave (cannone) të ushtrive osmane të përdorura në dy rrethimet e famshme të fundshekullit XV.

Në katin e sipërm janë përqendruar më shumë dokumenta e relikte që pasqyrojnë historinë mesjetare e atë moderne të kalasë "Rozafa". Materialet origjinale të ekspozuara shoqërohen me shpjegime, foto, skica e harta të ndryshme. Në qendër të një salle të madhe është ekspozuar maketi madhështor i kalasë së bashku me qytetin e poshtëm, ku ndodhej "Pazari i Vjetër".

Armët origjinale të kohës përbëjnë një koleksion të pasur e mjaft interesant për vizitorin. Ndërmjet tyre ka armë trofe, prodhime veneciane dhe otomane, që lidhen me betejat e përgjakëshme të fundshekullit XV.

Ekspozimi aty pranë i dy veprave të artit (riprodhim fotografik), i tabllos së P. Veroneze-s (Venecia, Pallati dukal) dhe basorelievit

të Carpacio-s, (Venecia, "Scuola dei albanesi"), të cilat kanë përjetësuar qëndresën e Shkodrës kundër Mehmetit II (1478-79) të fusin në atmosferën e atyre ngjarjeve të rëndësishme historike që u zhvilluan aty.

Koha e sundimit të Bushatlijve përbën një nga periudhat më të ndritura të historisë së Shkodrës e të kalasë së saj. Kjo periudhë gjen pasqyrimin e vet nëpërmjet shumë objekteve autentike të ekspozuara me shije, që nga prodhimet e famshme të pazarit e deri te ndërtimet publike.

Në vazhdim historia e kalasë dhe e qytetit prezantohet me dokumenta autentikë të shkruar në gjuhë të ndryshme të kohës si dhe me relikte të larmishme që ilustrjnë aspekte të shumta të jetës ekonomiko-tregtare e social-kulturore të Shkodrës përgjatë shek. XIX e duke u finalizuar me ceremoninë e ngritjes së Flamurit kombëtar në mars të 1914-ës. Veçojmë këtu flamurin origjinal dhe një foto të madhe të këtij evenimenti fiksuar nga studio Marubi^{*)}.



Sallë ekspozimi

Veprimtaritë shkencore e promovuese

Muzeu Historik i Shkodrës ka grumbulluar tashmë një eksperiencë të mirë përsa i përket organizimit të veprimtarive shkencore, duke bashkëpunuar ngusht me institucione shkencore-kulturore, intelektualë të qytetit si dhe studjues vendas apo të

^{*)} Guidë,...Po aty;

huaj që hulumtojnë për historinë e traditat tona të pasura lokale. Veprimtaria kryesore në këtë sferë mbetet Seminari Ndërkombëtar „Shkodra në Shekuj“, i cili në vitin 2005 realizoi me sukses tubimin e gjashtë periodik të tij. Tanimë janë botuar plotësisht materialet e gjashtë seminareve të para (gjithësejt 12 vëllime). Muzeu nuk e ka ndërprerë botimin e revistës shkencore-divulgative „Kumtari“ që ka nisur në vitet ,70 dhe ka arritur derë tani në numërin e 9-të të saj. Hapat e parë janë hedhur edhe në botimin e guidave e materialeve të tjera promocionuese të karakterit turistik, si kontribut në zhvillimin e turizmit në qytetin e Shkodrës e zonën përreth. Ndër këto shënojmë: „Kështjella „Rozafa“ „(1994), albumi me kartolina „Fletore të ikonografisë shqiptare (I)“ dhe së fundi „Muzeu Historik i Shkodrës-Guidë“ (2010).

Në vitin 2002, me rreth 150 objektet më prezantuese të trashëgimisë tonë arkeologjike u hap dhe qëndroi për 9 muaj në qytetin Arona e më pas në atë të Como-s në Itali ekspozita e emërtuar „Iliria“, që ngjalli shumë interes.

Mekëtë rast u publikua në italisht dhe një guidë e plotë arkeologjike për trevën e Shkodrës, ku përfshihen të gjitha vendbanimet, varrezat, kështjellat e monumentet e tjera, nga Paleoliti i mesëm në Mesjetën e vonë. Aty janë prezantuar gjithashtu të kataloguar të gjitha eksponatet e prezantuara në atë ekspozitë. Muzeu i Shkodrës për pesë vjet ka qenë pjesë e një rrjeti muzeal Ballkanik ku bënin pjesë Muzeu Historik Kombëtar i Tiranës, ai Prishtinës, i Shkupit, i Gjakovës, i Sarajevës, i Zenicës, i Beogradit, i Novi Sadit, i Banja Lukës, i Cetinës. Aktiviteiti ketij rrjeti udhëhiqej dhe mbeshtetej nga CHËB (Cultural Heritage Eithout Borders) me qendër në Stokholm (Suedi). Si veprimtari kryesore ne këtë kuadër përmendin serin e workshopeve të shumta kualifikuese dhe organizimin e ekspozitave te përbashkëta me tematika te ndryshme, e çka është më kryesorja mbështëtja me projekte konkrete e Muzeve në funksion te përshtatjes të tyre për të gjitha kategoritë ë vizitorëve dhe përmirësimin e gjendjes muzeale. Aktualisht muzeu merr pjesë aktive në projektin “Adria-muse” në partneritet me disa institucione simotra të rajonit, në kuadrin e programit të madh “IPA-Adriatica”, për të kontribuar në zhvillimin e turizmit kulturor.

Në punën e përditshme muzeu mbështet shkollat fillore ato të mesme dhe stafet e universiteteve me materiale divulgative dhe

informacion mbi historinë për programet mësimore që lidhen me kulturën dhe trashigiminë e qytetit dhe atë kombëtare në përgjithësi. Që me fillimet e lëvizjes turistike në qytetin e qarkun e Shkodrës, Muzeu Historik ka qenë shumë aktiv e i gatshëm jo vetëm për të pritur vizitorë të huaj, por edhe për të promovuar pikat e tjera të rëndësishme turistike brenda e jashtë qytetit; për të orientuar turistët në qendra e monumente historike, arkeologjike e natyrore. Muzeu ka krijuar lidhje të fuqishme me grupet e interesit, veçanërisht me organizata të huaja e agjensi turistike që veprojnë në qytetin tonë. Numri i turistëve të huaj, por edhe i atyre shqiptarë si në Muzeun qendror ashtu edhe në atë të Kalasë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, veçanërisht këto vitet e fundit. Gjithashtu përherë e më i madh është numri i nxënësve e studentëve që vizitojnë këto muze, jo vetëm nga qyteti e fshatrat përreth por edhe nga gjithë vendi, Kosova etj. Për të përballuar fluksin e madh të sezonit turistik (prill-shtator) muzeu ka instruktuar me forma të ndryshme guida-përkthyes që punojnë pranë agjensive të turizmit.

Muzeu tashmë ka ndërtuar dhe faqen e vet të internetit me adresën: www.muzeushkoder.org, e cila përditësohet herë pas here me materiale të reja, ku pasqyrohen, përveç vlerave muzeale edhe veprimtaritë e ndryshme që organizohen.

Komisioni i ngritur për formimin e institucionit: Abdullah Gjeçaj (kryetar), Ndoc Gashi (nënkryetar), Muhamet Uruçi (antar), Hamid Beqja (antar), Vladimir Jani (antar), Petrit Velaj (antar), Feti Bilali (antar), Lec Fishta (antar), Haki Llazani (antar).

Drejtues të Muzeut: Gjush Sheldia (1949), Vasil Llazari (1953), Pjetër Hasi (1968), Mithat Dibra (1978), Mentor Quku (1992), Maxhid Cungu (2001), Zamir Tafilica (2007), Fatmir Juka (2010)

Punonjës: Mynire Bebeziq, Tinka Kurti, Kahreman Ulqini, Njazi Vadahi, Gegë Marubi, Vehbi Ramadani, Magdalena Ujka, Flora Kuqani, Paulin Pero, Bajram Xhafa, Fatmir Selhani, Mentor Koplaku, Stefan Çapaliku, Pëllumb Sulo, Shaban Bilali, Xhyher Cani, Zamir Tafilica, Ndrëçim Mlika, Fatmir Juka, Semiha Osmani, Muhamet Boriçi, Justina Pici, Fanko.

Bashkëpunëtorët që në sajë të njohurive të tyre shkencore e teknike ndihmuan drejtpërdrejtë në evidentimin, klasifikimin, sistemimin e fondeve si dhe në alestimin e sallave ekspozuese gjatë themelimit të Muzeut qenë: Marin Sirdani, Leon Kabashi, Ndoc Kamsi. Në vitet në vazhdim ndihmuan në riorganizimin ekspozitiv, arkeologët

Skënder Anamali, Frano (Çesk) Prendi e Beb Jubani. Pas viteve '90, ndihmë të çmuar e të pakursyer dhanë dy arkeologë të tjerë shkodranë të Bërthamës Arkeologjike të Shkodrës, Bashkim Lahi e Gëzim Hoxha, që depozituan një pjesë të fondit arkeologjik nga gërmimet e tyre disavjeçare në terren.

Siç shihet në përshkrimin e sipërm tradita shkodrane në fushën muzeale është e hershme e dinjitoze. Kjo së pari, sepse qyteti i Shkodrës e krahina e saj ka një histori të vjetër e të pasur dhe me një trashëgimi kulturore të shquar. Së dyti, banorët e këtij komuniteti, megjithë rrebeshet e kohës, kanë ditur t'i ruajnë e t'i transmetojnë vlerat e krijuara nga brezi në brez, duke shprehur në këtë mënyrë, qytetari, identitetin kombëtar ; cilësi humane, kozmopolite e artëdashëse.

Sot, në rrethana të reja të demokracisë e të ekonomisë së tregut, janë krijuar hapësira të mëdha për një zhvillim të vullshëm kulturor në përgjithësi dhe të muzeve në veçanti. Aq më tepër që ky qytet e kjo krahinë, në strategjitë e zhvillimeve afatgjatë të shtetit dhe të pushtetit vendor, falë resurseve që gëzon, është orientuar kryesisht në zhvillimin e ekonomisë së turizmit. Nisur nga kjo, ekzistojnë të gjitha mundësitë që qyteti dhe zonat përreth të ndërtojnë një rrjet të gjerë muzesh të tipologjive të ndryshme, shtetërore e privatë, duke respektuar të gjitha kriteret dhe detyrimet ligjore. Gërmimet arkeologjike që kanë rinisur në parkun arkeologjik të Shkodrës dhe mesa duket së shpejti edhe në qendra të tjera të njohura, do të pasurojnë gjithnjë e më shumë vitrinat e muzeve që ekzistojnë e që do të ngrihen në të ardhmen.

Sot, në kushtet e hapjes së vendit, integritimeve rajonale dhe globalizmit, janë shfaqur dhe fenomene negative që rrezikojnë humbjen përfundimtare të pasurive të trashëguara. Shumë objekte me vlerë muzeale kanë marrë rrugën e eksodit në këto vite të tranzicionit. Po ashtu në shumë site e monumente të tjera vihen re ndërhyrje të grabitësve ilegalë, të cilët i shkaktojnë dëme të mëdha historisë dhe traditave tona. Për dimensionet që ka Shkodra me interlandin e vet, dhe me resurset e saja kulturore mund të ngrihen disa muze lokalë të profilizuar, si: muze i kostumografisë, i punimit të metaleve, i peshkim-lundrimit, i vitikulturës, i tregtisë etj.

Na ngelet detyrë që të evidentojmë, por edhe të ruajmë, përmes sensibilizimit të institucioneve shtetërore, shtresave të ndryshme sociale, universitetit, mediave etj., ruajtjen dhe trajtimin shkencor të objekteve tona, si një garanci e së ardhmes.

▪ Trashëgimi kulturore ▪

Ridvan KARAKAÇI

KARAKTERISTIKAT E AHENGUT SHKODRAN

Hyrje

Korpusi i këngës qytetare shkodrane është shumë i gjerë dhe i larmishëm. Ai mund të konsiderohet si një ndër artet më të bukura të muzikës qytetare shqiptare. Në ditët e sotme ekziston një repertor i mrekullueshëm me krijime dhe improvizime të arrira, të emërtuara “Kënga qytetare Shkodrane”, që mbijetuan gjatë shekujve. Kjo ishte pjesë e rëndësishme dhe e pandarë e zhvillimit të shoqërisë shkodrane.

Ky korpus këngësh përmbledh mbi 350 këngë me tekste e muzikë të botuara. Në një kuptim të përgjithshëm këtë korpus e përbëjnë dy shtresa arti muzikore me fizionomi e tipare të konsoliduara në kohë:

A: Këngë- valle, ku bëjnë pjesë ceremoniali i dasmës, shtregullat dhe shëtitë

B: Grupi i këngëve që përfshijnë këngët e ahengut shkodran.

Në vitet 50 të shek.XX një radhë këngësh të reja tentuan të sjellin një frymë të re me këngën si krijim në Shkodër. Pati një prirje për të pasuruar këngën shkodrane e shqiptare me këngën e re si: “Lule Borë”, “Me lule të bukura”, “Çikë mori çikë”, “Kënga e krushqve”, “Synin si qershia”, “Margjelo” etj.

Këngët aheng nuk u krijuan të bazuar në stilin tradicional vendas. Termi shkodran në rastin e këngës aheng nënkupton që edhe falë ndikimit të muzikës orientale u bë ndryshe nga çdo lloj kënge tjetër. Kjo këngë u bë e tillë falë mënyrave se si u përshtat meloditë apo kënga orientale në mjedisin shkodran, sesi ajo vazhdoi të nënshkruhej, transformohej e krijohej nga muzikantë vendas duke i përshtatur herë pas here kësaj kënge elemente melodike, ritmike e stilistike të traditës muzikore vendase.

Kënga aheng, duke filluar që nga fundi i shek.XVIII e në vazhdimësi, si krijim muzikor, deri në vitet 40 të shek.XX, pati një përhapje e shtrirje të gjerë. Këngët bënë dhe mbetën pjesë e rëndësishme e dasmave, u shtrinë edhe në ambiente të tjera, kremtime familjare për qejf, nëpër shtëpi karakteristike

shkodrane, në oborre me lloj lloj lulesh, bahçe, nën hijen e manit e më vonë në skena koncertale, radio e ekrane televizive, duke bërë prej vitesh edhe jetë artistike të pavarur.

Pak Histori : Formimi, Zhvillimi dhe Përhapja e Këngës Aheng

Muzika otomane ka pasur një impakt të konsiderueshëm në muzikën ballkanike, kryesisht në tipin e melodisë. Këngët aheng gjithashtu janë influencuar nga strukturat makame, ritmike, format e kompozimet, stilet e performancës, zhanret, instrumentet popullore, emërtimi etj. (aheng-heng-argëtim me saze, muzikë saze).

Procesi i formimit të këngës aheng kaloi nëpër disa faza të zhvillimit dhe konsolidimit të saj. Faza e parë lidhet me pushtimin osman të Shqipërisë. Ahengu si muzikë erdhi së bashku me pushtuesin osman dhe ushtri një ndikim të madh në jetën muzikore të vendit, ku gjeti interpretues e krijues të rinj. Në Shkodër, përhapje të gjërë pati muzika klasike turke, muzikë e shtresës urbane të shoqërisë turke. Nëpërmjet muzikantëve profesionistë të ardhur në Shqipëri e Shkodër duhej të kënaqte shijet e zyrtarëve të lartë turq. Me rimëkëmbjen e qytetit (gjysma e dytë e shek.XVIII dhe përgjatë shek.XIX) filloi të tërhiqte edhe vëmendjen e qytetarëve të pasur shkodranë, që kishin filluar të përthithnin zakonet e shijet turke, duke përfshirë edhe muzikën.

Oborri i Bushatlinjve, që nga 1800 kishte filluar të pajtonte edhe ahengxhijtë vendas. Grupi i parë është ai i Mehmet Shllakut nga Vukatana. Kjo periudhë është e lidhur tërësisht me përhapjen e këngës turke. Edhe instrumenet që luanin ahengxhijtë janë të huazuar nga muzika turke, si sazja, qemane (violinë), dajre.

Në gjysmën e dytë të shek.XIX fillon një fazë e ere që lidhet tërësisht me ardhjen në Shkodër të muzikantëve shkodranë që u afirmuan në shkollat e muzikës turke, në Stamboll e Izmir, si: Kasem Xhuri e Mark Kranjana. Ato formuan grupin e dytë të ahengut në Shkodër pas atij të Shllakut. Këto janë muzikantët e parë shkodranë të ahengut që sollën edhe sistemin e makameve turke (shkallë muzikore) së bashku me sazen, si bartëse të këtij sistemi. "Me to nis prirja me u dhanë me mish e shpirt me përmirësue ahengun shkodran", - thotë K.Gurashi.* Faza e tretë nis me Palok Kurtin, që nën ndikimin e reformatorëve Xhuri e

*) Kol, Gurashi. Të dhëna bibliografike mbi disa këngëtarë popullore. Almanaku Shkodra, nr.234, 1962.

Kranjana kënga aheng futet në një rrugë të re zhvillimi. Palok Kurti iu përkushtua tërësisht jetës muzikore të Shkodrës dhe luajti një rol të padiskutueshëm si një reformator i vërtetë i saj. Në këngët e tij të kompozuar, nga njëra anë dallojmë individualitetin e tij si krijues, nga ana tjetër edhe nismëtarin në krijimin e një tipi të ri të këngës shkodrane. Këngët e krijuara pas viteve 1890, si: “Marshallah Bukurisë sate”, “Për mue paska kenë kismet”, “Një kllëf me ar të çova”, “N’atë zaman t’asaj furie”, “Ta dish, ta dish” etj. (gjithsej 26), u bënë popullore, sepse sollën një formë të re në traditën e ahengut shkodran dhe për këtë shkak edhe u vlerësuan në popull si këngë të reja. Kjo fazë ka të bëjë me një largim të dukshëm nga ndikimet me bazë orientale, sidomos në pikëpamje të stilit të lirë melizmatik në melodi, si edhe të ritmit gati atlibitum. Kjo e çliroi këngën nga disa tema të rëndomta, duke dhënë vargje poetike me frymë lirike dhe përkatësi të qartë emocionale. Nën influencën e tij, krijues të tjerë të talentuar do të zhvillonin pandërprerë këngën aheng edhe përgjatë gjysmës së parë të shek.XX, si krijim popullor, por edhe me autorë. Analiza e këngës na jep arsye të qartë për afërsinë e tyre me periudhën e Palok Kurtit.

Pas viteve 40 të shek.XX, sipas mendimit tim, kënga aheng pushoi së krijuari. Sazja humbi si instrument bazë i këngës aheng (1942), duke u zëvendësuar me instrumentë të tjerë të temperuar si: braçi, kitara, klarineta, fizarmonika, piano etj. Melodia hyn në marrëdhënie me harmoninë klasike perëndimore.

Kënga e Ahengut Shkodran dhe Sistemi Makam

Futja e sistemit makam pati një rol të rëndësishëm në zhvillimin e këngës së ahengut shkodran. Siç u shpreha edhe më sipër, ndikimi në përgjithësi i muzikës orientale dhe në veçanti i muzikës klasike turke është i dukshëm në këtë këngë. Në hapësirën shqiptare gjetën shprehje si muzika fetare ashtu edhe ajo laike turke. Ajo në Shqipëri u shfaq nëpërmjet muzikës fetare të xhamisë, të dervishëve, muzikës folklorike, asaj gjysëm klasike, të romëve, dhe muzikës klasike. Pyetja që shtrohet është nëse muzika klasike turke pati përhapje të gjerë në Shkodër? Argumenti kryesor për përhapjen e saj është se makamët që u emërtuan në këngën e ahengut shkodran e kanë prejardhjen nga makamët e muzikës klasike turke si: raas, hysejni, sabah, sergja, që burojnë nga emërtimet e shkallëve të kësaj muzike. Të tjerat duhet të kenë prejardhje arabe. Emërtimet e tjera të muzikës turke nuk i hasim

në këngën e ahengut shkodran. Fillesat e shkallëve muzikore të këngëve të ahengut shkodran duhen kërkuar në instrumentin e sazes. Pamëdyshje është sazja instrumenti që integroi sistemet melodike të muzikës klasike turke, të fiksuara në intervale të pabarabarta të oktavës, të ndara në 14 pjesë. Kjo vërtetohet edhe me faktin se makami është dukuri vetëm e muzikës shkodrane e që nuk ndodh në asnjë nga qytetet e tjera të Shqipërisë për arsye se sazja në këngën e ahengut shkodran mbeti instrumenti i padryshueshëm mikrotonal. Nga kjo ndarje e pabarabartë sazja ka shërbyer për krijimin e formulave melodike që tek kënga e ahengut shkodran patën emërtimin makame.

Përmbyllje

Pazari i famshëm i Shkodrës që lagjja e shpërthimit të talenteve, jo vetëm në tregti e zejтари, por edhe në këngën aheng. U bë pjesë e rëndësishme e jetës shpirtërore të shkodranëve, për t'u përthithur nga të gjitha kategoritë sociale e fetare. Shpirti lirik dhe improvizimi kanë qenë tipare të rëndësishme të këngës aheng. Të kënduarit ishte pjesë e rëndësishme e të bërit muzikë; edhe këtu teknika vokale ndryshonte gjerësisht nga tradita muzikore vendase apo edhe e zonave të tjera të Shqipërisë. Duhej të kishe zë të fortë prej tenori që lartësohej nga toni në ton.

Tradita e formacioneve shoqëruese të këngës aheng shkodran është e gjatë dhe lidhet tërësisht me zhvillimin e saj. Grupi më i hershëm që njohim deri sot është ai i krijuar nga Mehmet Shllaku në fund shek. XVIII. Instrumentet janë të huajtura nga muzika orientale. Instrumenti bazë në shqërimin e saj që në fillim të jetës dhe deri në vitet 40 të shek. XX ishte sazja.

Tiparet dalluese e kanë bërë këngën aheng unike në të gjithë Shqipërinë. Ashtu si edhe krijuesit popullorë e profesionistë që i dhanë shpirtin e tyre apo dhjetra këngëtarë, të cilët e përcollën dhe i dhanë kuptim këngës në çdo kohë (mbi 700 bartës të saj), një punë të çmuar kanë bërë edhe hartuesit e melografët, duke ia transmetuar brezave që ta njohin atë. Edhe studiuesit, muzikologët, etnomuzikologët, të cilët kanë studiuar dukuritë që lidhen me këtë kulturë muzikore specifike, kanë rëndësinë e tyre.

Bibliografia

- *B. Aksag. Inheritance of the makam music in Ballkan. 2002.*
- *B. Aksag. Makam System. 2002.*
- Dungu, Pjetër. *Lyra shqiptare.* Romë: 1940.
- Gurashi, Kol. *Të dhëna bibliografike mbi disa këngëtarë popullorë.* Almanaku Shkodra, nr.234, 1962, 2963, 1964.
- Gurashi, Kol. *Palok Kurti dhe këngët e tij.* Dorëshkrim.
- Gurashi, Kol, Gj. Sheldija. *Këngët e ahengut.* Dorëshkrim.
- Sokol, Shupo. *Folklori muzikor shqiptar.* Tiranë: 1997.
- Zadeja, Tonin, Tonin Daija. *250 këngë shkodrane.* Shkodër:2000.

Arben PRENDI

KANGA POPULLORE SHKODRANE ME MOTIVIN E DASHUNISË

Kanga popullore qytetare shkodrane asht ndër ma të bukurat e folklorit shqiptar, mjafton me shfletue vetëm njërën prej përmbledhjeve të shumta me kangë popullore të botueme prej kësaj tradite të pasun: përmbledhjen *Kangë popullore shkodrane* të Kasem Taipit, në serinë *Mbledhës të folklorit 11*, Tiranë 1998, të përgatitun për botim nga i ndjeri dr. Selami Tabaku.

Dashnia dhe ndjenja komplekse e marakut

Veçanërisht u ndala tek kanga qytetare për dashuninë e cila shquhet për disa perla të vërteta të këtij arti, siç janë: *Marshallah bukurisë sate*, *Një këllëf me ar ta çova*, *Qysh në vakt të njasaj furi*, *Ti bylbyl qi këndon në pranverë*, *kenke nuri i bukurisë*, *Asaman mori Bakushë* etj. Përveç tekstit poetik e plot ndjenjë, meloditë e bukura të këtyre kangëve janë ba të pashlyeshme në kujtesën tonë nga kangëtarët e shkëlqyeshëm të traditës si: Marie Kraja, Luçie Miloti, Ibrahim Tukiqi, Bik Ndoja, Xhevdet Hafizi, File e Gjeloshi, Shyqyri Alushi e deri te brezi ma i ri i kangëtarëve bashkëkohës. Në shumë prej këtyne kangëve asht i pranishëm ndikimi i poezisë së shkrueme. Në to trajtohen marrëdhانيت mes djalit e vajzës të vendosuna në sfondin e përjetimeve personale por edhe në sfondin e mjedisit social e etiko-moral të kohës së krijimit të këtyre kangëve.

Ato karakterizohen nga ndjenja e dashunisë fatkeqe, e ndrydhun në vetvete, vetësakrifikuese, dashuni e cila nuk asht e mundun të realizohet lehtë në realitet, herë për shkak të mjedisit të ashpër zakonor dhe herë për shkak se vajza ka zgjedhun tjetërkënd, në zemrën e saj... Ban përshtypje nga këto kangë se autori i tyne asht zakonisht mashkulli. Asht ai që e shprehë vujtjen e dashunisë,

ndërsa femna asht e pranishme vetëm idealisht, por jo fizikisht, ajo mungon tue qenë e pranishme, si të thuesh shkëlqen me mungesën e saj. Ndaj shumica e kangëve burojnë nga vuetja e dashunisë së djalit për vashën e zemrës së tij, paçka se ajo ndoshta nuk ka për ta marrë vesh kurrë këtë. Pra, dashunia e pafat, me të cilën autori i kangës pajtohet, vuen dhe e kthen në art, si në kangën *Marshallah bukurisë sate: Vetvedin për ty e bora,/ e s'po dij, moj, se ku jam,/ prej zemre të zemrës të hoqa/ pse je e bukur, faj t'të kam*^{*)}.

Idealizohet bukuria e vashës dhe mungesa apo mospërfillja e saj në kangën *Një këllëf me ar ta çova: Si lis me gamba më je hapë/ e s'po dij se ç'mende ke,/ mue po don me më çartë/ e me më shti të gjallë në dhe*^{**)}. Kjo lloj bukurie asht hijerandë, mospërfillëse dhe mund të soditet si diçka e pamundun, në distancë, sepse ajo mund të sjellë edhe pasoja tragjike në mjedisin social.

Asht e çuditshme sepse shpesh mungon gëzimi, hareja, lumtunia në këto kangë. Ajo asht një bukuri madhështore, por me një hije të randë vdekjeje, që asht deri diku stërzmadhimi i efektit tragjik të kësaj bukurie, e cila nga burim jete, paradoksalisht, mund të kthehet në shkak vdekjeje të tmerrshme, siç asht futja gjallë në dhe, apo varrosja për së gjalli. Shembull të kësaj natyre gjejmë edhe te kanga *Iptida due me fillue: Edhe një her'po due me t'dashtë,/ masandej po due me dekë,/ më ke vue shami t' mëndashtë/midisin me gishta t'zez*^{***)}. Kurse te kanga: *Sa e bukur ishte Gjyla, bukuria e vashës i merr në qafë djemtë, në kuptimin abstrakt ata janë gati të bajnë gjithçka për bukurinë e saj, por edhe në kuptimin konkret në mjedisin tonë zakonor, bukuria e femnës dhe përpjekjet për zotnimin e saj, shpesh bahej shkak për grindje deri edhe vrasje. Kjo lloj bukurie e luen mendsh njeriun, si në kangën *Njajo molla n'gemb t'vet: jam i gjallë e m'ban të dekun/ kur të shiqoj, prishem ndër mend*^{****)}. Në një kangë tjetër vasha e paralajmëron djalin të ruhet prej bukurisë së saj: "Rueju, djalë, se m'shastise/ se jam nuri i bukurisë"^{*****)}. Ndërsa në kangën *Në Shkodër tonë ka ra një dritë, bukuria e vashës ndriçon krejt qytetin: Në Shkodër tonë ka ra një dritë/ ka lshue rreze**

*) * F. 116.

**) * Kasem Taipi, *Kangë popullore shkodrane. Mbledhës të folklorit 11*, Tiranë 1998, f. 116.

***) * F. 123.

****) * F.227.

*****) * F. 230.

anë për anë,/ perëndija t'ka goditë,/ kusur, moj, s'të ka lanë^{*)}.

Megjithatë në këto kangë gjen shprehje një liri e madhe emocionale dhe një kërkesë që çon në emancipim dhe liri ndjenjash. Autori i kangëve atë që shpesh ishte e kufizueme në realitet e shpreh lirisht dhe me guxim në krijimin e tij poetik, si në kangën : *Të due përmbi gjithkënd. Të due, të due,/ të due përmbi gjithkënd/ n'kqyrsh me m'ba keq mue/ të pasha në hallin tem*^{**}). Jo rrallë realiteti në të cilin jeton vasha shkodrane asht i ngjashëm me atë që këndon kanga tjetër: *Kenke nuri i bukurisë: Rreth e rreth n'avulli,/ porsi fëllanxa në kafaz/ marshallah moj shtatselvi/ del në xham, se po pëlcas*^{***}) ku vajza asht e mbyllun në shtëpi e rrethueme me mure dhe djali duhet t'i lutet kojshisë të presë manin që i ka zanë pamjen e shtëpisë së saj. Dëshira finale e të dashnuemve përputhet edhe me normën etiko-morale të mjedisit, të lidhen së bashku dhe të ndërtojnë çerdhen e tyne të re, shtëpinë e tyne.

Struktura artistike e këtyne kangëve ndërtohet propocionalisht në dy linja:

përshkrimi i bukurisë fizike të vashës si dhe përjetimi personal i ndjenjës së dashunisë dhe pasojave emocionale të saj mbi një dialog imagjinar mes djalit dhe vashës, ku zakonisht flet djali dhe vasha mungon.

Djali vajton dashurinë fatkeqe e cila prodhon vuetje për shkak të mosrealizimit. Shkak i dashunisë fatkeqe është ose mjedisi patriakal ose mospërfillja e vashës, si në këtë shembull: *Moj e vogël porsi voeja: Çka t'i baj, t'ma flasë një fjalë,/ çka t'i baj t'flas'me mue,/ t'i nap mollë e t'i nap ftue/ Hajt he qen, se nuk të due/ shko atje-o ku je msue*^{****}).

Ose tradhëtia e saj, mosmbajtja e besës së dhënë: *Jaraninë qi kena pasë,/ nuk ma mbajte more djalë,/ m'orave e s'më le t'gjallë.*^{*****}) Ose si në kangën *Ah sa shpejt ma vune kambën: Ah sa shpejt ma vune kambën,/ e n'rrug' m'hase, me sy s'më shiqon/ kur të shof se ma merr anën/ zemrën ma çon peshë.// Me e ditë ti se ç'jam tue hjekë,/ dhimë do t'kesh , moj*

*) * F. 130.

***) * F. 118.

****) * F. 120.

*****) * F.161.

*****) * F.147

bukuri/ a mendon se ke me dekë, mori drita e syve të mij)*

Me u mbrojtë prej mjedisit ata zgjedhin fshehtësinë e cila ndonjëherë zbulohet si në në kangën O zambaku i bardhë: O zambaku i bardhë/ fort u deshtme bashkë./ fort u deshtme e kush s'na diti/ veç zoti ynë dhe shpirti./ e hana qi na ndriti/ hana na paditi**)

Dashunia këtu del sistematikisht si *marak*, ndjenjë e cila asht gjendje komplekse mes dashunisë fatkeqe, domosdoshmërisë për komunikim, por edhe dëshirës së fshehun për kontakt fizik dhe realizim shpirtnor. Maraku shpesh provokohet nga bukuria e jashtëzakonshme e vashës së zemrës, bukurie cila të godet që në shikim të parë, si në kangën *Maraku ma i rand se plumbi: Maraku ma i rand' se plumbi./ paske zemrën katilleshë./ bij me fjetë e s'më merr gjumi? Jan'kah m'losin mendt prej kresë.// Ky marak fort më mundoi./ tash dy vjet e ra ndër tri./ fush'e male do t'i kërkoj./ e do t'bahem jeremi***). Ose në një shembull tjetër: *Jam ba faret si budallë: Jam ba faret si budallë./ e s'kam hak me t'kqyrë me sy./ plasa i mjeri për të gjallë/ qysh se m'xen maraku n'ty.****) Maraku e kapë edhe vashën e cila në kangën *Vaj bre djal çka asht maraku: Vaj bre djal çka asht maraku/ ti hala s'e ke provue./ me i pas vue vesh fjalvet t'hallkut/ ti ka dit' kishe mbarue*****)***

Paralelizimi me natyrën, veçanërisht me lulet, karajfili, zamaku i bardhë, vjollca, drandofilli, zymyli, maragylti etj, me shpendët, bylbyli, pllumbi, thllanza, me frutat molla, dardha, kumbulla, shega, ftoi etj. këto elemente nga bota bimore dhe bota e gjallë natyrore shpesh marrin kuptime simbolike për të shprehur në mënyrë alegorike gjendje të caktuara shpirtnore duke e pasurue tekstin e kësaj lirike me cilësi të mirëfillta artistike.

*) * F. 140.

**) * F. 232.

***) * F. 136.

*****) * F. 168.

*****) * F. 178.

TONIN ÇOBANI

**NJË TEKST POETIK I VJETËR SA VETË
MELODIA QË E KA PËRCJELLË SI KËNGË**

*(Mbështetur në notëzimin e valles 'Mori drandofillja e bardhë' të
Gjon Kujxhisë)*

Poezia shqipe dokumentohet e shkruar shumë vonë, ashtu si vetë gjuha shqipe e shkruar. Por, sikundër vërtetohet se gjuha e sotme shqipe është vazhdim i gjuhës së ilirëve, duhet pranuar se edhe poezia e sotme shqipe i ka modelet e veta më të hershme në kulturën ilire, që është ndër vlerat më të lashta të Mesdheut. Muzikologu Gjon Kolë Kujxhija në parathënien e librit tij "*Valle kombëtare*" flet për vjetërsinë e melodive, me të cilat janë përcjellë këto vargje poetike. Ai thotë: 'Edhe pse të shkurta e të thjeshta, janë [melodi, dhe vargje - shtoj unë] shumë të bukura dhe shprehëse. Ndër to gjejmë gjithfarë elementash: fuqi, ambëlsi, sinqeritet, mysticizëm etj., shprehje e vërtetë e shpirtit t'onë.'^{*)} Sa i përket teksteve, këtë hershmëri e vërtetojnë disa tufëza vargjesh, të mbetura si fosile, që vijnë deri në epokën moderne si modele të pakrahasueshme të artit të fjalës së bukur. Më së pari ato janë disa fragmente lirike të poezisë gojore shqipe, të cilat vazhdojnë të gjallojnë deri në ditët e sotme në ceremonialet tradicionale të dasmës dhe të mortit, apo ndër rituale kremtimesh, që për nga përmbajtja na duken të jenë të epokës parakristiane. Gjon Kujxhija shkruan: valët [muzikë, poezi dhe danzë] janë muzika ma e vjetra, ma origjinale, dhe me e bukura qi kemi trashiguar prej të parve t'onë.'^{**)} Në tekstin e një kënge, që njihet me titullin 'Mori drandofillja e bardhë', regjistruar me nota muzikore, së pari, prej Gjon Kujxhisë, thuhet vargje me një figurshmëri kaq të ngurtësuar sa që vajzat,

^{*)} * Gjon Kujxhia, "*Valle kombëtare*", Vol.I, 'Dasëm shkodrane', Firenzë, 1943, f. VI-VII

^{**)} Po aty, f. IX

që i këndojnë, zor se ua dinë më kuptimin. Nga ana tjetër, aty vërehen simbole iliro-mesdhetare me ngarkesa mistiko-rituale tanimë të harruara, si janë: numri nëntë (ku mrzozjshin nândë oqiç/ Nândë oqiç me nândë kumbonë), që ka lidhje me ciklin hënor.

E njëjta gjë mund të thuhet për figurat gjeometrike rrethore (Të gjithë një vashë po i rrotullon), që simbolizon diellin, sikundër disku (rrethi) në shklop (Të gjithë një vashë po i rrotullon/ me një thupur...) që simbolizon plejshmerinë lidhur me gjarpërin (kulti kryesor i ilirëve^{*)}), një lloj orgjie dioniziane, përhapjen e së cilës në brendësi të Ballkanit ilirologët e shpjegojnë me një tregim për lindjen e Aleksandrit të Madh, nga e ëma, Olimbia (fisi ilir i Mollosve), në bashkim mitik me një perëndi gjarpër (duke aluduar për Kadmin).

Por, si duket, nëse ato që i kanë bartur gojë më gojë këto vargje poetike ndër shekuj ua kanë humbur kuptimin, e ndjejnë emocionalisht atë që këndojnë nga melodia, ritmi dhe solemniteti i ceremonialit të dasmës ku vajzat këndojnë për nusen por, më shumë, për vetën e tyre. Sot kjo ndieshmëri mund të merret me mend, po të konsiderojmë si fjalëkyç vargun e fundit, një varg si kontrapunkt ironik, që përmyll këngën dhe orienton interpretimin e të gjithë vargjeve, duke përfshirë simbolet e lashtësisë dhe metaforat e ngurtësuar. Gjon Kujxhija do të thoshte `e këtu ndijmë "minorën"^{***)}. Ai varg ironik është: marinari " lypte vashën virgjineshë". Pra, kemi të bëjmë me një tekst poetik ku hymnizohet feminiteti dhe ironizohet një lloj morali që i bie ndesh natyrshmërisë. Është, afërsisht, koha kur virgjiniteti është institucionalizuar si normë morale, d.m.th., është koha kur patriarkati ka arritur në fazën e vet më të konsoliduar, që në Shqipëri ka zgjatur deri në fund shekullin e kaluar. Të asaj epoke duhet konsideruar ngjizja fillestare e atyre vargjeve që vijnë të ngurtësuar figurativisht deri në kohët moderne. Gjon Kujxhija flet për racën tonë të Iliro- Thrakëve, pjesëtarë të familjes së madhe indo-europiane`. Ai shton se `Shqipëria ka qenë përherë një urë kalimi, qi ka bashkue perëndimin me lindjen; Romë-Athinë, Romë- Kostantinopol^{***)}.

*) *Shih Aleksandëer Stipçeviq, Ilirët: historia, jeta, kultura, simbolet e kultit, Toena, Tiranë, 2002.*

**) *Gjon Kolë Kujxhija, ve për e cituar, f. VIII.*

***) *Po aty, f.VIII.*

Kështu vallja “Mori drandofilja e bardhë” vjen si një lirikë e kënduar, në tekstin e të cilës ka vargje që mund të merren, ndoshta, si ndër më të hershmit në gjuhën shqipe. Varianti i parë i saj u botua në fillim të shekullit XX nga shkrimtari Vinçens Prennushi (~ Kangë popullore gegnishte ~, Sarajevë, 1991); i dyti, rreth tri dekada më vonë nga folkloristi Kasem Taipi (‘Zana popullore’, Tiranë, 1933); i treti nga etnomuzikologu Gjon Kolë Kujxhija (‘Valle Kombëtare, Vol. I, Dasëm Shkodrane’, Firenze, 1943.) të cilin e kam zgjedhur si variant bazë të këtij studimi, pasi është i pari i regjistruar edhe si notëzim muzikor; i katërti vjen nga folkloristi Qemal Haxhihasani (‘Balada popullore shqiptare’, Tiranë 1982) dhe i pesti nga muzikologët Tonin Daija dhe Tonin Zadeja (‘250 kangë qytetare shkodrane’, Shkodër 2000), të cilët kanë riprodhuar notëzimin e Gjon Kujxhisë.

Fragmente të kësaj kënge janë gjetur edhe ndër arbëreshët e Zarës, në malësorët e Bregut të Matës dhe në Zadrinë, prej nga duhet të jetë mbartur në qytetin e Shkodrës.

Melodia që shoqëron tekstin është një frazë e vetme muzikore, e cila këndohet pa shoqërim instrumental (‘a capella’) nga një kor vajzash në ditët para dasmës dhe në shtregulla. Vajzat vendoseshin në dy radhë dhe këndonin duke shoqëruar vetëm me lëvizjen e njëres këmbë para-prapa. Në qendër të secilit grup qëndronin solistja (varianti i Zadrinës). Kompozitori Preng Jakova e paraqiti në skenë këngën ‘Mori drandofilja e bardhë’ si pjesë të tabllës muzikore ‘Dasma Shkodrane’ (1947). Duket se që nga ajo kohë në qytetin e Shkodrës nuk këndohet më ‘a capella’ dhe nuk ruan elementët e tjerë të interpretimit ritual-koreografik. Ndërsa motivi muzikor i saj u shfrytëzua nga kompozitori Çesk Zadeja si lajtmotiv kryesor në ‘Simfoninë Nr.1’ (1956), që është edhe simfonia më në zë shqiptare e shekullit XX.

Analiza tekstologjike na sugjeron të dallojmë disa shtresëzime të vargjeve, prej të cilave ka rëndësi ai më i vjetri, që lidhet me ceremonialin e dasmës, si ritual i çiftë zimit apo zhvirgjinimit për vajzën që do të bëhet grua. Nisur edhe nga partitura muzikore, mendojmë se struktura ritmike e vargut është bazuar në sistemin kuantitativ të zanoreve (konkretisht në këmbën e tipit-vvv), sistem që nuk funksionon më në poezinë shqipe, pasi vargëzimi i sotëm shqiptar bazohet tërësisht në sistemin silabo-tonik (bën përjashtim të pjesshëm poezia e shekullit XVII). Edhe ndërtimi

i disa figurave vjen i ngurtësuar, si fosile e një fleksibiliteti të hershëm poetik të gjuhës: mora gjethin me ty (ndërrova veshje, u riformova, u bëra zonjushë, jam gati për të çelur, për t'u bërë grua), pra, jam gati të marr detin me sy...me një thupur [të] xën lejthin, por edhe të pranoj dhimbjen e pasojate tjera (*pikoi lodja e ran ë det/u ngrideti akull-o*).

Më lejoni tani të ndalem te teksti o këngës 'Mori drandofillja e bardhë', duke krahasuar të katër variantet

Mori drandofillja e bardhë!

Kúr mora gjethin me ty,^{*)}

Mora detin-o me sy.

Në mjedis të detit-o,

Ish një lis i vogël-o.

Sá i vogël lisi ishte,

Sá të madhe hije kishte.

*Kú mrizojshin nândë oqiç,^{**)}*

Nandë oqiç me nândë kumbonë,

Të gjithë një vashë po i rrotullon.

*Me një thupur xën lejthin,^{***)}*

*Na i rá marinarit në sy.^{****)}*

Pikoi lodja e rá në dét;

U ngri deti akull-o;

Mbeten barkët shakull-o;

Barkaxhisë na i rá lëngimi;

Lypte gjana qi nuk ishin:

Lypte mish leprit të thînet,

Lypte djathë fëllanxe t'butë,

Lypte vashën virgjineshë.

(Gjon Kolë Kujxhija 'Valle Kombëtare, Vol. I, Dasëm Shkodrane', Firenze, 1943, f.2)

Dhe për të përfunduar, kërkoj leje për një koment disa vargjeve të Gjergj Fishtës që i referohet këngës "Mori drandofillja e bardhë" (Lahuta e Malcis", Kanga XXIV, "Zana e Vizitorit", vv. 530 – 572.): "E n'atë t'amblen gjuhë shqiptare / Te një lis a nën ndo'i dardhë /

*) Variant: 'kur mora gjethin në ty' (Taipi), 'kur mora gjethin më ty' (Haxhihasani).

**) Variant: 'ku mrizojshin nand-e grigje' (Prennushi, Haxhihasani)

***) Variant: 'me një thupër gem lejthi' (Taipi, Haxhihasani)

****) Variant: 'na i ra marinarit n'ÿy' (Prennushi), 'na i ra djalit në sy' (Taipi), na i ra manarit n'ÿy' (Haxhihasani)

unë kendo, po, e ti kendo, / Si këndon zogu i verës-o, / Mori drandofillja e bardhë!")*

Ky Zogu i verës i zë vendin marinarit të këngës popullore. Është një zog "i vocërr" dhe "i mjerë". Heroina e "Zanës së Vizitorit" (Tringa), e mban në dorë (në robëri), por në robëri a këndohet? S' del kanga në robin", thotë poeti.

Me gjithë atë, në vargjet: "Se tash del, po, prap pranvera, / Prap tash njethen gjeth e lule, / E me u de ka bora malit, / Me rrëmbye kan' përrojet zallit." realizohet një përshkrim i gjallë i ndërrimit të stinëve. Duket sikur përcillet shprehëshmëria e vargut "kur mora gjethen me ty". Më i fuqishëm bëhet ai përshkrimi i Fishtës kur i bashkohen edhe tingujt festivë të veglave muzikore ("E tash bien fej e zamare, / Tash tingllojnë linge e koçana (zile e këmborë), në sa vashat

(blegat) vijnë me mollëza të skuqura flakë ("Tash këndojnë bari e blega (barinj e baresha), / Blegat, mollëzat kuq si shega..")

Dhe vargu me sinergji universal ("Prap tash këndon ai zogu i verës"), që shpreh lidhjet e brendshme dhe të misterhme të poetit tonë Kombëtar me vargjet e këngës popullore ("Mori drandofillja e bardhë") që tashmë e kemi të notëzuar nga Gjon K. Kujxhija e të shfrytëzuar në krijimtarinë e muzikantëve të tjerë pas tij.

*) □ Vargjet e "Lahutës së Malcis" citohen nga Gjergj Fishta, *Vepra letrare 4, Epika* : "Lahuta e Malcis" dhe "Mojs Golemi", përgatitur nga Dr. Tefë Topalli, EBP : "Gjergj Fishta" & Gollettiana, Lezhë, 2002, f.449-450)

▪Filateli▪

Hysen S.DIZDARI

DOM NDRË MJEDA NË FILATELINË SHQIPTARE

(me rasë të 81- vjetorit të largimit nga jeta të dom Ndre Mjedës)

Dom Ndre Mjeda, lindi në Shkodër më 20 nëntor 1866 dhe u largue nga jeta, më 1 gusht 1937. Mjeda ishte teolog, shkrimtar, gjuhëtar, deputet shqiptar por dhe një nga poetët më të shquar të kombit shqiptar. Jakov Milaj në veprën e tij “Raca Shqiptare”, Ndre Mjedën e cilëson “nji ndër letrarët ma të mëdhaj qi ka qitun Shqipnija”.

Prof.Dhimiter Shuteriqi , duke vlerësu Mjeden si poetë thekson: *“Cilësit artistike të Mjedes janë të mëdha .Vargun e ka të përsosur,është mjeshtër i rrallë i strofkës dhe i tingullit. Ai është shembull i një ndergjegjëje artistike në historinë e letresisë sonë”.*

Posta shqiptare i ka dhënë vendin e merituar teologut, poetit dhe atdhetarit shquem ,Dom.Ndre Mjedes.


Emisioni i parë kushtue Dom Ndre Mjedës i emetuem në nëndor të vitit 1966, titullohet: “Ndre Mjeda”.

Ky emision përbahet prej dy pullave me vlerë 25 qindarka dhe 1,75 lekë.



Emisioni i dytë kushtue Dom Ndre Mjedës i emetuem më 17 Gusht 2016 , titullohet: “Figura të shquara kombëtare”

Ky emision përbëhet nga tre pulla me vlera të ndryshme .
Pulla me vlerë 10 lekë i kushtohet Dom Ndre Mjedes.



Ky emision u shtyp në 304.500 copë pulla postare dhe FDC në 250 copë
Me rastin e 81- vjetorit të largimit nga jeta të Dom Ndre Mjedes po ju kujtoj shqiptarve një pjesë nga poema e tij .
Poema e famshme “Liria” është shkruar në vitin 1911, në pragun e shpalljes së Pamvarsisë së Shqipërisë, por pau dritën e botimit vetëm pak para vdekjes së autorit në vitin 1937.

LIRIA

- I -

O shqipe, o zogjt’ e maleve, kallzoni:
A shndrit rreze lirie n’ato maja;
mbi bjesh’ t’ thepisuna e n’ograja,
ku del gurra e gjëmon përmallshëm kroni?
A keni ndie ndikund, kah fluturoni
ndër shkrepë, me ushtue kangën e saj?
A keni ndie një kangë të patravajë?
O shqipe, o zogjt’ e maleve, kallzoni!
“Lirim, lirim!” -- bërtet gjithkrah malsia.
A ka lirim ky dhé që na shkel kamba,
a veç t’ mjerin e mblon anemban’ robnia?
Flutro shqipe, flutro kah çelet lama,
sielliu maleve përreth që ka Shqipnia,
e vështroje ku i del lirimit ama.

.....

- VI -

Por nuk u shuejt edhe, jo, shqiptaria:
Lodhun prej hekrash që mizori e njiti,
lodhun prej terri ku robnimi e qiti,
shpreson me e zgjue fluturim mënia.
E kqyre: Ndër male po përhapet shkëndija

e lirimit t' Atdheut; fshehtas shëtiti
kasoll' për kasoll' rreth buneve e soditi
frymë të re tue zbrazun për gjithkah, hija
e Skanderbegut. Që ndër djepa rritin
nanat e Hotit djelmënin' ushtore
e idhnim n'armikun nëpër gji iu qitin.
E nalt, ndër maja, bukuri mbretnore.

▪Bibliofili▪

Gjovalin ÇUNI

KULTURA ISLAME NË KONTEKSTIN E PERIODIKËVE SHQIPTARË

Informacioni mbi veprimtarinë dhe krijimtarinë publicistike të pranishme në shtypin e përditshëm e periodik shqip, mbart dhe dinamikisht merr vlera me kalimin e dekadave. Mbështetja mbi trashëgiminë publicistike është e vlefshme si për njohjen e zhvillimeve nëpërmjet fakteve, dukunive ashtu edhe vlerësimeve të tyre nga bashkohësit dhe brezat.

Pak retrospektivë

Historia e publicistikës shqiptare fillon jashtë Shqipnisë, qysh në vitin 1848, kur Jeronim De Rada, në Napoli *fillonte botimin e gazetës së vogël "Arbëreshi i Italisë"*. 64 vitet e para të shtypit shqiptar u shoqruan me një sërë titujsh të tjera revistash dhe gazetash, që nuk përfshijshin vetëm kolonitë e shqiptarëve, por edhe trojet shqiptare të gjëndura nën sundimin turk. Kështu në vilajetin e Kosovës u botuan dy tituj gazetash "Prizreni" dhe "Kosova", krahas "Vjetarit të Vilajetit" (botim kryesisht statistikor i shtetit turk). Në kufijtë pak a shumë të sotëm administrativë të shqiptarëve, është pranuar nga të tanë se Shkodra, ishte qyteti ku numëroheshin më shumë botime. Vetëm gjatë periudhës së Rilindjes u botuan 9 (nandë) organe të shtypit në gjuhën shqipe dhe 1 (një) në gjuhën turke. Më 24 qershor 1879, filloi botimin e saj në Shkodër në gjuhën turke, por edhe me numra në shqip (gegnisht) gazeta e përjavshme "Ishkodra", *organ zyrtar i Vilajetit të Shkodrës*, '... e përjavshme me 4 faqe në turqisht, e pjesërisht shqip'. Gazeta kishte karakterin e një Fletoreje zyrtare me format 50*30 cm. Në të publikoheshin lajme të brendshme të Vilajetit të Shkodrës, por edhe të jashtëme, ngjarje, emnime, transferime, pushime nga puna, lidhje kontratash etj. Gazeta botohej në shtyshkronjën e Vilajetit. Në të njëjtën kohë me gazetën

“Ishkodra” pâu dritën e botimit në vitin 1891 edhe revista e jezuitëve: “Elcija e Zemers t’Jezu Krishtit” (botim tansisht në shqip); vjetari “Iskodranin Vilajeti-I Salname “(1894), dhe mâ mbrapa, me fillimin e shekullit XX, edhe shtatë organe të tjera, si: “Vjetari”, “Shqyptari (1904, shqip), organi i shoqërisë “Bashkimi”, “Xani i Shqyptarve”, “Dishiri” (1905-1906, shqip)”, “Shkodra (1909-1910); “Koha –Bashkimi” (1910-e përdyjavshmja), “Dielli” (1910, shqip-italisht-turqisht), gazeta “Hana” (1911-1912, italisht –shqip) dhe “Kalendari Vjetor” i klerit jezuit (1911-1928, shqip). Historinë e shtypit shqiptar studiuesit e ndajnë në gjashtë periudha. (1884-1912, 1912-1924, 1924-1939, 1939-1944, 1944-1990, 1990-deri në ditët e sotme). Pa i përmendun ato duhet theksú se në çdo periudhë Shkodra pati organet e saja. Numri i përgjithshëm i gazetave dhe revistave deri në vitin 1944, ndonëse jo tansisht i përcaktuem është në rreth 65. E teksa përmend statistikát e botimeve, nuk duhen harrue, përkundrazi duhen respektue, bashkëpunëtorët e gazetave që me të drejtë, siç shkruhej në shtypin e kohës “...arrijtën apothezen mâ te nalta te vepres dhe idealít te tyne.

Shtypi islam

Zani i Naltë

Një periudhë e rëndësishme në zhvillimin në përgjithësi të gazetarisë, cilësohet koha e súndimit të mbretit Zog. Me këtë periudhë është lidhun edhe zhvillimi publicistikës fetare islame. Në tetor të vitit 1923, menjëherë mbas ngritjes së institucionit të Komunitetit Mysliman Shqiptar filloi botimin në Tiranë revista e parë zyrtare e këtij komuniteti me emnin: “Zani i Naltë”, me administratë drejtuese, drejtor të parë Ismail Maçi dhe me drejtorë tjerë mbasárdhës: Shyqyri Myftiu, Isa Domi, Haki Sharofi, *“personalitete këto- siç thekson Genti Kruja- të shquara të kohës, të cilët me përgatitjen të lartë të kulturës dhe shkencave islame, por edhe të shkencave të tjera i dhanë një dimension shumë të gjërë revistës, e cila bëri jehonë të madhe, në të gjithashtresat intelektuale të kohës, dhe jo vetem”*. Studiuesi italian Dela Roka”, thekson: “.. se krahas frymës së triumfalizmit të të vërtetave të fesë islame, revista kishte edhe tone të spikatura patriotike dhe radhitet pa rezerva në një reformë të islamit shqiptar, në një drejtim modernizues.”

Revista në fjalë, me një periodicitet pak a shumë mujor u botúe

shqip dhe në arabisht me 32 faqe dhe njofti botimin me këtë emen deri në fund të vitit 1938. Ndonëse revista botohej në Tiranë ajo me shumë faktorë ishte e lidhur me Shkodrën, jo thjesht nga bashkëpunëtorët, por edhe prej fakti, që një pjesë u shtyp në Shkodër, në shtypshkronjat: “Ora e Shkodrës” dhe “Shkodra”. Mâ vonë tuj zbatue rregullat zyrtare të publikimit, ajo u lejue me u botu nëpërmjet shpisë botuese: “Ora e Shkodrës”.

Përmbajtja e revistës, struktura dhe bashkëpunëtorët tashma janë studiue imtësisht, nga Genti Kruja në parathënien e botimit ananstatik të revistës, “Kultura Islame” realizue nga Komuniteti Musliman Shqiptar në vitin 2014.

Pas disa dekada shkëputjesh kjo revistë ka rifillue botimin e saj si një revistë shkencore, kulturore, periodike tremujore në fundin e vitit 2012, me drejtor Genti Kruja.

Kultura islame

Me fillimin e vitit 1939, revista “Zani i Naltë” vijon botimin e saj, “*me një shej barazimi në përmbajtje*”, por kësaj radhe me një emen tjetër: “Kultura islame”, që vijoi me dalë deri në vitin 1945, me Sherif Putra redaktor, Vehxhi Sulejmani, përgatitës etj.

Ndryshimi i emnit, ndodhi në kushtet e reja kur Shqipnia hýni në një fazë të re historike, në atë të pushtimit italian. Përpjekjet e italianëve me pasë nën kontroll tanë shtypin, u shoqnuen me mbylljen e një pjese të gazetave të periudhës së Mbretnisë shqiptare, dhe me përpjekjet kthimit e të atýne që mbeten në organe thjesht propogandistike. Natyrshëm kësaj përpjekje nuk mund t’i shpëtonte edhe shtypi islam, sidomos në rastet e përvjetorëve, dhe të vizitave të personaliteteve shtetënore italiane në Shqipni. Përballë kësaj situatë, përjashto ndonjë ndjesi personale, gjithnjë komuniteti islam gjeti një rrugëzgjidhje tûj ja ndryshue nga njena anë emrin e revistës, dhe “*u përpoqën me aq sa mundën të qëndrojnë larg nga politika* (B.Fevziu). Siç u permend ma nâlt ndryshimi i emnit nuk u shoqënue me ndryshimin e platformës. Motoja e revistës ishte: *Fe/ Letersi/ Dituni/Artistike, ndërsa objektivi: shpirtin e fese, unjism e kulturës së Djelminisë Muslimane Shqiptare, çfaqëjet e mendimit të Popullit Shqiptar, rregjistrim e ngjarjeve e letërsisë Shqiptare, ngjallja ndër të rinj e ndjenjat e nalta fetare, shoqnore, vllaznore e atdhetare*

“*Pa rënë në subjektivizim të skajshëm, i cili e ka burimin tek orientimi ideologjik*” dhe *profilizimi i saj*, (A.Muka), revista “Kultura islame”,

si trajtesë ishte veçantë, krahasue me mediat e shumta të kësaj periudhe, ku ndihej fuqishëm fryma fashiste, si: “Jeta shqiptare”, “Shqipëria e re”, “Shkëndija”, “Bota shqiptare”, “Vullneti”, “Kosova”, “Fashizmi”, “Tomorri”, “Tomorri i vogël”, “Bashkimi i Kombit etj”, realisht vijonte me kenë pjesë e begatisë së botimeve të kohës.

“Revista- sic shkruan – A. Muka- vijonte të ishte një pasuri e tërë kulturore, nëpërmjet së cilës pasurohet niveli i mendimit teologjik shqiptare, gjatë tërë periudhës së postopavarësisë” Ekzistenca dhe vijueshmëria e revistave bazohen në disa faktore, mes të cilave permenden programi, zakonisht i shpallun në numrin e parë të çdo reviste, bashkëpunëtorët që mbajnë gjallë revistën, garancia financiare, reklama e deri tek shpërndarja.

Po morëm në dorë revistën kâ me u pa se në të bashkëpunuën emnat dhe pëndat ma të mira të kohës, të çveshura nga çdo lloj mentaliteti, që i takojshin jo vetëm spektrit të besimit islam, por edhe atij katolik. Revista mund të përkufizohet, si: “një palestër kulturore”, ku të rinj, emna të mëdhenj të së ardhmes me dije pjesa ma e madhe të përfitueme në vende europiane, por jo vetëm, arrijshin të përfaqnin talentin e tyne teologjik dhe kulturor.

Lista e bashkëpunëtorëve asht mjaft e gjatë, por më duhet më theksu, se larmija e formimit të tyne, i siguruan revistës jo vetëm origjinalitetin, por edhe larminë e trajtesave. Krahas problemeve fetare që xejshin vendin kryesor, në revistë u trajtuan edhe mjaft argumenta të etikës, sociologjisë, arsimit, letërsisë, (vepra origjinale dhe përkthime), probleme gjuhësore, trajtesa historike, folklor, etnografi etj.

Mes trajtesave nuk mund të lamë pa përmende edhe trajtesat me karakter albanologjik, mes te cilave spikasin edhe studimet mbi arbërëshët. Kjo temë, e trajtueme gjansisht edhe në revista të tjera të kohës, (si “Leka” nga Kolë Kamsi), nën trajtimin Izet Bebeziqit në disa numra të vitit 1939, me titull: “Shqiptarizmi jashta dhe brenda atdheut”, i rizbulon shkencës shqiptare mendimet e një përsionaliteti, të formuem jashtë vendit, (Austri, Itali) ish - nxënës i të famshmit Nobert Joklit, i fshehun dhe i panjohun, i mohuem e i nëpërkambun thjesht për arsye *politike të majta* në absurdin komunist. Me sygjerimet dhe rekomandimet e N. Joklit, Izet Bebeziqi, zbriti në vendbanimet arbëreshe për me studie në vend letërsinë e tyne, çka i dha landen e duhun

me realizue të parin transliterim të Milosao-s, punim i botuem në revistën “Shqipnia e Re” në Konstancë, në fund të viteve ‘20 të shekullit të kaluem. Transliterimi u përfshi edhe në antologjinë “Bota shqiptare”, të Filip Fishtës, tekst shkollor për shkollat e mesme. I. Bebeziqit i dedikohet, edhe organizimimi për herë të parë në Shkodër, i një veprimtarie përkujtimore kushtue Jeronim De Radës.

Bashkëpunëtori i vyem i “Kulturës Islame”, miku i Hafiz Ali Korçës, Arshi Pipës, Skënder Luarasit, Mons.Vicenc Prendushit, e sa të tjerëve, me përgatitjen e tij teologjike (pasi në fletët e revistës ka edhe polemika te karakterit fetar), dhe filologjike, jetën ja kushtoi, dijes dhe përhapjes së saj, tek të interesuemit. Ishte mësues, por ma së shumti punoi si bibliotekar. Libri zakonisht ndjekin fatin e zotënesit. Biblioteka personale “Illyria-Bebeziqi”, u shit dhe u keqpërdor ndër vite.

“Përkujtimi dhe homazhi për figurën e ndritun të prof. Bebeziqit – siç shkruen, N. Bushati- le të jetë pjesë e “borxhit” që Shkodra i detyrohet, nderimit të veprës së një personaliteti, e cila ishte një jetë e tanë e vume në shërbim të kulturës, e një intelektual me përmasa shumëdimensionale dhe njëheri e një punonjësi “model të bibliotekës”

Revista ashtu si simotrat e saj të karakterit fetar, të cilësueme nga komunistat, “me karakter të lartë ideologjik” u mbyll menjëherë, me vendosjen e atij rregjimi më 1945.

Tuj kenë e panjoftun ndër vite nga publiku, sidomos prej të rijve, në ditët e sotme shfletimi on-line i kësaj reviste është një mundësi për me njohë kontributin e vyer që revista “Kultura islame” ka dhanë gjatë gjashtë viteve të ekzistencës së saj.

Njeriu

Në korpusin e panjoftun të revistave, si trashëgimi publicistike islame është edhe revista e përmuajshme shpirtnore kulturore, “Njeriu”, organ i shoqatës “Drita Hyjnore”, me drejtor përgjegjës Sherif Puta. Revista u botue përgjatë viteve 1942-1944. Edhe kjo revistë ndër të tjera pati si qëllim “..zhvillimin nga çdo pikpamje të jetës sonë drejt përparimit të popullit e naltësimit t’Atdheut, nëpërmjet të parimeve të frymëzueme prej të vertetave fetare-filozofike”. Revista tashma është e publikue tanësisht si botim në vedit, prej shoqatës “Alsar’, drejtue nga Mehdi Gurra.

Përfundoj.Risjellja e botimeve retrospektive të revistave fetaro-kulturore islame, është një përpjekje e rivlerësimit të punës së

bâme nga brezat paraardhës në trasmetimin e vlerave të krijume nga mëndjet e ditura. Ata janë një mundësi për hapjen në ditët e sotme të dialogut fetar në shoqërinë tonë.

Bibliografi

- Blendi Fevziu. “Historia e shtypit shqiptar”. Tiranë, 2005.
- Genti Kruja. Kultura Islame. Botim anastatik. Tiranë, 2006
- Hamit Boriçi, Mark Marku. Historia e shtypit shqiptar. 2006
- [Roberto Morozzo della Rocca](#). “Kombësia e Feja në Shqipëri 1920-1944. Tiranë, 1994.
- Vullneti, 1929.

▪Letërsi-Art-Kulturë▪

Edhe në këtë numër të revistës “Gegnia” po vijojmë botimin e veprës “Lahuta e Malcisë” të atë Gjergj Fishtës, të përshtatur në prozë nga Skifter Këlliçi. Tue e falenderue autorin e përshtatjes, çmojmë punën e tij të censhme në këtë përshtatje e cila mendojmë se ka me i shërbye mjaft receptimit të veprës ma lehtësisht prej nxanësve të shkollave por edhe prej lexuesve të vegjël në përgjithësi.

GJERGJ FISHTA

LAHUTA E MALESISE

*Poemë epiko-historike, përshtatur në prozë, me shkurtime
nga Skifter Këlliçi*

KANGA E NJEMBEDHJETE

LUGATI

Kishte ra nata.

Knjaz Nikolla së bashku me gruen e tij, Milenën, po rrijshin pranë votrës, kurse fëmijët kishin ra me fjetë. Ai tymoste duhan, pinte venë dhe hante gështenja që e shoqja ia qëronte dhe ia vinte përpara. Dhe atëherë zuni t’i lëvdohej asaj tanë gaz:

- Ndëgjo, Milenë, turkun e mposhta, krajlat e Evropës mua më duen, kurse serbi dhe greku frikën ma kanë. Si të pushtoj Mostarin, në dorë do të shtij pastaj Shkodrën, Prizrenin dhe deri në Bullgari do të shkoj. Kështu bahem vërtet mbret. Atëherë dhe ty kam me të ba mbretneshë, kurorë kam me të vu kokë, dhe me arë kam me të mbulue, sepse udo që dielli shkrep mbi dhe, më trim se unë nuk ke me gjetë kurrë.

Qeshi Milena pas fjalëve të burrit të saj dhe heshti, sepse e shihte që ai fliste si i dehun nga vena që po pinte. Por, kur dëgjoji se fëmijët po qajshin, i tha e shqetësuese:

- Po shkoj t’i shoh se ata të shkretë, diçka kanë pa që gjumi nuk po i ze.

- Po çka paskan pa, moj grue, ia priti knjazi, që nuk dashkan të flejnjë, se ne këtu jemi dhe nuk kemi dëgjue ndonjë zhurmë!

- Nuk di ç’ka të them, por kur po luejshin nëpër kthina ë

pallatit, paskan pa të strukun mbrapa shtambave me ujë dikë me çallmë, si të ishte turk, me çibuk në gojë dhe qyrk4) mbi krahë, fytyrëzbehtë dhe buzëkërveshun, dhe me sy prej kah dilshin flakë. A mos ndoshta është lugat, siç po flitet gjithandej ? Sepse një turk i pabesë e faqezi atje poshtë oborrit kenka çue nga vorri dhe të kallka tmerr.

- A i ke mendtë në krye, Milenë, që nxjerr nga goja këto fjalë, se lugat a shtrigë në këtë shekull nuk ka, por kush e di se çka kanë pa ata, që u është dukë si lugat. Ai që des dhe futet në dhe, nuk kthehet ma në jetë. Po ju gratë merreni me dokrra, prandej më shih mue që merrem me njerëz të gjallë dhe as që më bjen ndër mend për të vdekunit.

- Mundet që lugetën të mos ketë, - tha Milena, - por jo shtriga, sepse, po të duesh, të njoh me një grue që këtu në Cetinë ka pa gra që dilshin natën dhe mandej prej pullazit porsi shkëndija futeshin brenda nëpër shtëpi dhe u xejshin në frymën njerëzve. Dhe në familje thojshin se ata kishin vdekë prej ankthit. Kurse vdekja u kishte ardhë nga shtrigat.

- Përralla, përralla, - u hodh Nikolla, - të tana janë përralla, sepse shtriga nuk ka askund! Por a di çka, moj burrneshë, meqë po thue se shtriga paska, a nuk m'i lëshon mue që të më përpijnë gjallë?

-Unë jam në hall, mor burrë, për fëmijët e shkretë që sonte m'i ka kapë frika, - ia ktheu Milena. - Por, çohu të bijmë dhe ne të flemë, se paska shkue vonë dhe ata janë tue na pritë.

Si tha këto fjalë, mbushë me maraz dhe me gjysë zani shtoi " natën e mirë", e shoqja shkoi të flente me fëmijët, të cilët vijoishin me kenë të friguem.

Qeshi Nikolla nën mustaqe e me i vu punëve kapak, mori dhe mbushi një gotë tjetër me venë, e piu, shkundi hinin e duhanit nga llulla, dhe shkoi edhe ai me fjetë në dhomën e vet ku shpejt filloi me gërhitë. Dhe qe, aty prej mesnate, knjaz Nikollës i doli gjumi dhe befas në mes të dhomës pa një njëri, ndenjun më këmbë, me mjekërr gati një pëllambë të gjatë dhe barkun të frymë, me trupin të mbështjellë me një çarçaf të vdekunish që aty-këtu kishte njolla gjaku të zi.

U tremb knjazi, dhe trupi iu rrëqeth, flokët iu çuen si shtëllunga përpjetë, fryma nisi t'i merrej dhe u mbulue i tani në djersë. E këqyrte atë i tmerruem, pa mundë me lëviz. Ishte ky lugati?

Kambë-kambë ai pa se ai nisi t'i afrohej shtratit të tij. Atëherë çoi shpejt dorën në kobure, deshi t'i jepte zjarr, kur befas lugati i tha:

-Nuk kam ardhë me ba keq e as me vra, por kam ardhë me të kallëzue për disa ndolli që është mirë t'i dish. Unë jam Mehmet Ali Pasha, që sulltani më pati nisë në Shqipni për me të dhanë ty , siç e di, Hot e Grudë, Plavë e Guci...Por, kur mbërrita në Gjakovë, më gjeti e zeza¹⁰), sepse krenët shqiptarë, me Ali pashë Gucinë kishin lidhë besë të madhe: plak dhe i ri të fillojshin luftën dhe aty ta shuejnin jetën e tyne . Kështu u ngrit e tanë Kosova dhe luftëtarët shqiptarë më rrethuen në shtëpinë e Abdulla Drenit, ku mue të mjerin edhe më vranë, më mbuluen tërë gjak dhe, siç më sheh, mbeta qyqe. Ndaj ty, knjaz Nikollë, nuk të ka mbetë tjetër, veç që ato krahina të Shqipnisë t'i qe tokë shqiptare nuk vë kurrë në dorë.

- Për besë, - nisi me i thanë Nikolla, - mbasi vetë Stambolli nuk mundka të më jepka këto krahina, e shoh që puna ka për të shkue gjatë, sepse , siç me the edhe vetë, qysh se kenke mbulue me plagë të përgjakura , Shqipëria nuk u merrka pa luftë.

U vrenjt në fytyrë pasha turk, sytë i nxorën shkëndija dhe dhambët i kërcitën prej marazi.

- Madje, të mbulohena me zi para se të futena në Shqipëri,- vazhdoi pasha turk,- sepse shqiptarët i kam pa vetë që janë trima dhe nuk bahen robë të të tjerëve. Prandaj, mblidh shpejt një ushtri dhe nise drejt për në Plavë dhe Guci që mandej t'u biesh atyre natën nëpër terr dhe t'i zhbish. Atëherë të mësysh në Malësi, të mposhtësh malësorët, sepse vetëm kështu mundena të pushtojmë Shkodrën. Mos harro se shqiptarët kanë nisë me u zgjue, kanë nisë të shkruajnë në gjuhën e tyre dhe thám se nuk ka me shkue gjatë që Shqipnia të kërkojë me dalë në vedi, si serbët , grekët dhe bullgarët, dhe të shkëputen prej Turqisë.

Kështu i tha Lugati knjaz Nikollës dhe, pa pritun, u zhduk nëpër kthinë, tue lanë mbrâpa një erë të qelbun, që u përhap nëpër taneë Cetinën. Knjaz Nikolla u çue atëherë u vesh shpejt dhe doli nëpër natë me hanë, të takonte Mark Milanin dhe kështu të mendojshin bashkë me nisë ushtrinë për në Plavë e mandej në Guci, t'i lajshin në gjak, të ndizshin në flakë Malësinë që kështu më pas të humbte Shqipnia

KANGA E DYMBEDHJETE

MARASH UCI

Pranë një lajthie që ngrihej në një mritz, tre barinj po kullotshin bagëtinë. Ishte Marash Uci me dy bijtë e tij. Marashi, i biri i Uc Mehmetit, i kishte ra detit anembanë, kishte pa tokat e sulltanit, që prej Hoti dhe deri ku buka piqet në diell sepse kishte kenë ushtar në ato vise.

Burrë i fortë dhe në armë, që i kishte si nanë e babë, babë kishte taganin dhe nanë, breshanën dhe motër e vëlla, dy pistolat, Marash Uci kërkohet dhe nderohet, sepse prej tij merreshin mendime dhe vendime nëpër gjyqe që baheshin në bajraqe.

Marashi u kallëzonte vazhdimisht djemve të Hotit ngjarje të mbushuna plot trimni të shqiptarit që bante dekën si me le. U përmendte orë dhe zana, u fliste për lugetën që dilshin kur hana mbulohej nga retë, për kulshedra dhe dragoj që endeshin nëpër viset tona, të cilët i njihte aq mirë.

Por ç'kishte sot Marashi? Përse ishte i vranuem dhe heshte, thue se bisha kishte ra në bagëti të tij dhe i kishte shqye, thue se tokat i ishin mbetë djerrë, thue se nga fatkeqësitë që kishte pasun ai i ngrati, miku e kishte gjetë pa bukë në shtëpi?

Jo, asnjë nga këto nuk kishte ndodhë, sepse, kur bishat kishin sulmue bagëtinë, nuk kishte mbetë kurrë pa i pa dhe pa i vra, se dhe qetë i kishin lërue tokën, se edhe miqtë i kishte pritë gjithnjë ma së miri.

Megjithatë, ai filloi t' u fliste bijve të vet:

-Pa dëgjoni, o djem të rinj, sot kam një punëdhe atje nuk mund të rri pa shkue. Sepse, siç thotë i moçmi, zëne zogun sot, se herën tjetër ka metë shpëtue nga duert. S' di pra, nëse atje ku po shkoj, kam me qëndrue një javë, a një muaj. Por, nëse asht thanë nga perendia që të mos shkel ma nën këto hije dhe të mos të luftoj kundër anmikut, si dikur në ato kohë që kanë perendue, ju o

djem, ju qofsha falë, më dëgjoni një këshillë:

Amanet po ju lë të rueni gjënë e gjallë, armët t'i mbushni dhe kurrë të mos t'i dorëzoni, me shokët kurrë të mos ziheni, se një ditë të ngushtë do t'ju gjenden afër si vëllezën. Të huejin mos ta poshtëroni, dhe, siç është zakoni, ta mbani me bukë, dhe vendin tuej gjithnjë ta doni.

Kështu tha Marashi, u çue më këmbë dhe shtrëngoi armët, ato armë që ndizeshin flakë si rrufeja që shkrep në male. Mandej kapërceu shpatin e malit dhe pas një ore u ndodh në Stare, kapërceu një përrua dhe shpejtoi hapin si të ishte një djalë njëzetëvjeçar.

Po arrinte në Gjenoviç, fshat i Hotit, ku do të takonte Cun Mulën, në atë shtëpi bajraktarësh, që ngrihej në krye të katundit, në atë shtëpi ku hante bukë i verbti dhe i shkreti.

-Mirë se të gjej or Çun Mula, - e përshëndeti kur e pa që ai i doli përpara derës së shtëpisë.

-Mirë se vjen, o Marash Uci,- ia ktheu Çuni.- Po ç'të shtyu ty të digjesh nëpër zheg dhe të vish në këto anë? Mos të ka ndodhë gjë e keqe-a, se të shoh që ke ardhë i armatosun.

-Jo, s'ka ndodhë gja e keqe. Por rreziqet që na kanë ardhë nga armiqtë po bahen edhe ma të mëdha. Ndaj, çoiu fjalë krenëve të Hotit që të mblidhen në Kishën e Shën Gjonit në Brigje dhe të kuvendojnë për gjendjen e randë në të cilën ndodhemi.

Kështu tha Marash Uci dhe, pa e zgjatë, nëpër zheg rrugën, mori të kthehej andej prej kishte ardhë.

Mbeti i menduem Çun Mula. Kishte dy rrugë: ose shqiptarët të shkojshin ushtarë në shërbim të sulltanit, ose të nisshin sulmet kundër Malit të Zi që i kërcënonte. Vendosi t'u çonte fjalë krenëve që të mblidheshin në kuvend, t'i peshojshin punët dhe të vendosshin si do të veproshin.

KANGA E TREMBEDHJETE

TE KISHA E SHEN GJONIT

Dielli kishte perendue dhe hana kishte dalë në qiell, kur në Veleçik filloi me pingëruë Zana dhe zani i saj nisi të përhapej tanë trishtim kudo:

-Eh, ju male shqiptare, në të cilat jeton shqipja e lirisë, dikur në ato kohë të bardha ju nuk latë të armik me na u afrue. Këtë e di çdo shpat, çdo përrue, çdo bimë dhe gur yti, kudo në Shqipni, ku gjaku i anmikut u derdh rrëkajë prej shpatës së çelikut që flakëronte në dorë të shqiptarit.

A kishte qenë e mundun në ato kohë të lumtuna, që me lotë gjaku sot lotohen, që qoftë një truell i tokës sonë të rrëmbehej nga dora e huej grabitqare? Kurrë, sikur bota e mbarë të ishte ngritë, sepse bij të Gjergj Kastriotit do ta kishin ndalë atë dorë rrëmbyese, do t'ia kishin këputë dorën me armët e tyne ngadhnhjimtare. Por sot kanë ndërrue stina dhe moti, se sot ka gjindje për të cilën zot është ari, dhe këtë tokë që shqiptari i ngratë e pati mbrojtë me gjak, sot duen ta ndajnë copa-copa, pa asnjë dhimë. Po pse? Sepse kështu don Evropa.

Uh, Evropë, ti grua e përdalun, që ke mohue besën e zotit, po kjo kenka shenja e qytetarisë, të ndash tokat Shqipërisë, me ushque këlyshët e Rusisë? Kështu prej eshtnave të shqiptarëve të gjorë që dhanë jetën për dheun e të parëve, je ti, Evropë që ban që të lindin fatosë të rinj, të cilët një copë të kësaj Shqipërie nuk lanë me ra në duert e shkjaut, pa e lanë të lahet me gjak.

E dëgjoi poeti këtë za të trishtë të Zanës dhe i tha:

-Lum, o Zanë, që po mallkon armiqtë dhe po i jep zemër djemve të Malësisë, të cilët po qajnë hallet e atdheut, se sot, sado që shqiptarët kanë ra poshtë, shkëndija e burrërisë nuk është shue në zemra, nuk kanë mbetë të shkreta armët besnike, sepse gratë tona po lindin fatosë të rij.

A nuk i sheh ti ata burra që kah Brigja po ecin nëpër shkambinj dhe po ngjiten në Kishën e Shën Gjonit? Ata janë krenët e Hotit që Çun Mula i lajmoi me u mblidhë në kuvend dhe me lidhin besën për me i dalë zot Shqipnisë.

Kur krenët kjenë mbledhë të tanë, u ngrit njeni prej tyne, Mashit, kreu i Hotit që nisi me thanë :

-Pa dëgjoni, o trima një fjalë, kemi katërqind e sa vjet që sulltanit i bajmë hysmet, kush në ushtri e kush angari, tue pasë dyshek tokën dhe jastek gurin, por tue qenë trima, qysh se ka nisë jeta. Por na ka dalë një anmik tjetër, shkajau që kërkon të na shkretojë. Ju e dini se Moskovi, të cilit hovi iu preftë, atje në Kuvendin e Berlinit me krajla të tjerë të Evropës ka vendosë me i dhanë knjazit të Cetinës Hot e Grudë, Plavë e Guci. Prandej ky knjaz ka ngrehë topa dhe ka mbledhë ushtri, që këto tri ditë të sulmojë Malësinë, sikur ajo të ishte gja e shkretë dhe jo pjesë e Shqipnisë.

Kështu i tha Mashu ato fjalë dha krerët e tjerë mbetën të heshtun, sikur rrufe t'u kishin ra mbi kokë. Qëndroshin me sy të ngulun për dhe dhe askush nuk nxirte një fjalë nga goja.

Por mandej Mashu nisi me folë përsëri:

-Ç' thoni burra, fe e zakone, bjeshkë e verri dhe kullotat tona vërtet do t'ia lëshojmë knjazit, pa shti asnjë pushkë?

U ngrit atëherë Gjetu Marku dhe tha plot zemërim:

-Në Hot e Grudë knjaz Nikolla nuk ka për t'i shkelë kurrë, edhe sikur të mbesim në çika, sepse mbarë malësorët, nga shtatë deri shtëdhjetë vjeç, dinë të vdesin, por për tokën e tyne.

Pastaj Çun Mula, si u mendue, nisi kështu me ligjërue:

-S'kemi ç'presim burra, armët besnike t'i ngjeshim dhe knjazit t'i presim hovin, sikur edhe të vdesim. E dimë se jemi pak dhe ata shumë, ndoshta edhe fishekë nuk kemi sa ata, por edhe ushtarët e Gjergj Kastriotit nuk i numëroshin kurrë ushtritë anmike, sepse numërohen dhentë, numërohen dhitë, por jo trimat që lindin me armë.

Atëherë pas tij u çuen menjëherë të tanë krenët e Hotit dhe u betuen sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit⁸), se knjaz Nikolla do t'i merrte ato trojet, veç kur pushtuesit malazezë t'u kishin grabitë lopë dhe qe, kur t'u kishin djegë stan dhe shtëpi dhe kur ata të ishin futë në dhe me gra dhe fëmijë.

-Atëherë unë po zgjedh njëzetë martina, - nisi me thanë përsëri Çun Mula dhe po ngujohem te ura e Rrzhanicës, për mos me lanë kambë malazezi të kapërcejë kufirin. Në Traboin të dalë Gjetja me djemtë e tij. T'i çojmë fjalë dhe Dedë Gjon Lulit që të ngrejë tanë fisin e vet. Dhe ti Masho, pa lindë dielli, të nisësh në Shkodër, të takosh Hodo Pashën dhe t'i thuesh që tanë qyteti të rrokë armët. Edhe gazetatat të shkruajnë se çfarë po e kërcënon atdheun që është në rrezik të madh.

Pastaj kuvendi u shpërnda. Të gjithë krerët ishin të shqetësuem. Mos ndoshta Shqipnia do të mbetej nën zgjedhën e malazezve?

KANGA E KATERMBEDHJETE

TE URA E RRZHANICES

Riza Pasha doli nalt mbi kalanë e Shkodrës dhe u habit kur pa që megjulla kishte ra mbi Rrzhanicë, fshat që shtrihet poshtë Podgoricës

-Nuk ka ra megjull atyre anëve, - i tha myftiu që e shoqnonte, por asht tymi i barotit që del nga pushkët e djemve të Hotit. Ata po luftojnë me ushtrinë malazeze të Mark Milanit, që ka dyndë atje edhe me topa, për me u futë në Malësi.

Trim si dragoi ky Mark Milani, hipun mbi kalë, kishte urdhnue burizanin e vet që t'i binte burisë dhe kështu ushtria ishte reshtue në fushën e luftës.

- Erdhi dita, - nisi ai t'u fliste ushtarëve - që ato që vendosi Rusia në Berlin me krajlat e tjerë të Evropë, ne t'i zbatojmë. Pra, Hot e Grudë, Plavë e Guci, t'i bajmë tonat. Por, siç e shihni, jo pa derdhë gjak. Në qofshi bijtë e atyne që ruejnë besimin në fenë tonë, ju në mbramje do të hyni në Hot dhe atje do të ngulni flamurin malazez.

Më të mbarue këto fjalë, u dëgjue përsëri buria dhe ushtria malazeze u sul përpara.

Rrëfen poeti:

-Eh, moj zanë, të qofsha falë, a mund të më thuesh, sa ushtarë ka Mark Milani ?

- Tetëqind pushkë janë në atë çetën që prin, - iu përgjigj Zana,- të gjithë nga Ljubotina; djem të dobët në pamje, por trima, të cilët kanë djegë saraje e kulla dhe kanë për prijës Ceroviçin, atë vetulltrashin mustaqezi, që thonë se se është Ora e malazezëve. Njëmijë pushkë dërgoi Cetina, djem të guximshëm, që kanë komandant atë Vukotiçin, të cilin , siç thonë, kunjazi nuk e ndërron me sytë e ballit. Nandëqind luftëtarë ka nisë për luftë Nikshiqi, të cilët kanë në krye vojvodën që quhet Matiniç, i cili mezi ç'pret të futet në Malësi.

-Matiniç, bre djalë djali, - thotë poeti,- me tanë mend paske kujtue se do ta shtrosh Malësinë me nantëqind vetë? Po si kujton ti, se Malësia ka dalë faret, se shqiptarët nuk bajnë ma djem, por

vajza që dinë të tjerrin lesh në furka? Ah, ngadalë, sot ke për të pa te Ura e Rrzhanicës se në Malësi nuk lindin vetëm gra. Do ta kuptosh këtë, kur të shohësh nanat malazeze tue vajtue dhe tue namë martinat, që ua lanë nuset e veja.

Dhe ja, porsi reja e zezë vjen ushtria malazeze, për me shkrepë në Malësi, me rrufe dhe shina. U prin Mark Milani, gjithnjë mbi kalë, dhe po i afrohet Urës së Rrxhancës. Dëgjohet përsëri buria. Ai merr dylbinë që të këqyrë ç'po ndodh atje mbi urë. Dhe i habitun pyet:

-A janë orla a janë petrita ata që shoh?

- Nuk janë as orla dhe as petrita, - gjegjet poeti, - por trimat malësorë, Halil Haka dhe Palokë Gjoka, me njëzetë djem të rallë që i ka dërgue Çun Mula për të luftue në Urën e Rrzhancës.

Kurse atje në urë Palokë Gjoka, djalë i fortë, çon dorën mbi ballë dhe thotë:

-Zot i madh, sa shumë shkja na paskan dalë, thue se janë krushq nga Mali i Zi, që kanë ardhë me marrë nuse në Malësi. Por nuk di se kujt t'ia drejtoj pushkën më parë. Ma tepër se kurrë armët sot nuk do t'i lëshojmë dhe nuk do të pranojmë që vajzat t'i martojmë, pa i fejue. Pra, të luftojmë burra, që vorrin t'ua bajmë anmiqve në këto shkambij dhe t'ia kthejmë knjazit krushqit, të mos turpnojmë kështu Hotin dhe veten. Mbarë Evropa ashtë ngritë më këmbë, sulltani dhe krajlat e Evropës po shohin si luftojnë shqiptarët me malazezët, tue përsëritë fjalët: " Ma mirë të vdesim dhe të na qajnë nën dhe, se të na shajnë se mbetëm gjallë nën shkjatë".

Krisi pushka, gjëmoi topi, po kush qëlloi i pari mbi tri taboret malazeze? Qenka Marka Kola, që me martinën e tij goditi në shenjë dhe la të vdekun burizanin e Mark Milanit.

-Më këmbë, djem, - uluriu Mark Milani, - se për atë zot, na ra Malësia!

Gjëmuen prapë pushkë dhe topa , gjëmoi Cemi, u drodh Rrzhanica.

Dhe ashtu si përroi që fryhet, kur bien shina dhe, tue shungullue turbullt, vërshon dhe rrokullis pemë dhe ura që, thyen ledhet nëpër ara, ashtu dhe Malësia u hodh në luftë.

Kërciti topi pa pushim, rrahu martina si bubullimë, ushtoi Rrzhanica, u ngrit tymi përpjetë dhe asgja nuk shihej, aq sa luftëtarët nuk njihshin njeni-tjetrin.

Rrëfen poeti:

“Oh, u orla dhe korba të zinj, qysh se trimi përleshet me trimin në fushën e betejës trupa të vramësh do të shihni, dhe ato do t’i keni ushqim, sepse shumë nga nanat kanë me vajtue, shumë nuse kanë me mbetë të veja të, sepse shumë nga djemtë me nga një vashë u banë dhandurë, morën nga një plumb në krahnor.

Pra, mos qaj nana e Sokolit, se djali mbeti tue luftue. Por e pagoi veten mirë, sepse vrau dy djem malazezë. Por të qajë edhe nëna e Matiniçit, të cilin e këputi Gjeto Marku. Por vetë e pati fajin ky prijës shkja, që erdhi me topa në Rrzhanicë dhe gjeti vdekjen në tokën shqiptare”.

Por çfarë ka Zana që po vajton? Tringa e mjerë ka mbetë pa vëlla. Edhe ai ka dhanë jetën në Rrzhanicë, pa pasë motrën që t’i qëndrojë mbi kokë, që plagët e trupit t’ia shërojë.

Ka dhanë jetën edhe Nikë Daka. Si ari i plagosun që sulet brenda në vathë, ashtu dhe ai, i plagosun për vdekje, u sul mbi urë kundër malazezvë, si të donte t’i përpinte ata të gjallë. Por atje e goditën dy plumba...

-Bini djem, se mbeti Nika! - briti atëherë Halil Haka.

Dhe atëherë u çue më kambë, nxorin taganin dhe mori yrysh mbi urë.

U dynd Gruda, u dynd Hoti, dhe si rrebeshet që lëshohen së nalti dhe bien teposhtë tue shungullue, ashtu dhe gurë e shkëmbenj u rrokulisën teposhtë tue rrëzue gjithçka që gjejshin përpara.

U ndeshën shqiptarë dhe malazezë, si dy përrenj që vërshojnë prej burimesh të ndryshme dhe përplasen me shkulme me njeni-tjetrin në grykën e një mali dhe lëshohen mandej gjatë zallit nëpër fusha dhe ara.

Heshti pushka heshti topi, u ndeshën luftëtarët midis tyre, flakëruen koka të prera, u derdh gjaku dhe bubulloi toka...

Rrëfen përsëri poeti :

“Shih, moj nanë e zezë shkja, dil një herë në atë vetull mali dhe numëroi ata që kanë mbetë pa jetë. Ai Jovani, ai Stijani, ai Nikiçi, a Radiçi, ashtë djali yt, moj kërcune

Po përse lumi i Cemit po gjëmon, përse mali po ushton, përse fusha sikur tundet?

Thonë asht thyer Mark Milani”.

Ti, mor Mark Milan, nuk i ke njohë djemtë e Malësisë. Rubla që të jep Rusia, nuk topit taganin tonë. Por nëse i gjallë kërkon të

arrish në Cetinë, jepu kambëve sa më shpejt.

U largue Marku, u largue ushtria e tij nga Rrzhanica, e ndjekun nga malësorët. Qenë me fat ata të që mbërritën të parët në Cetinë, sepse të tjerët, u kapën robë prej trimave shqiptarë.

Ra nata dhe ata zunë kudo prita, sepse malazezët nuk kishin besë mund të sulmojshin përsëri.

KENGAE PESEMBEDHJETE

KASNECI

Në kulmin e pullazit të pallatit të knjazi Nikollës u dëgjue një za që bani "Kra,kra...".

Ishte një sorrë që sillte ogur të zi. Ndaj knjazi doli në ballkon dhe, që ta përzinte, nisi me bërtitë me të madhe:"Hu,hu,hu!". Mandej hodhi vështrimin nga mali dhe pa një djalë tue ardhë me vrap si era, thue se po e ndiqte dikush .

" Mos është hajn?, - mendoj knjazi me vete.

Nuk zgjati shumë dha ai djalë mbërriti si vetëtimë në pallat dhe u takue me knjazin .

-Mirë se vjen, o gërxheli,- i tha ai.- A kemi me lajme të mira nga Mark Milani, atje në fushën e mejdanit?

- Mark Milani me ushtrinë e tij u largue nga mejdani, - iu përgjigj duke ofsha lajmëtari.- Shqiptarët disave u prenë kokat të tjerë i vranë.Në udhën e Qemoskut ata na vunë përpara, si të ishim derra nëpër ara. Na ndoqën pas gjurmëve, deri sa u err dhe atëherë lufta mbaroi. Nuk kishim për t'u tërheqë, se edhe dhe ne jemi zot të armëve. Por nuk mjaftoi ky kob i zi dhe u dha kudo kushtrimi që për do shtëpi shqiptari, një të shkojë në luftë, ata të malit, me pushkë dhe ata të fushës, me kuej, të gjithë të lidhun në besën arbnore. Dhe kështu, të primë nga Hodo Begu, shqiptarët janë sulë në malet tona me huta dhe taganë. Dy mijë djem ka dërgue Dukagjini dhe Shala. Ata kanë në krye Mark Lulën, i njohun si burrë i pjekun dhe për allti. Nga pesë bajrakët që ka Mirdita, kanë dalë tri mijë luftëtarë të shpejtë porsi rrufeja dhe të primë nga Prenk Bibë Doda dhe kanë zënë pritë në krepat e Rrogamit. Veç këtyne në Shkodër janë ba gati për luftë myslimanë dhe të krishtenë, të armatosun dhe veshun e mbathun si kapedanë.

Knjazi e dëgjonte i habitun kasnecin dhe mezi e përmbante veten. -Unë, të them të drejtën, - vazhdoi kasneci,- këtyne u druhem shumë, se kur një djalë zotni si ata, le tokë, grue dhe fëmijë, ai ka vendosë ma mirë me vdekë, se të kthehet, aq ma tepër që kanë në krye një luan si Hodo Begu. Veç tyne janë ngritë Tuzi dhe Malësia e Epërme, Shkreli, Vukli, Nikçi dhe Këlmendi, ku ka dalë për me luftue një djalë për çdo shtëpi. Janë ngritë mandej Lumë dhe Pejë, Gash dhe Krasniqe, Tetovë, Gash dhe Gjakovë, që në Tuz të sulmojnë së bashku, tue u betue, të krishtenë për Ungjillin, myslimanë për Kuranin, se sa të jenë gjallë, Malësinë të mos e dorëzojnë. Mark Milani prandej po tutet dhe po të lutet se që të nisësh edhe një herë luftën për me shti në dorë Malësinë... Por do të mendojmë për të tjera ngatërresa, të premtan ai, dhe pa shqye ndonjë copë toke shqiptare nuk do të rrimë, sa të kemi nanën Rusi. Kështu tha kasneci tue ofsha, kur knjaz Nikolla u vranue, u mpi dhe nga goja nuk nxori asnjë fjalë.

Ndenji kështu një copë herë dhe pastaj i shkroi Mark Milanit një letër, ku e porosiste që të largohej nga fusha e luftës.

“Mark Milan, - i shkruante knjazi , - asht tue më ardhë tepër keq që Hot dhe Grudë nuk janë toka të Cerngorës. Gjithmonë bela kanë pasë të huejtë me shqiptarët. Se lisi nuk pritet me një të goditun. Prandej çetat tash nisi shpejt në shtëpitë e veta. Me sa po shoh unë, Shqipninë do ta nënshtrojmë vonë”.

E mbështolli letrën me dyll të zi, e vulosi dhe ia dha kasnecit, që e uthi, e vuni në ballë dhe pastaj u nis nga e përpjeta, tue i ra rrugës kryq e tërthor, tue ecë ditën edhe natën, pa u ndalë asnjë çast.

Ma së fundi, kur po agonte, arriti në fushën e Qemoskut dhe u takue me Mark Milanin. Pasi e lexoi atë letër, ai mbeti kryeulun dhe mustaqevarun dhe vendosi të kthehej me ushtri në Cetinë.

KANGA E GJASHTEMBEDHJETE

KULSHEDRA

Përse sontepo shpërthen shtërgata me vetëtima e rrufe, thue se po shembet qielli dhe toka, përse po vërshejnë përroitë, përse po shungullon era dhe ushtojnë malet, sa me të futë tmerr? Përse moti po shkreh kështu?

Ka dalë kulshedra në Bigë të Shalës, me gjashtë kokë dhe gjashtë palë kthetra, me një sy në ballë në njenën kokë, që zjarr nxjerr nga goja , me bishtin që e hedh dhe e përdredh, tue hingëlli e turfullue.

Rrokullis gurë dhe shkëmbenj dhe Dukagjinin kërkon ta shuejë, sepse Shala i paska ba një dhunë; kur ishte vogël, dragoi Bala, i strehuem në një shpellë mali, tek po flinte, i paska nxjerrë syrin me një hu dhe ia paska ngulë deri në tru.

Ashtë ndezë në flakë e tanër Biga e Shalës, që nga gurishtet e lumit, deri në majë të pishave të malit dhe asht tmerrue gjindja nga kjo ngjarje, kur ka pa se nga nxehtësia edhe shkambijtë po plasshin si gështenja.

Të tanë janë ngulënepër shtëpi e stane, kurse bishat janë fshehë nëpër male.

Kur dragonjtë shqiptarë, si të fushës dhe Malësisë, kanë pa vetëtimat dhe kanë dëgjue bubullimat që ushtojshin nëpër Dukagjin, mbi Qafën e Diellit dhe lumin Drin, janë kujtue se ka dalë Kulshedra për me rrënuë ndonjë mal.

Atëherë, kudo ku kanë qenë, në mal a fushë, myslimanë, a të krishtenë, me flamurë kuqezi, me sopata, veriga, danë dhe hekura në duer, në Bigë të Shalës kanë marrë fluturim, për t'i dalë kulshedrës përpara që aq shumë dame po bënte.

Prej Mirdite ngrihet Llesh Gjoni, me të bashkohet Bibë Llesh Markola. Niset prej Shkodre Ndrekë Heqimi, që për trimni shokët i ka të rrallë dhe bashkë me të sokolat e çartun, Gokë Kukli, Beqo Qoshja dhe Hamza Sadiku. Pastaj zbresin nga Peja dy djelmosha si dy rrufe, Rustem Uka, Xhemë Sadriu, dhe pas tyne Ton Golia, të lindun dhe rritun në Rugovë, djem ma të fortë nuk i gjen në tanë Kosovën. Ata hipun mbi kuaj, marrin turr si duhia dhe vihen përballë Kulshedrës, sikur duen ta shqyejnë me dhëmbë.

Krahas tyne vihen Gjetë Gjeka nga Shllaku, që kur flet një fjalë, tundet shkambi, Prelë Tuli nga Palçi, mësyn nga Kthjella Mark Kuli, Dodë Preçi nga Kastrati, zbret si stuhi nga Shkreli Marash Vata dhe pas tij Gjin Pjetri nga Kurbini.

Takohen të tanë në Qafën e Boshit me dragoj të Shalës dhe Shoshit, me Mar Lilën, trim bujar, Gjelosh Kolën, Mehmet Shpendin, Let Putanin dhe Tol Canin, që i gjejnë tue luftue me Kulshedrën.

Mblidhen dragojtë në atë qafë mali dhe bisedojnë si të mësyjnë dhe ta mposhtin këtë kulshedër dhe pastaj tue vikatë, me armët

që kanë në duer, e godasin hërë në kokë, herë në shpinë, i vërsulen turra-turra, tue e gjuejtë edhe me copa shkëmbinjsh.

Trandet Biga, trandet Shala, kur kulshedra hidhet dhe përdridhet fort, ngrihet njëqind pash në ajër, herë sulmom me furi, herë struket në shpellë, lëshon flakë zjarr dhe jargë nga goja, rrëmben gurë me kthetra, që si kokrra rane bien kudo, përplas bishtin poshtë e nalt, sa ajri fishkëllen rreth e rrotull, por pa i frikësue dragojtë.

Dhe ja, turret ai Llesh Gjoni, që ka në dorë një palë danë të gjata dhe ndonëse e rreh era dhe shtërgata, nëpër dritën e vetëtimës përleshet me Kulçedrën, ia hap njenën nofull, kur ajo kërkonte që të përpinte Mehmet Shpendin.

Trembet Kulshedra, kur e sheh dhe zbrapset rrëshqanë si breshkë, futet në shpellë, por le jashtë krenët, nga të cilët vazhdon të nxjerrë zjarr.

Por Llesh Gjonin nuk e merr frika dhe drejt e mbi të sulet dhe me sa fuqi që ka, ia shtrëngon nofullën me danë.

Hidhet përpjetë Kulshedra, përpushet me kthetra, hingëllin me shtatë gurmazë, sa vigma e saj dëgjohet shumë larg, bahet gërmuq dhe rrëzohet për tokë, tue u përplasë dhe kalamendun mbi gurët e shpellës. Mandej përpiqet që danët t'ia hapë me kambë, t'ia brejë me dhambë, por më kot.

Lleshi kërkon ta tërheqë nga shpella, kurse kulshedra të shpëtojë nga shtrëngimi i danëve. Por nuk mundet. Ajo nxjerr nga goja shkumbë e gjak dhe rënkon thellë.

Atëherë Lleshi i jep shtatit me furi, e ngre kulshedrën, i nxjerr gjysmën e trupit të saj jashtë shpellës dhe u thërret shokëve të vinë aty sa më parë.

Dhe dragojtë lëshohen si shigjetë drejt shpellës dhe e sulmojnë kulshedrën nga të gjitha anët. Rustem Uka i këput me shpatë njenën kokë. Ton Golia ia flakëron në kokën tjetër me topuzin njëqind okësh. Hungëron shtaza me mëni, tërbohohet nga dhimbjet, kërcen përpjetë, por Lleshi ia ka mbërrhye qafën, kurse Gjeta Gega, i ngul patërshanën tri pëllëmbë në rrazë të grykës.

Ban Kulshedra të çohet më këmbë, ban të rrëshqasë vithambrapa, që të struket në shpellë, por Leshi vazhdon ta shtrëngojë me danët në duer dhe kështu ajo rrëzohet përmbys, me nofull të shqyeme deri në fyt.

-Bini burra, mos e lëshoni ,- piskat Llesh Gjoni dhe prapë me danët i këput edhe një kokë.

Sulen pastaj dragojtë e tjerë dhe me armët e tyre e godasin kulshedrën ku mundin.

Atëherë përsëri fishkëllen era dhe nis shtrëngata, shungullon mali me oshëtima, ngrihet tym dhe mjegull dhe tundet fort Biga e Shalës. Trembet Kulshedra dhe futet në shpellë, zbrapset edhe me shumë brenda saj dhe pastaj rrokulliset teposhtë faqeve të thikta bashkë me gurë e shkëmbinj dhe shembet në liqen. Ndërsa trupi i saj zhytet thellë ujnave të tij, toka tronditet anembanë.

Çohen atëherë dragojtë, shkëpusin një një copë mali dhe e venë në grykë të shpellës, që Kulshedra ta mos e hapë kurrë dhe të mos i sjellë ma dame Dukagjinit.

Pa pritun, dëgjohet kudo zani i Orës së Shqipnisë që lajmëron për këtë bamë të madhe të dragojve shqiptarë.

Mandej ajo u drejtohet orëve të tjera:

-Ata nuset nuk i kanë sonte, që t'iu gatuejnë darkë, prandej, moj motra, t'u bajmë bukën, të mjelim sutat, të gjejmë mjaltë nëpër zgavra dhe të pjekim mish për ta në hell.

Pas fjalëve të saj, orët zhduken dhe pa kaluar shumë kohë, gjejnë gjithçka duhet për atë darkë.

Atëherë dragojtë, me Llesh Gjonin në krye të vendit, ulen të hanë. Pastaj nisin të bisedojnë me Orën e bukur të Shalës, kujtojnë trimnitë e Gjergj Kastriotit, tregojnë për luftat e trimave, që Shqipëria të dalë në vedit dhe të mos urdhnohet ma as nga sulltani dhe as knjazi.

Ma vonë Ora e Shalës nis dhe u thotë shoqeve të veta që të ngrihen dhe t'ia nisin një valleje dhe të këndojnë për dragojtë.

Ngrihen shpejt orët e tjera, veshun me petka të bardha si dëborë, të kapuna dora-dorës, me kunora lulesh në krye dhe me ato këmbë të lehta vallëzojnë dhe këndojnë:

Na ishte një vajzë në Janinë, që Eufrozinë e quejshin, me bukuri të rrallë; synin si dielli, ballin si hëna dhe shtatin si i selvi e kishte. E sheh Ali pasha në ballkon dhe e pëlqen fort. Prandaj i thotë arapit që atë vajzë ta merrte dhe t'ia sillte atij.

Dhe arapi ashtu ban.

-T'u thaftë goja, - i thotë vajza, - unë nuk shkoj, se kam erz dhe fe, dhe nuk di me folë me pashallarë, qoftë ky Ali pashë Tepelena, që kokën mund të ma presë, siç ka pre koka të tjera.

Mbushet pasha tanë mëni dhe e porosit arapin se, nëqoftë se vajza nuk do të shkonte po atë natë tek ai, gjumin do ta bante me bretkosa.

E takon arapi vajzën dhe e merr me trap dhe e çon në liqen.

-Nuk ka rrugë tjetër, - i thotë. - O do të shkosh sonte te pasha, ose këtu do të të mbys në ujë.

-Unë te pasha do të shkoj, por më parë due të vishem, - thotë vajza dhe merr e hidhet nga trapi në ë ujë dhe zhduket në fund të liqenit. U përhap lajmi anembanë: -Kësi vajzash ka në Shqipëri, që për erz dhe për fe, rininë e bajnë fli.

Kështu kënduen orët atë natë; dhe kur nisi me ague, bashkë me dragoj, të gjithë u ngritën në ajërdhe u zhdukën si vetëtima.

KANGA E SHTATEMBEDHJETE

NE QAFE HARDHI

Nana kërkon të birin, Rustem Ukën...

E kërkon ato ditë pranvere kur bulon molla dhe lulëzon thana, kur në Qafë Hardhi po pingëron zana. Dhe ja, përmes rrezeve që lëshon hana, kur dita ende nuk ka ague, në atë qafë mali kishte shpërthye luftë e rreptë; kishte nisë pushka të kriste me ushtimë, kishte nisë topi të gjëmonte, sa sa ishin tronditë verri dhe kënetë. Ç' ka ndodhë?

Knjaz Nikolla ka ngritë një ushtri më kambë, me plot tetë tabore burrash malazezë, dikush kuqalash, dikush i murrmë, dikush me mustaqe deri në brez, a vesh më vesh, por të tanë të guximshëm, që nuk i tremb as pushka as tagani. Komandant kanë Mark Milanin, të cilin knjazi e ka urdhnuë që t'i prijë ushtrisë natën, pa hanë, dhe ta nxjerrë fshehtazi në Plavë e Guci. Dhe për këtë qëllim ka dërgue atyre viseve një pararojë prej treqind vetësh.

Dy trima shqiptarë, djem të rinj, të dy të lindun dragoj, në agimin e asaj dite Ora e shqiptarëve i kishte porositë që me huta mbërthye në duer, të dilshin dhe të zijshin pritë pranë një pylli, në Qafë Hardhi, sepse andej mund të kalojshin anmiqtë malazezë.

Dhe vërtet, pa kalue shumë kohë, nëpër errësinën, që mbulonte pyllin, ata kishin dëgjue zhurmë hapash të lehtë dhe pastaj kishin pa njerëz të armatosun që nuk flitshin me njeni-tjetrin dhe bajshin përpara si të ishin hajna që shkojnë për me grabitë dhe vra. Por shpejt kishin kuptue se ata ishin një çetë, pararojë e ushtisë malazeze.

Atëherë Rustemi dhe Uka nuk kishin mendue gjatë, por kishin nisë me luftue kundër tyne.

Ushtoi bjeshka cep më cep, si të kishte krisur topi dhe havani.

Ashtu si shpëndahet një tufë ngjalash dhe struken nëpër rrasa e zhur, kur dikush hedh një gur në pellg, ashtu dhe malazeztë, kur dëgjuen krismat e hutave të Rustemit dhe Xhemës, u shpërndanë nëpër pyll dhe u fshehën si të mundshin mbas kaçubave dhe trungjeve të pemëve. Kuptuen se kishin ra në pritë. U shtrënguen të luftojshin, se vetëm kështu mund të shpëtojshin kokën.

Me armët e tyne trimat dragoj vranë shumë nga armiqtë.

Dragojtë vetëm dy dhe malazeztë treqind, që vikatshin e mallkojshin njeni-tjetrin dhe qëllojshin edhe ma me tërbim.

... Lufta ndizet dhe ma shumë, rënkojnë të plagosunit, plumbat vërshojnë pa pushue, gjeth e degë bien për tokë, fillon bari të thahet. Kaq shumë vapë nis e ban nga flaka e barotit.

A thue dy trima, sado dragoj, do të përballin një ushtri?

Ngre Rustemi kryet pëmbi një shkëmb dhe u ban zë armiqve:

-Me ngadalë, moj Cernagore, se këtu i thonë Shqipni krenare, nuk po i biem më qafë ndokuj, nuk po luftojmë për me rrëmbye gjanë e huej, por për nder dhe për liri, që knjazit të mos i biem kurrë në dorë.

I dëgjon këto fjalë kerserdari malazez, i fshehun pas një një grumbulli gurësh, vranohet në fytyrë, shtrëngon dhambët dhe me za sikur të ishte tue pallë, vikat:

- Siç e kemi pasë zakon, ballë për ballë me armiqt jemi pre dhe nuk jemi fshehë si urithë.

Mandej ngrihet më kambë, me pushkën në dorë dhe taganin ndër dhambë dhe vrapon nëpër terr me njëqind ushtarë, i mbrojtun pas trungjeve të pemëve dhe herë me vrap dhe herë këmbadoras, sulet me furi dhe u afrohet rugovasve, për me i shti të gjallë në dorë. Dhe mbetet i habitun kur tash që ka ague, përballë tyne nuk sheh ushtri, as çetë, por vetëm dy vetë.

Mirëpo dy dragojtë nuk bien kurrë në dorë të tij, sepse Rustem Uka, kur ka pa çetën e shkëjve, edhe ai ashtë ngritë më këmbë, si luan ka zanë vend pas një shkëmbi dhe ka nisë me qëllue edhe ma shpejt dhe pa mëshirë mbi ta.

Vrapin shkjatë e kanë ndalë dhe atëherë krismat e pushkëve dhe fishkëllimat e plumbave kanë nisë të bien kryq e tërthor.

Dalin barinjte nëpër stane dhe habiten kur dëgjojnë këto krisma

që vijnë nga pylli dhe japin kushtrimin. Ashtu si pas një shiu të rëndë vjeshte prej kreshtave të thikta shkëputen gurë, bien teposhte, tue u rrokullisë e dërmue dheun dhe plandosen teposhtë, derisa të hasin në një pengesë, a të ndalen në një përrue, ashtu dhe barijtë u sulën në Qafë Hardhi, atje ku kishte nisë lufta.

Me pushkët në duer, kësulën në gji, sapo arrijnë atje, zenë prita dhe nisin me shti pa reshtë mbi anmiqtë.

Janë mbërthye dhe kapërthye shqiptarë me shkja, ndërsa mjegulla dhe tymi u rri mbi krye. Një çast shqiptari shkjaun po e shtyn, pastaj ashtë shkjaun që nis ta mësyjë atë. Shtyhen dhe zbrapsen si vala e detit, njeni vritet, tjetri plagoset...

Dhe kur shqiptarë dhe shkja luftojnë ende trup me trup dhe pushka vazhdon të kërcasë, Zhukë Isufi, ashtu si mëzati kur e pickon zekthi, sulet ngado, ashtu dhe ai merr yrysh kundër malazezve të mjerë.

Lëshohet pastaj Man Sela me dy kobure në brez dhe martinën në dorë, sa kur e shohin shkjatë, zbrapsen si lepuj nëpër shpella, për të shpëtue prej plumbave të tij.

Ngrihet më pas dhe Nel Bisha dhe pas tij edhe Rahman Dyli, që shtien mbi shkja të tjerë, të cilët bien shakull për tokë dhe bahen mish për kafshë të egra.

Rrëfen poeti:

“Ju të mjera nana shkina seç po mbështilleni edhe më shumë me të zeza, qyshse trimat shqiptarë po luftojnë në Qafë Hardhi, dhe jetën po jua shkurtojnë, zemrën po jua ndajnë dysh, tue lanë dikë pa burrë, dikë pa djalë. Të shkretat ju që jeni gjallë, sepse gjithnjë do të vueni nga ky kob.

Por zemra mue gjak po më pikon, kur shoh se shkjatë na paskan vra Tahir Gjelin, Isuf Pulën, Kot Kaçelin dhe djem të tjerë që ma të mirë se ata, vështirë me u gjendë në këtë tokë.

Një i tillë është Isuf Pula, të cilin nuk e tremb flaka e barotit, që turr lëshohet mbi malazezë, dikë tue e vra, dikë në gjak tue e la, thue sikur kulshedra po përleshet me të.

Dhe ja, përballë i del një shkja. Vazhdojnë të shtien me armë kundër njeni-tjetrit. Një plumb godet hutën e Isufit dhe e damton. Ai nuk mund ta përdorë ma, prandej nxjerr taganin dhe si ari i sulet malazezit. Por ai arrin ta qëllojë. Isufi mбетet, nuk rënkon, bie për tokë dhe kur po jep shpirt, i mbuluem tanë gjak, arrin të thotë: “Shëndosh vatani!”.

Sheh Rustem Uka se çfarë ndodhi dhe bashkë me shqiptarë të tjerë, tue uluritë si bishë u sulen malazezve, që atëherë lenë pritat dhe zbrapsen në pikë të vrapit, si zagarë, marrin përmes pyllit dhe zhduken shpatit pa lanë gjurmë, tue lanë plot të vramë.

Sapo sheh që malazeztë thyhen në Qafë Hardhi, Zana fluturon shkëmb më shkëmb dhe ia merr kangës:

-Ty të lumtë, moj Shqipni, që ngado ku bie dielli, nuk ke shoqe për trimni dhe besë. Zbathë dhe zhveshë ashtë shqiptari, jetën e kalon me vështirësi, por sikur të huejt të shkelin tokën e vet, mbushet me mëni, ngrihet me armë dhe sulet kundër tyne, si skifteri mbi zogjtë e pulës.

Knjaz Nikolla atje në Cetinë pas këtyre ngjarjeve rri e mendon gjatë dhe kupton edhe një herë, se sado që të dërgojë ushtri, nuk futet dot në Shqipni. Megjithatë, nuk përulet...

Rrëfen poeti përsëri:

-Mos u ngut, moj Zanë, dhe kangës dhe valles mos ia merr, se lufta ende nuk ka mbarue, dhe Shqipnisë hallet nuk i kanë mbarue. Unë druej se sot gjak ka për t'u derdhë përsëri, se shkjaun nuk mposhtet kaq shpejt. Shih malin e Vizitorit që asht nxi, mbushë me ushtarë malazezë, që po shpejtojnë nga Ura e Sutkjeskës, në atë shesh ku Mark Milani ka dhanë urdhën që të mblidhet tanë ushtria. Shih, Zanë si shpërtheu zjarri në atë buzë mali. Pra, lufta ka fillue përsëri. Ç'do të bajnë tash shqiptarët?

-Të qëndrojnë, nuk ka rrugë tjetër, - përgjigjet Zana.- Unë po shoh tash se malazezët kanë sulmue Strekën, Gashin, Krasniqen, Murinën, Reçin dhe Dardhën, Nikajn dhe Mërturin e plot krahina të tjera, dhe po dyndin nga Plava dhe Gucia. Shoh që shqiptarët po ngrihen. Atyne u prin Ali pashë Gucia, ai që ka hypë në atë kalë pullali. Me të janë bashkue bajraktarë dhe bejlerë të tjerë. Janë Sadri Mehmeti e Jakup Feri, Alush Smajli dhe Smajl Hasani, që me një të goditun me tagan, i presin kokën armikut. Po kaq trim janë dhe Prelë Tuli, me hutën që nuk e ndan nga krahu dhe zjarrin në gji, dhe të tjerë që po bashkohen dhe po marrin nga Sutjeska, për me u vu përballë ushtrisë malazeze.

Kështu foli Zana dhe nisi të fluturonte cep më cep tëmaleve, derisa u ul mbi një shkamb në majë të Sutjeskës. Që prej andej do të shihte se si do të zhvillohej lufta midis midis shqiptarëve dhe shkjave.

KANGA E TETEMBEDHJETE

TE URA E SUTJESKES

Kur pa se përpekjet për me pushtue Gucinë tue marrë Qafë Hardhinë, përfunduen me humbje të randa, sipas këshillës së knjaz Nikollës, Mark Milani vendosi që me tetë taboret e tij, pa u diktue nga shqiptarët, të niste sulmin nga Sutjeska, ku do të gjendte shteg të lirë.

Por u gabue ky ky komandant dinak, sepse Ali pashë Gucia me dy mijë ushtërë të tij u ngujuen rreth këtij qyteti dhe nisën me hapë zjarr kundër forcave malazeze, në pritje të një beteje të ashpër.

Rrëfen poeti:

“Shqiptarë dhe shkja me mëninë që kanë për njeni-tjetrin kanë për t’u ndeshë mbi ata shkambij. Kanë për t’u gri, kanë për t’u pre, kanë për të mbetë të vrarë, pa pasë pranë të të mjerat nana, që t’u thonë një fjalë të ambël”.

Kështu nis atje beteja, nis pushka të kërcasë, nis topi të gjëmojë, lëshohen si breshën plumba e gjyle, dëgjohen krisma që t’i shurdhojnë veshët, shihet tym, që sytë të verbon, sa që të kesh edhe njëqind kokë, vështirë se ndonjë do të mbetet pa t’u këputë. Ushtojnë britmat dhe vikamat, ashtu si të ujqënve të uritun, kur dëbora mbulon bjeshkë e vërri, si breshni që kur nis e bie, zemrën bujkut ia ligështon.

Atëherë shqiptarë dhe shkje dalin nga pritat dhe nuk shohin jetë a vdekje, veç hap pas hapimësyjnë njeri-tjetrin, grykë më grykë sulmojnë me armë dhe dhe bien të vdekun në atë truall.

Sa keq për shqiptarët që janë ndodhë në kufi me kata anmiq të pabesë, por edhe trima!

Kur po mësynte anës një kodre, i pari që ra në atë truall, ishte Selman Ymeri nga Plava, që një fjalë peng kurrë nuk pati lënë. Pas tij dhe një plavas tjetër, Kurt Zeneli. Por hakun e tij ia mori Adush Haliti që e qëlloi në kokë shkjaun dhe e la pa frymë në një përroskë. Mandej mbeti i vramë Beqir Haxhia, ai burrë i guximshëm prej Gucia, që nuk gjendej as në Shqipni dhe as në Cërnegore.

Befas, kur Micani Leka nga Dardha pa një malazez që po shtinte mbi Zyber Smajlin nga Reçi, ngriti hutën dhe plumbi i tij goditi në gurmaz. Malazezi ngriti duert në varrë, filloi me bërtitë dhe, tue u lëkundë, ra pingul në një pellg, me kambët përpjetë dhe kokën zhytun në baltë.

Atëherë kur një malazez tjetër pa se ç'pësoi shoku tij, nuk e bani të gjatë, por shtrëngoi taganin ndër dhambë dhe me pushkën në duer, iu vërsul Micanit, që ta shqyente, ashtu si ariushqyen me dhambë një derr të egër që i afrohet shpellës së tij.

Por Micani, me ta pa, u çue më këmbë, vuni hutën në sy u vu përballë tij. Të dy qëlluen flakë për flakë mbi njeri - tjetrin. Ra shkja pikë gjallë për tokë, por ra dhe Micani i goditun në krahnor. Ra në përrue mbi hutën me duer. Dhe kur shokët iu afruen, munda me u thanë:

- Amanet, shokët e mi, kur të kaloni nëpër Dardhë, armët e mia atje të m'i çoni, dhe në oborr të kullës të m'i lini. Nanës dhe babës mos u tregoni, se janë të vjetër dhe do të dëshpërohen. Sikur nana të pyesë për mue, i thoni se djali asht martue. Nëse pyet se ç'nuse mori, i thoni se mori një plumb në krahnor. "Qëndro, nanë, - i thoni, - se Micani mbeti tue luftue në Mal të Zi, për Shqipni".

Rrëfen poeti:

"Micani, ty nana të pati porositë që kur të shtiesh mbi malazezë, të kujtohesh për një plakë që kishte thanë se luftë dhe dasmë pa mish nuk ka. Dhe ti, si bishë u vërsule dhe qëllove kryq e tërthor dhe vrave shumë nga malazeztë. Prandej ty, Micani, nuk ka përse të dhimbet jeta, se veten e ke pague mirë dhe emni yt ka me u këndue në Lahutën e Malësisë".

Pasi Mata dhe Micani ranë në fushën e luftës, gjëmoi sërishmi topi dhe havani, buçiti huta dhe novica, dhanë jetëntë tjerë shqiptarë dhe malazezë, ku dy-tre, ku pesë, ku gjashtë, dhe të gjithë të rinj.

Po përse po këndon një zog i zi, në ato lugina të Gucisë tue fluturue nga një selvi në një tjetër?

- Amanet, fusha dhe male, shuani këngët dhe vallet, se në Krasniqe ka ra një kob. Tek luftonte kundër shkajve në Sutjeskë, Arif Smajli, ky djalë vigan, qenka vra. Sa shumë lot ka me derdhë nana e vet, kur të marrë vesh këtë lajm.

Kështu këndon zogu.

- Ule zanin, ti zog mali, - i përgjigjet poeti, - se nuk di se çfarë

po thue, se ti veç të këndosh nga një degë në një degë tjetër di. Përse ta qajë e ama Smajlin, kur ai trimi Sadik Rama ia ka marrë hakun, kur ka vra dy malazezë dhe tre të tjerë i ka plagosun? Por nana të qajë Cen Brahimin, që kur pa Sabriun, pra probatinin, e vet, që plumbi e mori në parzmë, iku me vrap dhe e la të vdekun. Koriti kështu Shqipërinë, sepse shkjetë ia prenë kokën, ia ngulën në hu që ta hajshin sorra e skifterë.

Atëherë ata nisën të lëvdoheshin:

- Pa shiko, Ali pashë Gucia, kjo koka në majë të hunit është e Sadri Çunit që dashka me të thanë një fjalë. Dashka me të thanë se komandant Mark Milani kërkon t'i japësh drekën në Plavë, darkën në Guci, ku do të vijë të pushojë, mandej të ndalet në Shkodër dhe ta ngulë flamurin në kalanë e Rozafatit .

Kur Ali pashë Gucia kur pa kokën e Sabri Çunit mbi hu dhe dëgjoji se si talleshin me të, lëshoi kushtrimin:

-Bini burra, kudo që jeni, se shkja po na vë në lojë, na ka nxi armë dhe fytyrë, prandej t'i marrim hakun Çunit dy për një, siç e kemi në kanun.

Ashtu si bagëtia vihet turr e vrap pas bariut që ka gjetë ujë për me shue etjen në ditë të nxehta vere, ashtu dhe burrat e Malësisë e dëgjuen kushtrimin e Ali pashës dhe u sulën nga furi aty ku shkjetë kishin ngulë kokën e Sadri Çunit.

Kur malazezët panë shqiptarët që po i sulmojshin, të gjithë trima në za, lanë pritat nxorën taganët dhe me fytyra të vnerosuna dhe sy të të skuqun si gjaku, tue vikatë u sulën edhe ata si llavë kundër shqiptarëve.

Lahet në gjak e tanë fusha e betejës. Trimi përleshet me trimin, hidhet, struket, herë ngre shtatin me dredhi, herë taganin e tund me furi, herë tue u mbrojtë, herë tue mësy, jo për me shpëtue vetë i gjallë, por për me lanë hasmin pa krye.

Shkrabiç Pera, trim i çartun, merr hov dhe hidhet mbi shqiptarë, thue se do që t'i përpijë, ndeshet me Sulë Memën nga Lumi i Bardhë, kërkon t'i presë kokën dhe t'ia dërgojë knjazit si dhuratë. Por asht Qerim çela, si zog petriti, që taganin ia ngjesh atij në krye dhe ia ndan më dysh.

Fusha e betejës bahet lamsh, trimat vazhdojnë me u kapërthye, shqiptarë mbi shkje dhe shkje mbi shqiptarë dhe shumë prej tyne mbeten të vdekun .

Por ende nuk është marrë gjaku i Sadri Çunit.

Ndeshet tash Prelë Tuli me një shkja, i gjatë sa koka i takon në tavan, krahun e ka të trashë sa një muranë, shtatin të madh sa një mullar. Vasil e ka emnin.

- A jeti ai Prela, që je ba kasap mbi ne - i thotë Vasili, - që ke pre krenë malazezësh, si të ishin kokë bagëtish? Të kam kërkue në qiell dhe po të gjej në tokë!

Dhe pas këtyne fjalëve sulet mbi të si kulshedër, thue se do ta shtinte nëndë pashë nën dhe.

Nis e i thotë Prela Vasilit:

-Kokën kam me ta pre, si me pre një kokë berri dhe nanën tënde do ta mbështjell në zi.

-Unë, mor Prelë, - përgjigjet Vasili, - shqiptarin e kam si burnotin që e thith me hundë dhe e ha dy herë gjallë. Por ta dish se ne, malazeztë, shpejt kemi për me shkue në Shkodër dhe mandej kemi për të pushtue Shqipninë. Kurse ty Prelë, tash po ta këpus kokën dhe si Sadriut kam për ta ngulë në hu.

-Mortja ty mendjen ta ka trulllosë - ia kthen Prela tue qeshë me të madhe, - prandej ndaj mbahu, Vasil, se ngusht ke ra.

Pastaj i turren njeri-tjetrit. Shkumbë u del nga goja, djersët u rrjedhin rrëke-rrëke, kah orvaten, kah rropaten që shoqi-shoqin ta venë nën vete. Mandej Prela nxjerr shpejt thikën dhe ia ngul shkjaut në brinjë. Gurgullon gjaku teposhtë, ndërsa shkjaun përplas kambë e duer tue u zvarisë nëpër tokë. Por Prela nuk ndjen aspak dhimbje për të, ndaj ia pret kokën dhe trupin ia hedh në hendek.

-A po dëgjon, or Mark Milani - nis e bërtet, - të përshendet Ali pasha i Gucisë dhe të thotë mirë se vjen kur të duesh në Plavë dhe Guci, ku e gjen tryezën gjithmonë të shtrueme. Por tash po i çoj knjazit një dhuratë, pemë e mirë, mbi në Malin e Zi, por këputun në Shqipni, që ta ndajë ndër miq që ka kudo.

Dhe Prela, pasi thotë këto fjalë, ia flak kokën e Vasilit malazezve. Ç'janë hjedhë përtpjetë dhe janë tërbue shkjatë!..

Janë derdhë shkrep më shkrep mbi shqiptarë, kush pa opingë, kush pa kësulë në kokë, me tagana dhe pushkë në duer, me sy që u lëshojnë shkëndija, tue gërthitë e uluritë dhe tue u sulë poshtë shpatit.

Atëherë dëgjohen sërishmi krismat e armëve, shqiptarët lenë llogoret, hidhen mbi malazeztë, që zmbropsen në Sutjeskë, të tmerruem dhe të mundun prej tyre.

KENGA E NENTEMBEDHJETE

PATER GJONI

Ç'po vikat dhe po mallkon Zana:

-Shue, qoftë kjo kjo fara e shkja, qysh se ra në Ballkan, sepse i ashtë vardisë fisit të shqiptarit dhe ashtë përpjekë përherë, pa asnjë të drejtë dhe arsye, me rrëmbye me pushkë dhe me top toka shqiptare, dhe të mos me e lanë të ngrejë kokën kurrë.

- Mos mallko, moj zanë, - i thotë poeti,- se mallkimi ashtë arma e të ligut, dhe jo vetëm nuk e tremb anmikun, por madje e ban me qeshë. Atë e tremb një zemër e guximshme, një pushkë dhe dëshira për me qenë i lirë, me besë të fortë, si në kohën e Gjergj Kastriotit. Por, a nuk po nuk ndjen, moj zanë, si gjëmojnë projet e zaje, kur shqiptarë dhe shkje po ndeshen në Sutjeskë fyt më fyt me fyt? Fluturo andej që t'i shohësh vetë me sytë. Malazetë janë shty në Sutjeskë ku po djegin shtëpi dhe stane.

Këqyr, moj zanë, rritë nëpër gurra, këqyr ata burra që po zbresin nga Vishnjeva në Vermosh. Mos pandeh se janë krushq dhe dasmorë dhe janë nisë me marrë nuse? Jo, janë trimat malësorë, që sapo Ali poshë Gucia dha kushtrimin, po vërshojnë nga Sutjeska, për me i dëbue malazetë. Ai i njeh ti, ata gunëz, kambëzbathun dhe kryqin në gji, që janë bashkue me atë çetë? U prin Patër Gjoni, frati i Këlmendit, që, me të dëgjue këtë kushtrim, bani thirrje që nga çdo shtëpi të dilshin luftëtarë për me u bashkue me ushtrinë.

Mblidhen të tanë në kuvend dhe bajnë pyetjen: "Të shkojnë, a të mos shkojnë në luftë?"

-Se për atë zot,- nis e thotë Uc Gjoka nga Hoti,- mirë që jemi gjallë, sepse jemi vra dhe po vritemi me shkjatë, kush për shteg, kush për kufi, vritu me ta në Kërbnicë, theru në Pllanicë, Shpuzë dhe Podgoricë dhe kështu po na shkon jeta zi e ma zi. Prandej unë them se këtë çeshtje sot ta lamë dhe të shohim turkun që lufton me shkjatë, deri sa të dy të hanë kokat e njeni-tjetrit.

- Mirë po flet ti, Uc, - thotë Vocërr Preçi, - sepse a do të kemi hajër, po të vritemi me shkjatë, kur në robni të turkut jemi, i cili gjunin në bark na e mban, lëkurën na e rjep dhe as të qajmë nuk na le?

-Unë them se turku ka mbarue, - shton Curr Ula,- por sikur shkjaun të hyjë në Shqipni, burra, ta dini mirë, se prej vendit tonë ai ma nuk largohet, se varë do të na mbajë në çengel, s' do të kemi as fis, as atdhe, as edhe një pëllambë tokë për me varrosë të afërmit tanë.

Për pak bahet qetësi.

-Pesëqind vjet kanë shkue,- flet pastaj Vocërr Deda ,- dhe ne themi: "Sot shkon turku, mot shkon turku"... I ashtë grisë xhoka, i ashtë çjerrë qyrku, por, megjithatë, ai mban kosha e trina. Prandej unë them se na del ma mirë me shkue nëpër shtëpia e të shtrohemi me petulla dhe raki, ndonjë berr ta pjekim dhe ta hamë dhe mandej të bisedojmë, nëse të shkojmë a të mos shkojmë, që të lemë kryet për turq a për shkja, sepse kemi kohë për të vdekë. I dëgjon ata Patër Gjoni dhe një dell i lëviz në ballë.

-Prindët tuj, burra trima, - thotë ai i zemëruem, - ato vende ku knjazi ka shpërthye e me ushtrinë e tij, i kanë la me gjak dhe i kanë ba nanat malazeze të qajnë, kurse vetë ata burra aty ku dhanë jetën, kanë mbetë pa u qa dhe pa u vajtue, janë ba ushqim për sorra dhe fajkoj, por vendin nuk e kanë lëshue kurrë. Kurse sot, vaj medet, shkjaun po shkel mbi eshtnat e tyne, tue u hedhë dhe spërdredhë, po hyn brenda në Guci, dhe ju në vend që t'i ndalni hovin, doni të rrini nëpër shtëpia, shtri mënjanë, duhan tue pi, me mendjen te rakia dhe mishi i pjekun, sikur vend i huej të jetë Shqipnia. Por ç'të baj se frati nuk vret, se ndrydhe, sot do të isha bashkue me luftëtarët, sepse nuk jam as krushk, as dhandër dhe s'kam për me mbajtë as bir, as bijë. Por kam për t'i namë shkjetë, kam për t'i mallkue, vetëm me lotë të syve të mi, lot me gjake vrer përzie, prandej po dal në atë kep bjeshke, me sy të hedhun nga Sutjeska: "Qofshin shue me tokë dhe farë, qofshin qofshin shue me bjeshkë e vërri, qofshin shue me bagëti, qofshin shue me njerëzit e shtëpisë, plak grue dhe fëmijë".

Kështu tha frati, u çue më kambë dhe u largue.

Kur panë trimat malësorë se ai mori rrugën nga bjeshka që të dilte në Sutjeskë dhe t'i lëshonte shkjaun ato mallkime, u ngritën edhe ata dhe ndoqën gjurmët e tij.

-Patër, - tha një nga malësorët,- ne jemi krye, por ti je sy, nga të na thuajsh ti, kemi për me mësyë, në flakë të zjarrrit, në ujët të detit, kundër asqerëve të knjazit dhe të sulltanit, që Malësia të jëtë e lirë.

Atëherë frati foli :

- Bini në gjunjë dhe pendohuni dhe unë kam me ju shlye mëkatet, pa qenë nevoja që të rrëfehëni, sepse lufta nuk pret.

Dhe trimat ashtu banë, ndërsa frati, tue ngritë sytë nga qielli, nisi dhe tha:

-Ki mëshirë për ta, o Zot, jepu forcë kundër anmikut që po u rri mbi kokë dhe nuk po u lë të shohin dritë me sy.

Pas kësaj urate, trimat u çuen më kambë, e falenderuan patër Gjonin dhe morën rrugën drejt Sutjeskës.

Seç' po u ndritshin martinat në krahë, taganat seç po xixëllojshin, kur hapin shpejtojshin, ndërsa në gji u vlonte gjak dhe urrejtje. Dhe kur kaluen anës shpatit, Lulash Ndreu, xhakoni i fratit, filloi me këndue:

- Na thonë se Moskovi i paska dhanë fjalën Malit të Zi, që të hyjë dhe të shtrohet në vise shqiptare. Po cili zot i tha Harushës së Veriut: "Në dorën tande asht e tanë Evropa dhe ndaje atë copa-copa?". Cili zot i tha shkja: "Merr drapnin dhe korr ku nuk mbolle?". Ah, ngadalë, ti, cubi i Cetinës, se ke për me hasë burra që kanë lindë me pushkë në dorë. A kujton ti se në dej të shqiptarëve nuk vlon gjaku që pati vlue dikur? Çohuni shqiptarë, myslimanë dhe të krishtenë, çohuni dhe mblihduni në fushën e betejës, që t'i tregojmë botës se Shqipnia asht e shqiptarit!

KANGA E NJEZETE

LEKET

Ndërsa Lulash Ndreu këndonte, lekët kaluen shpat më shpat dhe përrue më përrue, dolën në Sutjeskë dhe panë se në rrazë të bjeshkës po vlonte pushka dhe topi, se atje ngrihej një mjegull e dendun, se shtëpi dhe stane ishin rrënue, se gra që mbajshin në duer ç'të mundshin, po largoheshin të tmerrueme që andej.

Atëherë trimat, si një copë mali që shkëputet dhe shembet në zall, u shkëputën poshtë faqeve të thikta.

U trand Zana, si të shihte një rrufe që shkrep në kohë të kthjelltë. Por jo, nuk kishte shkrepë ndonjë rrufe, nuk ishte tundë toka nga ndonjë tërmet, por ato ishin krisma të armëve të malësorëve, që ushtojshin mbi Sutjeskë.

Seç u ndez vendi barot nga të shtimet e pareshtuna! Shqiptarë dhe shkja derdheshin shkambit dhe bregut, kodrës dhe livadhit, lëshoheshin në pikë të vrapit, duke vringëllue taganët dhe u përleshë me njëni-tjetrin!

Ndër ta ishin Mac Kaculi, Caruk Curi, Cuba Deli, Mash Coku dhe plot lekë të tjerë.

Luftimet vazhdojshin. Fyt më fyt e ballë për ballë, nandë të vdekun dhe vetëm një i gjallë kishte mbetë nga shkjatë. Vërshojnin malësorët, u kërcejnin malazezëve nëpër llogore, tue i hutue, tue i përpushë, tue i ba të dridheshin si gjarpëri që vëlon në zjarr.

Trimni të rrallë tregojshin dhe lekë të tjerë, Llesh Nikë Daka, Nikë Gjelosh Luli, Dodë Preçi, që i zmbrapsshin i dhe i zhbijshin malazeztë. Ankohej një nanë malazeze:

-Qyqja, bir, si i bahet hallit, se po shoh dy djem të rinj që po mësyjnë kundër teje dhe shokëve të tu, djem që si kulshedra po hidhen shkamb më shkamb. Tmerr do ta keni t' u dilni përballë, sepse kanë për t' ju përpi të gjallë! Mallkue qofshin ata që ju dërguen në luftë, që të ndesheni më keq se ujqënit dhe bishat me ta, vetëm prej dëshirës për të shkelë të tjerët dhe gjënë e huaj të rrëmbeni pa nder!

Rrëfen pastaj poeti:

-Keq po më vjen, moj nanë e shkretë, por ty djali t' u vra. Ishte fshehë pas një trangu peme. Askush nuk di me tregue se si ai iu sul dhe luftoi me lekët. Kaq trim ishte. Dhe vrau disa prej tyne. Atëherë si tallaze deti atyne iu hodhën dy djem të të rinj, ata që paske pa, që ty t' u dukën si kulshedra. Ata ishin djem nanash, Bec dhe Çul Patani. Bashkë me ta u sulën dhe lekë të tjerë.

Ushtoi zhurma, ushtoi era, u këputën kokë, u këputën trupa malazezësh. Kështu, moj nanë aty në një driz mbeti dhe biri yt. Përse të na binte kjo namë dhe kjo rrufe, përse shqiptarë dhe shkje të mos bajnë së bashku hije mbi këtë tokë? Sepse janë shokët e birit tënd që duen të bajnë robë shqiptarët.

Por ç'kanë malet që gjëmojnë, përse ngrys vetullat Mark Milani?

Thonë ka mësy Rushman Hasani, shpatë e gjallë, me shallin të dredhun rreth kokës, varun martinën në krah, futun koburet në brez. Ai shtrëngon dhambët, ulurin si përbindësh, buzët i shkumbohen, sytë i vnerosen, kur hidhet mbi shkjatë. Nuk po e ndal shkrep, nuk po e ndal shkëmb, po i kapërcen përroskat cep më cep dhe me shkjatë po përлахet, dikujt tue i pre krah, një tjetri tue i ça kryet, sa atyne u hyn tmerri.

Llahtarisen shkjetë dhe me taganë i sulen atij në shpinë. Por Rushmani rrotullon shtatin e tij të gjatë dhe me shpatën të shtrëngueme në dorë, ua këput kokat që bien për tokë si kokrra bostani. Këto pamje ia plasin zemrën Mark Milanit, që rri e shikon gjithcka në një rrafsh mali.

-Pasha armët që më ka lanë baba, - bërtet pastaj,- nishan në ballë kam për t'i vue, krushk dhe kumbarë do ta bëj, dy koburë larë në ar do t'i dhuroj, atij që do të vrasë këtë Rushmanin!

Atëherë Mil Spasi sypatrembun, nis e merr hov si derr i egër. Toka dridhet nën kambët e tij, kur mësyn drejt kah Rushmani. Mark Milani mbushet tanë gëzim. Por nuk sheh Dash Galanin që i del Milit përpara. Mirëpo ky i shmanget, pa pritun i ngul shpatën dhe e l të vramë.

Pastaj me një goditje tjetër të shpatës qëllon për vdekje edhe Kolë Cujën. E dëgjon Rushmani rënkimin e tij.

Si një fajkue që shpëton nga kafazi dhe fluturon në qiell si shigjetë, ndërsa shpendët zhduken nëpër përrenj, ashtu dhe shkjetë ua mbathin këmbëve, kur dëgjojnë jehonën e zanit të Rushmanit që mallkon Mil Spasin. Ky, kur e vëren, i dridhet trupi, buza i zbardhet, ngujohet aty si një derr i egër, që pasi ka kapërcye zabel më zabel, kur nuk sheh shteg për të ikur, turfullon me mëri dhe rri e pret.

Befas aty ia beh Bec Patani. Ballin e ka të gjanë si fushë mejdani, vetullat të zeza si të korbit, synin zjarr, si flakë baroti, mik me të huej dhe vëlla me shokë. E shen Milin, por nuk e njeh, ndaj i turret, tamam në çastin kur ai do të dyluftojë me Rushmanin.

Por kur e sheh përsëri Milin, ndalet i shtangur.

Vite ma parë sulltani kishte vënë bimbashin e vet, Ali Qorrin, të kapte gjallë a vdekun atë dhe shokun tjetër të tij, Çulin, si anmiq të Turqisë, që kishin vra shumë zaptie, nizamë e spahinj. Dhe do ta shpërblente atë me shumë pare.

Ali Qorri ishte ndjekë Becin dhe Çulin kamba- këmbës. Dhe një ditë me treqind seymenë i kishte rrethue në një shtëpi në Lezhë. Atje Beci me dy plumba në krahnor kishte arritë të vriste Ali Qorrin dhe bashkë me Çulin, midis zjarrit të armëve armike, kishte mundë të çante rrethimin, kishte kalue lumin Buna, kishte dalë në Malin e Zi dhe ishte ndalë në konakun e Mil Spasit. Ai i kishte pritë e mbajtë të dy për tre vjet si miq, si vëllezën dhe madje kishin pi gjakun e njeni-tjetrit.

-A më rrejnë sytë, a je ti Milo Spasi? - e pyet Beci atë që ka përpara,

- se kurrë nuk kam mendue se këtu do të takohemi së bashku dhe se do të luftojmë si bisha, si anmiq....

-Po, unë jam,- i përgjigjet Mili.

Atëherë të dy trimat përshëndeten sipas zakonit kokë më kokë dhe nisin e bisedojnë.

Habitet Rushmani, kur I sheh dhe habitet edhe ma shumë kur Beci i tregon ç'ka ndodhë midis tyre, ndaj i thotë Milit:

-Nëse do të dalim të gjallë nga kjo betejë, do të dojsa që të vijshe në Shkrej, ku jetoj, që djalit me m'i pre flokët dheme të ba kështu kumbarë.

Mili pranon me dëshirë, mandej nxjerr nga brezi revolen, më e fortë se pushka, dhe ia fal Rushmanit. Pastaj asht Rushmani që i dhuron Milit një pipë argjendi dhe si përshëndetet me të, i thotë Becit:

-Tash merre mikun dhe nxire shëndosh nga llogoret tona.

Ç'janë këto piskama që dëgjohen asaj gryke mali? Janë piskama që dalin nga gjokset e treqind barinjve, që kanë në krye Rustem Ukën, të cilët u zenë prita malazezëve, për mos t'i lanë të futen në Guci. Por aty vjen lajmi se Mark Milani me ushtrinë e tij po niset për nga Sutjeska, për ta rrethue dhe pushtue.

Atëherë Rustemi me sokolët e tij, ende pa perenduar dielli, fluturon andej dhe lëshon kushtrimin. Trimat e tij hidhen në luftë tue tundë taganët në ajër.

Aty kapërthehen dhe bëhen lëmsh me shkjatë, tymi i barotit u pengon pamjen, dikush ka humbë një sy, dikujt krahu i ka mbetë cung, shumë koka rrokullisen për tokë, gjaku derdhet me rrëke.

Vetëm kur dielli perendoj, pushuen krismat, u shkreh lufta dhe çetat u larguan, ndërsa hëna nisi me u dukë në qiell.

KENGA E NJEZETENJESTE

NDERMJETESIA

Rrëfen poeti:

- Amanet moj hanë, a di me më thanë, nëse të ka rastisë ndonjëherë të shohësh në këtë shekull, se ç' po ndodh në atë të mjerën Sutjeskë? Shpat, rudinë, vaditë me gjak, trupa njerëzish, njeni plagosun, tjetri vdekun, kush përmbys e kush në shpinë, disa shqiptarë, të tjerë

shkje, të dergjun të tanë mbi këtë tokë të zezë, pa pasë gur varri mbi krye.

Tutje janë kryqëzue huta dhe novica, këtu një këllëf kobureje, atje një vezme fishekësh, diku një batanie, në anën tjetër një xhurdi, ma tutje mbi mure të rrënueme shtëpish, trarë të shembun, tjegulla të thyeme, re tymi që ngrihet nalt, dhe një ulkonjë që ulurin mbi Sutjeskën e shkretueme.

Shumë nana kanë qa, shumë vajza janë fishkun, njëna për vëllanë, tjetra për burrin, të tanë të humbun, në Shqipni dhe Mal të Zi.

Sa qenë gjallë, shikuen me mëni njeni-tjetrin, u ndeshën, u vranë, dhe tash po në atë fushë i ka vëllaznue vdekja.

Atëherë Patër Gjoni shkon te pasha turk dhe i lutet që të vramët në luftë, shqiptarë dhe shkje, të mosbahen ushqim për sorra e falkonj dhe për kafshë të egra, sepse ata nuk ishin hajdutë të mbetun nëpër kaçuba, por trima që luftuen burrisht kundër njeni-tjetrit, kush si bishë e kush si luan.

-Prandej, - nis e flet Patër Gjoni, - kam mendue të shkoj te Mark Milani e t'i shpjegoj që deri nesër të vdekunit t'i varrosim dhe të kujdesemi për të plagosunit.

-Mirë e ke mendue,- pohon pashai turk,- i thuej Mark Milanit, që lufta të pushojë deri në agim dhe gjindja pa armë të merret me sabah me këtë detyrë të shenjtë.

Shkon atëherë Patër Gjoni në shatorren e Mark Milanit dhe bisedon me të. Pasi e dëgjon me vemendje, komandanti malazez i thotë:

-Në këtë punë të ndihmoftë zoti, mor i bekuem, se dhe mue me ke në besë. Por due me të pyetë për një gja: Ti i krishtenë dhe unë i krishtenë, të dy me kryq në dorë dhe me kryq në ballë, a është më mirë që të vazhdoni të jeni rob të turkut, që gjithmonë ju ka grabitë, apo të baheni ortakë me ne, tue ruejtë doke dhe fenë e krishtene dhe tue njohtë "gospodar" knjaz Nikollën tonë trim dhe fisnik?

Ia kthen frati qetë dhe mbarë:

-Tungjatjeta, komandar, muslimanë dhe të krishtenë së bashku e kanë Shqipninë një atdhe. Mirëpo ti nuk ke dyndë me top dhe bajoneta që të luftosh myslimanët, por për të shtrure toka tonat deri në valët e Drinit. Por ta dish se unë, frati, po të them këtë të vërtetë: Bashkë me myslimanë baj fli veten, për Shqipninë lidhem me vargoj dhe varem në kërrabë, se ju mund ta na nënshtroni, vetëm kur pëllambë për pëllambë truëllin tonë ta lani me gjak.

Kështu tha frati dhe bëni me u largue, por Mark Milani u tregue bujar

dhe u nda me të, tue i shtrëngue dorën.

Më të pushue lufta, gjatë tanë natës deri në agim, njerëzit e familjeve, shqiptarë dhe malazezë, secili në tokën e tyre, varrosën të vramët në luftë dhe u morën me mjekimin e të plagosunve, qofshin këta myslimanë, a të krishtenë.

Mandej, si hangrën bukë dhe pinë raki, sipas zakonit, tue bisedue me dhimbje për të vramët, trimat nisën me hapë gropa dhe llogore, me pre drunj, për me zanë shtigje nga mund të kalojshin malazezët dhe kështu, kur të vezullonte ylli i dritës, të nisshin përsëri me luftue.

...Dhe ja, kur po ktheheshin për në shtëpitë e tyre u duk një i ri, pa pushkë në krah dhe pa thikë në brez, pa kësulë në kokë, me fytyrë e duer të gërvishtuna, me këmishë dhe opinga të shqyeme, i cili mezi mbahej më kambë.

E pyeti Beci ç'i kishte ndodhë.

-Rastisi që një ditë dhe u zuna me do shokë të mi dhe shtimë kundër njeri-tjetrit. - iu përgjigj i riu,

- Dhe kështu u shtrëngova të hidhesha në Mal të Zi, ku, sa për të mos mbetë pa ngranë, punova te shtëpia e një zotnie. Por tash që lufta ashtë ndezë, malazeztë erdhën dhe më detyruen me punue për ta, me cue kosha me zahire dhe me mbajtë gurë dhe shkëmbinj për ushtrinë e tyre. Vendosa me ikë tinës, sepse shkja, pas besës që vutë për varrimin e të vramëve, asht tue ju rrethue. Kështu Mark Milani ka dhanë urdhën që menjëherë ushtria malazeze nga Sutjeska të shtrihet në rrazë të bjeshkëve, të zëjë tanë rrugët dhe shtigjet dhe të arrijë në Nokshiq. Prandaj them se duhet të shpejtoni dhe t'i dëftoni Ali pashës dhe krenëve shqiptarë që të përgatiten, sa nuk asht vonë.

Atëherë Beci me shokë dhe të riun malësor u nisën shpejt për në Sutjeskë dhe njoftuen krenët se ç'po ndodhte. Ata zunë me kuvendue dhe pastaj vendosën me lanë deri në mëngjes një forcë prej treqind vetësh në Sutjeskë dhe me u nisë natën, për me mbërrijtë në Nokshiq.

KANGA E NJEZETEDYTE

TRINGA

Vetëtin andej nga Nokshiqi. Gjëmimi krismave dëgjohet në Pejën e vogël. Janë armët e ushtrisë së Mark Milanit që shtien, që të derdhnin përsëri gjak shqiptari.

Komandanti malazet e ka mendue mirë: Gjatë tanë natës, ende pa ague, kur afati i besës për me varrosë të vramët në beteja nuk ka mbarue, ushtria e tij, pasi ka kalue nëpër gryka e nëpër maja, t'i afrohet Nokshiqit dhe që aty të vërsulet me tetë tabore, ashtu si fajkoi i vësulet një lepuri kur e pikas në ndonjë drizë.

Dhe kështu forcat e tij futen befasisht në Nokshiq dhe nisin me shkatërrue çdo gja që gjejnë përpara.

Nokshiqasit dalin të llahtarisun nga shtëpitë. Fëmijët qajnë, nënat dihasin, aty klithin, aty thërrasin njeni-tjetrin që të ikin që, të shkapërcejnë ledhe dhe gardhe, nëpër kodra e brigje, dhe bashkë me ta edhe gjedhët, që turren me tërbim; hingëllojnë mazat, marrin fushës, pluhni ngrihet nëpër ajër dhe bashkohet me tymin që del nga rrënojat e shtëpive që digjen.

Ne Nokshiq mbeten veç disa pleq dhe do gra, sa me rruajtë ndonjë kasolle e bagëti. Të tjerët me fëmijë për dore dhe djepa në krahë, tashma janë largue të tmerruem nëpër terr, që t'u shpëtojnë mizorive të atyne që në krahnor në vend të zemrës kanë një gur vorri dhe dinë vetëm të grabisin dhe të vrasin.

Kështu Mark Milani kërkon t'u tregojë shqiptarëve seç'kob tjetër po u sjell. Por nuk ka mendue mirë, se këtë nuk ka arritë ta bajë as sulltani i i Stambollit e jo ma knjaz Nikolla.

Rrëfen poeti:

- Po çuditim, kur shoh atje larg një shtëpi me oxhak që nxirka tym, dhe që paska një vathë përbri, me dhi e dhen, aty pranë një qen në stelë, një kalë dhe gjedhe në katue, kotecat plot me shpendë dhe ma tutje një pendë me qe për me lërue arën...

Një bukuri e rrallë në Plavë dhe Guci...Dhe po habitem kur nuk po shoh asnjë njeri që të largohet nga kjo shtëpi, për me shpëtue veten, as me plaçka ngarkue në shpinë, as me bagëti të vume përpara, sado që shkina e shkja po i afrohen; shkjetë me armë dhe shkinat me thasë e strajca, për me grabitë si zakonisht gjanë e huej.

Veç te dera e kësaj shtëpie po shoh një vajzë, që ka veshë një xhubletë të bardhë, që ka një rubë rreth ballit dhe flokët i derdhen jashtë shamisë.

Shtatin e paska si breshana synin si yll, ngjaka si molla në degë, si lulja që shpërthen. Dhe ndejka dhe këqyrka se ç' tmerr po ndodh përreth...Dhe nuk dashka t'u largoka!...

A thue, zanë, qofsha gabue, kjo vajzë ashtë miqësue me ndonjë shkja, prandej rri dhe po pret atë te dera e shtëpisë?

Përgjigjet Zana:

-Mos e thuej, bre burrë atë fjalë, se baj be për vjollca e karajfila, për bilbila nëpër bjeshkë, për hijeshi nëpër lëndina, për flutura nëpër fusha, për orë e shtojzavalle, se vajzë ma fisnike nuk ke pa. Asht e bija e Ulë Kaqetës, burrë i pushkës dhe i fjalës, e cila nuk ka koritë as babë dhe as nanë që tash kalben në varr, që i kanë lanë plang e shtëpi dhe gjithçka të begatë.

Tringë ia thonë emrin. Ka dhe një vëlla, Curr Ulën, pika e djalit, të cilin ajo e do si sytë e dritës. Por Tringa paska lindë orëzëzë, sepse vëllai tue luftue me shkja, u plagos randë nga dy plumba. Dhe tash u ba një vit që lëngon, pa mundë me u ngritë kurrë më kambë.

Natë e ditë motra tue ofsha, i rrinte mbi kokë, si nana i rri fëmjës te djepi dhe lotët nuk i thaheshinn kurrë në sy. I sillte mjek, i blente melheme, por ai i mjeri nuk po bahej mirë, fliste në jerm dhe priste vdekjen. Kurse ajo as nuk hante as nuk pinte dhe vetëm rrallë thërriste ndonjë shoqe për me e ndihmue.

Por kur po agonte, kishte mbetë vetëm, se edhe shoqet tashmë ishin largue nga Nokshiqi me familje, që të mos vriteshin nga shkjatë.

Si e marrë mendsh për fatin e vëllait, u çue e mjera dhe doli te dera e shtëpisë, pa qiellin mbulue me tym, pa flakët e zjarrit që po përhapeshinn rreth e rrotull, dëgjoi krismat e pushkëve, pastaj pa shkja që shtijshindhe vritshin këdo pa mëshirë, që po i afroheshin shtëpisë së saj dhe një çast edhe ajo mendoi të ikte. Por kujtoi vëllain.

“Si mundem me e lanë Currin vetëm”, - tha me vete, - të shtrimë, kur askush nuk mund ta ndihmojë dhe shkjatë do ta vrasin menjëherë?”.

Djersë të ftohta i ranë mbi ballë, donte të qante dhe nuk mundej, zemra i rrehte prej trishtimit. Nuk dinte e shkreta nga t'ia mbante. Veç të shkante të mbytej në lumë. Apo të binte në duart e shkjavë, të fliste gjuhën e tyne dhe t'u shërbente si robinë?

“Si nuk u shkëputka një një buzë mali për me më zanë nën vete?” - mendoi.

Shihte malazeztë që tue vikatë futeshin nëpër shtëpitë aty pranë, që vazhdojshin me vra dhe me grabitë dhe që pas pak do të arrijshin edhe në shtëpinë e saj.

Ashtu si suta që ndahet nga shoqet dhe turret si shigjetë në pyll, tue u dridhë nga frika, kur sheh gjuetarin që shtin, ashtu dhe Tringa vrapoi në shtëpi, e zbehtë si qirini, me buzë të nxime,

mbërtheu shulin në derë dhe të rëqethuna nisën me i shkue nëpër shtat. Nga tmerri të gjitha sendet i dukeshin si të ishin shkja, me orendi, enë dhe rroba...

Në ata gjendje, dënasi, harroi veten, harroi dhe shkjatë, po jo vëllain, ndaj shkoi dhe i qëndroi mbi kokë, i puthi ballin, i puthi sytë dhe ia lau fytyrën me lotët e saj. Vëllai u përmend dhe kur pa se cirka i bijshin mbi fytyrë, mendoi se jashtë ishte tue ra shi, prandej e pyeti :

-Moj shtëpi që mbetsh shkret, po kaq shpejt çatia po të pikon?

-Jo, mor Curr, - i përgjigj motra,- nuk janë cirka shiu ato që pikojnë nga hatullat, por janë lotët e mi.

-Po ti, motër përse po qan dhe po ma ndan zemrën dysh, kur tashma shpirti po më del? Mos të kam lanë pa ngranë dhe pa pi, pa u veshun dhe stolisë si shoqet e tjera në Malësi, ose mos të paskam folë randë?

Atëherë motra i vuni dorën në ballë dhe iu përgjigj ambël:

- Çka po thua, mor vëlla, po kaq shumë jermi të ka turbullue? Ti nuk më ke folë kurrë rëndë, por si nuk t' u mëkëmb ky shtat, për me dalë te dera, si nuk t' u tha motra nga vera, që unë të mos shkoj robinë te shkjatë?

Curri vranoi vetullat dhe i tha:

-Ç'thue Tringë, edhe pse unë do të kalbem nën dhe, ti nuk do të shkosh kurrë robinë te shkjatëv, se fisi ynë nuk të lë, pa derdhë gjak.

-Por ti nuk e di, mor vëlla, se shkja ka ra në Nokshiq dhe po ban kërde tue vra dhe plaçkitë!

Atëherë vëllai u zbeh, psherëtiu, hodhi sytë nga pushka, që nuk e kishte prekë me dorë që prej një viti, fryma iu mor dhe nuk tha ma asnjë fjalë.

Kur e pa të vdekun, Tringa nisi me vajtue, por edhe mendoi si do ta varroste, kur shkja vazhdonte të vriste dhe të digjte...

Përjashta dëgjoheshinn zëra malazezësh që mblidhshinn kashtë, për t' i dhanë zjarr një shtëpie aty pranë.

Atëherë Tringa nxitoi të futej dhe të fshihej në një arkë të madhe, por pastaj u ndal dhe tha me vete:

"Ç' më duhet ma jeta, kur kam vëllanë të vdekun mbi dhe? "

Flakëroi drejt e në dhomë të burrave, ku ai dergjej i vdekun, e puthi edhe një herë në ballë, rrëmbeu hutën dhe mësyu nga dera, në oborr. Dhe befaz vuni re një malazez të vrazhdë që po afrohej andej.

Kur pa Tringën, kujtoi se ndodhej para një zane dhe u betue

për Shën Pjetrin e Cetinës, se sikur rrotull t'i binte botës, nuk do të gjendte kurrë vajzë ma të bukur sa ajo. Prandej vendosi ta merrte dhe ta shpinte robinë në shtëpinë e tij.

Kështu sulet nga Tringa, por ndalet kur sheh se ajo ka ngritë hutën drejt tij.

-Mos, moj bujareshë, - bërtet i tmerruem,- se po shoh se vërtet qenke bijë fisi trimash!..

Por Tringa e qëllon drejt e në parzëm. Malazezi shembet si shkamb, por vajza nuk luan prej vendit, me synin si flakë baroti. Dhe kur përpiqet të fusë në hutë plumbin e dytë, një malazez tjetër aty në oborr, shtie dhe godet në ballë. Tringa bie e vdekun, me mollëzat e fytyrës të lame krejt në gjak.

Edhe dielli që ndriçonte për ditë mbi tokë, nuk kishte pa një vajzë shqiptare të binte gjallë në duert e shkjave...

KANGA E NJEZETEETRETE

TE TBANAT E CURR ULES

Kështu u shue Tringa atje në oborin e shtëpisë. Si lulja e çelun mbi gem, që këputet nga breshëri.

Vrasësi ishte Vasil Ndreka, një shkja, sykërveshun dhe thinja në kokë.

Kjo ndodhi kur trimat shqiptarë që po vijshin nga Sutjeska, gjatë rrugës nëpër kreshta e suka, u ndeshën me gra dhe fëmijë të cilët kishin lënë Nokshiqin. Dhe kur prej tyre mësuen se ç'krime kishin ba shkjatë kundër gjindjes së pafajshme, gra me fëmijë dhe të moshuem, u derdhën me furi si bisha mali, shpateve të thikta, luginave, kodrave dhe fushave, të gjithë që të jepshin jetën në Nokshiq.

Dhe ja, Gjetë Gega, bajraktari i njohun i Shllakut, tue u vërsulë thep më thep, arriti te shtëpia e Tringës dhe kur e pa atë të vrame nga Vasili, e qëlloi me pushkën e tij dhe e la të vdekun. Pastaj nxori prej millit shpatën dhe i preu kokën.

Por Vasili nuk ishte vetëm. Në çast aty u duk një burrë kaproç, harushan, me kryet si rrënjë trungu, mustaqet derdhë si shtëllunga, i fortë, sa pa u lodhë fare, mund të mbante këdo në shpinë, nga Nokshiqi në Cetinë.

Ky ishte Millosh Pera prej Vasoviçi, që kur pa Vasilin pa kokë, ngriti novicën, por ajo nuk mori zjarr. Atëherë e hodhi tutje, nxori taganin dhe u vu përballë Gjetës.

Edhe Gjeka nxori taganin e vet dhe të dy nisën të përlësheshin. Taganët përplaseshin e vezullonin në duert e tyre, gati për me pre kokat e njeni-tjetrit.

Kur shkinat panë me sy këtë dyluftim të rreptë, lëshuen britma dhe u banë zë shkajave të vijshin në ndihmë të Milloshit. Por ata ishin hutue pas plaçkave që po grabitshin. Milloshi u ndodh ngusht, sepse nuk mund të mësynte, por vetëm të mbrohej me taganin e tij.

Kështu Gjeta shty dhe Milloshi prit, hapu Gjeta, për ta lënë vdekun, rrëshqit Milloshi, për t'i shpëtue, erdhi një çast që Gjeka e goditi Milloshin në bark. Ai u tërhoq gjithnjë mbrapsht, kambët i ndeshën në kufomën e shokut të vet, Vasil Pera, të vramë Tringa, dhe nuk lëvizti.

Por kur Gjeka i ktheu shpinën, duke e kujtue të vdekun, shkajau i përmbysun si buell, u ngrit më kambë dhe u përpoq që ta godiste atë në qafë. Por nuk mundi, sepse iu errën sytë, bani disa hapa, tagani i shpëtoi nga duert dhe ra i vdekun për tokë.

Gratë malazeze u llahtarisën kur panë ç'ndodhi dhe nisën me bërtititë dhe me qa. Pastaj iu sulën Gjetos që ta mbytyshin. Atëherë Gjetaja shkuli një hu gardhi dhe filloi tua tundte mbi kokë që t'i trembte. Dhe ato tue sha dhe mallkue Gjeton, u larguen.

Por britmat e tyne i dëgjoi Kërstiç Vuku, një nga besnikët ma trima të knjaz Nikollës, që hekurin e brente me dhambë. Kur pikasi shokët e vet, Vasil Ndrekën dhe Millosh Perën, të shtrimë përmbys dhe të vdekun, u mbush me mëni, flokët iu ngritën përpjetë dhe me novicën në duer, si ujku sulet mbi një sqap, edhe ai u sul mbi Gjeton, që nxori shpejt koburen i dha zjarr dhe ia thau shkajaut lëkurën.

Në ato çaste aty u derdh një çetë ushtarësh malazezë. Ata nuk pritën, por banë drejt nga Gjetaja për me e copëtue me taganët e tyne. Por nuk panë që në mes të oborrit u duk Luc Gjeloshi, nga Gruda, që u turr dhe qëndroi pranë Gjetos me shpatë në dorë.

Kështu nisi kjo betejë. Dhe sapo një nga malazezët deshi ta godiste Gjeton, Luci shtjeu me pushkë mbi të dhe e qëlloi nën vetull.

U tërbuen shkajatë kur shikuen shokun e tyre të vdekun dhe i rrethuen të dy trimat malësorë. Dhe do t'i kishin vra, por, pa pritun ay ia behën malësorë të tjerë, djelmosha si dema, që edhe

hija e tyre të frikësonte dhe hovin nuk ua ndalte as topi.

Këta si panë që shkjetë kishin rrethue Gjeton dhe Lucin që mezi mbroheshin, u lëshuen kundër tyne. Aty u mbërthyen, u kapërthyen, u kacafytën, disa të rrokun, të tjerë të plandosun për tokë. Përpiqeshin me duer t'i zijshin frymën njeni-tjetrit, përpiqeshin edhe t'i nxirnin shpirtin me thonj, si kthetra kulshedrash.

Vazhduen kështu gjatë këto dyluftime.

Bijshin për tokë të plagosun nga shqiptarë dhe malazezë, tue rënkue nga dhëmbjet e varrëve, bijshin dhe të vramë dhe mbeteshin të heshtun...

Nga shatorrja e tij Mark Milani pa re tymi që ende ngriheshin nga shtëpitë e rrënueme dhe të djeguna në Nokshiq që kishin mbulue qiellin. Mbathi atëherë çizmet, u vesh, u armatos dhe çoi më kambë ushtrinë të përbame nga gjashtë tabore, kaloi me të nëpër bjeshkë dhe u ndal në rrethinat e Sutjeskës. Mendonte t'i sulmote shqiptarët në befasi dhe t'i gjendte as të fjetun dhe as të zgjuem, t'i rrethonte, dhe ashtu siç zihen peshqit gjallë në rrjetë, edhe ai t'i zinte ata, t'i vinte në radhë si bagëti dhe t'ia dërgonte të gjithë të lidhun knjaz Nikollës në Cetinë.

Por dëgjoi krisma armësh poshtë Nokshiqit. Krejt i habitun dhe i turullusun, u turr në një shkamb, ngriti dylbitë dhe nisi të këqyrte rreth e rrotull, mal më mal dhe vërri më vërri.

Atëherë mbeti dhe ma i habitun kur pa luftëtarë shqiptarë që kishin nisë me luftue, pa shpatat që ndritshin nën rrezet e diellit, pa plot ushtarë të tij të përmbysun atje tek Tbanat e Curr Ulës, pa dhe kapitenin e tij, Mirkon, që ndonëse trim, dukej i hutuem dhe ashtu si mëzati që bërlyket në fushë tue uluritë, edhe ai vikati tanë zemërim:

-Ku je, Mirko, që ti mos qofsh?

Kuptoi se luftëtarë të tjerë kishin ardhë nga Sutjeska në Nokshiq, për me dëbue forcat malazeze nga tokat shqiptare. Dhe menjëherë dha urdhën që disa tabore, me shkja nga më të egrit, që nuk dijshin ç'ishtë besa dhe nderi, të hidhesin andej, për me ndihmue ushtrinë, që kishte humbur mendjen pa plaçkave dhe që po grabiste në shtëpitë pa zot.

U dëgjue atëherë buria që dha sinjalin e sulmit, pastaj krismat e daulleve dhe ushtria malazeze u nis për në Nokshiq, për t'i ardhë në ndihmë forcave të Mirko Kapitanit.

U ndez përsëri plot urrejtje lufta midis shqiptarëve dhe shkjave, vloi përsëri huta dhe novica, u përziën kapica dhe kësula, britma, ulurima, zunë topat të gjëmojshin, shungullima e tyne u përhap gjithandej dhe qielli i Nokshiqit u mbulue përsëri nga mjegulla dhe tymi.

KANGA E NJEZETEKATERT

ZANA E VIZITORIT

Ndërsa lufta vazhdonte e ashpër, Zana e Vizitorit kishte dalë në një cep prej nga po kundronte se si në rrethinat e Nokshiqit lufta vazhdonte të ishte gjithnjë dhe ma e ashpër.

Ishin një grusht trimash shqiptarë të atyre anëve, që për pesëqind vjet nuk ia kishin nda pushkën sulltanit dhe e kishin kalue jetën të lirë, ashtu si shqipja, kurse serbi ngastrestar kishte nisë krushqi dhe miqësi me turkun.

Dhe ndërsa vazhdonte me dëgjue krismat e e armëve që dendësoheshin gjithnjë e ma shumë dhe me kundrue dyluftimet me tagana dhe trup me trup, te Tbanat e Curr Ulës, sytë e Zanës panë Tringën e mjerë, të shtrime pranë derës së shtëpisë dhe të zhytun në një pellg gjaku.

Zana e kishte njohun atë ende fëmijë, kur lunte me shoqe të saj, në fushat e Vizitorit, kur shtihej sikur qante, që kur të bahej nuse, të dinte të vajtonte për burrat që do të vriteshin në luftë me malazezët, kurse tashti kishte mbetun vetë e vrame prej tyre.

Dhe kur e shihte aq tëçiltër dhe aq të thjeshtë në ato argëtime e lojna fëmijësh, dhe të endej fushave si një flutur, Zana kënaqej dhe u tregonte shtojzavalleve për të. U fliste për bukurinë e saj, për shtatin si trungu i pishës, për vetullat e holla, për sytë si kokrra qershie, për dhambët si gurët e lumit, u rrëfente si e mbronte nga kafshët e egra, kur kulloste tufën e dhenve, të cilat, sado të urituna, gati për t'iu sulë dhe shqye, largoheshin prej saj me kokë të ulun.

Prandej, kur Zana e Vizitorit pa trupin pa jetë të Tringës, u rëqeth dhe me flatrat e prarueme, si ato të pëllumbit, u lëshue teposhtë, drejt e në oborrin e shtëpisë së Curr Ulës.

Vdekun Curri, i shtrimë në dhome, Tringa shtrimë, pa jetë në

oborr...

Si nana që kur fëmijën e ze gjumi në vatër, e merr pezull dhe e çon te shtroja, ashtu dhe Zana e ngriti pezull, ia vuni asaj kryet në njenin krah, si të druente se mos po i delte gjumi, u ngrit në ajër përmes plumbave dhe gjyleve të topave, dhe pasi fluturoi, u ul në strehën e saj, pas shkëmbinjsh të kreshtave të Vizitorit.

Pas kreshtave shtrihej një fushë e gjelbërueme, ku vijshinorë dhe zana të viseve shqiptare që laheshin dhe freskoheshin aty në ujnatin e një gurre dhevallëzojshin dhe këndojojnë nën dritën e hanës.

Në atë fushë e uli Zana Tringën dhe nisi të ofshante. E dëgjuen këtë ofshamë motrat e saj dhe ia behën aty si vetetimë. Dhe kur panë trupin e vdekun të Tringës, u shkrehën në vaj dhe ranë përmbys mbi të.

-Mjaft, vajza, pushoni vajin, - u tha Zana, - se kemi kohë për të qajtur. Jetojmë në një vend, ku bari rritet me lotë, ku toka ashtë e brujtun me gjak, ku shqiptari, qoftë burrë, qoftë grue, ka vuejt, qysh se e mjera Shqipëri ka armiq turq e shkja. Por tashti të bahemi gati që të varrosim Tringën.

E lanë dhe e veshën trupin e saj me roba të reja, e varrosën sipas zakoneve dhe e kujtuen përsëri të vogël kur endej fushve dhe mbledhte lule me shoqe, ndërsa dëgjohej kanga e zogut të verës që këndonte aq bukur. Mandej zanat lëshuen një piskamë që jehoi nga Vermoshi deri në bjeshkët e Tropojës, te Maja e Hekurave dhe ma thellë viseve të Shqipnisë.

Atëherë u ngrit Zana e Vizitorit dhe me lot në faqe dhe me zemër të pikëllueme, nisi të thoshte:

-Dëgjoni, orë dhe zana, due të zë nje be të madhe: Pafsha rrezet që lëshon hëna, pafsha vesën nëpër lëndina, pafsha ahe dhe qepariza, mos e pritsha kurrë pranverën, as mos më thanshin zanë, në qoftë sederi nesër, pa lindë dielli, Tringës hakun nuk kam me ia marrë. Treqind shkja kam me zanë rob, trimijë çika, nuse të reja, para kohës kam me i lanë të veja, që të qajnë si gjithë qyqet në kasollet e tyre.

Pastaj Zana u ngrit në ajër dhe lëshoi një piskmë të madhe. Ushituen bjeshkët, malet, shungulluan fusha e dhe lumejtë. E dëgjuen atë lekët e Malësië dhe u kujtuen se në Nokshiq ushtria shqiptare kishte nevojë për plot trima të tjerë, ndaj u çuen të tanë më këmbë, ngjeshën armët në brez dhe morëm rrugën që të conte atje.

Shungulloi dhe Dukagjini, Shala dhe Shoshi, Shllaku dhe Temali.

Zana lëshoi përëri një piskamë që këtë radhë ushtoi në Pejë e

Gjakovë, u dëgjua në Rekë dhe Rugovë dhe plot trima të tjerë u nisën për në Nokshiq, pa u ndalë dhe pa pushue askund. Kur nisi të fryjë era, deti u zbardh nga tallazet dhe retë zunë qiellin. Do të fillonte shtërgata dhe shi, do të gjëmonte Cetina.

KANGA E NJEZETEPESTE

GJAKU I MARRUN

Fort ushtoi piskama e Zanës së Vizitorit nëfusha e bregore, fort jehoi në lumej, fusha e lëndina.

Por këtë piskamë e dëgjoi edhe Ora e Malit të Zi, që jetonte në një strofkë ndër shkëmbinjtë Durmitorit. E njohu dhe kuptoi se, ashtu si dëbora që bie në tanëShqipninë, edhe kjo piskamë binte nëçdo shtëpi malësori dhe do tëëgrishteburrat tëngriheshin dhe t'i vijshinnë ndihmë ushtrisë shqiptare, atje në Nokshiq, ku ziente lufta...

Me fytyrë të kuqe e vetulla të vrazhda dhe menjeninsy të prishun, por e fortë dhe e pabesë si shtrigë, ajo u hodh përjetë dheu lëshue fluturim kah Nokshiqi, drejt një maje shpati, ku ishte shatorrja e Mark Milanit. Dhe fluturoiposhtë, nëpër gryka dhe lugina, nëpër përrenj dhe pellgje, si të kishte frikë se nalt mbi re do të ndeshej meZanën e Vizitorit, që do t'i binte pingul, do të përleshej me të dhe do ta mposhtte.

Ç' bani atëherëajo? Pa pritun, u shndërrua dhe mori pamjen e njëpoetitmalazez, që kishte jetue në Cetinë, burrë me mjekrën të gjatë dy pëllëmbë, që përmendej për kangë të mo\$me me nam, iu afrue Mark Milanit dhe nisë t'i fliste me gjysmë zani:

- Dëgjo, Mark, ty ka me të sulmue si stuhi tanë Malësia. Dhe kam frikë se, po nuk u banegati, shqiptarët, të idhtë si helmi, kanë me të mundëkeq, saqë vështirë do ta kesh të shpëtosh kokën.

Kështu tha Ora e Malit të Zi me pamjen e poetit malazez dhe u zhduk menjëherë prej shatorres.

Atëherë Marku u çue më kambë, flokët iu ngritën përjetë, vetullat iu ngrysen, dhe dha menjherë urdhën që malazezët të baheshin gati me sulmue ushtrinë shqiptare dhe, pa perendue dielli, tathyejshin dhe të zijshin robë sa më shumë shqiptarë, të hajshin

mëngjesin në Plavë, drekën në Guci dhedarkën në Shkodër, në kalanë e Rozafatit.

Bieboria, gjëmon daullja, dhe taboret malazeze,të prime nga vojvodë e kerserdarë,ashtu si copa shkëmbinjsh që shqepen nga malet, rrokullisen teposhtë dhe tundin tokën si tërmet, ashtu dhe hordhia e knjaz j Nikollës mësyn për nëNokshiq.

Ç'asht ndezë vendi flakë në Nokshiq, Hot e Grudë ku përplasen shqiptarë me shkja,ç'ka krisë huta dhe novicë, ç'janë ndeshë egërsisht midis tyne, njëni mësyn, tjetri mbrohet, kush turret me vrap, kush e ndjeknga pas, kodër më kodër e shkrep më shkrep, tue i bërtitë tanëmllef njeni - tjetrit.

Luftëtarët malësorë uthonë me krenari malazezëve se nuk kanë dalë në luftë për të vjedhë, por për t'u ndalë atyne hovin, se ata janë vrasës dhë plaçkitës. Dhe ata tmerrohen kur para tyne shohin sokolë si Çun Mula, Lul Rapuka, Lucë Deti, Nikë Gjelosh Luli, Gjeto Mark Ujka...

Tutjejanë Islam Makalushi, Osman Haxhia, Bec Patani, Rrushman Hasani, Dodë Preçi, Gjeto Daka e plot të tjerëqë i bajnë shkjatë të zmbra sendhe të mos dinë se ku të fusin kokën, kur dëgjojnë britmat :“Bini Hot e bini Grudë!”.

Të dridhet këmisha në shtat, kur sheh gjylet e topave që plasin dhe trupat e gjakosun dhe copëtuem të luftëtarëve që dergjen në fushën e betejës, ndërsa të tjerë vazhdojnë të kacafyten me tagana, deri sa muzgu nis dheshtrin pëlhurën e vet mbi tokë.

Atëherë pushon lufta, dëgjohen vetëm rënkimet e të plagosunve që kërkojnë ndihmë, ose të atyne që janë tue dhanë shpirt.

Ndërkaq era pushon dhe nga qielli mbushun me re, fillojnë me rarrëke shiu. Ushtria shqiptarenis të mbushet me luftëtarë që vinë nga Malësia e Madhe, Reka dhe Kuqishta, deri nga Dukagjini dhe vise të tjera shqiptare.

Nëpër shtigje të vështira nga njeri shpat në tjetrin atyne u prin Zana e Vizitorit.

Rendin njeri pas tjetrit rojat malazeze, arrijnë te shatorrja e Mark Milanit dhe e njoftojnë se ushtria e tij asht rrethue.

Si dredh mustaqet dhe kafshon buzën me dhambë, ai merr shpatit si bari, kalon vetëm nëpër zabele e shkurre dhe takon mikuntij, Mirko Kapitanin, dhe i tregon ç'ka ndodhë.

-Që tash nëpër shi, rrugë pa rrugë, - i thotë Mirko Kapitani, - nise ushtrinë për ngaura eLimit dhe që aty, tinës, nëpër errësinë, urë

pa urë dhe me barkë ose pa barkë, kalo nga Qafë Morina dhe ndalu në Cetinë. Vetëm kështu mund të shpëtosh.

Dhe Mark Milani e dëgjon këshillën e tij.

Por kur ushtria po arrinte në urën e Limit, përballë saj kishin zënë vend rugovasi, që nuk linin as edhe një zog të kalonte mbi urë. Mark Milani e kuptoi se ishte rrethue nga lumi dhe nga shpati i malit.

Kështu në atë vend të ngushtë, si në një gropë, u ndez lufta. Dhe aty Oranisi t'i ndihmonte malazezët se si të dilnin nga rrethimi. Por Zana e Vizitorit, e fshehun pas një reje, e njohti dhe nuk ia ndau synin. Të dyja, herë duke qëndruar pa resh, herë mbas malit, iu sulën njera-tjetrës dhe nisën të përlesheshin me flatra, me kthetra dhe grykë më grykë. Dhe ja, nëpër ajër, hipun mbi dy breshka deti, u dukën dy suta dhe panë se si Ora e Malit dhe Zana e Vizitorit po kapërtheheshin. Të dyja iu hodhën Orës malazeze mbi shpinë dhe filluen t'i shkulshin flokët, t'i zijshin frymën. Ajo u përpoq t'u shmangej, por nuk mundi, sepse Zana, së bashku me sutat, e ngritën në ajër dhe e çuen në Vizitor, te vorri i Tringës së mjerë. Atje e lidhën në një bli.

Pastaj Zana u nis për në Nokshiq, ku vazhdontë lufta midis shqiptarëve dhe shkjave, kurse secila nga sutat kapën nga një gjarpër të gjallë, tanë helm dhe nisën ta goditshin Orën e malazezve ku të mundshin, pa mendue se ku i dhimbte dhe ku i digjte.

Gërthiste ajo në kupë të qiellit, përdridhej dhe përpiquej me shpëtue, por nuk mundte.

-Ah, ngadalë, se nuk të lëshoj kurrë,- i tha njëna nga sutat,- se ti pastaj do të shkosh të ndihmosh Mark Milanin, i cili kërkon me shtrure Shqipninë nën këmbët e knjaz Nikollës.

Ora, e lidhun gjithnjë pas blirit, rënkoi, kur mendoi se vërtet nuk mund të bante asgja për ushtrinë malazeze. Në betejën e Limit shqiptarët kishin shkatërrue tri tabore të saj dhe kishin mbetë të vramë treqind shkja dhe po treqind prej tyre ishin kapë robë.

Ç'po lumnon Zana, ç'po fluturon nëpër qiell dhe ç'po ia merr kangës në majë të Vizitorit me jehonë që përhapet në të gjithë Shqipninë!

-A të kam thanë, knjaz Nikolla,- kumboi kudo zani i saj,- se deri sonte, pa perendue dielli, gjakun e Tringës kam për ta marrë. Por

pyete Mark Milanin dhe ai ka me të dhanë sihariqinin
se ushtria e tij u shpartallue në Lim.

Kështu kishte ndodhë dhe kështu do të ndodhte.

Shqiptarët do të përballojshin sulmet e malazezëve, do t'i
thyejshin dhe do t'i dëbojshin nga tokat shqiptare.

KANGA E NJEZETEGJASHTE

KOHA E RE

Kanë pushue krismat e armëve, ka pushue lufta dhe poeti ka
shkue në qytetin e lashtë të Lezhës. Dhe atje i drejtohet zanës:

-Hej, moj zanë, që je kaq e hijshme, që e ke fytyrën të shtrume
si fletë trëndafili, tëbardhë si dëborë dhe si brymë, zanin si të
bilbilit, a kujtohesh ndonjëherë për mue, për me më tregue për
ngjarje të hershme, por fluturon mollë më mollë dhe ftue më
ftue, tue këndue dhe vallëzue me shoqe të tua nëpër lëndina, ku
lulëzojnë pemë dhe ku shfaqen orë dhe zana të tjera?

Si të shkoi jeta me kangë dhe valle, tue nga pas sutash nëpër
shkëmbinj dhe tue u zhytë e freskue nëpër gurra?

A di ti se mue po më le këmba dhe dora se nuk do të shkojë
shumë kohë dhe do të kaloj në jetën e përtejme?

Pra, dëgjoma një fjalë, leni sot shtojzavallet, leni fluturat nëpër
fusha, leni sutat të marrin malet, leni vjollcat dhe lilat, leni gurrat
dhe perrenjtë, se tue u la dhe tue u freskue në dritën e hanës a të
diellit, drue se ftohesh e sëmundes..

Prandej, hidhu nga Dukagjini, ku kalon dimnin e egër, fluturo si
ylli që shndrit dhe behma këtu në Lezhë, që në këto ditë pranvere,
të jem larg zhurmave dhe potereve dhe të këndoij "Lahutën e
Malësisë", se si u end fati i Shqipnisë, si doli ajo nga zgjedha e
robnisë turke, si u shpëtoi kthetrave të Shkjenisë.

Hidhu, pra, këtu në Lezhë, që kangën të ma vesh në fill, tue ma
ndriçue mendjen me këshillat e tua, të bash që fjala të tingëllojë
herë-herë e butë, si flladi në pranverë, por edhe herë e fortë, e
rrebtë dhe dërmuese, si duhi plot shungulim; të rrjedhë mbarë,
që të kthjelltojë mendjen dhe zemrat e shqiptarëve, t'i mbushë
me ndjenja të mira, që feja dhe atdheu të shkojnë përpara. Sepse,

po u end kënga së mbari, shqiptarët ty kanë me të urue...

Edhe këtu nuk ke për t'u mërzitë, sepse këtu gjen gjithçka që të kandet ty, vezullime, gurgulime dhe blerime, vise me kodra e lugina të veshuna me lule gjithfarësh, bilibila që këndojnë nëpër degë pemësh, keca dhe qengja që blegërojnë, hardhia që përdridhen nëpër qepariza, kopshte ku lulëzojnë pjeshka e zerdelia, ku blerojnë drunj në breg të Drinit, ku nën qiellin kaltër dëgjohet fyelli dhe kënga shqiptare, njëmend stinë për orë dhe zana, se këto vise, që në kohë që nuk mbahen mend, kanë qenë log zanash me orësh, ku viganë e katallanë ndesheshin edhe para ilirëve dhe mandej shqiptarë, që lindën në këto troje.

Këtu në Lezhë ke me pa një kala, ngritun me mure që prej trimijë vjetësh, ke me dëgjue se vala e Drinit kur kalon andej qan për Gjergj Kastriotin atje në vorr, shpata e të cilit vezulloi mbi Shqipni si rrufeja e Perendisë, sepse dikur këtu edhe mbretët ilirë, Bardhyli dhe Teuta, Pleurati Agroni dhe Genci nuk dijshin ç'ishte frika nga romakët...

Mandje në mbrëmje, kur del hana, mblidhen zana dhe ora dhe dora- dorës këndojnë për luftërat e të parëve tanë, për fatin e keq të Shqipnisë së mjerë që pas vdekjes së Gjergj Kastriotit u bë robinë e Turqisë.

Por, nëse ti, moj zanë, mërzitësh nga këngët e mia, dil e këndo bashkë me shoqe të tuat, ndiq suta deri në Vel. Dhe atje do të shihni një shpellë. Një natë të errët kur vetëtonte dhe gjëmonte, Gjjon Markaj paska mësyre në atë shpellë Kulshedrën, i paska mbërthye në qafë një palë danë dhe e paska ngujue, sa nuk mund të lëvizte. Dhe ajo mbeti e zhytun në ujë, me danët varun në qafë, nga ku rridhte vazhdimisht gjak. Ndaj, atje mos hyni, se atje shtrigat e Kthellës takohen me ato të Mirditës, Selitës dhe Xhubës.

Dhe, në qoftë se ke dëshirë të shetitësh bregut të detit, do të shohësh floçka dhe kshteza, ndenjun shulla dhe mandej tue luajtë nëpër ranë. Ato janë si gra të detit që jetojnë si bretkocat në ujë dhe tokë. Dhe sikur t'i kapësh dhe t'i mbash në shtëpi, mund të mësojnë të flasnin shqip. Kështu ka ndodhë, me një këlmendas që kapi një të tillë, u martue me të, bani fëmijë, i rriti dhe u foli atyre në gjuhën tonë.

Por duhet të të them diçka tjetër, moj zanë belhollë. Ka disa kohë që zana të Elikonës kanë lanë fusha e male të Greqisë, kanë dalë në Shqipëri, dhe mendojnë se shqiptari nuk është pa fis dhe atdhe, që të ulë kokën para turkut dhe malazezit, se vetë Shqipëria të jetë

zonjë më vete, që atje të mos sundojë kurrë Sulltani, që shqiptarët ta mësojnë ta shkruajnë gjuhën e tyre, të kenë pavarësi, se ndryshe, thonë, lirinë do ta fitojnë me armë në dorë.

Tash, moj zanë, me sy qershi, po kuptoj se ty të pëlqen që bashkë me shoqe të tuat më shumë të shkosh fushë më fushë dhe krue më krue dhe bashkë me to të ligjërosh, të këndosh dhe të hedhësh valle.

Po mirë do të ishte që të dilshe nga Veli në Bushat dhe që andej të hidheshe në malin e Rozafatit e pastaj të ndaleshe në kalanë e Shkodrës, ku do të gjeje zanat e Elikonës që me zana shqiptare do të nisinin me vallëzue .

Bashkohu dhe ti me to, thueja kangës, por pastaj kthehu këtu përsëri, sepse kanga e endun pa ty, është si vaji dhe tymi që të mbulon sytë. Kështu pra, nëpër hanë dhe nëpër dritë, tue u argëtue, nuk do të merzitesh dhe moti do të kalojë, ashtu si ke dëshirë, pa u kujtue që lahuta ka mbetë varun në sergji.

Eja, pra, moj belhollë, dhe kangën ma fillo dhe kështu, unë këndoj dhe ti këndon, do të këndojmë si zogu i verës.

KANGA E NJEZETESHTATE

XHEMJETI

Viti 1908.

Në pallatin e sulltanit asht mbledhë mexhlizi. Erven pasha ngrihet e thotë se të gjithë ata që jetojnë nën hanë dhe yll, të quhen osmanllij. Kështu pra, do të quhen të gjithë popujt e pushtuem nga turqit, thue se të tanë t'i ketë lindë një nanë. Kështu do të quhen edhe shqiptarët. Pa u ankue, pa ba za...

Por shqiptarëve, si do që e njohin sulltanin dhe këtë komitet, nuk po u hyn në kokë mendimi që ta quejnë veten me emrin osmsnlj, të ndërrojnë kështu kombësinë, të ndërrojnë gjuhën , zakonet, sepse të krishtenë, a myslimanë, gegë e toskë, janë të tanë shqiptarë.

Ata më shumë se kurrë duen të hapen shkolla për mësimin e gjuhës shqipe, duen të shkruhen libra e gazeta po në këtë gjuhë, nuk duen të japin ma nizamë, duen që Shqipniia të jetë më vete⁴) dhe jo nën hijen e sulltanit.

-Ju kushedi nuk e dini,- thotë Erven pasha në mexhliz,- se qyshse prej qindra vjetësh e kemi vu Shqipninë nën këmbët tona, pesëdhjetë e katër herë shqiptarët me armë në dorë kanë ngritë krye kundër nesh. Prandaj këtyre “pis arnautëve” duhet t’ua shtypim hundën me grusht që të mos u bjerë kurrë ndërmend që të na nxjerrin telashe .

Ngrihet pastaj një plak me mjekërr. Asht Sinan pasha që thotë:

- Avash, se shqiptarët janë fis i vjetër dhe prej më shumë se katërqind vjetësh që kemi hy në atdheun e tyre, i kemi shty të bajnë gajret për ne. Në Jemen dhe Sebastopol kanë kanë derdhë gjak, fyt më fyt janë pre me shkja, në luftë të parët kanë sulmue dhe të fundit janë tërheqë. Janë pjekë në diell, janë ngri në murlan. Po ne ç’kemi ba për shqiptarët? I kemi rjepë nëpër taksidarërë, i kemi nxjerrë prej shtëpive, prej tokës, i kemi i varë në litar, i kemi ba të vdesim. U kemi ndërtue ura, u kemi çelë rrugë?, Jo, në Shqipëri Turqia nuk ka lanë një shenjë. Pse duem atëherë qa ajo që të rrijë gjithmonë rob nën ne, që shqiptarët të mohojnë vendin ku kanë lindë? Prandaj asht ma mirë që të mos i ngasim, që të mos kemi telashe me ta.

Pas tij çohet Turgut pasha që mbledh vetullat e denduna dhe nis me ligjërue:

-Nëse Turqinë nuk duem ta vemë në rrezik, shqiptarët duhet t’i shtypim, e jo më të mos i ngasim dhe t’u japim një farë pavarësie. Pra, nuk ka derman, nëse në Shqipni nuk dërgojmë njëqind tabore që ajo mos guxojë të ngrejë kurrë krye. Me fuqi u ngrit Turqia, me fuqi do të mposhtet dhe Shqipëria.

Atëherë mezhlizi e cakton turgut pashën komandant të këtyre njëqind taboreve me të cilat do ta nënshtrojnë shqiptarët.

Ashtu si karkalecët që përhapen në arë, e mbështjellin fund e krye dhe shkatërrojnë bimët e mbjella, kështu që nga jugu dhe deri në veri të Shqipërisë u përhapën asqerët turq për të mposhtë shqiptarët me fermanin e sulltanit që solli Turgut pasha:

“Shqiptarëve t’u hiqet sylahu, t’u merren armët, të mos hapen shkolla në gjuhën shqipe, të detyrohen të shkojnë asqerë, të shlyejnë të gjitha taksat...”.

U mblodhën atëherë krerët e maleve shqiptare dhe vendosën:

“Ne shqiptarë jemi, mor Turgut pashë, dhe shqiptarë do të mbesim, edhe pse ke ngrehë në tokën tonë ushtri, topa dhe havanë”.

U zemërua atëherë Turgut pasha dhe e kuptoi se edhe këtë radhë, si gjithnjë, do ta kishte shumë të vështirë me shqiptarët. Prandaj

vendosi që të kthehej edhe një herë në Stamboll dhe të bisedonte për këto punë me sulltanin. Por, megjithatë, ai kërkoi t'i trembte dhe t'i nënshtronte ata me çdo mënyrë, që të zbatoheshin ato që ishin shkruar në ferman.

Kështu një ditë asqerët turq kapën Hafiz Mylimin dhe e rrahën në sokak, aq sa i thyen kambët, sepse kur e kishin pyetë nëse ai ishte shqiptar ose osmanlli, ai u ishte përgjegjë: "Jam shqiptar me gjuhë dhe fis".

Megjithatë, shqiptarët nuk mposhteshin...

KANGA E NJEZETETETE

DEDE GJON LULI

Viti 1911.

Të shtatë mbretërit e Evropës çohen më këmbë dhe pyesin:

-Ç'asht kjo gjamë që paska ra në andej viseve të malësive shqiptare ? Cili asht ky Dedë Gjo Luli, që me një grusht malësorësh trima ka nisë pushkën kundër nizamëve të sulltanit? Dhe i dërgoka fjalë Bedri pashës:

"Amanet po të le, mor pashë, që t'i thuesh sulltanit këto fjalë: " Tash nuk të njohim ma për mbret, se ti nuk ka zanat tjetër, veç të na djegësh e të na rrënosh, të na grabitësh dhe të na vrasësh. Kështu që nuk mundemi ma të durojmë dhe prandej kemi ba armëtgati kundër teje".

Pas këtyne fjalëve, Dedë Gjo Luli, veshun e mbathun dhe me alltien në këllëf dhe mauzerin në sup, bashkë me çetën e vet ka marrë rrugën drejt e nga Rapsha e Hotit dhe ka shkue dhe ka trokitë drejt e në derë të konakut të Marash Ucit.

Janë takue trimat dhe kanë nisë të kuvendojnë.

-A nuk të duket mirë, që, pa e zgjatë, qysh sonte t'i biem turkut?- e pyet Deda Marashin.

-Turkut nuk është vonë kurrë që t'i biem, - përgjigjet Marashi,- që ta nxjerrin sa më parë, qoftë nga dera, qoftë nga penxherja, por nuk di sa armë keni me vete.

-Shtatë mauzere dhe një kobure.

- Me kaq pushkë them nizamit mund t'i rrëmbejmë armë , - ia

kthen Marashi.- Unë po shkoj me lajmërue trimat në Shkrel e Kastrat dhe mandej po çoj fjalë dhe në Këlmend, që gjënë e gjallë, gratë dhe me fëmijët të marrin shpatit dhe burrat të bahen gati për luftë. Kështu them së turkun kemi për ta thye.

Në nadje, pa zbardhë dita, me njëzetë djem si petrira dhe shtatë mauzerë dhe një allti, Dedë Gjo Luli sulet në befasi dhe merr në dy posta turke, ku gjenden gjashtëdhjetë nizamë.

Seç gjëmoi fusha e Rapshës, seç ushtoi Veleçiku nga armët e Dedës, të Kolë Vatës, Prelë Kerit dhe e lekëve të tjerë! Ishin ata që u lëshuen mbi posta që ruheshin nga nizamë, shumë prej të cilëve mbetën të vramë dhe të plagosun, tue lanë armë dhe municione. Të nesërmen, të tmerruem nga ky sulm i beftë i Dedë Gjo Lulit me trimat e tij dhe të çetave të tjera malësore, pa shti asnjë fishek, filluen të dorëzoheshin edhe posta tjera në kufijtë me Malin e Zi dhe brenda tokave shqiptare në Grudë, Deçiç, Krevenicë, Tuz.

Kur mori vesh Bedri pasha seç kishte ndodhë në Malësi, nga zemerimi gati sa nuk nisi t'i binte kokës me grushta. Thirri prapë mexhlin dhe në praninë e sulltanit nisi të thoshte me frikë:

-Malësia është çue si lugat dhe kërkon që nesër të arrijë në malin e Rozafatit dhe që andej të marrë kalanë Shkodrës, t'u bjerë daulleve dhe curles dhenë sy të Evropës dhe mbarë njerëzisë të ngrejë atje flamurinshqiptar. Kështu Shqipnia do me dalëme vete, që të mos urdhnohet kurrë nga sulltani, dhe mandej, ashtu si berrat theren dhe varen nga këmbëtnë konop, ashtutë na varin edhe ne.

Hollë dhe gjatë u menduen turqit, biseduan se t'ia bajshin hallit dhe e pleqnuen që shqiptarët t'Ishtypshin, që Shqipnia të mos shkëputej nga sulltani.

Filluen kështu përsëri luftimet në Hot, Grudë e Deçiç, Dhe jo vetëm atje...

...Vallë çka, Bedri pasha që po rrin tue fërkue mjekrën?

Qenka vra kajmekani i Lezhës! Kur pushka dhe topi vlonte në Malësi, ai me një tabor nizamësh qenka çue dhe paska shkue në bregun e Matës, për me mbledhë xhelepin. Atëherë Dedë Çoku dhe Llesh Nika me shokë i paskan zanë pusi përballë Zejmenit dhe e paskan këputë përtokëme disa plumba.

U vra qyqari dhekurrë nuk i ra ndërmend që të kërkonte xhelepe taksa të tjera.

Fort u ndez atëherë lufta. Mbetën nizamë të mjerë gardheve, kënetave dhe hendeqeve, u zhdukën me vrap nga mundën, lanë

mushka me plaçkë dhe municione.

Mbetën dëshmorë dhe nantëmbëdhjetë trima malësorë.

Pastaj nëpër muzg të natës malësorë të Bregut të Matës u nisën për në Durrës, për me dëbueturkun dhe për me ngritë në kalanë e këtij qyteti flamurin kuq e zi. Por atybanë pritë nizamë, me vendas që u shkojshin pas, që për turpin e tyneishin në besë me turqit...

Shpërtheu luftë e ashpër. Përsëri u vranë malësorë, ndër ta Kolec Marku, Gjokë Doda, Zef Arapi Nikollë Gjeçi dhë të tjerë. U plagos rëndë Llesh Nika.

Kur e ndjeu se do të vdiste, u la amanet shokëve që tavarrosnin në hijen e Kishës e Fretërve në Rubig...

U mbodhën atje miqtëngado që ishin që takujtojshin:

-Çohu, Llesh, për me ligjërue, thueja një fjalë babës që të ka rritë, ty nuk të trembi gjylja e topit, nuk të ligështoi duhma e barotit, kur mbi turqit u sule si rrufe.

Pasi e varrosën, krerët shqiptarë të Lezhës, Krujës, Kurbinit, Zadrimës, dhe Mirditës vendosëntë luftojshin që këmbë turku të mos mbetej atyne viseve.

Ndërkaq në Shkodër ia behu Turgut pasha. Mbas tij, shtëtëdhjetë tabore. Dhe u çoi fjalë malësorëve:

-Në rast se pas pesë ditështë gjithë kryengritësitnuk vinë në Shkodër dhe nuk dorëzohen me gjithë armë, do t'ua zhbijshhtëpitë me gjithë themele, nuk do të lë as gjel dhe pulë të këndoje dhe të gjithëdo t'i varnë çengel.

U mblodhën menjëherë krenët e Malësisë, Dedë Gjo Luli, Mirash Luca, Mehmet Shpendi, Frano dhe Mirash Pali dhe bashkë me ta Luigj Gurakuqi dhe burra të tjerë shkodranë dhe siç ishin më këmbë, pa e zgjatë, ikthyen fjalë Turgut pashës:

-Burrë boll i fortë je, porthyeje zverkun prej këtij vendi se të njohim se kush je, se kurrë nuk do të ketë miqësi midis nesh, se do të coptohemi gjithnjë tue luftue.

Turgut pasha u zemëru shumë pas kësaj përgjigjeje, ngritiushttrinë më këmbë, një pjesë enisi nga Veleçiku, pjesën tjetër nga Shipshaniku, qëta nënshtronte Malësinë sa më shpejt.

-Ah, ngadalë, bre Dedë Gjo Luli, - bani be Turgut pasha,- se kjo është ushtria e Sulltanit të Stambollit, a nuk po sheh se nizamët si korba të zinj që po të rrethojnë nga të gjithë anët, si në ditë të qametit?

Kështu mësyu turku me furi dhe u ndesh me luftëtarët shqiptarë,

si gjithnjë ushtoi pushka me utërimë dhe bubulloi topi kobshëm. Luftojshin trimat mbi fushë dhe shpat, gjaku u ridhte curil mbi trupa, të reshkun ishin nga etja dhe uria dhe, megjithatë, luftojshin, rrëzoheshin dhe ngriheshin.

Por një topçi turk mori nishan me topin e tij, që kështu të vriste sa më shumë malësorë. Atëherë u hodhën mbi të Gjon Muculi, Lulash Zeka, Lik Mirashi dhe të tjerë që e flakëryen topçiun tutje me gjithë top dhe nisën me luftue grykë më grykë me nizamët turq.

Mirëpo ushtrisë turke i erdhën në ndihmë forca të reja. Tash gjylet e topave filluen me ra me breshni. Tymi dyndej në ajër, shëmbeshin troje që mbeteshin të shkretueme. Turqit bajshingjithnjë përpara, toka pëllambë për pëllambë mbulohej me gjak.

Habitej Evropa kur shihte që Malësia trime vetëm me pushkë, përballonte shtëtëdhjetë tabore të ushtrisë turke.

KANGA E NJEZETENENDE

LUFTA E BALLKANIT

I shkruen sulltanit Franc Josefi, perandori i Austro-Hungarisë:

“ Të lutem shumë, mos i merr me të keq shqiptarët , mos dërgo kundër tyne pashallarë me ushtri, që të bash kaq shumë dame, siç ke ba, se ma keq do të jetë për ty. Ta dish se ata kanë për t’u ngritë prapë dhe kurrë nuk kanë me të lanë të qetë.

Shqiptarët duen sot të jenë më vete dhe të mos kenë të huej mbi kokë. Prandej , që të mos kesh telashe me ta, nuk ban keq t’u japësh lirinë, se asht ma mirë t’i bësh miq e të lirë se robë dhe armiq” .

I mendoj mirë sulltani këto këshilla të Franc Jozefit, ndaj duhej të mblidhte pashallarët, të pleqnote këtë punë me ta dhe të merrte një vendim.

Por fjala i i ra në vesh carit të Ruisë. Ai ai nuk e zgjati, u ngrit si katallan e u bani za shkjavë të Ballkanit:

-Ma tepër se kurrë ngrihuni sot dhe bjerini sulltanit, se ndryshe Shqipnia ka me ju dalë nga dora.

Por edhe kraji i Nemces, burrë me mendje të hollë, i çoi fjalë sulltanit që shqiptarëve t' u jepte lirinë, se mandej të çamet e kresë do të vazhdojshin jo vetëm në Shqipni, por në tanë Ballkanin.

Ashtu sikur në një fshtat të përhapej zani se ka dalë një kafshë e egër dhe po ban dam, dhe atëherë fshatarët turren për ta vra, ashtu dhe ballkanasit u lidhën ndërmjet vedit4), ngjeshën armët që të dilshin në luftë kundër turkut.

Por as turku nuk ndenji as fjetë dhe as me duer në ijë dhe sy përpjetë, se për luftë shokun e kishte të rrallë.

Prandej mblodhi ku mundi nizamë nga popuj që kishte pushtue sulltani, arabë, lëkurzinj, pra nga Azia, në Afrikë dhe i nxorin përballë ushtrive të Ballkanit.

U ndeshën turq e shkja, sikur të ishin ngritë si lugetën.

Rrihte topi shpat më shpat, vlonte pushka dhe mitralozi dhe këmbësori dhe kalorësi suleshin me shpata tue vikatë. Ballkani ishte ndezë ne flakë. Tym e flakë ngriheshin si mjegull, gjithçka përreth lëkundej e dukej sikur qielli dhe dheu po shembeshin.

Njeri sulu, tjetri zmbropsu, shtyu, mbrohu, kacafitu, turk e shkja, me njeni-tjetrin kapërthye si bollat nëpër ferra, si derrat me derra.

Por bullgari u idhnua, dhe nisi të shtrëngonte dhambë dhe dhëmballë. Pastaj lëshoi një ulurimë:

- Burra shpejt për në Stamboll!

Dhe si shkëmbinj që shkëputet me zhaurimë nga një majë mali, tue marrë me vete pemë dhe gurë dhe shemben teposhtë, ashtu dhe bullgari me gjak përzi me vner, synin gacë dhe zemrën të ndezun, u sul mbi turkun.

Ata ngasin, vikasin, zbrazen gjylet që bien si breshër mbi tokë, ulurijnë njerëz dhe bisha, shemben fshatra, qytetet shndërrohen në gërmadha, të vdekunit mbeten të vetmuem mbi dhe, të plagosunit gërthasin, kur kuejt dhe rrotat e topave shkenin mbi ta.

Trim bullgari, i egër turku, i pari me kryq, i dyti me kuran, nuk ndalin të shtimet e pushkëve, pa e ba Ballkanin zhar.

Si dy re në një natë dimri, njera shkëputun nga jugu dhe tjetra nga veriu, që ndeshen me rryma të kundërta dhe ashtu shperthejnë në rrufe, ashtu vazhduen të perplaseshin bullgari me turkun dhe lanë me gjak njeni-tjetrin. Erdhi çasti u tërhoq dhe mori rrugën e kthimit për në Stamboll. Atëherë shkjatë u vërsulën mbi Shqipni nga Kaçaniku për të arritë në Adriatik, tue e drydhë vendin, tue vra e shkatërrue. Dhe kështu lufta mbaroi.

Por, kur Franc Jozefi mori vesh se malazeztë ishin futë brenda tokave shqiptare, u mbush tanë mëni dhe ngriti më kambë tetëqind tabore. Pastaj i çoi fjalë shkjavë se në rast se brenda tetë ditëve ata nuk do të largoheshin nga tokat shqiptare, atëherë ai do t'i sulmonte.

U gëzue mbreti i Italisë dhe i dha fjalën Franc Jozefit se dhe ai do të mbante anën e tij, që sllavët ta ndalnin hovin, se ndryshe ata do t'u kërcejshin në shpinë .

Megjithatë, shkjavu nuk donte ta ndalte hovin; ai ngulte këmbë të mos lëshonte toka shqiptare, thue se ishte zot në Evropë.

Atëherë u vrenjt krajl i Anglisë dhe u bani za gjashtë krajlave të Evropës që të vijshin sa ma shpejt në Londër dhe të kuvendojshin, sepse Ballkani ishte tym e mjegull.

KANGA E TRIDHJETE

KONFERENCA E LONDRES

Krëfen poeti:

-Hej, moj zanë, ti qofsh e bardhë, tridhjetë herë toka asht rrotullue rreth diellit, tridhjetë herë kanë shpërthye lulet e prillit, që nga dita kur ti më nxite me shkruë kangët kreshnike të "Lahutës së Malësisë", të cilat kam dëshirë t'ua le nipave tanë, që të mësojnë se si Shqipnia u ba më vetë.

Që kur u lidhëm bashkë, më ke shoqnue nëpër mrizet e Parnasit dhe atje, krah për krah, kemi ngritë këtë përmendore, që as rrufetë dhe as kohnat të mos e dërmojnë.

Viti 1913.

Në Londër të shtatë krajlrat bisedojnë me njeni-tjetripër Shqipninë. Krajli i Anglisë, që çan qimen mes për mes, por, siç duket, pak i pabesë, i peshon fjalët dhe nis e ligjëron:

- Mali i Zi ka futë kambët në tokat shqiptare dhe nuk do që të tërhiqet që andej. Por shqiptarët vazhdojnë me luftue dhe kërkojnë të jenë të pavarur.

Thotë krajl i Italisë:

-Për gati pesëqind vjet shqiptarët e ngratë janë shtrëngue t'i bajnë

sulltanit hyzmet, për pesëqind vjet turku i ka ka shkelë dhe i ka vu ata nën këmbët e tij, por rrallë fis dhe popull ka luftue si ai për të qenë i lirë.

Vallë ç'ka thënë krajli i Moskovit?

-Nuk kemi asnjë nevojë që të lodhemi me Shqipërinë, se atë e ka ndreqë shkjaun i Ballkanit. E ka ndreqë në grykë të pushkës dhe në teh të taganit, sa nuk bahet më mirë, tamam në kohën kur këta vëllezën tanët i vunë turkut këmbët në bark dhe e lëshuen shakull për tokë, ku ai rri duke krakaritë si korb nga hallet që i kanë ra mbi kokë. Por çuditim kur mendoj se nga na doli kjo Shqipni, emnin e së cilës nuk e kishim dëgjue ma parë se qenka në Evropë?! Prandej të mos rrahim ujë në havan?.

E dëgjoi Franc Jozefi ç'ka tha krajli i Moskovit dhe nisi me folë:

-Turku prej kohësh këto toka, nga Shkodra deri në Janinë, pa pushkë nuk do ta kishte shti në dorë kurrë. Prandej, pas kaq shekujsh kjo krahinë në Ballkan, asht pjesë e Evropës dhe, siç asht vetë Turqia, do të jetë edhe ajo, e quejtun Shqipni. Dhe atë ne, gjermani dhe italiani, do ta mbrojnë nga shkatë, edhe sikur ata ta bëjnë dhambin sa të dërrit.

Por ndryshe foli krajli i Francës:

-Para se turqit të vijshin këmbë në Shqipni, ky vend ka qenë e krishtenë. Por sot të krishtenët janë pakësue, kurse myslimanet janë shumë, prandej kjo krahinë, nga Shkodra në Janinë, nuk ka se përse të quhet Shqipni, sepse sot shqiptarët, që të mbeten të bashkuem me Turqinë, po luftojnë kundër malazezëve dhe serbëve. Por tashti që Bullgaria theu Turqinë, kanë dalë ca shqiptarë që kanë shkue në Vlorë dhe atje paskan gjetë një paçavure kuq e zi, na e paskan varë në një hu dhe atë hu na e paskan ngulë në një shtëpi të madhe, ku paskan nisë me këndue, se qenkan shqiptarë dhe dashkan Shqipni... U ngrit atëherë mbreti i Italisë dhe ia priti:

- Vërtet, ka pasë shqiptarë që kanë shkue nizamë dhe nuk kanë luftue për Shqipninë, por për sulltan e Turqi. Mirëpo shqiptarët në shekuj, edhepse myslimanë, nuk e kanë mohue atdheun, janë ngritë kundër turkut, janë ba dhe kurbanë, sepse ai i ka shtrure në dajak, i ka plaçkitë, dëbue dhe vra. Ndaj duen të jenë të pavarun.

Atëherë nuk iu durue Franc Jozefit, që i ra tryezës me grusht dhe tha:

-Në qoftë se nuk doni që Shqipnia të ngrihet, unë që tashti po kthehem në atdheun tim. Dhe deri nesër do të dërgoj ushtri në

Ballkan dhe me majën e mprehtë të taganit, ndihmën e zotit dhe të italianit do të ve kufijtë e Shqipërisë. Atëherë nuk do të ketë burrë që t'i lëvizë ato. Kurse fjalët e Francës dhe të Ruisë që u thanë këtu në këtë tryezë, janë fjalë të shkreta, thashetheme gazetash dhe jo për një kuvend mbretnish, ku vendoset fati i shteteve dhe ku bota ka ngulë sytë. Ajo pret që në Ballkan të sjellë paqe dhe miqësi.

Më të thënë këto fjalë, Franc Jozefi u ngrit më këmbë dhe mësyu nga dera për të dalë.

Por shpejt atij i doli përpara Vilhelmi, mbreti i fortë i Gjermanisë dhe kështu kuvendi vazhdoi. Herë u ngrit Franca dhe herë herë Rusia dhe herë të tjerët, u gjet pastaj zgjidhja dhe të shtatë krajat vunë dorë që Shqipnia të bahej zonjë me vete.

Dhe kur kokëforti knjaz Nikolla, ku me pushkë dhe ku me të holla, nuk donte ta lëshonte Shkodrën, krajat u zemëruen dhe dërguen shpejt anijet e tyne me topa, që dolën në brigjet shqiptare, e kapën knjazin për veshi, e nxorën jashtë nga Shkodra dhe i dhanë shqelmin për në Cernagora.

Në Shqipëri ka ra një gjamë, sulltani është çue më kambë dhe ka thënë:

-Vallë rrufeja asht tue bubullue, apo lufta diku ka nisë?

I ka kthtje përgjigje një pasha:

-As ka ra rrufe dhe as është ndezë diku ndonjë luftë e re, por po dëgjohet kjo gjëmë, sepse janë shqiptart që brohorasin.

- Pse ç'ka ndodhë?

- Atje në Londër krajat, të mbledhurn në kuvend, paskan vendosë që Shqipnia të mos jetë ma pjesë e askujt, por të bahet më vete. Prandaj rrahin topat nëpër kala.

Valëvitet flamuri në tokën e Gjergj Kastriotit dhe deri në qiell ushton brohoria dhe gërthet fusha dhe Malësia: "Për jetë të jetës rroftë Shqipnia!"

Dhe kështu pas sa e sa mjerimesh të shkatueme nga sulltani dhe shkjetë e Ballkanit, ashtu siç kishte premtue perendia, Shqipnia ma së fundi u ba më vete.

Gjergj Jozef KOLA

MREKULLIA E HESHTUN E NANË TEREZËS

-Dramë-

PERSONAZHET

NANË TEREZA

DRANDJA

AGETINA

GRUPI I MOTRAVE TE NANË TEREZES

(7 persona engjij të veshun me kostumin
e Nanë Terezës e me krahë engjujsh.)

NEXHMIJA

SEKRETARI I LIDHJES

XHELATI

KRYEMINISTRI

GRUPI I SORRAVE

(5 korba me krahë të zij dhe me një gjarpën në sqep.)

QIRAXHIJA

QIRAXHESHA

-vijon nga numri i kaluem-

AKTI I TRETE

Në skenë hyn Agetina, hjedh menjihërë tabaren në qoshe dhe vërsulet në dhomë tuj thirrë e kërcye si balerinë që papritmas ka marrë krahë. Mbas saj vërshojnë edhe 7 engjij-balerina, me veshjen bardhe-blu si të Nanë Terezës dhe e ndjekin mrapa. Ata bajnë një rrathë gjysë hanë në sfond.

AGETINA:

O Loke, o Nanë, ca me të kallxue!

DRANDJA:

Shëndet e baftë Zoti. A thue mi ke gjetë ilaçet se tanë ditën më

kanë therë kocat.

AGETINA

Sot asht dita ma e rrallë e veçantë e jashtzakonshme e jetës tande.

Prej Lajmit që po të jap, nuk ke me pasë dhima ma.

(Vazhdon tuj kërcye e gzueshme nëpër dhomë.)

DRANDJA

A thu ka ardhë dita e gjygjit të fundit e po pshtojmë?

AGETINA

Jo Loke, ma shumë se kaq, na po ndriçohena!

DRANDJA

Mos më lodhë tash moj bijë, po më thuej a i ke gjetë ilaçet apo jo: Lazri e Gonxhja kanë tash sa vjet që mi premtojnë e njeni apo tjetri kanë me e mbajtë fjalën.

AGETINA

(*Reciton*)

Se në balkue u çilën lulet

Shpija asht shend e vendi asht verë Lokes zemra në kët dimën

Ju mbush plot me pranverë.

DRANDJA

Ti je ba e marrë krejt sot? A nuk sheh vedin? Gruaja 50 vjeçe hidhet e lot si me kenë në Teatër ?

AGETINA

O Loke e zembrës! Për ty kam mbetë gjithnji 50 vjeçe.

DRANDJA

Pse po imiton Gonxhen tash e më thërret njashtu si ajo?

AGETINA

Hapi veshët pra se kët lajm të mirë nuk ke me e ndi ma në jetën tande. Unë u bana pesëdhjetë vjeçe qëkur ke ra e sëmurë, porse sot më duket vedja si njizet.

DRANDJA

Thuje pra pashë dashninë e Zotit se më lodhe!

AGETINA

(*Kërcen nëpër dhomë nga gëzimi e shendi.*)

Se në balkue u çilen lulet...

Ah Loke kët ditë duhet me e shenue fort në kalendar.

DRANDJA

Po na qeshin kojshija e po thojne se këto dy nanë e bije, pa burrë në shpi paskan luejtë mendsh.

AGETINA

Loke sot na ka tanë bota në gojë dhe për mirë na ka, për mirë.

DRANDJA

Pashë një kyt dritë diellit thuje pra.

AGETINA

“Loke, moj Loke e zemrës: Gonxhja ka marre çmimin Nobel.”

DRANDJA

“Pse po gzoresh kaq fort! Ça po asht ky çmim kaq i randsishëm?”

AGETINA:

“Asht një çmim që e merr një njeri për tanë botën dhe ai fatlumi që e merr, përveç emnit të mirë, fiton edhe një milion dollarë”.

DRANDJA:

Tash je ba e marrë krejt, po kush po i jepka Gonxhes tonë një milion dollarë? Ajo fundja një murgeshë e thjeshtë asht e pa me hi me ju dhanë tana murgeshave që punojnë në botë me fëmijët, nga një milionë dollarë, bota ska ma dollarë as për vedi.

AGETINA

Kështu më tha sot, Bukurija, përgjegjësja që kurrë ska folë me mue, vetëm këto ditët e fundit ka kenë krejt ndryshe, më ka ndejë afër, më ka pyetë tash e parë se si jam. Një milion dollarë, më tha, i kanë dhanë Gonxhes në vendet e Skandinavisë.

DRANDJA

O Age, të paste lokja ty. Gonxhja, me pasë një milion dollarë, na kishte shkruar përditë nga një letër.

AGETINA

Tash na shkruen moj Loke mos e humbë shpresën.

DRANDJA

Shpresa vdes e fundit e di mirë moj bijë, porse edhe Gonxhja të paktën një letër me pak rreshta të na kishte shkruar, se janë ba gati 20 vjet nga letra e fundit.

AGETINA

Po na nuk e dina a na ka shkruar apo jo moj Loke, se ka mundësi që na ka shkruar edhe përditë si thu ti e letrat na i kanë mbajtur ata, të sigurimit.

DRANDJA

Po çka i duhen letrat, që një bijë i nisë nanës së vet, këtyne të sigurimit?

AGETINA

Loke, këto të sigurimit dojnë me dijtë edhe sa lugë e piruj kena në shpi, jo ma letrat e i shifët mordja i shifët.

DRANDJA

Shëët, mos i përmendë moj Age, se këtu edhe muret kanë veshë.

AGETINA

Muret kanë veshë e bira të mëdhaja besa e duhet me mbledhë ndonji lekë e me thirrë mjeshtrin me i mbyllë se tash na mbyty ky dimën.

DRANDJA

Me thuj tash, prej mend ishte kjo puna e Novelës?

AGETINA

Nuk i thojnë Novelë, i thojnë Nobël moj Loke dhe asht një çmim që po ju jepka njerzve të ndryshëm në botë, shkencëtarëve e njerzve që bajnë gjana të mira për njerzimin. Edhe unë asht hera e parë që e ndij.

DRANDJA

Po çfarë shkence ka ba Gonxhja jonë moj Age, ti shikjo se mos janë tallë me ty në punë se këto të patenzotë kështu e kanë, losin me fukaranë.

AGETINA

Jo moj Loke asht e vërtetë e Bukurija me tha se Gonxhja asht e para shqiptare që e merr një çmim të tillë.

DRANDJA

Po përça paskan pasë me ja dhanë Gonxhes tonë një vlerësim kaq të madh?

AGETINA

Nuk e di mirë, se as Bukuria nuk ma tha se kishte frikë se po e ndigjote kush, ajo asht komuniste porse ka frikë edhe prej hijes së vet.

DRANDJA

Në kjoftë e vërtetë atëhere po më del fjala.

AGETINA

Po të del fjala?

DRANDJA

Harrove mramë kur të thashë se dhuratat e pronarëve të shpisë i ka prue Gonxhja?

AGETINA

Ah moj Loke ka një jetë që me habitë me mënyren se si i lidhë gjanat ti.

DRANDJA

Me dalë me gjetë bateritë e me na ndezë radion, se ndoshta japin

ndonji lajm për Gonxhen. Tash edhe në kjoftë se nuk ja lexojmë rreshtat, të paktën ja ndijmë zanin.

AGETINA

(Shkon dhe merr radion e dorës së mshehun diku në raft dhe përpigjet me vendosë bateri të vjetra.)

Ah moj Loke, te tana janë të shkarikueme.

DRANDJA

Jo te tana, se Lokja ka ruejte për ditë të veçanta, bateri në baule.

AGETINA

O Loke, flori të ka Agetina ty!

(Shkon e i merr dhe i vendos. Ulen të dyja afër shporetit – fuqi naftet dhe presin radion. Violonçeli në sfond luen një muzikë të gëzueshme.)

ZANE NE RADIO ZANI 1

Mirmrama. Kjoftë leftue Jesu Krishti.

ZANI 2

Këtu ju flet Radio Vatikani.

MUZIKA

ZANI 1

Unë jam Albert Akshija

ZANI 2

Kurse unë jam Ana Luka.

ZANI 1

Sot asht një ditë e jashtzakonshme për popullin e shumvujejtun shqiptar që vazhdon të shtypet nga komunizmi ma gjakatar i lindjes bolshevike.

ZANI 2

Kjo vepër e sotme asht ma shumë një mrekulli e vogël, që mbushë me dritë shpreset e gëzimit zemrat e çdo shqiptarit.

ZANI 1

Po më pëlqen me këtë rast me lexue unjillin e shën Gjorit: “Nji za thërret në shkretinë, hapeni rrugën sepse atij që po vjen mbas mejet unë nuk jam i denjë me i lidhe as lidhëcat e këpucëve”.

ZANI 2

Njashtu si Shqipnia i fali botës, Gjergj Kastriotin Skanderbegun, Atletin e Krishtit, po njashtu ajo i fali sot botës një murgeshë të madhe, emni i së cilës ka me hi në historinë e re të botës e deri në amshim.

ZANI 1

Sot murgesha me origjinë shqiptare, Gonxhe Bojaxhiu, e njoftun në mbarë botën si Nanë Tereza, fitoi çmimin Nobel për paqe...

DRANDJA

*(Çohet në kambë dhe lëshon një klithje zemret) Oh, Gonxhja e Nanës!
(Dridhet dhe bjen në krahët e së bijës. Ulen të dyja përtokë dhe me radion në një karrike ndigjojnë zanin.)*

ZANI 2

Gonxhe Bojaxhiu lindi në Shkup, të Maqedonisë së sotme me 26 gusht të vitit 1910. I jati i saj Kol Bojaxhiu rrjedh nga Mirdita e Shqipnisë, ndërsa e ama Drande Bojaxhiu e lindun Barnaj, vjen nga Novo Selia e Gjakoves.

DRANDJA

Po emnin e vajzarinë ku e paskan marrë vesht në Vatikan!?

ZANI 1

Çifti Kol dhe Drande Bojaxhiu kanë tre fëmijë, Lazrin, djalin e madh që mbaroi studimet e nalta në Grac të Austrisë dhe sot jeton në Itali, Gonxhen, Nobelisten e paqes dhe Agetinën, që jeton bashkë me nanën e saj në Tiranë. Pasionet e rinisë së Gonxhes ishin tre: me u ba mësuese, me shkruar poezi dhe me luejtë muzikë. Emrin "Tereza" e mori kur ishte 18 vjeçe dhe u dorëzue murgeshë.

DRANDJA

(Nxjerrë një fotografi nga krahnori dhe shkon përpara në skenë. Dridhet e flet)
Gonxhe, o loçka e zemrës. Tash një jetë pa të pa, ja zbardhë zemrën nanës tande. Gonxhe e zemrës së nanës, njëkshu jam gëzue edhe kur ke lindë e të mora në gjoks. Si njetëhere edhe tash e njëjta ndjesi po ma përshkon zemren. Uroj që vujejtja jonë ti ketë shërbye jetës tande.

AGETINA

Eja Loke se Radio Vatikani nuk ka me folë përdite për ne.

DRANDJA

Ah moj Age, si asht kjo jetë. Të ikë vajza si ferishte prej shpijet e të kthehet përmes lajmeve te tanë botës.

(Fillon muzika në radio.)

DRANDJA

Shko Age e na i nxjerr xhubletat, se sonte ka festë zemra e Lokes. (Gratë hapin baulen dhe nxjerrin dy xhubletat tradicionale gege dhe i veshin e shkojnë te radioja. Drandja bjen në sy se asht shumë e sëmurë.)

ZANI 2

Po vazhdojmë emisionin kushtue misionares shqiptare Nanë Tereza. Shqiptarja trupvogël asht kthye në një legjendë të gjallë.

Ajo asht nanë kujdestare e 7500 fëmijëve në 60 shkolla, asht nanë që mjekon 960.000 të sëmurë në 213 dispanseri. Ajo asht e vetmja në botë që trajton 47.000 viktima të lebrozës në 54 klinika, kujdeset për 3400 pleq të braktisun rrugëve, në 20 shpija pleqsh, ka birësue 160 fëmijë ilegjitimë e jetimë.

DRANDJA

O Age, 54 klinika tha, ka Gonxhja jone. Mendoje sa ilaqet duhet ti kenë atje?

AGETINA

Loke thuj ma mirë, kushedi sa ilaqet na i ka nisë dhe këto nuk na i kanë dhanë.

DRANDJA

Mirë e ke besa, se Gonxhja e ka nda edhe kashatën e gojës me tjetrin, jo ma ilaqet me ne.

ZANI 1

Vetë Papa Gjon Pali II e priti murgeshën shqiptare në një audiencë të veçantë sepse kjo ditë asht një festë e madhe për tanë botën e krishtenë.

AGETINA

Ndije moj Nanë, vetë Papa e ka pritë Gonxhen tonë.

DRANDJA

Po moj Age, tuj e ndi jam, po rri urtë ta ndijmë deri në fund se po më del zemra prej krahnorit sonte.

ZANI 1

Presidenti amerikan deklaroi në një konferencë shtypi se vepra e Nanë Terezës asht një shembull mirësjije për mbarë njerzimin. Puna e saj vetemohuese asht një akt i naltë human, që del mbi besimet fetare, nacionalitetet dhe idete politike. Ai propozoi ti jepet asaj çmimi qytetare nderi e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, çmim ky që derimetash e kanë marrë vetëm gjashtë qytetarë botës.

DRANDJA DHE AGETINA

(Thërrasin) Gonxhes tonë!

ZANI 2

Në një kohë që ky lajm ka marrë botën, në Tiranën zyrtare, nuk ka asnjë prononcim. Republika Socialiste e Shqipnisë asht i vetmi vend në botë që ka shpallë ateizmin me kushtetutë. Burgjet janë të mbushun me klerikë të besimeve të ndryshme dhe askush në botë nuk e ngre zanin për to...

AGETINA

Loke, kur erdha sot pashë disa makina në rrugën tone, e pra këtu as biçikleta nuk kalojnë? A thue se mos na vijnë për kontroll?

DRANDJA

Age të paste Lokja, ma shumë se kaq nuk kanë ça me na ba. Po na e marrin frymën përditë me skamje e vorfni e tash më duket se e kam prekë amshimin me dorë dhe po e bajmë deken si me le.

(Hin Nanë Tereza dhe dritat bijne mbi te e gjithandej asht terr):

Në thellësinë e pafund të zemrës time dridhet e heshtun një andërr e pajetue me parajsën në qiell dhe familjen në tokë guxoj me i prekë vetëm përmes të lutjes.

ZANI 2

Në fjalën e saj para gazetarëve Nanë Tereza tha:

(Flet Nanë Tereza. Zani i saj në Audio.)

By blood I am Albanian. My citizenship is Indian. I am a catholic nun. As to my calling, I belong to the World. As to my heart, I belong entirely to the heart of Jesus".

NANE TEREZA

Me gjak jam shqiptare, me nënshtetësi, indiane. Përsa i përket besimit, jam murgeshë katolike. Sipas thirrjes, i përkas botës. Por zemra ime i përket plotësisht Zemrës së Krishtit. E djeshmja iku. E nesërmja s'ka ardhë. Na kena vetem të sotmen. Le t'ia nisim. Vetem dashunia ka me e ndryshue boten!

DRANDJA.

Zemra e Lokes, o Gonxhe ky asht zani jot!

ZANI 1

Kët ditë kaq të shënueme për kombin shqiptar të dhunuem nga diktatura, Radio Vatikan ja kushton Nanë Terezës dhe po lexojmë një nga poezitë ma treguese të jetës së saj: „Balada e shqipes“.

NANE TEREZA

Sa shumë ke vuede ti o shqipja ime, saqi sot çdo e keqe njetet menjihërë në ty dhe vetëm kujtesa për Itakën të mban gjallë, siç të mban rrahja e zemrës në fluturim.

AGETINA

Loke ndije Gonxhen tonë, poeteshen tonë!

NANE TEREZA

O ti zog hyjnor në qiell Sa ma lerg të jesh në hapsinë, aq ma shpejt të rreh zemra

kur merr rrugen të kthehesh në fole...

DRANDJA

Tuj e ndi jam çdo fjalë e tingull.

NANE TEREZA

Në kjoftë se në vendlindje ja gozhdojnë derën të bukurës tonë, në botë na i hapin asaj dritaret:

(Bjen dera fort dhe hologrami zhduket. Engjujt e Nanë Terezes rrethojnë Dranden dhe Agen si me dashtë me i mbrojtë. Dera bjen mrendë dhe hyjnë në dhomë nexhmija me sekretarin. Mbas tyne hyjnë 5 korba të zinj që mbajnë në sqep nga një gjarpën. Shenja Yjore e korbit bahet sfond i gjysës së skenës.)

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

TE DY.

Ky vend nuk ka fe, as din e as iman, as Zot e as Perëndi. Ne të dy jemi ata që kemi ndërtuar një tempull te ri, me libra te rij, me rituale te reja, ku duhet të edukohet ky popull dhe njeriu i ri.

NANE TEREZA *(si hologram)*

Në pabesi te doli një hanë e kuqe dhe te rrëzoi përdhe
E të lidhi kryeposhtë në shkambijt e Adriatikut.

Aty je ala sot tuj vuejtë në heshtje, në etje dhe uri...

NEXHMIJA

(Thërret) Korba të zinj!

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

(Marrin gjarpnijt prej sqepit ne krahë dhe flasin një nga një.)

Ne nuk jemi aspak fajtorë. Ne e morëm rrugën për tek burimi. Rrugës fiqtë nuk ishin pjekur të gjithë, prandaj na u desh të prisnim. Te burimi ishin armiqtë tanë, gjarpërijtë e ujit. Këto na sabotuan pesëvjeçarët.

SEKRETARI

Ky po, ky është një grup që e meriton çmimin Nobel.

(Korbat marrin gjarpnijt në gojë dhe vërsulen nëpër shpi tuj kontrollue gjithandej dhe mbasi nuk gjejnë gja shkojnë e mbushin gjysën e skenës.)

NEXHMIJA

Ku është letra!

DRANDJA

Cila letër?

SEKRETARI I LIDHJES

Letra e nobelistes.

AGETINA

Këtu ska nobeliste. Jena vetëm dy gra të sëmura e pa ilaqe.

SEKRETARI

Sikurisht që nuk ka, se çdo të bënte një nobeliste në këtë bodrum të leckosur?

NEXHMIJA

Unë dua letren e vajzës suaj, asaj murgeshës që sillet nëpër botë dhe vjedh vrer për vendin tonë...

DRANDJA

Letrat e Gonxhes time nuk vijnë, nuk na i jep kush e unë nuk e di se paska ligj që ndalon letrat e vajzës drejtue nanës së saj.

SEKRETARI I LIDHJES

Përfaqesuesi jonë në OKB na ka shkruar:

(Nxjerrë një letër dhe lexon.)

„Po të mos ishte një agjente e zellshme dhe e vyer e veprimtarisë së Vatikanit, Tereza do të kishte mbetur një person i panjohur në këtë botë, sikurse kanë mbetur me mijëra që kanë bërë sakrifica njerëzore ndoshta edhe më të mëdha. Tereza Bojaxhiun e bëri të famshme me emrin 'Nënë Tereza e Kalkutës' më shumë propaganda e fuqishme e Vatikanit, sesa përkushtimi e sakrifica e saj. Ajo është murgeshe, është reaksionare, sepse të gjithë klerikët në botë janë reaksionarë.

KORBAT

Reaksionarë, reaksionarë, të gjithë reaksionarë!

DRANDJA

(kollitet fort nga sëmundja)

Vajza ime asht një murgeshë e thjeshtë që përkujdeset për të sëmurët në botë, ju jep ilaqe dhe një strehë të ngrohtë në dimnin e acartë.

NEXHMIJA

Po ti pse kollitesh kaq shumë, vuan edhe ti nga çdo sëmundje se zakonisht reaksionarët, janë të gjithë të semurë.

AGETINA

Nana vuen prej Reumatizmes kronike dhe i duhen ilaqe e Gonxha na i ka premtue porse deritash nuk kena marrë gja

SEKRETARI I LIDHJES

Ah çfarë nobelistet na qenka kjo Bojaxhiu! Ajo shpërndan ilaqe të sëmurëve nëpër botë dhe nënës së vet nuk ka mundesi ti sjelle ilaqet...hahahahahahah.

KORBAT QESHIN BASHKE ME TE

Hahahahahahah! Nuk i sjellë ilaqe nënës së saj.

DRANDJA

Unë Gonxhen e kam në zemrën time dhe nuk kam nevojë për ilaqe.

Kur ajo asht mirë jam edhe unë mirë.

NEXHMIJA

Po ç`të mirë mund të sjellë një murgeshë që përpiket ditë e natë të rrëzojë pushtetin tonë popullor, diktaturën e proletariatit!

SEKRETARI I LIDHJES

Pale i kanë dhënë ata borgjezo-revizionistët edhe çmimin Nobel për Paqen. Ajo nuk sjell Dafinat e paqes porse shpatën e luftës.

Korbat therrasin njëherësh te trembun

Jo! Dafinat jo!

AGETINA

(Ju drejtohet korbave)

Apoloni dashunonte Dafinën. Dhe digjej në zjemrin e pasionit si çdo zemër poetike

Në dashuninë e parë.

KORBAT THERRASIN

Jo Apolonin, jo!

NEXHMIJA

Pusho ti reaksionare, lëri korbat e mij të qetë se të vendosim prangat në çast.

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

SEKRETARI I LIDHJES

Apo kujtoni se jeni familje nobelistësh dhe jeni të mbrojtur prej diktaturës së proletariatit.

DRANDJA

Na jena dy shqiponja me krahë të shkullun dhe kërcënimi juej se po na i shkullni krahët nuk na tremb sepse këtu nuk ka çka me shkullë ma.

NEXHMIJA

Nuk trembeni nga ne ju, armiq? Nuk ju mjafton se jetoni falas, merrni ilaqe falas, keni pensione falas ?

AGETINA

Pensioni na takon me ligj si tanë botës, ilaqe nuk ka as me lekë e as falas...

DRANDJA

Ndërsa për shpinë, na paguejmë qiranë për çdo muej.

SEKRETARI

Qeranë!? Tek ne nuk paguan askush qera, se banesat janë falas.

AGETINA

Gjysa e pensionit e Nanës Loke shkon për qiranë e ja japim pronarëve nelt.

NEXHMIJA

(u jep urdhën Korbave dhe ata dalin jashtë e sjellin qeraxhijtë) Thërrisni qeraxhijtë!

NEXHMIJA

Ju merrni para nga këto qytetarët këtu për banesën e shtetit? Ju borgjezë të ndyrë!

QERAXHIU

Shpija ishte e jona dikur, trashëgim nga xhaxhallaret....

QERAXHESHA

Porse ne nuk marrim para se jemi vetë qeraxhinjë këtu, që kur shpija osht shtetëzue dhe këto i ko sjellë këshilli i lagjes.

SEKRETARI

Po ku jemi neve këtu: qeraxhijtë, ju kërkojnë qera, qeraxhijve të tjerë, në shtëpinë e shtetit!

NEXHMIJA

Gënjeni ju reaksionarë!

DRANDJA

Mosni bre, se për çdo muej ju japim në derë si lebrozë, paratë në një zarf.

QERAXHESHA

Mos na bini ne qafë moj none se kemi edhe ne kalamaj me rritë.

NEXHMIJA

Pra kujt duhet ti besojmë ne, juve borgjezëve apo këtyre reaksionarëve? Ta dini se nesër ju internojmë në vend nëse nuk thoni të vërtetën.

QERAXHIU

Shoqja Nexhmije, ju jeni Partia, ne nuk do ju gënjëjmë kurrë!

NEXHMIJA

Hë ç`thoni juve te dyja? Nëse na provoni se këto ju kanë marrë para për shtëpinë e shtetit, ne i internojmë nesër dhe kjo shtëpia ju kalon juve?

DRANDJA DHE AGETINA NE NJI GOJE NE MENYRE

DEMONSTRATIVE

(Kanë pa qiraxhijtë që janë mbledhë grusht tanë frikë.) Jo nuk na kanë kërkuë asnjëherë para.

SEKRETARI

Shumë mirë pra na jepni letrën e nobelistes.

TE DYJA

Jo!

NEXHMIJA

Doni të ju internojmë nesër në mëngjez?

DRANDJA

Ma keq se në këtë biruce ku keni me na çue?

NEXHMIJA DHE SEKRETARI I LIDHJES

A kështu e mendoni ju?!

(Ata të dy këshillohen me njëri tjetrin në heshtje dhe në anën tjetër Drandja dhe Agetina kapen dorë më dorë.)

Po sikur të thërrasim Xhelatin e t'jua nxjerrim me dhunë?

SEKRETARI I LIDHJES

Jo ma lërë mua këtë punë.

(Ju drejtohet Drandes dhe Ages.)

Unë mendoj se ne mund ta gjejmë një rrugë të përbashkët, ne ju kallxojmë atë që ju dëshironi dhe ju na jepni atë që do të dëshirojme neve?

DRANDJA

Folë shqip se asgja nuk po marrim vesht.

SEKRETARI I LIDHJES

Ne do ju tregojmë juve një letër që nobelistja e njohur me emrin Nënë Tereza ka dërguar në adresën tuaj....

DRANDJA

Letër prej Gonxhes!

SEKRETARI I LIDHJES

Po, dhe në shpërblim, ju do na jepni letrat e tjera që mund të keni marrë prej saj...

AGETINA

Po pse e keni mbajtur të mshehun letrën që na ka nisë ne Gonxhja?

SEKRETARI I LIDHJES

Sepse letra të tilla janë rrezik direkt ose indirekt për diktaturën e proletariatit.

TE DYJA

Po kjo asht letra jonë, letra e Gonxhes tonë?!

NEXHMIJA

Ore do rrini urtë juve apo do ju zhgulum krahët!

KORBAT

Ju zhgulum krahët juve. Sa herë shihem në pasqyrë Me rrjedh gjaku në fytyrë.

TE DYJA

Zot ke mëshirë për ne.

SEKRETARI I LIDHJES

Ne do ta gjejmë një zgjidhje që të jetë e kënaqshme për të gjithë, porse ju duhet ta dini se ne nuk bashkëpunojmë me reaksionarët.

AGETINA

Na nuk kena asnji letër prej Gonxhes, sepse nuk na ka mrritë asnji. Lazri na ka shkruar disa herë dhe na ka kallxue lajme prej saj.

Mos genje ti bushtër se partia i di të gjitha.

DRANDJA

Na nuk rrejmë, se nuk dijmë, se jena shqiptarë të ndershëm.

AGETINA

Prej Gonxhes nuk kena asnji letër, vetëm prej Lazrit, që na ka kallxue për jetën e saj.

NEXHMIJA

Edhe ti po gënjen, pa je edhe plakë. Ne kemi dosjen e letrave që reaksionarët kanë nisë nga jashtë me qëllimin kryesor për rrëzimin e pushtetit tonë popullor dhe aty është shënuar se ju keni marrë një letër, nga Mother Theresa, pra nga vajza juaj.

DRANDJA

Po ajo nuk asht letër, asht një fotografi që na ka nisë Gonxhja nga Irlanda para 20 vjetësh.

SEKRETARI I LIDHJES

Ka shkruar nobelistja gjëkafshë mbas fotografisë?

DRANDJA

Ka shkruar diçka për mue, për nanën e saj, porse kjo asht private...

SEKRETARI I LIDHJES

Private? Po ku jetoni ju shoqe. Tek ne nuk ka asgjë private. Gjëja private është e ndaluar me ligj, me kushtetutë.

DRANDJA

Edhe fotografia që një bije ja nisë nanës së vet asht pronë shtetnore?!

NEXHMIJA

Gjithçka që rrezikon diktaturën e proletariatit dhe pushtetin tonë

popullor është pronë e jona.

DRANDJA

Po a nuk keni shpirt ju, a nuk jeni nanë?

NEXHMIJA

Une e kam në duart e mija për 30 vjet brumin e ketij kombi dhe prej tij po mbruaj një njeri të ri, të paprekur nga reaksioni borgjezo-kapitalist, dhe aty shpirti nuk luan asnjë rrol, pasi shpirti nuk ekziston.

DRANDJA

Jo mos grue, mos e thuj njat fjalë, se shpirti asht Zoti!

NEXHMIJA

Zoti! Po as Zoti nuk ekziston, ne e vramë atë me kushtetutën tonë para dy vjetësh. Nuk e paskeni marrë vesht akoma?

DRANDJA

Fjala e njeriut nuk ban mort, Fjala e Zotit asht jeta.

Ne jemi gati të vrasim këdo që na kërcënon pushtetin tonë popullor dhe dikaturën e proletariatit.

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

DRANDJA

Unë andrroj përnatë se si vjen Gonxhja ime dhe me bjen ilaçet e ulet afër mejet e më thotë se ka ardhë vetëm me ndi të rrahunën e zemrës.

O Zot! E lind njeriu fëmijën e vet dhe e rritë e nuk e lajnë me e gëzue.

SEKRETARI

O ironi e fatit! E të mendosh se vajza juaj mbledh jetimët nëpër botë dhe ju jep strehë.

NEXHMIJA

Ndërsa unë ëndërroj gjithnji mbi kohën kur themelua partinë se si po vrapoja në një pyll dhe papritmas më bjen në dorë një shqiponjë e plagosur. E marr në dorë dhe e fshehi në një bunker. Ata që më afrohen ta marrin i vras të gjithë. Kur nuk mbetet më asnjë rrezik, filloj e ta zhveshi e të ushqhem me puplat e saja të përgjakura. Zoti si një shpend i plagosur vjen prej jashtë e çukitë mbi bunkerin tim, porse nuk ka forcë të më depërtojë...

DRANDJA

Mos moj grue, mos u kap me Zotin se nuk ja del!

NEXHMIJA

Unë i dhashë shpendit në kafazin tim ëndrrën time, i mësova këngën time, i injektova palcën time dhe asnjë Zot nuk doli të më ndalojë. Gjithandej në kafazin tim lindin dhe rriten zogj të vegjël që mbajnë frymën time, frymën e zogut te ri që nuk do fluturojë kurrë.

(ajo shkon te Korbat dhe vallezon me to)

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

AGETINA

Ty të nxjerrtë vorri jashtë, moj Nexhmije!

DRANDJA

Zoti vonon porse nuk harron...

NEXHMIJA

Ndoshta nuk kemi prova të provojmë se e vramë Zotin, porse tempujt e tij ja shkatruam ama. Ne kemi prova të mjaftueshme se krijuam njeriun e ri antizot, veprën më të ndritshme të partisë.

SEKRETARI I LIDHIJES

Cili Zot! Me pasë Zot ju kishte sjellë letrat e nobelistet apo ilaçet e saja. Për të dalë tek Zoti ju duhet të kaloni përmes nesh. Ju na e hodhët njëherë me Nobelin, porse nuk do na e hidhni më.

NEXHMIJA

Ky është një thes me ilaçe që ju ka dërguar vajza juaj, ajo me dy emra, nënë Tereza dhe Gonxhe Bojaxhiu. Në shkëmbim të këtyre dua fotografinë që po thua se e ke akoma.

DRANDJA

Ajo fotografi më mban gjallë në jetë tash kaq vjet. Ajo asht ilaçi që më mban gjallë frymën, si mund ta ndrojt me ilaçe të përkohshme?!

NEXHMIJA

Nuk po kuptoj? Unë të afrojt ilaçet që vajza jote të ka nisë për të shëruar sëmundjen dhe ti kapesh mbas një fotografie. Kaq thellë janë futur paragjykimet fetare dhe zakonet prapanike tek ju reaksionarët, të mbaheni mbas figurave... Sekretari Kështu ja plasni zemrën vajzës suaj, që do e marrë vesht se e ëma nuk ja pranon ilaqet....

DRANDJA

Ajo fotografi asht drita e dashunisë që më mban gjallë.

NEXHMIJA

(I drejtohet Sekretarit)

Të thërrasim Xhelatin e të jau nxjerri me dhunë letrat?

SEKRETARI

Jo se me dhunë nuk ju nxirret këtyre, duhet të përdorim metode tjetër, sepse këta përdorin atë moton që kanë mësuar në Biblën e tyre: “Me qenë të urtë si pëllumbi e të zgjuar si gjarpri”.

KORBAT

Gjarpëri, gjarpëri ishte fajtori!

SEKRETARI I LIDHJES

(I drejtohet Drandes dhe Ages.)

Ju jeni edhe besimtare si vajza juaj, nobelistja, e pra më thoni çfarë është me e rëndësishme për juve: Fjala e Hyjit apo një foto? Në besimet monoteiste pikturat ishin të ndaluara.

AGETINA

Ku doni me dalë ju shoku artist i lidhjes së shkrimtareve?

SEKRETARI

Dëshironi të lexoni letrën e nobelistet, Nënë Tereza, të lindur si Gonxhe Bojaxhiu?

TE DYJA

Po !

SEKRETARI I LIDHJES

Atëhere na jepni fotografinë ta shohim dhe kështu shkëmbejmë sejcili materialet që disponojmë.

(Dy grate mblidhen në vedi të rrethueme nga 7 engjujt dhe diskutojnë pa za, ndërsa nexhmija merr sekretarin afër dhe shkojnë te korbat me gjarpnij.)

DRANDJA

Dakort jena, na e jepni ju letrën dhe ju kallxojmë fotografinë.

SEKRETARI

Na ju kallxojmë letrën dhe ju na kallxoni fotografinë e nobelistes, ndoshta keni edhe foto të çmimit Nobel edhe më mirë.

DRANDJA

Unë due letrën e vajzës, e Nobeli nuk na duhet gja: Për njato dy gisht letër jam gati me dhanë tanë nobelat e botës.

DREJTUESI I LIDHJES:

Me të vërtetë çfarë ju duhen juve çmimi Nobel, fundja ajo një murgeshë e krishtere është, një reaksionare, të na e jepnin neve çmimin, që shkruajmë gjithë ditën për popull.

DRANDJA

Po merre ore shoku i lidhjes se arteve, po ju a jap me plot dëshirë,

vetëm me jepni letrën e vajzës.

(Nexhmija nxjerr letrën që ka futë në kornizë për mos me pas kontakt dhe ja kallxon).

Te dyja nanë e bijë e marrin në dorë dhe e lexojnë. Hologrami i Nanë Terezes del prapë.

LETRA E NANE TEREZES

E dashtuna Nana Loke, e dashtuna Age! Unë ju due fort të dyjave, ju mbaj në sy e ju marr gjithkund me vedi kur shetisë nëpër botë, për me e pa bashkë atë. Afër çdo fëmijë të hjedhun nëpër rrugët e Bombeit ju kujtoj ju të dyjave e më duket se ju kam afër. Këndej rrugët janë të mbushuna me pleq të braktisun, të mbetun vetëm, të hjedhun në rrugë si thes me plehna e unë kur i marr afër e ju jap një strehë e di se ju të dyja më shihni dhe më jepni forcë me lutjet tueja. Njashtu siç kam marrë Jezu Krishtin dhe shën Marinë në zemren time, njashtu ju kam edhe ju të dyjave e ju ndij se si rreh zemra juej bashkë me temen...

TE DYJA

(Letra dhe zani i Nanë Terezes i ka mbështjellë të dyja në një mjegullnajë që i shkëpute prej personazheve të tjerë në skenë.) Gonxhe e zemres tonë.

NANE TEREZA

(Flet me të dyja në atë aureolën që ka formue me zanin e saj.) Tashma me kushtetutën e re të qeverisë së Tiranës asht ba tepër e vështirë për mue me nxjerrë leje, porse sa ma e zezë të bahet nata, aq ma fort ndrin ai ylli i Zotit në qiell...Ju rroku fort dhe e ndij zemren si rreh bashkë. E jueja Gonxhe.

(Shtrin duert me i prekë.)

TE DYJA

Gonxhe e zemres tonë.

(Shtrijnë duert dhe e prekin si në tablonë „Dora e Adamit“ e Mikelangjelos)

NANE TEREZA

Shpesh në lutjet e mija e kujtoj racën lire, sepse në të struket një potencë e jashtzakonshme e jetës, megjithse asaj nuk i jepet as shanci ma i vogel me mbijetue. Edhe nëse ka fat me u mbjedhë, i sulen qindra barishte të egra dhe ja marrin frymën, sapo nxjerrë filizin. Kjo po e vonon ringjalljen në vendin tonë.

AGETINA

Kështu ishte nën osmanet e kështu vazhdon edhe nën komunistët sot moj motër. Unë kam me shkruë poezi sa të jem gjalle, me atdhe të lirë apo të pushtuem.

DRANDJA

Fara nganjihere kur ruhet mirë në hambar e mban mrenda vedit dritën e jetës me qëllim që kur të dalin të shpërtheje me tanë forcën e saj.

NANE TEREZA

Në kjoftë se hebrejte e gjetën ma në fund një vend ku me shpalosë gjeninë e racës së tyne në liri të plotë, na vazhdojmë u sjellë nëpër botë e tuj ba atje art e letërsi, shkencë dhe besim, sepse vendi jonë vazhdon të jetë i papërshtatshëm.

(Nxjerr dy kutija dhe i afrohet)

Shikjo Age, këto janë dy kutijat që bjen çdo epokë me vedi dhe këto mbajnë kohën.

AGETINA

(I merr në dorë)

Ça janë këto kutija që e mbyllin kohën mrendë?

NANE TEREZA

(E merr njenen kuti në dorë)

Osmanet për 400 vjet grabitën njenën kuti, atë materjale, ndërsa na në vorfninë tonë, ruejtëm fort atë shpirtnore. Kur erdhi dita që historia me peshue gjanat, atëhere Shqipnia na mbeti ne, sepse na kishim ruejtë poezinë dhe gjuhën tonë.

AGETINA

Na kena mbetë sot një grusht i vetëm moj Gonxhe.

NANE TEREZA

Na jena ruejtësat e kutisë së zemrës së Shqipnisë dhe atë kuti duhet me e mbushë në çdo epoke të re me artin e poezinë tonë.

AGETINA

Nuk na kanë lanë asnji shanc sot me u marrë me kurgja.

NANE TEREZA

Na nuk duhet me u ba kurrë si komunistat që shohin vetëm me shkatrrue kulturën e si me u pasunue përdite e ma shumë. Shqipnia ka me na mbetë në përjetsi, sepse ata nuk dijnë me ba art e poezi, se janë të huej në vendin tonë.

AGETINA

Ata kanë në dorë kutinë e pasunisë moj Gonxhe, perditë e ma shumë grabisin atdheun e ne tash na lajnë me vdekë urijet siç na kanë lanë tash 30 vjet dikaturë.

NANE TEREZA

Na jena poetesha në shpirt motër, prandaj na duhet me mbushë kutinë e kohës me art e poezi, sepse vetëm kjo e siguron mbijetesën tonë.

(Lokja nxjerr me kujdes foton dhe lexon tekstin mbas fotos)

Në thellësinë e pafund të zemrës time dridhet e heshtun një andërr e pajetue me parajsën në qiell dhe familjen në tokë guxoj me i prekë vetëm përmes të lutjes.

NANE TEREZA

Unë shkruaj perditë sa herë që gjej kohë, se poezia asht fryma e jetës time.

AGETINA

Unë kam me shkruar gjithmonë Gonxhe sa të jem gjallë.

NANE TEREZA

Ty të pastë Gonxha, na u mësue me tashma me poezinë e peshpëritun në zemër.

AGETINA

400 vjet nuk na lejuen me shkruar gjuhën tonë, porse na imponuen gjuhë beduinesh. Tash erdhën komunistët, kjo farë hidhash dhe na imponojne me shkruar e folë një gjuhë mushket, gjuhë stepash.

NANE TEREZA

Mbas tyne ka me pasë një vakum të madh, ka me ardhë një kohë dhe shkolla ka me kenë si një ndertesë e djegun ku dija ka me hi dhe me dalë prej dyerve e dritareve të shembuna. Ka me ardhë një brez kalimtarë, as mish as peshk e mbas këtij brezi ka me nisë jeta.

NEXHMIJA

(Ndërhyn e ja merr letrën me forcë tuj e shpërnda hapsinën prej aureole që mbështjellë Nanë Terezen me familjen e saj.)

Këtë vend e kemi ne në dorë dhe do e mjelim mirë. Ju vazhdoni të prisni derisa të kthehet Uliksi juaj në Itakë dhe t'ju lirojë. Prisni ju, prisni më kot, sepse ne e kemi vrarë me kohë Uliksin tuaj, ore Arbënore.

NEXHMIJA

Na jipni tani fotografinë.

DRANDJA

Kjo asht letra e vajzës, e Gonxhes, që me ka nisë mue!

NEXHMIJA

(E kërcënon dhe Korbat e ndjekin mrapa)

Ju jeni shqiptarë dhe shqiptari e mban fjalën kur e jep.

SEKRETARI

(Sillet përreth vedit)

Shqiptari është një qenje e çuditshme. Të gjithë afër tij e thërrasin: o shqiptar dhe ai sillet përreth e pyet se për kë është fjala. Të

thirresh shqiptarë dhe të mos ndjehesh i tille, kjo është pyetja shekspiriane.

DRANDJA

Para se me ta dhanë foton me shkrimin e vajzës deshta me tu lutë si nanë që jeni dhe kam dëgjue se edhe ju keni një vajzë. Të lutem me lejo të shkoj me pa vajzën time.

NEXHMIJA

Kurrën e kurrës! Përçdo vit më shkruan ajo vajza juaj, reaksionarja dhe më kërkon leje. Po si mund të vijë një murgeshë në vendin tonë,

kur këtu nuk ka murgesha!? Hahahahaha

KORBAT

Hahahahaha

Sa herë shihem në pasqyë

Më rrjedh gjaku në fytyrë

NEXHMIJA

Ju jeni të prekura politikisht, me djalin në Itali dhe vajzën nëpër botë duke marrë çmime....

SEKRETARI

Pikërisht, çfarë ju duhet çmimi Nobël juve, atë duhet ta marrim ne që bëjmë letërsi dhe art të jashtzakontë.

AGETINA

Te paktën Nana Loke me shkue sa me e takue një herë para se me vdekë, me marrë ilaçet dhe me u kthye prep.

NEXHMIJA

Në asnjë mënyrë, sepse ne nuk kemi nevojë për ilaçet e botës kapitaliste. Nëse nuk ke gjetur ilaçe të një farmaci, të jap unë një adrese ku ti marrësh ilaçet.

DRANDJA

Po sikur ti japësh leje Gonxhes sa me ardhë me na takue, krejt shkurt, në kufi, në tokë asnjane, para se me mbyllë sytë nga kjo jetë. Ju

bahet shndet tanë jetën Ju dhe fëmijëve tuej...

NEXHMIJA

Jo e pamundur, kjo është e pamundur! Shoku Enver e ka quajtur atë: Leckamane! Nuk e lejojmë të hyjë në Shqipërinë tonë dhe as ti afrohet asaj.

DRANDJA

Po pse moj grue, po ju jeni vetë nanë?

NEXHMIJA

Sepse vajza juaj është murgeshë e krishterë, dhe feja është armiku numër një i diktaturës së proletariatit.

SEKRETARI

Na jepni fotografinë e nobelistes.

TE DYJA

Jo kurrë! Sot po e bajmë deken si me le.

NEXHMIJA

Nuk na mbetet rrugë tjetër: të thërrasim Xhelatin.

(Hyn Xhelati në skenë. Në dorë ka një drapën dhe një çekan. Asht veshë si kasap gijotine. Shkon tuj fërkue drapnin me çekan.)

XHELATI

Erdha unë sapo dëgjova zërin e partisë dhe ja ku më keni.

NEXHMIJA

Mund t'ju marrësh foton këtyre grave?

XHELATI

Foton? Unë jua marr edhe shpirtin në vend?

SEKRETARI

Foton duam neve, jo shpirtin.

XHELATI

Më kujtohet një herë kur më caktuan shef të krimeve në hetuesinë e grave kriminele antiparti. Bënte ftoftë si tani, ngricë, ishte dhjetor dhe në qeli kishte diku minus 6 gradë. Po ndërroheshin vitet dhe ata ishin ngjeshur dy e nga dy nëpër qeli për t'u ngrohur sadopak. Unë hyra në mesnatë ku ndërrohen vitet me shkopin tim dhe u rashë sa munda e ku munda. Ata thërrisin si shpendë të plagosur, te zënë në kurthë. Femra ishin, antiparti ishin, kujt i duheshin?

SEKRETARI

Po çfarë kishin bërë ato?

XHELATI

As ato nuk e dinin se pse ishin aty dhe as unë nuk e dija, porse meqë ishin aty të gjithë e dinim se diçka duhej të kishin bërë. Përndryshe nuk ishin aty se partia nuk arreston njeri kot.

NEXHMIJA

E shanin ato shokun Enver?

XHELATI

Pa ta provonin një gjë të tillë.

NEXHMIJA

E shanin apo jo?

XHELATI

Mbas drurit tim as që e dinin se në ç`botë ishin. Thërrisin si shpendë të plagosur, klithnin deri në mëngjez derisa humbisin ndjenjat. Unë prisja sa të vinte ky çast dhe pastaj u hidhja ujë të ftoftë akull dhe ata dridheshin aty, ndërsa unë nuk ngopesha së talluri me armiket e partisë dhe të popullit.

NANE TEREZJA

Unë Shqipninë e mbaj në zemren time dhe lutem për të. Njashtu në duert e shejtanit shqipja dridhet ndërsa ai ja shkulë puplat një e nga një, porse unë kam shpresë se lutja ime i bahet mburojë.

XHELATI

Ku është fotografia e asaj murgeshës që kërkon të rrëzoje pushtetin popullor dhe diktaturën e proletariatit?

LOKJA

Po a nuk ishin nana të dashtuna fëmijësh, bija të shtrejta baballarësh, bashkëshorte të nderueme, këto martire?

XHELATI

Ditën që ata hynin në birucën time zhvisheshin nga të gjitha këto tituj dhe detyrime. Ata nuk ishin më as njera dhe as tjetra: ishin vetëm të burgosura antiparti. Ata ishin gra, një racë inferiore ndaj neve burrave me mustakë.

SEKRETARI

Po si është e mundur të arrijë njeriu një shkallë të tillë përkushtimi ndaj detyrës, të zgjohet në mesnatë e të torturojë armiket e popullit?

XHELATI

Isha 15 vjeç kur dola malit dhe mësova të vrisja e prisja kë të më binte në dorë. Atëhere nuk pyeste kush për gjyqe dhe gjyqi ushtarak ishte më i shpejti dhe më i drejti. Pastaj kalova në armën e sigurimit pasi aty kontakti me elementet antiparti ishte me i shpeshtë. Në fillim rrihja dhe vrisja edhe unë si të tjerët, por me kalimin e kohës gjithçka ndryshoi.

NEXHMIJA

Çfarë ndryshoi tek ne?

XHELATI

Jo tek ne, porse tek unë ndryshoi gjithçka. Tashmë torturat kundra armiqve më ishin bërë një lekurë e dytë. Më dilte gjumi në shtëpi në mes të natës dhe vrapoja në birucat e hetuesisë, merrja

shkopijtë dhe rrihja për orë me rradhë derisa më linin forcat. As nuk e dija se pse i rrihja dhe as ata nuk e dinin se pse rriheshin. Rëndësi kishte që unë të ngopesha e të shkoja të flija i qetë.

SEKRETARI

Jipnin rezultatet e duhura këto metodat tuaja?

XHELATI

Deri më tash nuk jam zhgënjyer. Kush ka rënë në dorën time ose më është rrëfyer mua ose ka perfunduar në ferr dhe i është rrëfyer djallit ...hahahahahahaha.

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

NANE TEREZJA

Unë Shqipninë e kam në zemren time dhe sa herë më dridhet buza për të. Lutja ime më del prej zemret dhe një zemer plot me dashuni nuk zhgënjehet kurrë.

NEXHMIJA

Ke ndonjë metodë të duhur t`ja marrësh fotografinë këtyre?

XHELATI

Kam metodën e macës së zezë?

SEKRETARI

Macës së zezë?

XHELATI

Po e kam përdorur në burgun e grave, sa herë dhe ata më kanë treguar mbas kësaj torture edhe ditët që nuk i kanë jetuar ndonjëherë.

NEXHMIJA

Pa ta dëgjojmë këtë? Dëgjoni edhe juve familja e murgeshës reaksionare.

KORBAT:

Sa herë shihem në pasqyrë . Më rrjedh gjaku në fytyrë

XHELATI

I lidhi gratë si fillim, pastaj i zhveshi lakuriq, ju veshi një thes deri në grykë dhe brenda ju fusë një mace. Pastaj e lidhi grykën e thesit dhe ato i lë me duar të lidhura. Filloj të rrahë macen me shkop. Zërat e gruas dhe të maces përplasen gjithë kohën nëpër qelinë e ftoftë...

AGETINA DHE LOKJA

Mjaft, mjaft pash dashnine e Zotit, mjaft!

DRANDJA

(E nxjerr foton tanë kujdes prej xhubletës dhe pëshpëritë)

Merre pra, zjermi i ksaj fotoje ju djegtë e përvëlofte si rrufeja e bjeshkëve.

(Ajo rrëzohet përdhe ndërsa shkon e bija dhe e mban)

AGETINA

Mbaju Loke para këtyne!

DRANDJA

Në terrin e pafund të kombit tonë, këto janë nata ma e zezë.

NEXHMIJA

Po ju si jeni veshur kështu, si reaksionarë të maleve.

AGETINA

Këto janë veshjet tona që bashkë me besimin tonë kena trashëgue prej ilirëve e këto dy thesarë asnji kohë nuk ka me na i hjek.

(Agetina e mban fort foton në dorë dhe ndërsa e sheh, një dritë ja mbushë fytyrën)

Oh mrekulli!

(fotografia njashtu si edhe letra e ka fuqine mrekulluese me i ba njerëzit që e shohin me kallxue të vërtetën, me pa në shpirt ditën kur asht lidhë fryti i shpirtit të sejcilit.)

NANE TEREZA FLET SI HOLOGRAM

Vetëm Zoti mundet me ba mrekulli dhe Zoti asht dashuni e dashunia asht në zemren tonë. Prandaj mos e kërko motër mrekullinë e jetës me anë të mendjes porse të zemrës. Vetëm zemra e ka forcën me e shndritë mendjen, ndërsa mendja asht mjeti i zemrës.

AGETINA

Motër e dashtun, sa herë kjo jetë më ka hjedhë në mesin e rrugës pa asnji shpresë e shpesh kam mendue se kurrë s'kam me u çue ma në kambë.

NANE TEREZA

Te njerëzit e hjedhun si thasë plehut nëpër rrugët e Bombeit, unë kam ndeshë ma fort dritë në zemër se sa në shumë udheheqësa shtetesh. Ka me ardhë koha kur jeta do mbushet me njerëz me zemër të ndritshme. Ata kanë me ba mrekullina gjithandej. Mendja jonë asht e pafuqishme para universit, ndërsa për zemrën, universi asht kandi i lojnave të saj.

AGETINA

(Me foton në dorë flet për jetën e vet. Personat e tjerë i mbulon terri dhe duken vetëm si hije)

Unë nuk mundem me dashtë ma, Gonxhe, se dashunia asht

shumë e fortë e ajo të vret nëse nuk ndeshim njeriun që dashunon sa ti. Apoloni deshti vetem një herë, me një dashuni ma të madhe se ai, për me na kallxue se sejcili në jetë e ka Dafinën e vet.

NANE TEREZA

Ah moj Age a thue ke me ma falë një ditë se nuk të ndejta afër si motër e madhe me një këshillë e me një fjalë!

AGETINA

Tashma jam 50 vjeç e s`kam besim me ja hapë kërkujt zemrën e me i kallxue zjermin që digjet aty, sepse kërkush nuk mundet me m`dash të me tanë njat dashuni që asht aty mrendë....

NANE TEREZA

Unë Shqipninë e mbaj gjithmonë krejt afër në zemrën time dhe zemra jote Age, rreh bashkë me mue.

AGETINA

Ah Gonxhe, motër e zemrës time! Sa koha e pajetueme na kaloi ne të dyjave!

NANE TEREZA

Nganjisherë ndodh në vende dhe popuj që sytë mbulohen me shtresa territ dhe ata përplasen rrugëve te historisë pa e përjetue dritën, porse gjatë tanë ksaj kohë ata e ruejnë kujtesën e dritës në lockë të zemrës. Derisa ajo dritë të jetë aty, ka shpresë dhe kjo asht lutja ime e përditshme për popullin shqiptar.

AGETINA

Ah moj Gonxhe drita ka humbë aq thellë sa mendja nuk mund ta ndjekin ma.

NANE TEREZA

Drita e zemrës asht gjenija e mendjes tonë motër e dashtun. Une kam mbledhë femijë autistë të hjedhun në rrugë dhe kam pa në sytë e tyne një dritë të jashtzakonshme dashunijet për jetën. Sadoqi ato ishin të kufizuem në lëvizjet e trupit dhe mendjes së tyne, zemra ju rrihte me një dashuni të madhe.

AGETINA

Edhe vendi jonë me duket si një fëmijë autist, në trunin e të cilit ka një vend të langshëm që nuk arrinë me u formue e duket se pret një ditë ma të mirë...

SEKRETARI

(Vjen e ja merr Ages foton e Nanë Terezes dhe kështu dialogu ndërpritet)

Unë isha femijë, diku në adoleshencë dhe mbaj mend se ne nuk kishim fiq në kopshtin tonë. Atëhere një ditë hipa në kopshtin e

komshisë dhe ja vodha të gjithë fiqtë e pjekur. Dola në oborr dhe nisa ti shes e që atë ditë nuk bëj gjë tjetër vetëm çdo stinë shes frutat e vjedhura të komshisë e mallkoj veten, pse nuk patëm edhe ne në shtëpinë tonë një frut .

NANE TEREZA

Njeriu duhet me zbritë në fund të zemrës e me zbulue aty zjermin origjinal që digjet në sejcilin prej nesh. Vetëm një zemër e madhe ja krijon hapësinën një mendjes së ndritun.

SEKRETARI

E vetmja gjë origjinale e imja është një fik i papjekur, sepse unë nuk e pata asnjëherë kohën të prisja pjekjen e fiquve.

Parti e dashur / të vegjël jemi/ porse ty në zemër/ gjithnjë të kemi...

(Ai bjen në gjunjë dhe ja lëshon portretin Nexhmijes.)

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fëtyrë.

NEXHMIJA

Atë ditë kur vrava për herë të parë njeriun që kisha ma të shtrejtë e bana këtë për hir të zogut të madh të pushtetit, që mu afrua si dhuratë. Në mes të dashurisë së parë dhe sigurisë së jetës unë zgjodha të dytën. Atë ditë e pashë se unë do të vrisja të gjithë jetën, vetem të mbaja pushtetin mbi gjelin e majmë të detit që quhej Shqipëri.

NANE TEREZA

Romakët e kanë dijtë që me Herodin: asnjë komb nuk mund të shtypet, të persekutohet e të shfytyrohet ma mirë se sa prej llojit të vet të deformat. Në vendin tonë ka tash 5 shekuj që sundon egjra dhe bari i keq, i cili ja merr frymën grunit të mirë të racës tonë.

NEXHMIJA

Kam një jetë të tanë që e bëj këtë, sepse çdo ditë e pushtetit që merret me dhunë i ngjan ditës së parë të marrjes së pushtetit me dhunë. Udhëheqësit e vërtetë kalojnë mbi kufoma. Unë e kam marrë me gjak dhe vetëm kështu do e lëshoj gjelin e majmë te Shqipërisë.

NANE TEREZA

Tashma shqiponjës ju ja keni nxjerrë kocat jashtë e ajo po vdes përditë e ma shumë. E keqja po vazhdon në popullin tim, sepse fara e keqe përhapet ma shumë se gruni i mirë. Prej kësaj fare

merren drejtuesat e do ja marrin frymën grunit.

NEXHMIJA

Në fillim i vrisnim shqiptarët me plot dëshirë, sa herë që na thoshin, jugosllavët, apo më vonë rusët e tani së fundi kinezët. Dëshirat e tyre përputheshin me etjen time dhe të Enverit për gjak. Kur njeriu mësohet me një mënyrë drejtimi të pushtetit ai nuk di të veprojë ndryshe. Shpeshherë enveri më zgjon në mesnatë dhe më pyetë: Nexhmije, kë do vrasim sot? Koha na bëri si dy killer, që nuk mund të jetojnë pa vrarë.

SEKRETARI

Unë kam përshkruar ama një Enver krejt tjetër nga ky që thua ti shoqja kryetare?

NEXHMIJA

Po kjo është detyra e artistëve në diktaturë, të përshkruajnë realitetin që duan të shohin njerëzit, jo atë që egziston.

SEKRETARI

Ma jep shancin ta shoh edhe një herë këtë foto.

NEXHMIJA

Merre se po më djeg duart e lëkurën, zemrën e sytë. Kush e solli këtë murgeshë te mallëkuar këtu? Sa te jem unë gjallë ajo nuk do guxojë te vijë në vendin tim. Shqipëria është e imja, e imja, e imja....

(Prej fotografisë del zjerm. Ajo e lëshon e bjen në gjunjë e fotoja mbetet e varun në ajër. Sekretari shkon te Nexhmija dhe ajo ja ngul atij dhambët në qafë. Njashtu bajnë edhe korbat me gjarpnijt. Xhelati i bjen vedit me çekiç dhe ja ngulë vedit drapnin. Këto janë pamje prej ferrit ndeshkues.)

NANE TEREZA

Unë lutem për popullin tim shqiptar që e kam në loçkë të zemrës, lutem që një ditë fara e keqe të shkulet krejt e fushat tona të mbushen me grunin e mirë e bukën e bardhë të jetës.

(Haleluja e Hendel e mbushë skenen dhe nexhmija e sekretari bashke me korbat dalin jashtë tuj bërtitë nëpër skenë refrenin tragjik.)

Sa herë shihem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

DRANDAJ DHE AGETINA

Larg prej nesh!

AGETINA

Jashtë, se ju jeni fara e egër e këtij vendi !

NANE TEREZA

Gruni i butë i jetës e siguron vazhdimsinë e fushës e jo egjrat!

QERAXHIJTE

Koha e keqe na ka ba njerez pa ngjyrë, pa undyrë e pa dritë!

DRANDJA

Shkoni në paqe me Zotin se të gjithëve na kanë lidhë për kashatën e gojës.

(Ata dalin pa fjalë ndërsa të dyja shkojnë te shporeti-fuqi dhe ulen përreth tij afër njena tjetres. Nanë Tereza ju shkon mrapa dhe i mbulon me mantelin e famshëm të Madones. Edhe engjujt e veshun si motrat e Nanë Terezës i bajnë një gjysë aureolë në sfond. Krijohet kështu një ambjent i terapisë së Fjalës. Gjithçka asht terr, përveç dritave që ndriçojnë tri gratë prej nelt.)

NANE TEREZA

(MBAN NJI SHQIPE NE DORE)

Shqipen e rrëzuen me shigjetë helmit dhe ajo mbeti e plagosun, ra viktimë dhe ata e futën në kafaz. Aty e mbajtën për sakrificë, flijim për kurban, për shekuj me rradhë. Tash erdhën komunistët dhe ata njashtu e prishën kafazin e kalbun të osmanëve dhe ndërtuen një prej hekur betonit. Aty mrendë futën shqipen e pashërueme mire e plagosën e kthyen në viktimë dhe tash janë gati me e sakrifiku për blemësin ma të parë.

AGETINA

Ky vend asht si një i sëmure me gangrene e ja sharrojnë kocin përditë e atij nuk i ban ma përshtypje kurgja.

NANE TEREZA

Une për këtë e mbaj Shqipninë në zemrën time, sepse kam pa në sytë e njerëzve gjysë të vdekun, dritën e ringjalljes.

AGETINA

O motër me të vërtete kanë me ja shitë Shqipninë atij që paguen ma fort?

NANE TEREZA

Fati i keq, ky shejtan i kohës po e mban Shqipninë si një shqiponjë të sakrificës në një kafaz të historisë moj motër dhe duhet me ardhë një hero prej qiellit, me e prishë kafazin e me ja kthye shqiponjës kujtesën.

AGETINA

Gonxhe, mbas komunistave a ka me ardhë demokracia ndër ne?

NANE TEREZA

Po vjen dita dhe P.P.SH-ja po copëtohet dhe bashkë me të edhe kafazi ku mbahet shqiponja e flijimit. Prej saj kanë me dalë dy parti të tjera e ata kanë me ndërtue dy kafazë e sejcila prej dy partive ka me e futë shqipen tuj u ndërrue për çdo zgjedhje në kafazin e sakrificës.

AGETINA

Motër për ne nuk paska shpresë ma në kët jetë!

NANE TEREZA

Ju nuk duhet me humbë Shpresën se Zoti i mban premtimet e veta. Unë kombin shqiptar e kam në zemrën time. Nji komb nuk mbijeton prej sasisë së egrës, porse prej cilësisë së grunit.

AGETINA

Ah moj motër, terri nder ne ka lëshue rranjë dhe askërkush nuk po del me ndezë yjet e dritës. Kam frikë se kur të vijnë drita, nuk kena me mujtë me pa ma kurgja, vetëm terrin, si shpendi i natës.

NANE TEREZA

Na kena genin e ilireve motër dhe ato që trashëgojmë prej tyne duhet me i mbajtë fort. Dhuna e historisë na ka shtypë zemren, porse nuk na e ka shprishë embrionin tonë e na shpejt kena me u lirue prej saj. Ke me pa kur ky embrion të shpërthejnë e të mbushi fushat e malet tona me bukurine e races tonë.

AGETINA

Nata ka qenë e gjatë shumë dhe pesha e randë e nuk e di a kena me pasë ma forcë në sy për me pa dritën, motër?

NANE TEREZA

Vetëm kështu kena me mbijetue, nëpërmjet dritës që shkëlqen në sytë tonë të hyjnueshëm.

DRANDJA

Ah moj Gonxhe, zemra e Lokes, kur ishe e vogël, nji ditë trete rrugën në nji pyll afër nji fshati në dalje të Shkupit dhe na u nisëm me të gjetë. Binte shi dhe bubëllime e ti ishe njite mbi nji pemë të naltë me krahët deri në qiell. Përreth kishte mjaft shkurre, porse ti kishe zgjedhë krahët e lisit që shtriheshin deri në re e kur unë të pveta se pse ndejte aty, se të rreh shiu nga tana anët, më je përgjigjë.

NANE TEREZA

Ma mirë me ndejë nën shiun që shohim në sy, se me u msheh prej rrufesë, që na bjen në terr.

DRANDJA

Atje mbi pemë ishte ndalë edhe nji shpend i madh dhe kishte hapë krahët nëpër degë e lagej njashtu si ti, ndërsa në shkurre ishin strukë, grizhla të trembuna. Unë të thashë se ti nuk duhej me fluturue aq nelt me zogj te qiellës, porse me ndej poshtë me zogjtë e fushës.

NANE TEREZA

Ah moj Loke, Zemra e shqipes rreh ma fort se të tjerat sepse ajo e matë prej nelt largësinë e kthimit në fole dhe klithma e gzimit vizaton qiellin tonë të ri.

HALLELUJA E HENDEL ...

(Të tri gratë i japin dorën lehtë njena-tjetrës si në një pamje trinijet dhe tri dritat mblidhen në një. Muzika bjen dhe engjujt e Nanë Terezës flasin.)

Engjulli 1

Në vitin 1979, Nanë Tereza e lindun Agnes Gonxhe Bojaxhiu mori çmimin Nobel për paqen. Ky çmim i krijoi asaj mundësinë e hapjes së shprijave të mëshirës në shumë vende të botës.

Engjulli 2

Qeveria komuniste e injoroi krejtësisht çmimin Nobel, me logjikën ateiste se ajo ishte vetëm një murgeshë e besimit të krishtenë. Kjo qeveri nuk e lejoi asnjherë Nanë Terezën me vizitue familjen e saj në Tiranë, nanën Drande e motrën Agetina, që jetonin të dyja në një vorfni të ngjashme me rrugët e Bombeit.

Engjulli 3

Disa muej mbas dhanies së çmimit Nobel për paqen Nanë Terezës, një ndëshkim prej zemërimi hyjnor ra mbi diktaturën komuniste në Shqipni.

Engjulli 4

Qeveria pushkatoi Ministrin e mrendshëm nën pretekstin e komplotit për rrëzimin e pushtetit.

Engjulli 5

Nji vjet ma vonë kryeministri Shehu vrau vedin dhe u shpall agent i perëndimit, ndërsa diktatori Hoxha kaloi një diabet të randë që i mori në fillim mendjen e kresë e më pas edhe jetën.

Engjulli 6

Ishte ky ndëshkimi për mëkatin e randë te refuzimit të dashunisë së një nane të madhe?

Engjulli 7

Ne vitet '80 vejusha Hoxha kalon në kriza nervore. Ajo sheh per vite me rradhe të shoqin e vdekun si lugat nëpër shpi dhe beson se vorri nuk e mban mrendë atë. E dëshpërueme ajo i kërkon ndihmë Nanë Terezës, e cila nuk ja ka refuzue askujt në botë deri tash, as lebrozëve të trupi dhe atyne të shpirtit.

Engjulli1

Ndodhi kështu që Nanë Tereza bekoi varrin e diktatorit ateist,

tuj u mbyllë një rrath të randë të së keqes në historinë e vendit të shqipeve. Shqipnia asht një vend i vogël si ajo, porse me një shpirt të madh si ajo.

ENGJULLI 1

Me ardhjen e demokracisë dhe shembjen e diktaturës komuniste, vejusha e diktatorit u dënue në fillim të viteve '90 për shpërdorim detyre, porse jo për krimet e vrasjet që kishin krye bashkë me të shoqin në 45 vjet diktaturë.

ENGJULLI 2

Sot ajo jeton në Tiranë me një pension të dyfishtë, megjithëse nuk ka mbarue asnjë shkollë dhe nuk ka punue kurrë në jetën e saj. Pasionia financiare që familja Hoxha ka shpërnda nëpër kontot sekrete në botë, nuk asht percaktue as sot e kësaj dite.

ENGJULLI 3

Sekretari i lidhjes së shkrimtarëve socialistë, me të ardhë demokracia, kërkoi strehim politik në perëndim dhe jeton edhe sot e kësaj dite atje, megjithëse askush nuk e di arësye e vërtete të përfitimit të statusit të azilantit. Gjithë jetën e shau perëndimin, ndërsa në pleqëni shkoi me ju hangër bukën. Në Shqipni ka ndodhë një fenomen mjaft i çuditshëm në përpunimin e të kaluemes vrasëse. Aty dënohet soc-realizmi por nderohen autorët e tij.

ENGJULLI 4

Oficieri i sigurimit Xhelat C. gëzon edhe sot një pension të dyfishtë dhe në demokraci e mbushin në çdo përvjetor me dekorata lufte pa ja hjekë pseudonimin Trimi, për asnjë çast. Edhe në këtë rast, dënohet diktatura komuniste porse nderohen persekutorët. Dikush thotë se kjo asht sindroma e vendit se këtu ka qenë gjithmonë kështu. Dënohet persekutimi e nderohen persekutorët.

ENGJULLI 5

Nanë Tereza hapi në Tiranë dhe në shume qytete të Shqipnisë shpijat e saja të mëshirës ku pranohen të sëmurë dhe të pastrehë, njerëz që nuk kanë ilaçe dhe nuk kanë mundësi ushqimit.

ENGJULLI 6

Sa herë që Nanë Tereza sjellë maunet me ilaçe dhe ushqime në Tiranë, njerëzit habiten prej saj, një grue aq e vogël me „by pass“ në zemër dhe në moshë të thyeme, punon vetë në shkarkimin e ilaçeve me një zell të papërmbajtun.

ENGJULLI 7

A thue se kërkon për çdo herë e ma shumë me kapë me doemos kohën, në të cilën nuk muji me ardhë te nana dhe motra e saj, që vdiqën të sëmura, pa ilaçe dhe në mjerim të plotë...

E P I L O G

(Të gjithë largohen dhe në skenë zbulohen ngadale dy vorre. Në njezin sillet rrumbullak si e krisun nexhmija, e cila vuen nga skicofrenia, kjo lebrozë e shpirtit njerzor, ndërsa në tjetrin asht Nanë Tereza dhe vendos lule e lutet në heshtje.)

NEXHMIJA.

(Në kriza haluçinacionesh)

Me lërë ore të qetë, më lësho, ç'punë ke me këmbën time. Nuk të mjafton sa ishe gjallë kur më çoje nga gjumi në mesnatë dhe më thojë: Nexhmije kë do vrasim sot? Nuk të mjaftoi kjo por edhe tani i vdekur nuk po më ndahesh? Bota kujton se kam bërë jetë të mirë me ty, po ç'jetë ishte kjo? Vetë e çmendur dhe burri i çmendur.

(Sillet rreth tij dhe një hije zgjatet nga varri dhe e kapë në kambë)

Ma lësho ore këmbën, ma lësho, ose më merr me vete. Nuk të lë varri brenda? Po pse ore pse? Dikur me thojë se e gjithë Shqipëria të përket ty, madje ishe bërë fanar për gjithë Botën e tani nuk po të lë as varri brënda? Ç'farë thua ore? E kanë kinezet bombën atomike? Po ç'më duhet mua kjo. Edhe nëse e kanë për vete e kanë.

(Ajo rrëshqet e bjen mbi varr)

NANE TEREZA

Lokja e zemres seme, unë jam Gonxha jote e kam tash një jetë që të premtuj se kam me të pru lulet ma të bukura që ka çilë pranvera. Tash jam këtu afër tejet dhe koha nuk ka ma forcë me na nda. Më duket sikur jam ajo Gonxha jote e vogël që shëtiste nëpër kopshtin e feminisë në Shkup dhe tanë zogjtë këndoishin bashkë.

(fshin lotët dhe vendos lulet.)

Age, motra e zemres time, ti je rritë bashkë me mue në një botë jashtë botës, e njëherësh në zemren time. Dashuninë për ty e kam ushqye me lutjen time, njashtu si engjujt ushqejnë dashuninë për Krijuesin e gjithsisë. Të gjitha datëlindjet tueja i kam festue me ty, rininë tande e kam përcjellë me lule të bukura. E kur u rrite dhe u bane e madhe, kam thane në largësi: Agetina asht ba zojë

grue tash.

NEXHMIJA

Më lësho ore se po mbytë së gjalli. Çfarë do më shumë nga unë? Piramidën ta bëra, në mes të Tiranës qëndron më i madh se gjigandi i Rodosit, po çdo më shumë ore?

(Hija zgjatet dhe e kap prep.)

Më lësho ore të thashë Nuk të zë varri brenda? Ne vetë jemi fajtor, ne të gjithë të vetëquajturit komunistë: Mehmeti, Haxhiu, Hysniu, Ganiu, Kadriu, Aliu e të gjithë ishim një bandë që e morën Shqipërinë peng, e shkëputem nga bota dhe e lamë të ngrodhte urijet. Banditë ishim të gjithë. Në vend që të hanim vetë e t'a lejonim edhe popullin të hante e të pinte, e lamë të ngordhte. E pra këtu tek ne kishte për të gjithë. Mund ta bënim vendin një Zvicër të dytë, por jo, nuk deshëm këtë, më mirë e kthyem në një enklavë banditësh. Si shpërblim vramë njeri tjetrin, ja hëngrëm kokat njeri tjetrit....

NANE TEREZA

Ju të dyja keni ndejë bashkë një jetë të tanë, njashtu si ç`kam ndejë unë me vorfninë dhe sëmundjen e botës Sa herë kam marrë një të moshuem, te braktisun në rrugët e kryeqyteteve të Botës dhe i kam dhanë strehë, i jam lutë në heshtje Krijuesit të gjithsisë me ja ba shëndet Lokes dhe Ages time. Unë gjithë jetën ju kam pasë në zemren teme si dy qira që nuk shuhen kurrë për jetë të jetëve. Edhe tash që jeni këtu e shoh se sa hije e bukur i ka ra fytyrës tuej e sa paqja sundon mbi strehën e fundit...

NEXHMIJA THERRET

Më lësho ore se ma more frymën. Qëkur ke vdekur, hija jote shëtitë nëpër kokën time dhe nuk më lë të qetë. Po ç`kërkon ore nga unë!

NANE TEREZA

Age, kam disa ditë këtu e siç bajshim dikur kur ishim të reja, e kam vizatue vendin tonë me fjalë. Ndiqe poezinë që kam shkruar për kryeqytetin tonë.

(Nxjerr një libër dhe lexon)

THE GREAT MUTATION

Vendi jonë përplasat në vorbullën e një mutacioni të papamë e unë nuk e di se deri ku lëkura jonë mund ta mbijetojë shndërrimin e pandalshëm e të përditshëm.

Këtu, të huejt përkujdesen me mbledhë ashklat e të kaluemes e po ndërtojnë përditë piramida prej drujsh të kalbun ndërsa rranja e gjallë e atdheut shkon tuj u dridhë ftoftit nëpër zallin e kohës në mes të gurëve të përgjakun. Nji ditë tash zgjohena të gjithë si zhapinj të varun nëpër shkambij të thatë anash lumejve, në brigjet e Adriatikut, në pritje të dallgës së madhe...

NEXHMIJA

Nënë Tereza, Nënë Tereza...

NANE TEREZA

Urdhno, zonja Hoxha.

NEXHMIJA

Po çfarë zonje jam unë, afroju e më thuaj si të shpëtoj prej kësaj plage që më ka zënë sytë. E gjithë bota sheh dritë, ndërsa unë shoh vetëm hije të vdekurish. Më duket sikur vetë lëkura ime është e akullt, prej të vdekuri...

NANE TEREZA I SHKON AFER

Tash jena në moshë të thyeme e sejcili ka kryqet e veta me mbajtë.

NEXHMIJA

Ti je e krishterë e je mësuar ta mbash, porse mua që isha ateiste për një jetë të tërë çfarë më duhet kryqi mua?

NANE TEREZA

Njeriu vijon me kenë në djep të jetës së tij dhe ai përkundet lehte prej universit, prandaj asht herët me u çue në kambë e me i ra mohit dashunisë së nanës së vet, krijuesit të universit e të dashunisë.

NEXHMIJA

Dashuria ka një kuptim tjetër për juve dhe tjetër për mua. Unë kam vra dikë për me marrë një tjetër. *(thërret)*

Më lësho ore se ma more frymën.

NANE TEREZA

Kujt po i thërret njashtu? A nuk po je mirë? Unë kam ilaçe me vedi? Sapo i shkarkuam nga makina e unë punova me plot dëshirë. Me duket sikur sa ma shpejt që punoj aq ma afër Lokes dhe Ages jam dhe po ju sjell ilaçet që nuk mujta me jau dorëzue kurrë.

NEXHMIJA

Ilaçe? Ti e din mirë se unë nuk ja dhashë nënës tënde të sëmure ilaçet që ja ke nisë dhe e lashë të vdiste, ndërsa ti do më afrosh mua ilaçe?

NANE TEREZA

Na duhet me e dashtë anmikun, porse jo persekutorin dhe vrasësin tonë. Na duhet me e falë anmikun kur del drita dhe ai asht tashma në terr. Me e falë don me thanë me i kallxue rrugën për në dritë.

NEXHMIJA

Po, drita asht gjithçka, drita asht jeta. Mua më zgjon Enveri në mesnatë dhe më pyet se kë do vrasim sot. Po kë do vrasim ne ore? Unë s'kam asgjë në dorë tashmë. Sa ishte gjallë ai më dridheshin të tërë, porse tashmë që jam vetëm, kam frikë, kam vite që kam frikë të flejë, se vjen Enveri e më ulërin në vesh....

NANE TEREZA

Po ç'farë kërkon ai, se të vdekunit kur na dalin në gjumë kërkojnë diçka prej nesh. Edhe unë e shoh Nanën dhe Motrën që me dalin e më kërkujnë ilaçe dhe bekim.

NEXHMIJA

Ai më kërkon ndihmë, më thotë se nuk e lë varri mbrendë, se nuk e duan as atje në botën e të vdekurve ta kenë afër. Me sa duket edhe atje janë ziliqarë ndaj tij, sepse pak njerëzve u takon në jetë të kenë një shtet krejt për vete e të bëjnë ç' të duan me të.

NANE TEREZA

Kjo puna e të vdekunve që dalin natën se nuk i len vorri mrendë nuk asht edhe aq e thjeshtë. Në fakt kjo ka të bajë ma fort me vorrin që njeriu ka mrenda vedit se sa vorrin real. Vorri i jetës jena na vete.

NEXHMIJA

Ore, Nënë Tereza të gjithë thonë se je si shejtore, se bën mirë në jetë të dhe pa shpërblim, nuk do ma mohosh ndihmën apo jo?

NANE TEREZA

Unë jam murgeshë e krishtenë, as ma shumë dhe as ma pak dhe nuk mundem me ja mohue ndihmën askujt edhe me dashtë. Pra që në bisedën parë ju thashë se jam gati me ju afrue doktorat e me ju ble ilaçet ma të shtrejta. Njiherësh si njeri nuk kam asnji paragjykim e madje te falem Nderës se më ke dhanë leje me ardhë e me pa nanën e motrën e me ju sjellë lule te vorri e nji bekim dashunijet.

NEXHMIJA

Nuk më duhet mjeku jo, se mjekë kemi sa të duash nëpër këmbë e pasuri kemi për të blerë ilaçet më të mira. Unë dua atë që

nuk blihet askund, me kanë thënë që vetëm njerëz si ti mund ta afrojnë.

NANE TEREZA

Une nuk mund të afroj ma shumë e as ma pakë se ju afrohej atyne që kanë nevojë.

NEXHMIJA

Dua të jem e sinqertë, të paktën një herë të vetme në jetë : unë të kam dhënë lejen të vish në Tiranë, pasi kam nevojë për ty...

NANE TEREZA

Na jena njerëz e kena gjithnji nevojë per njeni tjetrin. Edhe unë kam peshën e randë të hijes mbi krahnuer dhe tash që takova Nanë e Motër më duket se ata fluturuen të dyja në qiell.

NEXHMIJA

(thërret)

Më lësho ore më lësho. A e sheh moj grua, a e sheh se si me tërhjek prej këmbësh?

NANE TEREZA

Po çfarë kërkon ai?

NEXHMIJA

Fatin e Shqipërisë. Ai më këndon gjith natën:

U ngrit fat`i Shqipërisë,

Si i vdekuri nga varri, Mori rrugën e Asisë,

Duke rendur si i marri.

NANE TEREZA

Po tashma që Shqipnia asht në udhëkryq të historisë, cili asht drejtimi i saj?

NEXHMIJA

Shiko këtu: Shqipëria është plaçka jonë dhe ne po kërkojmë ta shesim sa më shtrejtë që të jetë e mundur. Përpara kësaj situate të re po mendojmë të gjithë, porse një gjë është e sigurtë: Lirë nuk do e shesim jo, se e kemi blerë me gjak.

NANE TEREZA

Bota po ndryshon dhe uroj që liria fetare te vijë edhe në Shqipninë tonë. Une jam lutë dhe vazhdoj të lutem për kët ditë.

NEXHMIJA

Shqiptarëve nuk u duhet gjëkafshë liria, as fetare as demokratike, sepse tashmë ata janë si një zog që e ka humbur aftësinë e fluturimit.

NANE TEREZA

Unë popullin tim shqiptar e mbaj në thellësi të zemres time dhe lutem për të. Prandaj unë e di se Zoti e ka shkruar një rrugë lirisht edhe për të. Po cili është mendimi juaj personal, se ju vijoni me pasë në dorë dorë fatit të Shqipërisë?

NEXHMIJA

Rëndësi ka që ne të kontrollojmë kalimin e popullit shqiptar nga stalla e komunizmit në një nga stallat që na afrohen dhe drejtimin ta mbajmë ne.

NANE TEREZA

Unë nuk dua me përzie në punët e mrendshme, porse Shqipëria është përcaktuar se ajo në thellësi të zemres së saj ka kulturën e përcaktimit.

NEXHMIJA

Të them të drejtën në fund të zemrës jam për rregjimet islame, sepse ata janë të ngjashme me diktaturën e proletariatit e në fund të fundit të drejtat e njeriut siç thotë përcaktimi vetëm sa e tërbojnë popullin tonë.

Këtë popull e mban vetëm dhuna, diktatura e bë tërbjet.

NANE TEREZA

Me dhunë nuk arrihet kurgja në jetë, vetëm me anë të dashunisë, se vetëm dashunia ka me e ndryshuar botën.

NEXHMIJA

Të mos ishte dhuna, ne do na kishin zhdukë me kohë. Shoku Ramiz po e këshillon çështjen me intelektualët dhe ai mendon se ne duhet të mjetim në dy krahe: islamit dhe përcaktimit. As mish as peshk, as lindje as përcaktim. Problemi është Enveri?

NANE TEREZA

Po ç`hyn Enveri tashma?

NEXHMIJA

Enveri është gjithandej. Ai më del në ëndërr dhe më thotë: ne jemi ateistë dhe nuk na duhet gjë islami, vazhdon: ne jemi komunistë nuk na duhet gjë përcaktimi kapitalist. E pra kur i them se na duhet të zgjedhim se komunizmi nuk ka të ardhme, atëherë bëhet lugat dhe më kafshon fort ashtu si hije.

NANE TEREZA

“Popullin tim e kam në zemer dhe lutem për të, e sa herë e shoh, ndeshi në një greminë ma të thellë se të lebrozit ma të pa shpresë. Populli im vuen përditë e ma shumë nga lebroza e shpirtit. Unë e shoh se si ky shpirt bjen copa e grima e kërkush nuk ja zgjat

doren me e shërue e as me e dashtë. Të gjithë janë në ikje e sipër, në plaçkitje e sipër. Me vendosë për fatin e një kombit duhen njerëz me mendje të kthjelltë dhe pasione te kullueta.

NEXHMIJA

Do më ndihmosh apo jo? Unë të solla ta shohësh mamanë dhe motren e vdekur u t'i sjellësh lule, porse jeta kështu e ka; duhet të japësh diçka që të marrësh diçka tjetër.

NANE TEREZA

Unë mund të marr me vedi në një nga klinikat e mija dhe aty mund të jetosh sa të duesh. Deri m` sot nuk i kam thanë kërkujt jo, se dashunia e Krishti asht e pakufishme. Më dhemb zemra kur mendoj se në duert e kujt po vendosen fatet e Shqipnisë.

NEXHMIJA

Hë pra se e nxore vete. Unë kam lexuar Ungjillin e ri, aty ku Jezusi thotë se po vdes për ne dhe se Ai i merr të gjitha mëkatet tona. Dikush të afron përjetësinë gratis dhe unë nuk mund të them jo. Kjo më duket akoma absurde porse a e din ti se më ka liruar nga pesha e hijes? Tash lexoj shpesh aty dhe sapo e marr librin në dorë në mes mejet dhe Enverit krijohet një hapësirë paqet.

NANE TEREZA

Me dashtë tjetrin, kjo asht e vërteta ma e madhe e njeriut, urrejtja për tjetrin kjoftë i pasun apo i vorfen, i bardhë apo i zi, nuk e rritë mirqenjen në botë, vetëm vorfnine...

NEXHMIJA

Po ashtu është, Marksi na genjeu, Lenini po se po, Stalini vrau, Titoja trathtoi, Mao Ce Duni shfarosi sa mundi, tash kam ngelë vetëm unë me burrin që nuk e zë varri brenda dhe më përndjek ditë e natë.

NANE TEREZA

Njerzit vetëm në dashuni janë të barabartë, sepse dashunia asht e pafund dhe pafundsia nuk ka masë. Urrëjtja asht e shkurtë, qorre dhe ajo e sëmurë njeriun.

NEXHMIJA

Unë jam e sëmurë dhe nuk e fsheh, sepse dua të shërohem e sikur të mos të dua të shërohem nuk të kisha thirrë, porse të kam thirrë se ti je shpresa ime e fundit. *(i bjen në gjunjë)*.

NANE TEREZA

Çohu Nexhmije se une e njoh kët shikim.

NEXHMIJA

E ke ndeshur më parë ne jetë? Pra e di se çfarë kam? I ke shëruar ata?

NANE TEREZA

Kët shikim e kam ndeshë te lebrozët e braktisun, të përzanë jashtë qyteteve të botës.

NEXHMIJA

Lebrozët? I ke prekë? I ke marrë në dorë?

NANE TEREZA

I kam shtërngue fort dhe i kam bekue se në ato shpirta kishte një dritë të bukur të Zotit. Porse nuk mund të rri pa thanë se lebrozet në shpirt janë shume ma të llahtarshëm se ato në trup.

NEXHMIJA

Më beko Nënë Tereza më beko se po çmendem. Lebroza po më bën të më bjerë shpirti copë e grimë.

NANE TEREZA

O Zot i pafund! Ne duert e kujt ka përfundue Shqipnia ime. Lebrozë me duer që kullojnë gjak, mbajnë në dorë foshnjat e sapolinduna dhe i infektojnë me të kegen e tyne! Moszotmakeq!

NEXHMIJA

Më beko pra, se ti nuk mund t'ja mohosh bekimin një lebrozi, më beko!!!!

NANE TEREZA

Po të bekoj në emën të Atit e të Birit e të Shpirtit Shejtë. Kështu unë bekova shërimin tand, porse jo vazhdimin tand.

NEXHMIJA

Ti beson se unë do të shërohem? Do të mund të flejë një natë te qetë?

NANE TEREZA

Une kam besue gjithmonë edhe në ditët ma të errëta të jetës time se dashunija ka me e ndryshue botën.

NEXHMIJA

Cilën botë? Këtu ndër ne nuk do ndryshojë asgjë. Ne u konvertuam dhe u bemë komunistë. Kujtuam se fara e stepave ruse do të ngjitet ndër ne. Mbas 50 vjetësh u kantandisëm në gjysë njerëz, gjysë kafshë, as mish as peshk, as perëndim, as lindje. Morëm në qafë një popull të tërë që nuk e di më se kush është .

NANE TEREZA

Sa herë që del një ditë e re, ka shpresë, sepse dashunia asht si dielli që del mbi botë për me e ndriçue atë. Zoti nuk ka kërkue

kurrë shumë prej nesh, vetëm me dashtë njeni tjetrin.

NEXHMIJA

(sillet rreth varrit te diktatorit)

Ore Nënë Tereza, ti nuk mund ta kuptosh se nuk ke jetuar këtu. E di ti ç'është terapia kimike? Ja këtë lëndë kimike ne ja futëm shqipëtarëve në gjak. Aty tashmë u shua gjithçka, qelizat e mira dhe të këqija. Bota pret se aty do të dalin të mirat dhe të fillojë jeta, të mbytet kanceri i kohës, porse bota do zhgenjehet rëndë. Këtu ndër ne e keqja është shumë thellë dhe e mira nuk ka më fuqi ta mundë atë...

(i thërret të shoqit)

Po më lësho ore Enver më lësho! Do më vdesish për së gjallë! Po ç'më duhen mua kinezët dhe bomba e tyre atomike.

NANE TEREZA

Unë Shqipninë e mbaj gjithnji në zemrën time, e kam dashtë edhe atë herë kur e gjith bota e mëshironte sepse ajo i ngjante një fëmije të braktisun në rrugën e historisë dhe askush nuk ja hidhte dorën.

NEXHMIJA

Po më lësho ero se më mbyte! Ç'më duhen mua internacionalja dhe bomba atomike e kinezëve!

NANE TEREZA

"Ne kjoftë se trupi jone, gjaku dhe kockat e kanë të vështirë ripërtrimjen, shpirti jonë ka një aftësi të jashtzakonshme me u ringjall e me e rifillue jetën, sepse në shpirtin tonë, aty thellë, jeton Zoti."

NEHXMIJA

Ma lësho ore dorën, ma lësho ore këmbën, unë do të çmendem në këtë vend të huaj, në këtë varr të zi që e quajnë Shqipëri.

(Varri hapet dhe del një dorë)

NANE TEREZA

Dashunia ka nisë me e ndryshue botën dhe Shqipninë unë e mbaj thellë në zemrën time.

NEXHMIJA

Neve nuk na mban varri mbrendë në këtë vend se ne nuk jemi prej këndej, jemi vetëm grabitçar që kanë rënë në follenë e shqiponjës dhe aty ja hanë vezët derisa të kthehet ajo.

(Ajo bjen në varr dhe bahet terr përmbi te)

NANE TEREZA

„Unë Shqipninë e mbaj në zemren time prandaj edhe kur të vdes po ja la botës një lutje të hapun:

Njashtu siç të kam shërue unë lebrozet tuj o botë, ma pastro edhe ti Shqipninë prej lebrozës së shpirtit“.

HALLELUJA E HENDEL E MBYLL SKENEN

MANJOLA BRAHAJ

MELANKONIA

-Cikël poetik-

JETSHKRIMI

Ka lindur në Tropojë më 1986. Ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, për Gjuhë shqipe dhe Letërsi.

Ka përfunduar masterin shkencor në drejtimin “Teori dhe kritikë letrare”, ka mbrojtur tezën me një studim kushtuar prozës së Anton Pashkut dhe ka doktoruar pranë po atij Fakulteti.

Shkruan dhe ka botuar artikuj dhe ese në shtypin shqiptar e atë kosovar.

Ka botuar krijimet e saj në poezi në revisten letrare të Prishtinës “Jeta e Re”, në “Mher Licht”, “Obelisk”, “Nacional”, “Poeteka”, “Illz” në Tiranë dhe “Urat” në Tropojë.

Në revistën “Kuvendi” në Miçigam, në “Orizzonti” në Itali, “Bitacora” në Meksikë dhe në “OrteSchëeizer Literaturzeitschrift” në Zvicër, në antologjinë “Las femmes (se) racontent experiences dans les PECO” në Rumani dhe në Heamus plus Nr.1, 2017, gjithashtu në Rumani.

Është autore e librit me poezi “*Vajtimi i Kalipsosë*”, me të cilin ka fituar çmimin kombëtar “Migjeni” në konkursin për “Çmimet



Kombëtare të Letërsisë” për vitin 2010.

Në dhjetor 2012 vlerësohet me çmimin e parë në konkursin mbarëshqipëtar organizuar nga “Klubi Zahiri” me poezinë “Anima”, si poezia më e mirë e publikuar në internet.

Ponë vitin 2012 vlerësohet me çmimin “Rahman Dedaj” oraganizuar nga shoqata Prokult në Podujevë, me poezinë “Largsitë”.

Në 2013 boton një cikël me poezi në “Antologji e poetëve të Malësisë së Gjakovës”, realizuar nga Klubi letrar “Gjon Kazazi” dhe Klubi i Shkrimtarëve dhe artistëve, Tropojë.

Në qershor 2014 ka botuar librin e saj të dytë me poezi “Na nuk jena t’ktuhit”.

Në korrik 2015 është vlerësuar në konkursin “Tra un fiore colto e l’altro donato” dhe botuar në revistën “Orizzonti” me poezinë “Metamorpohosis”.

Është fituese e çmimit të dytë në konkursin ndërkombëtar të zhvilluar në Itali “Terre lontane”.

Në 2015 ka marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar “Ditët e Naimit” në Tetovë, ku dhe ka botuar një cikël me poezi në antologjinë me titull “ Zërat e ujit”.

Në 2015 boton një cikël me poezi të zgjedhura në antologjinë e poezisë së të rinjëve “A dangerous method” nga shtëpia botuese, Albas, Tiranë.

Në 2016 është vlerësuar nga aktiviteti “Ora e poezisë” me çmimin vëllimi poetik më i mirë, i cili i është akorduar vëllimit “Na nuk jena t’ktuhit”

Në 2018 boton vëllimin e saj të tretë me poezi me titull “Çka nuk tregohet nuk ka ekzistue”

Ka përkthyer dhe sjellë në shqip me cikle poezisht disa autorë të botës latine, që i ka botuar kryesisht tek revista letrare “Jeta e Re” në Prishtinë. Disa prej tyre janë; Pablo Neruda, Federico Garcia Lorca, Octavio Paz, Horge L. Borges, Ernesto Sabato, Mario Melendez, Fernando Carrera, Adriana Hoyos dhe po po punon me Alejandra Pizarnik.

Poezitë e saj janë përkthyer dhe botuar në revista elektronike në internet në; anglisht, italisht, spanjisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Pritet të dalin së shpejti krijimet e saj në antologji në Itali dhe Francë. Aktualisht jeton dhe punon si mësuese e “Gjuhës shqipe dhe letërsisë” në gjimnazin e gjuhëve të huaja” Asim Vokshi” , në Tiranë.

Cikël poetik

MELANKOLIA

Ai palos për të njimijtën herë një faturë çaji.
Ajo lëviz duart poshtë trikos së leshtë.
Përreth luhet një kangë vaji,
kullon prej syve një ngjyrë ullinjsh t'lashtë,
që përfundon n'filxhanin e zi si një ndjenjë faji.

Asnjë tundim teknologjik,
telefonat prehen si kufoma thirrjesh t'humbuna,
prej kush e di ç'botësh!
prej kush e di se kujt!

Ai ngre dorën e nis drejt saj tue u dridhë,
e përfundon tue e lidhë nye për tjetrën,
ngul shikimin në tavolinën e zezë
si mungesa e shtrime mes tyne.

Ajo pëshpërit diçka,
si një thirrje e mistertë
mes ndrojtjes dhe melankolisë,
një tingull i heshtun, që mezi depërton buzët,
për t'u nisë;
jo drejt veshit,
jo drej mendjes,
drejt shpirtit.

Shikimi i ullinjte i ka humbë në t'zitë e kafes,
nuk shikon n'sytë e andrruem,
veçse shkurt,
si vétimë në një mot t'ligë,
pastaj krejt peshën e energjinë e tyne
e mbyt në një filxhan t'zi.

Ndrojtja vallzon përreth.
Ajo ka ftohtë.
Ai hurb dhe njëherë çajin e ftohun.
Një dimën i pamëshirë kalon përskej.
Ajo mendon...
Ende i rrjedh dyshimi në dej.

Ai merr xhaketën dhe ban me ikë
brenda saj pikon melankolia pikë pikë...

TUE E DITË

E zgata puthjen
 E zgata puthjen,
 derisa ta shpraza krejt frymën e qenies sime n' gojë

E zgata puthjen
 E zgata puthjen ,
 tue e ditë se mbas puthjes gjithçka do mbarojë

E zgate përqafimin
 E zgate përqafimin,
 derisa e ngule shpirtin tand n' mu

E zgate përqafimin
 E zgate përqafimin,
 tue e ditë se mbas përqafimit çdo gja ka me mbaru

LËKURA

Lëkura ime e njeh ferrin e fshehun poshtë buze
 ndonëse nuk e shqiptoi dot kurrë,
 e njeh ankthin për me qenë e jotja
 me hiret e hyjnisë së një muze.

N' mbyllje, sytë nisin andrrimin
 hapen kopshte plot lule t' kuqe,
 nuk di unë ku jam në këtë çmendinë
 etjesh t' pashkrime,
 ikjesh plot huqe.

Lëkura ime vdes n' kërkim t' puthjes
 andrimi i meket
 ngjyra i fiket
 nuk e gjen ma veten as të vetvritet.

Edhe nata e njeh zjarmin e fshehun poshtë lëkure
 që don me i djegë vitet
 me themele e mure.

ATDHEUT

Tokë e bjerrun lutjesh t' shprazta.
 Në ty kanë mbi mallkimet e gjakut t' derdhun,
 në ty po gëlojnë kryeneçësi t' liga,
 që ftyrën tande e kanë mrrolë e tjetërsue.
 Tokë e bjerrun ndjesish krejt Zotat t' paskan mallkue.

Tokë që t' kem ba me duert e tona ferr,
 androjmë arratisjen ku premtimet na jepen,
 e langun n' djerës që shpërblimin kurrë s' e merr,
 e thame n' diell t' rrejshëm ku jetët dehen.

Tokë e bjerrun zemre
 s' kishe pasë pak vend për zotsitë e një femne.

Ti që i len me t' hypë n' shpirt,
 e me shetitë n' ftyrën tande
 derra meshkuj barkmdhenj me vetura,
 që kurvat e tyne i shpërblejnë me doktoratura.

Tokë e bjerrun dashnie,
 shekujsh ke pi ujë përvujtnie.

Tokë bijsh t' flligësht t' etun për gjak e terr,
 shekujsh kangët e tua dëshmojnë veçse tmerr.
 Ngrihesh mbi mite që s' i beson as vet,
 si kryeshkamb i randë që veten kurrë s' e gjet.

Tokë e bjerrun andrrimesh t' pamujtuna me ikë,
 ngulesh dita ditës n' fatin tonë si thikë.

A KEM' ME PASË

A kem' me pasë ne përvjetorë të varun në supet e mureve,
 për me na kujtue ndonji çast që kujtesa jonë njerëzore e ka shkelë?
 Nuk dihet ku merr fund syni që asht çelë!
 As andërr e liqenit për me u vetvra!
 A kem' me pasë?

Nuk dihet kurrëgja...

Përkthimi**Charle BAUDELAIRE****LETËRKËMBIMET**

(Përktheu Vinçens MARKU)

Natyra është një tempull ku kolona të gjalla
 Lënë nganjëherë të dalin fjalë të ngatërruara;
 Njeriu aty kalon përmes pyjeve të simboleve
 Që e vështrojnë me shikime familjare.

Si jehona të gjata që së largu shkrihen
 Në një njësi të errët dhe të thellë,
 Të përhapura si nata dhe drita e diellit,
 Aromat, ngjyrat dhe tingujt përgjigjen.

Ka aroma të freskëta si mishi i fëmijës,
 Të ëmbla si oboe, të gjelbra si lëndinat,
 E të tjerat, të korruptuara, të pasura dhe ngadhënjyese,

Që kanë shtrirjen e gjërave të pafundme,
 Si rrëshira, myshku, benzoini dhe temjani,
 Të cilët këndojnë ngazëllimin e shpirtit dhe të ndjenjave.

ALBATROSI

Shpesh, për t'u zbavitur, njerëzit e ekuipazhit
 Kapin albatrosë, zogj të gjerë të detrave,
 Që ndjekin, bashkudhëtarë përtacë,
 Anijen që shket mbi hone të hidhëta.

Sapo i kanë vënë mbi kuvertë,
 Këta mbretër të kaltërsisë, të ngathët e të turpshëm,
 I lëshojnë mëshirshëm flatrat e tyre të mëdha e të bardha
 Si rrema tërhequr ngjitur me to.

Ky udhëtar me flatra, sa i plogët dhe i mefshtë është!
 Ai, dikur kaq i bukur, sa komik e i shëmtuar është tani!
 Njëri i nget sqepin me llullë,
 Tjetri e imiton, duke çaluar, të gjymtuarin që më parë fluturonte!

Poeti është i ngjashëm me këtë princ resh,
 Që nuk i ndahet stuhisë dhe qeshet me harkëtarin;
 I mërguar në tokë mes talljeve,
 Flatrat prej gjigandi e pengojnë të ecë.

SPLEEN

Kur qielli i ulët dhe i rëndë peshon si një kapak
 Mbi shpirtin që rënkon pre e mërzive të gjata,
 Dhe duke përçafuar të gjithë rrethin e horizontit,
 Na derdh një ditë të zezë më të trishtë se netët;

Kur toka kthehet në një qeli të lagësht,
 Ku Shpresa, si një lakuriq nate,
 Rreh muret me krahët e saj të ndrojtur
 Dhe përplas kokën në tavanet e kalbura;

Kur shiu, duke tendosur litarët e pafund
 Imiton hekurat e një burgu të gjerë,
 Dhe një popull memec i merimangave të fëlliqura
 Shtron rrjetat e veta thellë në trurin tonë,

Kambanat papritmas bien me tërbim
 Dhe lëshojnë drejt qiellit një ulërimë të tmerrshme,
 Si shpirtrat endacakë dhe pa atdhe
 Që fillojnë të ofshajnë me ngulmë.

E makinat e gjata të varrimit, pa tambure dhe pa muzikë,
 Parakalojnë ngadalë në shpirtin tim; Shpresa,
 E mposhtur, qanë dhe Ankthi mizor, despotik,
 Mbi kokën time të përkulur ngul flamurin e zi.

XXXIX - UNË TË DHUROJ KËTO VARGJE...

Unë të dhuroj ty këto vargje me qëllim që, nëse emri im,
Anije e ndihmuar nga një erë e fortë e veriut,
Do të ankorojë fatmirësisht në epokat e largëta
E do të bëjë të ëndërroj në një natë trutë njerëzor,

Kujtimi yt, i ngjashëm me mitet e errëta,
Do të lodh lexuesin si një timpan,
Dhe me një hallkë vëllazërore dhe mistike,
Do të qëndroj pezull tek rimat e mija krenare;

Qenie e mallkuar që, nga greminat e thella
Deri në kupë të qiellit, asgjë, përveç meje, nuk të përgjigjet!
O ti që, si një hije me gjurmën kalimtare,

Shkel me këmbë të lehtë dhe me shikim të kthjelltë
Vdekatarët e marrë që të kanë gjykuar hidhët,
Statujë me sy shkëlqimtarë sterrë të zi,
engjell i madh me ballë të bronzte!

▪Ese▪

Sami REPISHTI Ph.D*

100 VJETORI I REVOLUCIONIT BOLSHEVIK- MEDITIME TË NJI VIKTIME

Ridgefield, CT.- Më 7 nandor 2017 u mbushën plotë 100 vjet nga data kur komunistët bolshevikë, nën drejtimin e V.L. Leninit përmbysën rregjimin e Carit Nikolla II dhe filluen ndërtimin e ish-Bashkimit Sovjetik, tue ndryshue kështu fatin e botës mbarë, përfshi edhe Shqipërinë tonë.

Ky "revolucion" që shumë historianë e konsiderojnë si një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë moderne filloi më 23 shkurt 1917, me protesta popullore në rrugët e Petrogradit / Shën Petersburg ish-kryeqytet të Rusisë cariste për 200 vjet. Protestues të uritur dhe të lodhur nga lufta me Gjermaninë, kërkuan "bukë e paqe". Autokrati Car Nikolla II preferoi me dergue trupat ushtarake për paqësimin e gjendjes. Në përpjekje u vranë 40 demonstrues. Ushtria u trondit dhe filloi "mosbindjen" e autoritetit carist. Shumë ushtarakë u bashkuan me popullin. Kjo shkaktoi abdikimin e Carit Nikolla II më 2 mars 1917. Një qeveri e re civile u formue e kryesue nga Aleksandër Kerensky.

Në ndërkohë, V.I.Lenini, emigrant në Svicër, më 3 prill 1917 u kthye në Petrograd me ndihmën e shërbimeve të mshehta gjermane që llogaritshin në premtimin e Leninit se do të bante paqe të ndame me Gjermaninë. Kjo lejonte Gjermaninë me luftue vetëm kundër frontit të Perëndimit. Llogaritjet gjermane u vertetuen. Lenini nënshkroi Traktaktin e Brest-Litovskit (1917): paqe me Gjermaninë!

Me arritjen e tij në Petrograd, Lenini mori drejtimin e grupeve komuniste/bolshevike. Ai deklaroi se nuk njihete Qeverinë e Kerenski-t dhe proklamoi parullën "Paqe, bukë, tokë !" si pikënisje për revolucion.

**) Artikull i dërguar për botim nga autori, ish i burgosun politik në Shqipërinë komuniste (1946-56), dhe në Jugosllavinë komuniste (1959-60)*

Për një kohë të shkurtër Lenini fitoi përkrahjen e madhe të një popullsie të lodhur. Ky ka qenë fillimi i "revolucionit të tetorit" në Rusi.

Menjherë, komunistët filluan përgatitjen e një force ushtarake efektive, dhe natën 6-7 nëntor 1917, nën komandën e Leon D. Trotsky-t, forcat revolucionare morën në dorë ndërtesat qeveritare të kryeqytetit, dhe pushtetin e vendit. Kongresi i Dytë Panrus i Sovjetëve, i mbledhur në Petrograd, formoi qeverinë e re nën drejtimin e V.L. Leninit, e përbërë me shumicë "komisarësh politikë".

Qeveria e re me operacione ushtarake të përgjakëshme vendosi "diktaturën", (ma vonë diktatura e proletariatit) e plotë në vitin 1922, datë në të cilën u formua Bashkimi Sovjetik që mbijetoi afër 70 vjet (1990). Mbrenda pak muajve, Lenini forcoi disiplinën në rradhët e klasës punëtore; në Rusi gjendja u bë shumë e rëndë. Bashkimi Sovjetik për arsye të krizës ekonomike dhe luftës u bë skenë e shtypjeve të pamëshirëshme dhe vëjtjeve të pa kontrollueshme. Diktatura tregoi forcën e vet.

Edhe sot, Presidenti Putin deklaroi se për arsye të ndasive të mëdha në Rusi "...vendi ka nevojë për një qeveri të fortë". Fatkeqësisht, liria e demokracia e pritur nga miljonët e shtypun nuk u realizua në Rusi. Por gjatë kësaj periudhe, Bashkimi Sovjetik dëshmoi një rritje të madhe industriale, të arritur me çmim të ultë: miliona qytetarë të kombeve të ndryshme vdiqën nga shtypja dhe uria...!

Revolucioni ka qenë edhe arsyeja e shumë luftave kombëtare për çlirim në shumë vende të botës, që kanë njikohësisht shekullin njëzetë shekullin ma të përgjakshëm në historinë moderne.

Kush ishte udhëheqesi "Bolshevik" V.I. Lenini? Condoleezza Rice, profesore dhe ish Sekretare e Shtetit, spjegoi: "Kur u kthye Lenini nga emigracioni, ai shfrytëzoi situatën që solli lufta në popullsi dhe ushtri, të predikua një shkëputje të plotë me të kaluemen. Ai ishte një revolucionar deri në palc; që në fillim, ai u shpreh me një retorikë të zjarrtë dhe me një fjalor politik që këshillonte "luftën deri në ekstrem." Ajo spjegoi se "për Leninin 'modaliteti' nuk duhet të mbështetet mbi bazat e standardeve idealiste që ushqejmë; nuk duhet të bëjmë kurrë kompromis, dhe duhet të jemi përherë ekstremistë... Në mes të një shoqërie vizionarësh, Lenini përqendronte vëmendjen e tij në një objekt dominat

që zakonisht nuk është objektivi i klasave intelektuale: marrjen e pushtetit me çdo mjet”.

Ky qëndrim anti-moral dhe plotësisht i pa skrupull solli rregjimin e “hurit dhe litarit” në ish-Rusinë cariste, të vendosun nga Lenini, e të njohun eufemikisht si “diktatura e proletariatit”, dhe nuk pushoi asnjherë deri në vitet 1989-90 me ndryshimet radikale të fillueme nga reformisti Mikhail Gorbaçev... reforma që përfunduen me zhgënjimin e madh: Presidentin Putin. Shpresa për demokratizim dhe integrim në Botën e Lirë të Perëndimit nuk u realizue, dhe sot në shumë vende ish-komuniste, mbeturinat e së “keqes së madhe” vazhdojnë me helmue atmosferën e shoqënisë civile tue përfshi edhe Shqipërinë tonë!

Shprehja “revolucion” në shkencat shoqënore dhe politike përdoret me përcaktue një lëvizje të madhe, të papritun, dhe tipikisht violente- zakonisht me gjak- që përmbysë rendin ekzistues dhe strukturat e shoqatat e lidhun me këte rend, dhe formon një rendi të ri.

Sa e përgjakëshme ka qenë veprimtaria e Leninit ? Nji shembull: Në mars 1922, ai shkruente: “Ashtë pikërisht tani, dhe vetëm tani, kur në krahinat ku popullsi vdes nga uria dhe njerzit ushqehen tue ngranë mishin e njeni tjetrit (kanibalizëm) dhe qindëra, ndoshta mijëra kufuma mbushin rrugët tona, që na mundemi (dhe prandaj duhet) me zbatue konfiskimin e pasunisë së Kishës me egërsinë ma të madhe, dhe energji pa asnji mëshirë... Pikërisht në këte moment na duhet të luftojmë klerin në mënyrën ma të pamëshirshme e vendimtare, dhe të dërmojmë rezizstencën e tij, me nji brutalitet të atillë që kleri nuk duhet të harrojë në dekadat që vijnë...” Sa ma i madh të jetë numri i fetarëve reaksionarë dhe i borgjezisë reaksionare që ne do të ekzekutojmë për këtë arsye, aq ma mire për ne! (Martin Amis)

(Shenim: Arkivat kishtarë tregojnë se në vitin 1922, V.I.Lenini ekzekutoi 1.962 murgjë, 2.691 priftën, 3.441murgesha. Pse? “Besimi ashte pjesë e natyrës njerëzore, kështu që bolshevikët ishin të detyruem me e shtypë në të gjitha format e tij, dhe të gjithë denominacionet tue përfshi islamizmin e budhizmin.”(po aty). Nji tragjedi e vertetë, nji ngjarje që shkaktoi vujtje të mëdha, shkatërrim dhe degradim” (Prof. Orlando Figes)

Akti i fundit: Lenini vdiq në 1924 e la trashëgim për Stalinin nji shtet policor, funksional, që ai perdori pa mëshirë (1924-1953)

në asgjasimin e miljona qeniesh njerëzore të pafajshme. (Vetëm vdekja e J.V.Stalinit shpëtoi nga asgjasimi fizik pesë milionë jahudije në kampet e akullta siberiane të përgatituna nga Stalini) Vazhduesi i Leninit, kryekrimineli J.V.Stalin (që ka qenë dhe mbetet person i idealizuem edhe nga shumë komunistë shqiptarë!) ishte një monstër i vertetë. Kush ishte Stalini?

Historian i njohur Sebastian S. Montefiore në studimet e tia e përshkruen kështu: "Deri në vitin 1917, J.V.Stalini ka qenë një dissident carist, rrugaç, pijanec, kangëtar, dashnor që vraponte mbas vajzave, dhe një imitues i shkelqyeshëm".

Prof. Stephen Kotkin, Princeton U., spjegon: "Diktatori Stalin ka qenë një udhëheqës kontradiktor, ideolog e oportunist njëkohësisht, njeri me vullnet të hekurt dhe krijesë e sistemit sovjetik, njeri pa karakter që shpërdoroi bashkëshorten e vet deri në vetëvrasje (dhe nuk e percolli në varr!) dhe një udhëheqës që frymëzoi popullin e vet. Stalini bani atë që edhe udhëheqës të tjerë të dalluem kanë ba. Ai artikuloi dhe punoi me kambëngulje për një qellim; në rastin e tij, një shtet të fuqishëm, të mbështetur nga një shoqëni e unifikueme që çrranjosi kapitalizmin dhe ndërtoi socializmin industrial. Metodrat e tia anti-njerëzore janë asgja ma pak se një apokalips për popullsinë e vendit. Uria e madhe në fshat vrau ma shumë se shtatë milionë qytetarë rus e të tjerë, pesë milionë "kulakë" u arrestuen, deportuen, ose u ekzekutuen. Kamëngulja e tij mund të spjegohet me idenë e tij fikse të ndryshimit 'me çdo çmim' të gjendjes shopqënore dhe ekonomike në modernitet, që ai e pau si rruga e marrun nga fuqi të tjera të mëdha: prodhim masiv, konsum masiv, kulturë massive dhe politikë masive. Anglia dhe Gjermania janë dy shembujt që ai imitonte. Arrestimi i miljona anëtarëve partie, në mes të vitit 1931, tregon fatin e atyne që guxuen mos me u bindë, ose me kundërshtue "udhëheqsin", "gjuqet spektakolare" të qytetarëve të pafajshëm- ma vonë të pakësueme- shpesh mbas torturash të randa që detyruen e rrfye "anmiqt imagjinarë". Për Stalinin, terrori "përbënte një formë sundimi, një mjet i artit të qeverisjes shtetnore".

Edhe fakti që Stalini aplikoi metodat tronditëse në shtypjen e një opozite të dobët, metoda që sollën ferrin mbi tokë për bashkatdhetarët e vet, spjegohen me nxitjen e shtupjes me shpërblime byrokratike nga një system represiv formidabel, dhe

nga monopoli i pushtetit të një partie të vetme në jetën politike të vendit. "Ai merrte fuqi nga adhurimi i klasave të ulëta me imponue gjithçka nga nivelet e ndalta. Në marrëdhëniet e politikës së jashtme, sjellja e tij pa busull orientuese dhe pa parime të caktueme e paraqesin atë një oportunist me eksperiencë dhe ideolog me aftësi mendore të kufizueme". (S. Kotkin)

Si Lenini ashtu edhe Stalini kanë vuar nga paranoia e vrasjes, deportimeve, asgjatimit të popullsisë të tanë. Si përfundim ata ndertuen një regjim, shovinist dhe ekspansionist, shtet policor, sundimin e një njeriu të vetëm, kultin e individit, dhe gjetën mbështetje në terror, kampe përqëndrimi dhe në "Big Lie" (gënjeshtër e madhe)

"E meta themelore e programit marksist ka qenë përballja pikë për pikë e ideologjisë me natyrën njerëzore, - shkruente shkrimtari izraelit Martin Amis. Udhëheqsit komunistë e kuptuen këtë kontradiktë, por vendosën me lanë programin të paprekun dhe me ndryshue natyrën njerëzore. Në terma praktike ashtë ajo që na quejmë "totalitarizëm" e që do të thotë nënshtrim total të qytetarëve ndaj politikës zyrtare". Vetëm "gardianët e revolucionit" mund të ndryshojnë këtë situatë. Kjo spjegon se përse pozita e Stalinit si gjysëm- perëndi zbritet nga fronit dhe përfundon sot në një shenim negativ e pa randësi historike...!

I pyetun nëse Qeveria ruse do të festojë 100 vjetorin e Revolucionit, zadhanësi qeveritar u përgjegi: "Qeveria nuk ka një plan festimi". Gazeta e njohun "Pravda" komentoi: "Çfarë kemi këtu për festim?" Vitin e kaluem, Presidenti Putin inaguroi "Murin e Rihabilitimit" dhe në mes tjerash, ai tha: "Kjo e kalueme shumë e tmerrshme nuk duhet në asnjë mënyrë të fshihet nga kujtesa e jonë; sepse, nuk mund të justifikohet, në asnjë mënyrë e gjithë kjo që ka ngjarë". Vetëm një 'guardian i revolucionit' guxon me ndryshue historinë. Lavdi e përkohshme...!

Disidenti i madh dhe shkrimtari rus Vladimir Nabukov, në një artikull të vitit 1948, shkruente: "Nën sovjetet, që në ditët e para, e vetmja mbrojtje për desidentët ishte shpresa se kapriçet e qeverisë do ti kursejnë pa shpresë në drejtësi ose ligjë. Asnjë parti e dytë nuk u lejue përveç pushtetit komunist. Burokracia dominoi që në fillim. Opinioni publik u dërmue. Klasa intelektuale u eliminue. Çdo ndryshim që bahej ishte një dekorim i skenave të shëmtueme të një grope të thellë e të zezë ku mbretnoi shtypja dhe terrori."

Ashtë kjo shoqëni e re dhe e pa besë që u adoptue nga udhëheqja gjysëm alfabete e vendit tonë – student të falimentuem, teneqegjinjë, karrocierë, mjelse lopësh, shoferë, aventurierë pa busull morale..!

“As prindërve, as fëmijve të tyne nuk u besohet. Të gjithë të tmerruem ditë e natë, në çdo nivel tue përfshi edhe vetë Stalinin që jetonte me frikën e vrasjes çdo minut të jetës së tij” shkruen Nabukov. (Nji shembull: kur Stalini udhëtoi për Teheran (Persi, 1942) në takimin me Churchillin dhe Rooseveltin, aeroplani i tij shoqënohej nga 27 avionë luftarakë. Kur udhëtoi për Potsdam (Gjermani, 1945) truproja e tij kishte 18.500 ushtarë e policë)

Në Bashkimin Sovjetik nji popullsi e tanë ka qënë traumatizuese. Posa u hapen arkivat (mbas vitit 1990) u zbulue mënyra mospërfillëse me të cilën udhëheqësit sovjetikë, nën Stalinin firmosnin vendimet për dwnime me vdekje të qindra mijëra qytetarëve para se ata vetë të ekzekutoheshin gjithashtu, nji atmosferë e imortalizuese nga shkrintari ish- komunist Arthur Koestler në librin e tij “Errësirë në Mesditë”.

Tashti, “ ..me urdhën të presidentit Putin arkivat janë mbyllë përsëri! Nji represion emocional i fortë ashtë zhvillue me qëllim të mbulohen bremjet e ndërgjegjes për vuetjtet në Rusinë e sotme. Kjo ashtë plotësisht ajo që rregjimi Putin dëshiron dhe paraqet: nji shoqëni te tanë psikologjikisht e ndryshueshme, dhe pa dëshirë me kthye kohën kah e kaluemja e vet, me përfundim të pa evitueshëm në nji depression të hapun gjanesisht, dhe me besimin se vendi nuk ka nji të ardhme” përfundon Francis Fukuyama, (Stanford, Shqipëria me 2017) Kjo spjegon me hollësi sa larg janë në gjendje me shkue demagogët ideologë, me zhdukë ose me shtrembnue të vërtetën; me mshehë atrocitetet, vorfëninë, urinë lokale të fshatit, ekzekutimin fizik të klasës intelektuale, ndalimin “zyrtar” të ushtrimit të fesë, klerikëve e mbylljen e faltoreve, shuemjen e traditave- besë, nder, burrëni, mikpritje etj- dhe të jetës tradicionale e kulturore në qytet e fshat popullsi e terrorizuese nga frika vetem sepse kërkon liri e demokraci...!

* * * * *

Në Shqipëri ka pasë dhe ka edhe sot qytetarë të ndershëm që besojnë se “totalitarizmi” ka ngritë kokën përsëri mbas 27 vjetëve tranzicioni kaotik, tue përfshi presionin politik, mungesën e plotë të shoqënisë

civile koshiente e gjëndjes në vend dhe jashtë kontrollit qeveritar, një arsim të pa organizuem me i përgjegjë nevojave të kohës dhe që nuk shërben interesave të studentëve as edhe ekonomisë së vendit që vuen nga papunësia e madhe, korrupsioni i shfrenuem që ka kapë për fyti edhe kuadrot drejtuese, dhe veprimtari mafioze pa frikë ndëshkimi...!

Por unë dyshoj se gjendja e sotme ashtë e pa shpresë! Sepse nuk ekziston akoma në vendin tonë një ideologji "zyrtare" që mobilizon masat e gjana esenciale për një shoqëri "totalitariste"...!

Një njohës i mirë i sistemit sovjetik, dhe rregjimit të kuq në Shqipëri, analisti Dr. Janos Bugajski, në një intervistë me Zërin e Amerikës [9 nandor 2017] bani këtë deklaratë: "Përsa i përket trashëgimisë komuniste [në Shqipëri] kjo çfaqet në mes tjerash tek gjëra të këtilla si varësia tek Shteti për punësim dhe për ndihmë, tek një farë tolerance ndaj shtypjes shtetnore, tek vazhdimi i lidhjeve dhe interesave speciale që vazhdojnë qysh nga koha e komunizmit dhe tek përfshirja e pamjaftueshme e publikut në aktivitetet shoqënore; publiku akoma nuk e sheh veten si subjekt por si objekt politik, dhe kjo duhet ndryshe. Megjithatë as që mund të bahen krahasime me të kaluemen komuniste. Absolutisht duhet një rehabilitim moral-sepse ish përndjeksit komunistë shetisin lirisht në rrugët e Tiranës. Mendoj se duhet të ketë ma shumë vëmendje nga media dhe nga sistemi arsimor, më shumë informim publik rreth atyne që vuajtën nen komunizëm"

Dr. Bugajski quen viktimët e komunizmit "heroj" dhe kundërshtimin e tyne "heroizëm" i treguem nga këta përsona gjatë periudhës së shtypjes...!

Në një intervistë të njikohëshme për Zërin e Amerikës, e dha edhe Zonja Gentiana Sula, drejtoreshë e Autoritetit të Informimit mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit. Ajo mendon se "moshapja e arkivave u ka mohue njerëzve të drejtën për të njohë të vërtetën sepse shumë plagë të së kaluarës ende janë të pambyllura"

Në Shqipëri, vendi në disa raste e gjen veten në një kontradiktë me brezat e rij (të painformuem), një pjesë ka nostalgji; të tjerë që ende nuk janë shkëputur dot nga mentaliteti i së kaluarës.-Shqipëria vlerësohet nga të huajtë ekspertë se nuk e ka përfunduar periudhën e tranzicionit nga diktatura në demokraci"

Unë do të shtojshë:"nga skllavëria komuniste në një jetë të lirë; nga frika e ushqyeme, në guxim me farkëtue fatin me duart e veta".

Le të zbulohen të gjitha krimet e kryeme kundër qytetarëve shqiptarë, le të demaskohen të gjithë kriminelët, dhe të gjinden të gjitha vendet ku janë krye këto krime të pabesueshme dhe makabre të regjimit komunist në Shqipëri; le të zbulohen të gjitha varret individuale e varrezat kolektive dhe të bahen ata vende pelegrinazhi, "vende të shenjta" për adhurim nga të gjithë-veçanërisht për nxanësit e shkollave tona; le të kthehen ata në objekte frymëzimi dhe subjekte meditimi të thellë. Sepse vetëm, një ndërgjegjsimi plotëi së kaluemes sonë tepër tragjike, do të pengojë përsëritjen e saj.

Nga vorret e harrueme, viktimat akoma të shqetësuese, kerkojnë me za të naltë: Vllazën, motra! Mos na harroni! Mos harroni mesazhin tone: kurrë ma diktaturë në Shqipëri, kurrë ma ideologji të hueja në Shqipëri, kurrë ma "gënjeshtat e mëdha" në Shqipëri.....!

Skender DRINI (1935-2014)

REKUJEM PER KARLO LJARJEN

Eshtë e çuditëshme që persona të fshehur në një harresë dekadash të shpërthejnë me një fuqi shkatërruese kur nuk e pret. Po fliste Rikardi te *E djela shqiptare*. Po fliste me atë shkodranishten e tij “të tmerrëshme” që vetëm atij i shkon. Të mos provojë askush të flasi si ai, se dështon. Nuk e shihja nga vendi ku isha dhe dëgjoja vetëm zërin. Po nuk ishte nevoja ta shihja, sepse askënd nuk mund ta materializojë zëri, siç materializon zëri, Rikardin. Tundimi për ta dëgjuar ishte i madh, por kujtimi i befasishem i të jatit ishte edhe më i madh dhe unë u mora me të jatit.

Ai dikur nuk ishte më shumë se një mësues. Po, a mund ta kuptojmë çfarë ishte kjo fjalë në gjenezën e vet? Nuk besoj se mund ta gjeje këtë fjalë në një fjalor të gjuhës. Mund ta gjeje vetëm në një fjalor teologjik në barazpeshë me fjalën shënjtore. Kështu që nga Sokrati, Savanarola, Pestaloci dhe deri te Dhaskal Todri. Në gjenezë të vet kjo fjalë ishte një ideal por që erdhi deri te profesioni nën peshën dërmuese të kohërave. Sot nuk mund ta di se çfarë është bërë, nuk mund ta di nëse mund ta pranonte një fjalor teologjik...

Karlo Ljarja ishte një mësues bukurshkrimi i dalë nga shkollat gjermane, por grafika e tij nuk ishte baroku i rëndë gotik, nuk ishte “pedantizmi” i habzburgëve, nuk ishte as spitullimi i kopistëve francezë të Mesjetës. Ishte një filozofi e thjeshtë, që përmbledh në pak fjalë: “Nje ovale, një vijë e drejte”. Kjo ishte motoja vitale e Karlo Ljarjes dhe nuk do të çuditësha aspak nëse ajo vinte përpara kohrave të Gutenbergut. Vinte nga ato kohra, kur në mes të shkronjësve të parë që shtyheshin me njëri tjetrin kush të argëtonte më shumë princat me një kaligrafi arabeskash, kishte dhe të atillë që mendonin thjeshtë për “një ovale, një vijë të drejte” për kaligrafinë që i duhej diturisë.

Eshtë e tepërt të thuhet që shkruante nga e majta në të djathtë. Nuk mund të niste nga krahu tjetër, jo vetëm se e pengonte formimi i tij, por kryesisht se e pengonte Kongresi i Manastirit. Po të kishte fituar atje orientimi oriental Karlo Ljarja do të ishte gjetur shumë ngusht, se te gjuhët arabe dominojnë ovalet, por jo vija e drejtë. Në atë kohë

përflitej shumë alfabeti i Dhimitër Kamardës, që nuk e kam shumë të qartë nëse ishte një krijim, apo një pershtatje e alfabetit grek. Mos ishte një filo grek Kamarda ? Aspak ! Po, pse atëhere ? Pergjigjen nuk mund ta gjeja në bankat e shkollës, por besoj se e gjeta shumë më vonë, kur u njoha me përpjekjen e jashtzakonëshme të Greqisë, për të mos lejuar që shqiptarët të kishin alfabetin e Kamardës. Kjo dukej absurde dhe pa sens në vështrim të parë, dukej si një goditje kundrejt vetvetes, sepse vende të zhvilluara aplikonin politikat e një "neokolonizimi" kulturor, përmes organizmave të mëdha anglo-saksone dhe frankofone. Grekët ishin kundër alfabetit të Kamardës, sepse ai herët a vonë do ti nxirte pellazgët inspirues të helenëve, ishin kundër Kamardës, sepse druheshin që shqiptarët do të mund të lexonin një ditë Homerin në gjuhën shqipe. Ata që vendosen për alfabetin latin duhen nderuar po aq sa ata që firmosën pavarësinë në Vlorë, sepse vunë gurin e themelit të aspiratës evropiane të shqiptarve.

Shkumësi ishte i keq, i mbetej në dorë, e linte në baltë në pjesën më delikate të shkrimit. Gëlqere.-pëshpëriste- ai dhe këtë fjalë nuk e mbaj mend nëse e thoshte në latinisht, apo italisht. E shtërngonte mes nofullave zemërimin nga shkumësi i keq për pak çaste, pastaj nxirte nga xhepi një tjetër që dukej nga mbështjellja e fundit të tij, që vinte nga një civilizim i panjohur për ne. Qarkullonte me humor te ndokush, që ai porosiste ata që dilnin jashtë shtetit t'i sillnin shkumës, por ky ishte një humor për të vrarë veten, pasi nuk ke asnjë shans të argëtohesh me pasionantin e çmendur pas punës së tij. Bukurshkrimi ishte një lëndë që trajtohej me buzqeshje nga Ministria e Arsimit dhe deri te disa prej nesh, por si mund të buzëqeshje kur ai të tregonte një fletore të shkatërruar dhe krejt të verdhe, një fletore të një nënpunësi, apo nxënësi të vitit 1912, kur shqipja sa kishte nisur te shkruhej ? Ajo fletore të bënte të thërrisje drejt qiellit: "O Kozmos sa jemi prishur!" Ajo fletore i shkaktoj andralla Karlo Ljarjes. Nuk mund të sillte shëmbuj nga e kaluara. Për fat fletorja kishte datë dhe ajo e kaluar ishte e Ismail Qemalit. Drejtori nuk mund të hahej më të dhe çështja u mbyll.

E pyesnim, por ai nuk besonte shumë te grafologjia. Nuk përjashtonte që ekstremet mund të njiheshin, një njeri i qetë nga një kolerik, por nuk përjashtonte as teprimet dhe spekulimet. Në shkrimin e hershëm të Hitlerit, përpara se ai të vinte në fuqi, nuk shfaqet ndonjë temperament patologjik. Çfarë mund të thosha unë nese

do të kisha në dore një shkrim të Karlo Ljarjes? Paqësor, i matur, i arsyeshëm, i qetë, i qetë deri te qetësia e akullit. Edhe trashigimtarët e tij kështu duhet të ishin. Këtu do të gaboja po të kisha parasysh talentin dhe karakterin impulsivo-eksapansiv të Rikardit. Po, pse po merrem kaq shumë me bukurshkrimin e Karlo Ljarjes, kur ai ishte një mësues i përsosur i gjermanishtes dhe kishte edhe plot kualitete të tjera të spikatura? Sepse për to është folur, por nuk është folur për bukurshkrimin, për romantikën e tij.

Pas shkollës së mesme vjen një pauzë e gjatë, tepër e gjatë deri sa gjëndet në bibliotekën e qytetit. Tani më është një pensionist, që po merret me antikuarin dhe që nuk ka hequr dorë për asnjë çast nga ato mbikrahurat e zeza, që i mbulojnë mëngët njëlloj si ata nëpunësit provincial të Turgenjevit. Vjen aty i pastër, i hekurosur dhe i kërpitur si një manekin vitrinash dhe largohet në drekë sikur të kishte dalë nga ndonjë kaldaje. Aty ka shumë pluhur, shumë lagështi dhe merimanga, por kjo nuk e shqetëson. Çfarë është ai libër i vjetër, që e mban ai në duar me aq shenjtëri? Një bibël? Ai ngrinte sytë dhe më vështronte thelle, sikur të më thoshte që mbante në duar autorin, mbante në duar një njeri. Në atë çast nuk kishte rrugë tjetër, veçse të bindeshe për metampsikozën, për shndërrimin e autorit në shkronja. Biblioteka ishte e frikëshme. Aty brenda ulurinin qindra mijra shpirtra, por ulurimat e tyre nuk mund t'i dëgjonin të zakonshmit. Ato trembnin vetëm njerëzit e ditur. Ato nuk mund të trembnin as drejtorin e bibliotekës, një fanatik të Partisë. Ai nuk ishte shumë i kënaqur nga Karloja, jo vetëm se e kishte quajtur ditën e parë "zoti drejtor" në vend të "shoku drejtor", por edhe pse i dukej që nuk kishte shumë rendiment. Si i shfletonte aq ngadalë ato fletët e librave sikur të ishin fletët e teserës së Partisë?

Karlo Ljarja e mori vesh se çfarë po shkruaja. Po, si mund të shkruhej për rrethimin e Shkodrës, pa ditur se çfarë ka thënë Hortensa? Foli me aq intimitet, sikur kjo Hortensa të ishte ndonjë kushurirë e tij dhe jo e shoqja e konsullit austro-hungarez në Shkodër, Xambauer. Çfarë kishte thënë Hortensa ai ma tregoi duke më vënë përpara një liber të tërë që e kishte përkthyer nga gjermanishtja pa ia kërkuar unë. Nuk mund t'ia harroj kurrë!

Ky shkrim nuk është një nderim vetëm për Karlo Ljarjen, por për gjithë brezin e tij, që kemi fare pak shanse ta ndjekim pas.

▪Reçensione▪

Gëzim PUKA

“PROBLEME, AUTORË DHE VEPRA NGA LETËRSIA SHQIPE BASHKËKOHORE”

- Studimi i A. Prendit si ndërmjetësim midis historianit dhe kritikut të letërsisë dhe “Fjalorin e rimave” i V. Markut dy botime me vlerë për kulturën tonë letrare.

Prof.as. dr. Arben Prendi është tashmë një studiues i formuar që vjen me këtë libër studimor pas një përvoje të gjatë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor.* Pas përmbledhjes me studime letrare “Tekste në kontekste” (2011), monografisë: “Letërsi shqipe bashkëkohore - Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realiteteve metafizike në romanin bashkëkohor” (2015) vjen me vëllimin studimor: “Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore” që është i konceptuar në tri ndarje që lidhen më letërsinë shqipe bashkëkohore, me letërsinë romantike e moderne, si edhe me folklorin e letërsinë gojore shqiptare. Janë bërë objekt i analizës disa autorë të letërsisë bashkëkohore shqiptare, si: Ismail Kadare, Martin Camaj, Dritëro Agolli, Ali Podrimja, Adem Demaçi, Ridvan Dibra, Virion Graci, Ben Blushi, Mira Meksi etj. Nga letërsia romantike dhe moderne janë përfshirë disa artikuj për Jeronim de Radën, Faik Konicën dhe Justin Rrotën.

Ky ndërmjetësim i studiuesit Prendi në procesin e komunikimit të veprave letrare me lexuesin është një veprim kompleks dhe përfshin elemente të ndryshme, që nga paraqitja e zakonshme e shënimeve elementare e deri te hapja e çështjeve që lidhen me aspekte të ndryshme të vlerave letrare të cilat shpesh, të paktën nga lexuesi i zakonshëm, mund të kapen me vështirësi. I tillë është artikulli që trajton disa çështje të hapura mbi letërsinë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX. Autori arrin të depërtojë në shtresat e vlerave artistike të veprave të kësaj periudhe dhe i bën

*) Kumtesë e mbajtur në promovimin e botimeve të Departamenti të Letërsisë: “Studime letrare 2016-2017” më datë 13.12.2017.

të mundur lexuesve ta kenë të hapur një variant të leximit, një variant nga me të mundshmit. Në këtë punë studiuesi ndihmohet nga mjete të ndryshme, nga dija teorike e historike letrare.

Kur merremi me gjykimin e së kaluarës, ne nuk mund të mos jemi njerëz të së sotmes, ne nuk mund të harrojmë ato shoqërizime që gjatë leximit të një vepre, na zgjon konteksti kulturor i kohës së sotme, vlerësimet e sotme, përvoja e fituar që nga dalja e veprës që studiohet, ndikimi dhe kuptimi i tyre. Në ndihmë të kësaj ideje do të citoja nga ky libër: *“Çështja e rishikimit të letërsisë së realizmit socialist mbetet ende e hapur. Nga pozita e sotme e vlerësimit dhe e gjykimin të kësaj periudhe mbetet detyra e rishikimit në kompleksitetin e saj, duke veçuar çka i përket realizmit socialist dhe çka ndonjë modeli tjetër, si: Modeli realist, modern apo tjetër fare.”*^{*)}

Nga pozitat e sotme të vlerësimit, vazhdon të mbetet detyra e integritetit të autorëve të ndaluar, apo edhe veprave të ndaluara të autorëve *“të lejuar”*. Shembulli më domethënës i këtij integriteti është vepra letrare e Martin Camajt, por edhe e Kasëm Trebeshinës, Bilal Xhaferrit, Arshi Pipës dhe Zef Zorbës etj., autorë për të cilët tashmë kemi artikuj studimorë, punime doktoraturash, monografi etj.

Si pasojë nga kjo periudhë vijojmë të kemi gjendje komplekse: a) letërsinë e botuar nga autorë të pranuar nga sistemi, por që ka vlera të dyshimta estetike: letërsia e realizmit socialist; b) letërsinë e botuar nga autorë të pranuar nga sistemi, por me vlera të mirëfillta estetike; c) letërsinë e pabotuar nga autorë të pranuar dhe të përjashtuar, e cila ka vlera të mirëfillta estetike, por ka mbetur pjesërisht e paintegruar”.^{**)}

Është karakteristikë në analizat e Arben Prendit përpjekja për të qenë sa më shumë shterues. Interpretimeve të tij nuk i shpëton dot prerja vertikale në thellësi qoftë në anën tematike, qoftë në anën stilistike të veprës. Duke qenë një njohës i mirë i poetikës së poezisë dhe të prozës, ai i përdor mjaft mirë instrumentet teorike në vëzhgimin e dukurive letrare. Analizat objektive shpesh ndërthuren edhe më qëndrime të caktuara emocionale ndaj veprave, duke e bërë më të ndjeshëm shkrimin e këtij autori. Studiuesi dhe kritiku ndërthuren bukur në metatekstin e tij, që ka ambicien dhe seriozitetin e institucionit në qasjen ndaj veprës

*) Prendi, Arben: *Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore, Shtëpia botuese “Fiorentia”, Shkodër, 2017, f. 16*

***) Prendi, Arben: *Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore, Shtëpia botuese “Fiorentia”, Shkodër, 2017, f. 19*

letrare, e cila së bashku më autorin, lexuesin, referentin dhe repertorin e gjerë të teksteve përbëjnë atë që quhet sistem letrar. Duke e lidhur me ndjeshmërinë kritike të Prendit do të citoja një interpretim shumë interesant të një poezie të Martin Camajt: *“Poezia ‘Fill i gjetun’ merr shkas nga një ngjarje konkrete dhe banale, ikja e rrymës elektrike në një qytet, për të përfunduar në një dukuri abstrakte, emocionale me vlera përgjithësuese filozofike: ‘Natën që shkoi u fikën dritat e mbeti/ qyteti në terr deri n’agim’.* Thjeshtësisë dhe komunikativitetit të tre distikëve të parë ua zënë vendin abstraksioni, polisemia e teksit të katër vargjeve të fundit: *‘Në nadje vrejta rrethin e andrrave/ në truell/ e gjeta fillin e tretun/ në pikën e ndaljes së dritës’.* Momenti i zhytjes në terr, fikja e dritave elektrike, është moment për të medituar për qytetërimin e llambës me vajguri, për qytetërimin e elektricitetit dhe mënyrat e jetesës të lidhura me to. Ky moment bën lidhjen e fillit të tretur ndërmejt dy qytetërimeve, ndërmjet dy botëve, mes fshatit të vendlindjes dhe qytetit modern të botës së huaj, pjesë e të cilit është bërë poeti. Drita natyrore e diellit që ndriçon qytetit në mëngjes, e ndihmon poetin të gjejë *‘fillin e tretun në pikën e ndaljes së dritës’.*”^{*)}

Lëmi i tij i studimit në folklor dhe në letërsi shqipe i ka dhënë një profil interesant përsa i përket risive dhe analizave të thukëta interpretative e kritike. Vetë fakti që ai i qaset shpesh në studimet e tij letërsisë bashkëkohore, autorëve të qendrës dhe të periferisë së sistemit tonë letrar, tregon ndjeshmërinë e lartë të këtij autori ndaj prodhimit *“të freskët”* letrar, që është baza e një sistemi letrar të qëndrueshëm. Përmes këtij libri, A. Prendi synon një ndërmjetësim midis letërsisë dhe lexuesit, ndaj ai shfaqet edhe si kritik, roli i të cilit në ndërmjetësimin midis veprës letrare e lexuesit merr kuptim dhe vazhdon të funksionojë edhe sot.

Duke trajtuar pjesë të krajmëtarisë së shkrimtarit Ismail Kadare autori ndër të tjera sintetizon: *“Karakteristikë e veprës romaneske të Kadaresë është në tërësi intertekstualiteti, tipar karakteristik si për letërsinë moderniste ashtu edhe për atë jomoderniste. Intertekstualitet ndërmejt poezisë dhe prozës; ndërmjet romaneve të këtij autori dhe veprave letrare të shkrimtarëve të tjerë; me tekste të tjera letrare dhe joletrare, si: krijimet gojore, këngë lirike, epike, balada, epos, përralla, mite, kanune zakonore, kronika, dokumente historike etj.[...] Vepra letrare e Kadaresë është një kundërvënie estetike ndaj letërsisë dhe*

*) Prendi, Arben: *Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore, Shtëpia botuese ‘Fiorentina’, Shkodër, 2017, f. 49*

porosive politike të regjimit komunist.”)*

Me të njëjtin interes në artikujt e këtij studimi Prendi i qaset çdo teksti letrar që ekziston tani i gatshëm për t’u gjykuar nga bashkëkohësit qoftë i shkruar dje, qoftë i shkruar shumë kohë më parë. Duke interpretuar një ndër romanet më të fundit të shkrimtarit Ridvan Dibra “Gjumi mbi borë” Prendi shkruan: “Gjumi na del si një gjendje pranimi e kompromisi: “Gjumi nis e merr tiparet e një pushtimi, një pushtimi të bardhë e paqësor”. Bora mund të përkthehet si: kurth, grackë në cilën rrethet trupi, por edhe mendja e lodhur; nënkupto mejdisi mashtrues e joshës, mjedisi kompromentues të cilit i dorëzohemi jo rrallë për arsye e rrethanë të ndryshme. Gjumi mbi borë përveç atij të vërtetit, është edhe rënia në dëshpërim, në monotoni, dembelizëm, por edhe rënia në kompromis dhe në ideologjizëm në një mjedis tërësisht ideologjik. Personazhi kryesor e përballon gjumin duke rrëfyer dhe duke lexuar, duke shpëtuar edhe nga gjumi, por edhe nga “kalbja”, pra nga degradimi”.**)

Si një studiues dhe kritik estetik Arben Prendi na shpreh bindjen gjithnjë e më të madhe që vepra letrare duhet vështruar, në të vërtetë, me të gjitha rrethanat e rëndësishme dhe të domosdoshme, por para së gjithash në autonominë e saj relative.

Studimi dhe kritika e tij estetike bashkëkohore thekson nevojën që vepra artistike sa më shumë të çlirohet nga varësia e të tjerave, nga synimet jashtëartistike dhe antiartistike.

Ky studim i vlefshëm dhe ndërmjetësues i Arben Prendit konfirmon faktin e pohuar prej kohësh tek “Teoria e Letërsisë”: “Historiani i letërsisë duhet të jetë kritik, qoftë edhe për të mbetur historian”.***)

Duke përfunduar dua t’i them dy fjalë edhe për kontributin e vyer të prof. as. dr. Vinçens Markut me “Fjalorin e rimave”, i cili besoj se është një vlerë e madhe për kulturën tonë letrare. Siç e thekson edhe autori në parathënien e tij “...ai është një mjet pune i paanashkalueshëm për shumë njerëz që merren me punën e

*) Prendi, Arben: *Probleme, autore dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore, Shtëpia botuese “Fiorentia”, Shkodër, 2017, f. 103*

**) * Prendi, Arben: *Probleme, autore dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore, Shtëpia botuese “Fiorentia”, Shkodër, 2017, f. 170*

***) * Wellek, Rene; Worren, Austin: *Teoria e letërsisë. Botime “Onufri”, Tiranë, 2007, f. 44.*

letrave”.)

Hartimi i këtij fjalori është bërë sipas një aparati të mirëfilltë shkencor dhe kritere të qarta. Në të janë përfshirë 3065 zëra kryesorë, 4000 zëra të referencës së kryqëzuar, mbi 40 000 mijë fjalë rimuese, etj. E gjithë kjo punë flet për përvujtni shkencore, por edhe për një ambicie për të qenë në koherencë me punët e tilla të shkollave të ndryshme filologjike evropinane e më gjerë. Autori ka ofruar me këtë vepër mundësinë e përzgjedhjes dhe të kombinimit të fjalëve në frazën poetike. Ky fjalor dëshmon në një profil tjetër shprehësinë e madhe poetike që ka shqipja si një gjuhë e ëmbël dhe e gjerë.

*) * Marku, Vinçens: Falori i rimave, Shtëpia botuese “Fiorentia”, Shkodër, 2016, f. 5.

Njazi KAZAZI

“PERASHI- KRENARIA E KUJTESËS”, FOTO- ALBUM NGA BRAHIM MILOTI

Hyrje.


Para pak kohësh doli nga shtypi albumi “PERASHI- KRENARIA E KUJTESËS” Foto -album nga z. BRAHIM MILOTI, mësues e gjuhës shqipe dhe i letërsisë në shkolla të ndryshme të rrethit, botimet “Camaj-Pipa” dhe i Bibliotekës “Shkodra”, me rreth 247 faqe dhe format i madh.

Redaktor: Arjan Frashëri, shtypur në shtypshkronjën “Ilar”.

Pak fjalë për autorin.

Z. Brahim Miloti, mësues i gjuhës dhe i letërsisë së bukur shqipe dhe i historisë, i lindur në Shkodër më 04. 07. 1928. Mësuesi, që tashti e përshëndesin: “Gjyshi i lagjes Perash” ka mbaruar studimet në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, ka ushtuar pa ndërprerje detyrën e bukur të edukatorit dhe mësuesit për 36 vjet. Për 15 vjet k punuar në fshatrat e Malësisë së Madhe, në fshatrat e afërta me qytetin, si në Dobraq, Golem, Grudë, Shtoj i Ri dhe i Vjetër dhe Vrakë.

Në fshatrat Barbullush, Vrakë dhe Juban ka drejtuar shkollat 7-vjeçare. Më pas është transferuar në qytetin e Shkodrës ku ka punuar në shkollat e mesme “Jordan Misja”, “28 Nëntori”, “Xheladin Fishta” nga ku doli në pension. Për punë të mirë është



dalluar dhe vlerësuar herë pas here. Me vendim të Kuvendit Popullor është dekoruar me “Urdhrin e Punës së Klasit të Tretë”. Shembull qytetarie i “Shkodër Loces”, djepit të kulturës, që duhet të respektohet brez pas brezi...

Mësuesit në Album.

Në albumin “PERASHI- KRENARIA E KUJTESËS” secili që e merr në dorë shikon si janë pasqyruar miqtë e tij të punës, sepse edhe unë nuk pak vite në arsim (kam mbaruar më 1966 shkollën e mesme pedagogjike “Shejnaze Juka” dhe vazhdoj sot në Universitetin e Shkodrës “L. Gurakuqi”).

Në faqet e Albumit gjejmë pasqyrim duke filluar me Daut Boriçin (1825-1896) i cili në fundin e viteve 1860, harton abetaret e para. Studiuesit flasin për tre abetare: 1. *Abetare shqip litografuar në Stamboll më 1861 (ribotuar më 1869)*; 2. *Abetare shqip e ndryshme prej së parës , dorëshkrim*; 3. *Abetare shqip, ndryshe prej tre të parave*. Abetarja e parë e D. Boriçit është një abetare shqip-turqisht, me shkronja arabe turke dhe krijime origjinale të autorit, prej 32 faqesh, e hartuar sipas metodës sintetike. Alfabeti i saj ka 37 shkronja, nga të cilat 28 janë të alfabetit arab, 2 janë marrë nga osmanishtja dhe 7 i ka krijuar vetë. Në faqet e saj lexojmë: “*Xen me shkru shqip...*” (fq. 32 të Abetares). *) dhe i vlerëson këto punime të dobishme për gjuhën shqipe.

Në të njëjtën faqe është dhe “Mësuesi i Popullit”, Hamdi Bushati me veprat kryesore të tij “Shkodra dhe motet” në dy vëllime, që është një vepër enciklopedike që tregon më së miri madhësinë e qytetit të Shkodrës, vlerat e tij historike e kulturore, figurat e tij të ndritura **) në vitin 1998, ndërsa në vitin 2003 botohet vepra tjetër historike “Bushatlinjtë” .

Në vazhdim paraqet dy gjuhëtare të shqipes: Faik Lulin “Doctor Honoris Causa” dhe “Mësues i Popullit” autor i dhjetëra librave, veçanërisht “Metodika e gjuhës shqipe” dhe e letërsisë (disa botime) dhe i librave me bashkautorësi të Islam Dizdarit, në fushën besimit Islam, etj. dhe Akademik, Prof. dr. Bahri Becin, të UT, autor i shumë librave të gjuhës shqipe.***)

Gjatë faqeve të Albumit njihemi me arsimtarë dhe punonjës të

*) Shefik Osmani-Njazi Kazazi, “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historike-pedagogjike”, Botim i MASH, Shtëpisë botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, fq. 120.

**) Brahim Miloti: “Perashi- Krenaria e kujtesës”, Botimet “Camaj-Pipa” dhe “Shkodra”, fq. 19.

***) Po aty, fq. 20.

arsimit, inspektorë dhe drejtues të shkollave, si; Rexhep Dibra, Sadik Miloti, Shuajp Damnori, Rexhep Bërdica, Isuf Çoba (ish- mësuesi i bio-kimisë në shkollën pedagogjike "Sh. Juka", Prof. Abdullah Miloti (ish-mësues i psikologjisë e pedagogjisë në po atë shkollë), Nexhmi Bushati, Zydi Vasija, Sheuki Rroji, Asim Boriçi (ish-mësues i im në Pjertoshan, ne vitin 1956), Suzana Visija (Drejtoreshë e shkollës "Ali Laçej"), Haki Vasija, Agime Ramadani, Isak Ramadani, Vahid Ramadani, Ferit Hafizi, Enver Zylja, Enver Draçini, (mësues në shkollën pedagogjike "Sh. Juka"), Vera Hoti etj.

Gjatë Albumit jepen shumë fotografi me nxënësit dhe mësues të viteve shkollore, kjo është pasuri me vlerë për ato që do të vazhdojnë...

Një vend të veçantë zënë hoxhallarët e kësaj zone: Haxhi Hafiz Isuf, Haxhi Hafiz Halit Bushati, Haxhi Shefqet Efendi Boriçi, Hafiz Myrteza Zylja, Hafiz Maliq Zaja (Tari), Hafiz Xeudet Zylja, Hafiz Shaban Zaganjori, Hafiz Qazim Kadija etj. që dhanë njohuritë dhe shpirtin e tyre për edukimin e popullit të zonave ku ushtruan detyrat e tyre. Shumë prej tyre përmenden edhe sot në derset e hoxhallarëve të rinj dhe për shembuj të atdhetarizmit dhe besimit në një Zot.

Në foto të tjera jepen edhe Xhamitë e Lagjes Perash: Xhamia e Kuqe dhe Xhamia e Bardhë.

Në faqet në vazhim vazhdojnë mjekët: Dr. Ferit Hoti, Eqerem Bërdica, Sabri Bekteshi, Abdullah Bilali, Surri Bushati, Ali Zeneli, Sytkri Bushati, Qeramudin Dibra, Fiqiret Bushati, Zyhdi Çoba etj. dhe infermierët duke caktuar proceset e ngushta të punës së tyre.

Vend të veçantë në Albumin e z. Brahim Milotit zë edhe botimi i poezisë së "Kupe Danja", në originalin e shkruar nga Sadik Miloti të cilën e ka ruajtur për 50 vite më radhë, Z Lutfi Bërdica që në poezinë lexojmë: "Katillekin s'e kam dashtë/ Por kismet kështu paska kenë/ Mbasi erzin e kam bashkë/ Si myslimanë ashtu edhe të kshtenë/, në komentin që bën autori: "Kjo poezi në përmbajtjen e saj nuk ka nevojë për koment. Vllëzër të një gjaku. Nder e kombi kemi bashkë".*)

Dy fjalë si mbyllje:

Në mbyllje të shfletimit të këtij Albumi i uroj autorit jetë të gjatë dhe suksese në punën e tij arkivore. Nuk po ndalem më gjatë në tekstin prej 247 faqesh, me urimin që ju ta gjeni dhe ta shfletoni vetë për t'u njohur më nga afër me vlerat e tij...

*) Po aty, fq. 158.

▪Arkiv▪

Gjon KAMSI (1894-1992)**BANKA DHE MONEDHA SHQIPTARE 1913 – 1944^{*)}**

Në Shqipëri, para shpalljes së mvehtësisë dhe mbrapa, deri vonë, nuk ka pasë një sistem monetar të vetëm, por ka pasë, në qarkullim monedha të trashigueme prej qeverive të ndryshme që sunduen gjatë Vendin, si Turkija, apo sundimesh të shkurta, në vise të ndryshme të Vendit, si Mali-i-Zi, Serbija e Greqija, gjatë Luftës Ballkanike; Italia, Austro-Hungaria dhe Franca, gjatë Luftës së parë Botnore.

Kohën e sundimit të Turkisë, lira turke, mexhidia, çereku dhe paret e vogla, si groshi, meteliku, dyparëshi, kishin një qarkullim në tregun e vogël të mbrendshëm, për pagesa në arkët shtatnore dhe në marrëdhënie me tregjet e ndryshme të Perandoris turke. Ndërsa korona austro-hungare ishte monedhë llogarije në tregtinë me Jashtë.

Korona ka pasë hy në Vend, qysh në kohën më të hershme, kur Austria zavendsoi Venedikun në sundimin e bregut të Adriatikut, dhe në tregtinë e tij me Lindjen, tue pasë për qendër të tregtisë së saj me Jashtë, qytetin detar të Triestës, nëpër të cilin zhvillohej e gjithë tregtia me Shkodër, qendër e vilajetit të njëmni dhe të njëj tregtije, qi kishte përhapje deri në Shkup e Monastir, ekonomija e të cilave krahina, para se t'u hapte Selaniku tregtisë së tyre, u varte prej Shkodrës.

Vilajeti i Janinës, edhe ky, nëpërmjet të Prevezës, skele qi e lidhte me Triestën, zhvillote të gjithë tregtinë në korona austro-hungare.

Me zhdukjen e sundimit të Turkisë në Shqipëri, u zhdukën me të, nga tregu shqiptar: lira turke, mexhidia, çereku dhe zuni vendin e tyre korona austro-hungare, e pakundërshtueshme në tregun e Shkodrës, qi ishte një "emporium" për të gjithë tregun e Shqipërisë së Epërme e të Mesme.

Ishte koha e artë e napolonit me gjel, në qarkullim në Vendin tonë. Shqipëria, si çdo vend tjetër, përfaqësohet politikisht nga flamuri kombtar. E tillë është edhe për ekonominë monedha kombtare në vlerë e përfytyrime. Kështu me shpalljen e mvehtësisë së Shqipërisë, u mëndue nga Qeverija e Përkohshme e Vlonës, për krijimin edhe

*) Në këtë rubrikë vijojmë me botue materiale ne dorëshkrim ose daktilografim të pabotueme ma parë.

të monedhës së saj. Dhe, për arsye të rrethit të shkëmbimeve me Jashtë, i përcaktuem në rrethin gjeopolitik të Mesdheut, sistemi monetar i saj duhej t' ishte ai latin. E për arsye politike, mbizotnuese në politikën e krijimit të Shqipnis mëvehte, atësija e themelimit t'institucionit bankar u muer mbi vete nga Austrija e Italijs, të cilat me ânën e dý instituteve të veta të mëdhá bankare: *ËIENER BANK VEREIN* e Vjenës dhe *BANCA COMMERCIALE ITALIANA* e Milanit, do të themelojshin Bankën e Shqipnis, mbështetje e zhvillimit t'ekonomís së saj dhe të veprimeve thesari.

* * *

Nji shikim i së kaluemes mbi përfitimn e Bankave të qitjes (emisionit) të Ballkanit, na tregon se të gjitha ato banka kanë pasë nji pikë krijimi të përbashkët: në kryegjána (kapitale), në organizimin e në drejtimin, të cilët kanë kenë të gjithë të huej.

BANKA KOMBTARE E GREQÍS (Ethniki Trapeza tis Elladhos).

Në Greqí, për me e nisë nga mâ e vjetra, nën regjencën e Kontit Kapodistria, në vjetin 1829, u themelue nën êmnin "Banka Kombtare Financiare", e para ngrehín qitjeje, me ndihmën e Ludovikut të Bavjerës, të bankjerit Eynard, qi aq pjesë të madhe pat në lirín e Greqís, dhe të tjerë filohelenë. Por kje jetëshkurtë, pse ju ngjit bishtit të qerres së shtetit, me huana qi i bâni me kartëmonedha pa mbulesë, të cilat erdhën e u shvleftësuen kryekëput. Më 1841, Bankës Kombtare të Greqís, me privilegjin qi iu dha të qesi monedha, iu vunë baza të shëndosha. Themeltarëve të naltpërmendun iu shoqënuen vëllaznit Rotschild e kapitalista grekë si Zosimas, Vranis, Rallis e Stavros, i cili kje Qeveritari i parë i Bankës. Ajo u bâ nji ngrehín, si nga kryegjânat ashtu nga organizimi - frengu Lemaître përpiloi statutin - e dalun nga bashkëpunimi ndërkombtar. Kësaj pastaj, iu shtuen dý tjerat: *Banka Joniane*, me origjinë angleze dhe *Banka e Privilegjueme e Epirit dhe e Thesalis*, me origjinë frenge.

BANKA OSMANIJE (Osmanli Bankasi), me statut anglez, u themelue në vjetin 1854, vetëm për të bâ sherbimet e huas së kontraktueme nga Turkija në tregun e Londrës, dhe qendrën e kishte në Londër. Kje ndërmjetëse e tregtis anglo-turke, dhe agjente e Thesarit turk. Mâ vonë, tue pasë marrë huana edhë në tregun e Parisit, u krijue

nji interesë e përbashkëme anglo-frenge dhe kryegjâs së të parit iu shtue ajo e të dytit dhe kështu ngrehina e ré muer êmnin *Banka Perandore Osmaniye*, me Firman të 4 shkurtit 1863 dhe me cilësi të dyfishtë: qitëse dhe pune, qi përfshîte atë financiare të shtetit dhe t'ekonomís private. Kuvêndi i përgjithshëm i akcionistave mblidhej herë në Londër dhe herë në Paris, dhe ruente vetina të gjana, si në pjesën financiare ashtu n'atê mbarështuese.

BANKA KOMBTARE E BULLGARÍS (*B'lgarska Narodna Banka*).

Bullgarija nën qeverín e përkohshme ruse të Princit Dondukov-Korsakov, të cilit i detyrohet organizimi i Arkave të Bujqësis, nga rrjedhi mbrapa Banka Bujqësore, i vûni themelet, në vjetin 1879, *Bankës Kombtare*, si ngrehín financiare e shtetit, me fonde të marruna nga Thesari, për t'i vjeftë rilindjes e zhvillimit ekonomik dhe tregut kreditor të Princênís. Drejtimi i kje besue specialistit rus Karboner dhe organizimi, Krianovskit. Por, para se të mirrte cilësin e njëj ngrehine qitëse, kaloi do kohë bisedimesh dhe studimesh, si edhe kundërshtimesh, në mes të njenës palë, e cila mbante ânën e mprojtjes ruse, hasi në kundërshtimin e Ministrit të Financave Karavelov, mprojtës i nxehtë i sistemit bankar shtetnuer, dhe shkaktoi përgjegjen e tharptë të Ministrit Balabanov kur po bisedohej në këshill: « *Lemnani mos tjetër ta lexojmë e të mëndojmë mbi këtë kartë* – i tha princit – *mos na vëni thikën në fytyrë* ». Përendoi, kështu, projekti rus i trajtës së ré të Bankës Kombtare, dhe u mbajt ajo e vjetit 1879. Por, në vjetin 1883, tue u marrë për shembull Banka Kombtare e Rumanís, u punue prej Ministrit Keije një projekt i rí, me kryegjâ të nënshkrueme për 2/3 nga populli e 1/3 nga shteti. Dhe e muer qeverija me thirrje patriotizmës së popullit, për t'i ruejtë mvehtësis bankës, qi mos të bijë në duer të kapitalistave të huej e të merrnin drejtimin e të ndikonin ekonómín e vendit. Por, ky i shkretë patriotizëm âsht kudo xhep-shpuet, e populli s'u tund të çaset me blé akcione.

Banka Kombtare e Bullgarís, si nën princin Dondukon-Korsakov, mbet një ngrehín thjeshtë shtetnore krediti, të qesi monedha dhe t'i vijë zhvillimit ekonomik të Vendit.

BANKA KOMBTARE E PRIVILEGJUEME E MBRETNÍS SERBE (*PRIVILEGOVANA NARODNA BANKA KRALJEVINA SERBIJI*).
Në Serbí, sherbimi bankar, huanash hipotekare, të tregtis e të

industrís, dhe e qitjes së monedhave i kje dhanë Bankës *Union Générale* të Parisit, e cila i pat dhanë shtetit në vjetin 1881, një hua 90 milionash për ndërtimin e hekurudhave, por efektivisht kjenë 71.400.000 me një zbritje 18,6 miliona, për komisione etj. Në vjetin 1882, tue kenë se ajo bankë u shtý në spekulime të pamend, u thye. Kështu qeverija hoqi dorë krejt nga kapitalistat e huej dhe, mbas shembullit të Bankës Kombtare të Belgjikës, përpiloi, në vjetin 1884 mund të nisi veprimet, nën drejtimin dhe organizimin e specialistit belg Charles Boschmans, dhe nën êmnin: *Banka Kombtare e Privilegueme e Mbretnís Serbe*.

BANKA KOMBTARE E MALIT-TË-ZÍ (*Crnogorska Narodna Banka*).

Mali-i-Zí, i lidhun krejt ekonomikisht me Austro-Hungarín dhe qytetin e Shkodrës, monedhë ligjore pat koronën austro-hungare deri në vjetin 1909 qi u krijue, nga *Kreditanstalt*-i i Austrís, Banka Kombtare, e cila vûni në qarkullim monedhën e ré “perperin” me vlerë baras me koronën.

* * *

Mbas Luftës së parë Botënore, struktura e bankave të qitjes të shteteve të Ballkanit, për shkaqe ajsemi (inflacjoni) bâmun për nevojat e luftës, pësoi ndërhyrjen e kapitalit të huej, si edhë drejtimin i tyne iu shtrua mësimet dhe parimet të konferencave ndërkombtare ekonomike të Bruxelles, Genova dhe të Genëve-s, për me i mëkambë dhe me i shestue.

Bruxelles (1920) u këshilloi t’u ikin ndikimeve politike dhe ta frymëzojë drejtimin një politikë financjare e matun.

Genova (1922) u porositi, patjetër, mvehtësín faqe shtetit.

Por vepra e Shoqënis së Kombeve duel e dobishme në Ballkan, si me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë me plane masash sherimi e huanash, gjithashtu tue zbatue vetëm parimet themelore të Komitetit Financiar të saj.

Karta e Genëve-s u caktoi bankave të qitjes vetëm cilësín të mbajnë të qendrueshme monedhën, tue e përmbledhë në këto pika:

mvehtësí bankare;

të drejtë ekskluzive të qesin monedha;

kufizim të veprimeve bankare, huaje dhe skonti me afat të shkurtë dhe të lajshem;

pakësim huanash shtetit dhe kufizim të prém, paradhanjesh të reja pa kundërênë (contropartita);

përqendrim në bankën qendrore të të gjitha veprimeve monedhore të shtetit dhe të sipërmarrjeve shtetnore; sajim i një mbulese të mjaftueshme për një qitje të unjisueme.

Mbas këtyne parimeve themelore, dhe me udhëheqjen e Shoqënis së Kombeve, iu vënë themelet Bankës së Greqís qi trashigoi të drejtën e qitjes nga Banka Kombtare, qi e kishte, dhe e cila hoqi dorë në dobí të ngrehinës së ré.

Tue pasë pré shteti otoman, në vjetin 1914, marrëdhhanjet me Bankën Perandore Osmane, kjo kthei të quhet *Banka Osmanije*.

Turkija e ré u kujdes, prandej, të krijojë një bankë të veten. Më 11 qershuer 1930 u votue ligja organike e *Bankës Qendrore të Republikës Turke*, mbasi u ndëgjuen, mâ parë, shumë eksperta në zâ të huej si Vissering, Rist, etj. Dhe u përdorue një pjesë e madhe e parimeve të Komitetit Financjar të Shoqënis së Kombeve. Kryegjâja u mblodh në mes të ngrehinave shtatnore, të bankave të Vendit, të shtëpijave tregtare dhe një përqindje e vogël (10%) ndër shoqënit konçesionare të hueja. Selija qendrore e bankës u vendue në zëmër t'Azís, n'Ankara, kryeqytet i Turkús së ré.

Edhe *Bullgarís* iu desh, mbas sa pengimesh të tradicjonalistave, t'i shtrohej parimit të mvehtësis së bankës faqe shtetit. Dhe, simbas zotimeve të dhanuna në Genëve, përpiloi projektin përkatës mbas shembullit të Austrís dhe të Maxharrís. Banka Kombtare e Bullgarís muer trajtën autonome në vjetin 1928 dhe u vû nën kontrollin e një Këshilltari teknik, i êmnuem nga Shoqënjia e Kombeve. Ky u kujdes të stabilizojë monedhën, të kufizojë sherbimin n'atë të vetmin të kreditit me afat të shkurtë, tue u bâ kështu, një ngrehín qi të merrej vetëm me qitjen e monedhës.

Serbija, mbas luftës, nuk u gjet në kushte të njajta me tjerat shtete të Ballkanit, pse shtiu në kufijt e vet mbretnín e Malit-të-Zí dhe provincet e Kroacís, Slovenís, Dalmacís dhe Bosnjen dhe Hercegovinën, pjesë të Perandoris Austro-Hungare. Ajo pat në qarkullim trí lloje monedhash: koronën, perperin dhe dinarin, të shvleftësuem dhe të ngatrruem edhe mâ tepër nga regjimi ushtarak austro-hungar qi sundoi deri ditën e çlirimit, Serbí dhe Mal-të-Zí.

Banka Kombtare e Mbretnis Serbe-Harvate-Slovene, muer prandej përsipri zbërthimin e këtij problemi monetar, tue zavendsue Bankën e Privilegueme, e cila u shkrí në ngrehinën e ré, ndërsa Banka Kombtare e Malit-të-Zí hyni në likuidim.

* * *

Edhe Shqipnija e pushtueme nga ushtrinë ndërluftuese pat në qarkullim, gjatë luftës botnore, monedhat e tyne në viset e ndryshme të pushtueme: koronën austro-hungare, liritën italjane dhe frangun francez.

Por Austria për nozullimin e ushtrisë me gjâ të gjallë, e shtyme nga njëfarësoj mirësi ndaj popullin shqiptar mik, dhe gjithashtu levertije në blemjet, me gjithë qi mund të zbatonte, sikudo kjenë zbatue, me rreptësi, ligjët e luftës të rekuizimeve për nevoja ushtarake, pat sjellë korona argjanti me sasina të mëdhâ si edhë monedha ari, të cilat në ngastra tjera lufte nuk ju kërkoshin. Pse populli austriak dhe ai hungarez kishin besim të plotë në monedhat karte të bankave të tyne. Po ashtu si besim të plotë kanë pasë qytetet tona bregdetare, Shkodra e Durrësi kryesisht, të cilat pësuen humbje të mëdhâ mbas luftës. Simbas një llogarije të qeverisë Shqipnís, banknotat austro-hungare qi gjindeshin në Vend dhe kërkohesh vulosja e tyne nga likuidatorët e Bankës austro-hungare, kapëshin shumë e 450 milionave korona**.

Por malet e fushat i pështoi bindja e banorëve, të cilët në ar e serm, përgjithësisht, patën besim të vetëm. I forcuem nga kujtimi i lashtë, të trashiguem nga të moçmit, të *kai-me*-ve të sulltan Mexhidit, qi u banë hî e pluhun. Po ashtu si ndodhi mbas lufte, me shkatrimin e Perandoris Austro-Hungare, për koronën, monedhë të saj.

Në Jug të Shqipnís qarkulluen monedhat karte në dollarë, sterlina, franga France e lireta italjane, të cilat mbaheshin në një të shkuem (kurs) t'ujdisun gjatë luftës qi i lidhi dhe i shoqënoi bashkë me fatin e saj.

Korça dhe Gjinokastra pjesësisht, nën ndikimin politik dhe ekonomik të Greqís, treg i afërm i tyne, ndërruen në drahm kursimet qi kishin në dollarë, franga France e lireta italjane, tue u rrjedhun shkatrrime n'ekonomit e tyne, nga shvleftësimi i monedhës, mbas shkatrrimit ushtarak qi pësoi Greqija n'Anadoll, kû e fryme nga *megali-idea* e Helladës së dikurshme, desh me shtrî mbretin e saj n'Izmir e tej.

Nga kataklizmi monedhash qi solli mbarimi i luftës në gjithë kombet pjesëmarrëse në luftë, por sidomos më perandorit qendrore e shtetet ballkanike, Vendi ynë, për hîr të besimit fanatik të popullit fshatar në ar e argjant qi grumbulloi, u bâ një oazë në Ballkan me një qarkullim monetar metalik ari e argjanti aso kohe i vetëm n'Europë. Që Prof. Albert Calmes, eksperti financjar i Lidhjes së Kombeve, i cili u dërgue

*) Shkresë e Min. P. Mbrendshme: Nr. 122/4 dt. 12.7.1922, Prefekturave, qi përcjell shkresën e Likuidatorëve të Bankës Austro-Hungare: Dr. Luxardo, G.D. Mones, Alexander Ezureau – Vjenë, 22 qersher 1922.

për të mësue gjendjen ekonomike e financiare të Shqipërisë, mbërrijti deri aty sa të vlerësojë sasinë e metaleve të çmueshme që mbate populli shqiptar, në një shumë njëqind mijona franga ari, pa llogaritë stolit ari, që, si dihet, janë pajë e përgjithshme e grues shqiptare të malit, të fushës e të qytetit, me veshje kombtare.

Me një begati të tillë paresh florí, krijimi i Bankës me kryegjâ kombtare paraqitet, kudo mendohet, fare e kollajtë. Por pa u dijtë, se psikologjia e popujve ndërron vend me vend, edhe në ata popuj më të qytetnuem. Pse, si thonë, sikur populli freng të kishte dorëzue n'arkët shtetnore, të gjithë at ar, që, mbas luftës, doli në shesh, i mshehun nën dhé, Franca nuk do të kishte pasë nevojë të bëjë ato detyrime aq të mëdhá, që bani, në Angli e Amerikë, për të mbajtur në kambë luftën. Detyrime të cilat i shkaktuen, mbas lufte, atë krizë financjare të rrezikshme, të cilën, vetëm zotësija dhe besimi në atë burrë shteti, si kje Raymond Poincaré, mundi ta shpëtojë.

Mund të thomi se “shqiptari kurdoherë jep jetën pa kursim, por zor paret”, për mos me thanë “kurr”, simbas një thanjeje që i ka mbetë frëngut, popull trim dhe atdhetar i flakët.

Por, si ka mungue besimi, kanë mungue edhe njerzit që atë besim, në fuqit ekonomike të Kombit, ta kishin zgjue dhe ndritë në mendën e zëmrenë e popullit. Pse, si pat thanë Luigj Gurakuqi, kemi pasë ministra thesari e jo ministra finance.

N'ânë tjetër, begatija e përparimi i një populli, ndër lamijet e ndryshme të jetës, duen mjete aq të mëdhaja financjare, që kurrë një populli, sidomos popujt e Ballkanit, kanë mundun t'i sigurojnë dhe i kanë sigurue qysh në lindjen e tyre mvehte, nga burimet e vendit.

Krediti është çelësi i begatis, si në jetën e njeriut ashtu në atë të një Kombi, i cili çmohet ndër kombe të tjera, për kreditin sa më të madh që gëzon.

Qeverija e Përkohshme e Vlonës, megjithëse e tillë, me besimin që i dhanë përfaqësuesit e Kombit ditën e ngritjes së Flamurit të Kombit dhe të shpalljes së Mvehtësisë, desh të hjedhi edhe gurin themeltar të mvehtësisë ekonomike e të zhvillimit përparimtar të Kombit, tue i dhanë jetë një ngrehinë me cilësi qitjeje monedhash, dhanje huanash dhe sherbime pune.

Kryetari i qeveris, Ismail Kemal Vlora, me fjalën që mbajti para popullit në sheshin e mbledhjes në Vlonë^{*)}, me çâshtjet e tjera me randësi kombtare të ditës, përmëndi e vleftësoi krijimin e bankës me këto fjalë:

« E them me lavdurim se puna e bankës për Shqipëri, është një i dyti fitim, pas liris, edhe nga pikëpamja ekonomike edhe politike. »

Dhe shtoi:

*) “Perlindja e Shqipërisë”, Vlorë, dt. 30/5 Vjeshë e II 1913, nr. 23.

« *Qysh të mos gëzohet njeriu kur në kohë që një njeri, si Esad Pashë Toptani, bje në turbullim dhe s'ë lë të mjerën Shqipëri të mëndohet as për vëllezërit t'onë të Malësisë e të Dibrës që ikën burra e gra, nga zjarri i anmikut e muarën malet e brigjet kû pa bukë, pa mbulesë dhe pa strehë të munduem me vdekën ? »*

« *E para e punës, është që Banka me pare të hueja do të jetë fis kombëtare shqiptare nën kontrollin e njëj Komisari t'ëmnuem prej Qeverisë shqiptare, me administratorë të cilët do të jenë gjysmë shqiptarë, t'ëmnuem edhe ata prej Qeverisë shqiptare. »*

« *Banka pa një sigurim ka me i dhanë Qeverisë, një kredit jo më pak se 50000 lira (kupto lira turke flori për randësin e kuptimit në popull – Gj.K.) në vit. Dhetë miljona frangat e saj do të përdorohen prej shqiptarëve për çdo punë me një faiz, jo si sot 20, 30 e 70%, por me 4, 5, e 6%. »*

Akti i konçesjes, për krijimin e bankës së privilegueme në shoqëni anonime shqiptare, me êmnin: *Banka Kombëtare e Shqipënisë* e me të drejtën të mbajë shqytin e shtetit shqiptar, u nënshkrua më 4 tetuer 1913, n'êmnë të qeverisë së Shqipnisë, nga Kryetari i Qeverisë dhe Këshilli i Ministrave, dhe nga ana e bankave nga pala përfaqësuese e *Ëiener Bank Verein*^{*)}, n'êmnë të saj e të një togu bankash austriake-hungareze, dhe nga përfaqësuesit e *Banca Commerciale Italiana*^{**)}, n'êmnë të saj e të një togu bankash italjane.

Ngjarjet qi ndoqën krijimin e Shqipënisë, me lëvizjet përçase dhe kryengritjet, mbas ardhjes së mbretit Wied, elikjamase të Esad Pashë Toptanit, dhe vorio-epirote të Zografos, bânë qi ai akt-konçesje të mbesi, me ratifikim, simbas nenit XXII të tij, i pazbatuem.

* * *

Mbas Luftës së parë Botnore, Shqipnija u gjet e kapërthyeme me shumë çashtje politike të mbrendshme e të jashtme, të një randësije me vetë kênjen e shtetit dhe pa asnjë përkrahje të ndoj Fuqije të Madhe si patën shtetet fqinje. Pse edhe Italiya, qi së bashku me Austrí-Hungarín mprojtën ktijimin e shtetit shqiptar, qysh me Traktatin e Tiranës më 2 gusht 1920, i cili rregulloi rrjedhimet e luftës së Vlonës, mbajti një qëndrim të ftohtë, gati mosinteresimi, ndaj të gjitha çashtjeve shqiptare, politike dhe ekonomike.

Dërgata shqiptare e kryesue me nga Ministri i Financave, Tef Curani, i cili nuk mund t'ishte "*persona grata*", nga e kaluemja e tij në shërbim të politikës austro-hungare e prandej anti-italjane;

*) Baron Karol Pitner dhe Oskar Pollak.

**) Pietro Fenoglio dhe Guido Ansbacher.

me pjestarë, mandej, Qazim Kokoshin e Spiro Kolekën, të cilët në luftën për lirim e Vlonës kanë pasë pjesë udhëheqëse në Këshillin e 12-ve, nuk mund të kje një Dërgatë “*ad hoc*” për atë marrëveshje miqësore ujdinash e bashkëpunimi, për të cilën ishte dërgue në Romë. Ajo Dërgatë qëndroi atje për një kohë të gjatë, – në një kohë mandej, kur Italia në Rapallo bëni marrëveshjen me Jugosllavin. – E tue trokitë derë në derë, herë te një jurist, herë te një drejtor banke, për të mësue cila trajtë shoqnije do t’ përshtatej më mirë Vendit tonë, për themelimin e një banke qitëse monedhash dhe pune: a do t’ ishte një shoqni akomandite apo një shoqni anonime. Ju premtue një projekt nga një drejtor banke italjane n’ëmën të një togu bankash për sajimin e Bankës, por qi mbet një premtim, si do të mbette, pse në marrëveshjen qi ajo Dërgatë pat nisë me Qeverin e Italis, i kje përmendë krijimi i Bankës mbi ato baza të aktit të konçesjes të 4 tetorit 1913, me dy togjet austriake e italjane të Qeveris së Përkohshme të Vlonës, qi nga ana e Dërgatës nuk kje pranue.

Një Dërgatë tjetër e kryesueme nga vetë Kryetari i Parlamentit Eshref Frashëri, me Ministrin e Financave Kolë Thaçi, më 1922, muer udhën e Belgjikës dhe në Bruxelles kontrakttoi me *Banque de Brabante*, themelimin e Bankës.

Kjo Bankë, krijesë e mbasluftës, kishte një kryegjâ prej 2.000.000 frangash belgë. Ishte gati e panjoftun, pa një kredit në tregun bankar të Parisit, simbas njoftimeve zyrtare edhe të vetë Qeveris së Belgjikës. Ndërsa nga Lidhja e Kombeve, me interesimin e mikut të Shqipnis, Justin Godart, kushtet e vûme nga ajo bankë në kontratë, u gjikuen krejt të damshme për shtetin shqiptar. Dhe as Qeverija e Xhafer Ypit, qi kish marrë atë nismë, nuk pat guximin t’ia paraqesi Parlamentit për bisedim e pranim.

Në Konferencën e Gjenovës (1922), më e madhja konferencë ekonomike në botë qi kujton historia, kû u mblodhën kryetarë qeverinash dhe eksperta t’ekonomis e të financës në zâ të mbarë botës, muer pjesë edhe Shqipnija, me Mehdi Frashërin.

Kërkesa e një huaje, aq e bujshme, jo më pak se 100 miljona franga ari, kur huanat ngurroheshin me u dhanë Rusis dhe Austris, pse kapitalistat për t’investuem kryegjânat kërkojnë garancina të forta, për sigurimin e tyne dhe të fitimeve, kje pritë me të qeshuna. Dhe një delegat i një Fuqije së Madhe, kish thanë: “*L’argent est trop cher et ne cherche pas d’aventure*”, shqip: “Parja është shumë e shtrëjtë e nuk kërkon aventura”. Ndërsa përgjegja zyrtare e Komisionit shqyrtues

kje: “*La Conférence n’est pas compétente*”, shqip: “Konferenca nuk është kompetente”, qi, si pat thanë Luigj Gurakuqi në Parlament, ato fjalë donë të thonë: “keni lajthitun derë e pa andrra me sÿ çelë”.

* * *

Dalja jashtë e monedhave argjanti, kjoftë për pagesë mallnash të sjelluna nga vendet e hueja, kjoftë për spekulime tregtare, e vështirësoi pa masë qarkullimin monetar të Vendit, për mungesë monedhash të vogla, në tregtimet në tregjet e qytetevet.

Kësaj vështirësije monetare, Qeverija desh t’i dalë para me një ligjë të pranue me nga Këshilli Kombtar, më 13 fruer 1922, dhe nga Këshilli i Naltë i Shtetit, më 16.2.1922, me anën e së cilës, Qeverija autorizohej të presi kartëmonedha për një shumë 3 miljona franga ari.

Monedhës shqiptare, me atë ligjë, iu vû emni *Lek*. Çdo 100 Lekë bâhej barazi me 20 fr.ari dhe çdo lek pjestohej në 100 qindarë, tue hÿ kështu edhe monedha shqiptare, bashkë me tjerat të Ballkanit, në sistemin monetar latin.

Monedhat pjestore do t’ishin nga 25 qindarë, 50 qindarë dhe nga 1, 2, 5 dhe 25 lekë.

Monedhat karte me vlerë në bazë t’arit e me numër të lekëve të shkruem mbi ’to, do të nënshkruheshin nga Ministri i Financavet dhe nga Arkëtari i Përgjithshëm i Shtetit. Por përdorimi i tyne ndër pagesa dhe arkëtime nga Arkët e Shtetit, qi kishin për monedhë llogarije frangun ari, ishte, nga ajo ligjë, i kufizuem në 25% monedhë karte.

Mbulesa me ar e kësaj 25% monedhë karte do të depozitohej në një bankë europjane, simbas nenit 7 të ligjës.

Një orvatje tjetër për të përballue mungesën e monedhave të vogla në tregun qytetës, kje ligja e pranue me nga Këshilli i Naltë i Shtetit, qi autorizote Bashkít me pré monedha karte pjestore, nga 25 e 50 qindarë dhe nga 4 e 2 lekë për një shumë 80.000 franga ari, të garantueme nga pasunít e patundshme bashkijake, të hipotekueme n’émnin e Financës së Shtetit dhe me një qarekullim të kufizuem mbrenda qarkut të prefekturës së Bashkive e me një të shkuem me gjobë dhe burg, për të gjithë ata qi do të kundërshtojshin pranimin e tyne ndë pagesa. Por as njena, as tjetra ligjë, nuk patën zbatim.

Kje Tregtija dhe tregtarët mâ në shêj, qi vunë në qarkullim diftesa me vlerë të shenjueme mbi to, për lehtësim të veprimevet arke të tyne.

Asinjatët (*assignats*), monedhat karte të dikurshme të Francës (1789-1797), kjenë modeli i ligjëve të Shtetit Shqiptar dhe të

veprimit të tregtarëve të Vendit, të mbështetun, për sigurim të qarkullimit të tyne, nga Bashkít mbi pasunít bashkiake, dhe nga tregtarët, mbi pasunít e tregtís së tyne.

Me këtë emërtim të sigurimit me pasunít e tundshme dhe të patundshme, kjenë qitë në qarkullim në Shkodër, kohën e qeverimit Ndërraleat të Gjeneralit francez Bardi de Fourtou, në vjetin 1920, bileta 20 qindarësh të shtypuna nga Perlimtarja, si quhej atëherë Bashkija, për një sasi 250.000 copë dhe vleftë 50.000 korona serm.

Dhe asaj bilete iu dha emni "Sigurim arke".

SIGURIM ARKE

I PERLIMTARES SË SHKODRËS

PËRMBI

QINDTAR 20 QINDTAR

PERLIMTARJA E SHKODRËS PËNGOHET PËR KET

DETYRË ME TË GJITH GJANË E TUNDSHME E TË

PATUNDSHME TË VETEN. SHKODËR 30.I.1920

KRYETARI

M.Juka

NËNKRYETARI

N. Vogli

NËNKRYETARI

J. Repishti

(p a r a)

sigurim arke i perlimtares së shkodrës

përmbi 20 qindtar

për me lehtësuem ngushticen e të hollave

të vogla perlimtarja e shkodrës po

shtypë shumen e 50000 (pesëdhjetëmi) fr sermi

ky sigurim arke áshtpa interesë (faiz) e merret

në pagesë prej perlimtares së shkodrës deri me

30.vi.1920 e mbliidhet prep prej arkës së perlimtares

tuej kthye vjeftjen serm me 20.VI.1920

të përbâmit i ktyne sigurimeve arke

ka me ken'i ndeshkuem mbas ligjes

(m b r a p a)

Mbrapa, tue dashtë me zberthye çashtjen e monedhës dhe themelimin e bankës, Qeverija i paraqiti Parlamentit, në

mbledhjen e 14 prillit 1923, ligjën mbi shtypjen e kartëmonedhës me êmnin lek e me vlerë një frang ari, në pjestime të ndryshme deri në 50 lekë, për një shumë 20 miliona franga ari. Por, në rishikimin që i bëri ligjës, Komisioni i Drejtësis dhe ai i Financës të Parlamentit, ajo shumë u zbrit në 5 miliona. Dhe në bisedimin që rrodhi në Parlament, u vërejt se populli shqiptar, mbas provave të hidhuna që ka pasë, nga monedhat e hueja karte, që u shvleftësuen, si korona austro-hungare, lira italjane dhe duhet shtue drahmii për Korçë e Gjinokastër, nuk mund të ketë besim në monedhën karte shqiptare. Me gjithë këtë, u tha, qellimi i ynë është të mbledhim ar e argjant e kështu të themelojmë Bankën Kombtare me mjetet tona.

Ndryshe nga monedhat karte, kartëmonedhat njihen me cilësinë monedhe në vetvete pa pasë mbulesën metali. Shkaktojnë, prandej, trazime në ekonominë dhe në financat e shtetit që do t'i përdori. E ligja "Greshan" vërtetohet pikë për pikë. Domethanë, monedha e keqe bën t'ikë monedhën e mirë, atë metalike ari, sidomos. Monedhat pjestore argjanti edhe këto zhduken nga qarkullimi. Tregtija e jashtme vuen, përse për pagesa jashtë nuk ka mundësi të përdoren. Mallnat për rrjedhim, hypin në çmimet e tyre.

Ligja e kartëmonedhës dhe e themelimit të Bankës në mënyrën e saj, mbas asaj të vetme mbledhje që u bisedue në Parlament nuk u kthye më, kaloi në heshtjen e arkivave, në pritje, si u tha më vonë, të vijë eksperti financiar i Lidhjes së Kombeve. E ky kje holandezi Hunger, mendimi i të cilit nuk ka mujtë me këndë i ndryshëm nga sa thamë më sipri për kartëmonedhën me të shkuem ligjuer, domethanë "me të fortë".

* * *

Ardhja e organizatorit të financës, kje një hap tjetër i Qeverisë për themelimin e Bankës, por me një trajtë të ndryshme nga ajo e ligjës paraqitun Parlamentit nga Qeverija në mbledhjen e 14 prillit 1923.

Me një shpallje** me anën e Prefekturave, nga Ministrija e Mbrendshme, mbi urdhënin e Kryeministrit të Qeverisë së kryesue me nga Ahmet bej Zagolli, u lajmue populli se Organizatori i Financës ka parashtue, me pelqimin e Qeverisë Shqiptare, ngrehjen e një Banke private qitëse e krediti, në të cilën, një pjesë e madhe e kryegjâs së saj do të jepej nga pjesëmarrës të huej.

*) Qarkore e Ministrit së Punve të Mbrendëshme, të gjithë Prefekturave Nr. 19295 dt. 5.XI.1923 mbi urdhënin e Kryeministrit me shkresën Nr. 759/1 dt. 29.X.1923.

Kryegjâja e Bankës, e caktueme në 5.000.000 franga ari, përbâhej nga akcjone 500 fr.ari.

Prefektat e Kryetarët e Bashkive, u urdhënuene me pyetë ndër qarqe e aytete të tyne kush donte nga populli të marrë pjesë dhe në ç'sasi akcjonesh, për me dijtë se sa do të mbetëshin për akcjonistat e huej.

Edhë ky hap i Qeverís duet shpuet, pse askush nuk iu afrue me dhânë për themelimin e nji Banke n'atë kohë, me nji qeverí të kryesueme nga Ahmet bej Zagolli me klikën e tij. Nuk ia kishin besimin, me gjithë qi paravêhej êmni i Organizatorit të Financës, i zgjedhun për atë kambë nga Lidhja e Kombevet. Por jo se banka ngrehej nën shêjet e saja, për të sigurue kështu besimin e popullit, për akcionet qi do të nënshkruete dhe paret qi do të dredhëte për 'to.

Edhë êmni i organizatorit nuk kishte fitue atë besim, pse në punë u pá se mâ fort interesohej për interesat e kapitalit të huej se sa për interesat e ekonomís së Vendit. Si shembullin e dha me mprojtjen qi i bâni komçesionit të vojtit të gurit në dobí t'Anglo-Persjanes.

Dhe s'vonoi e na la shëndetin, pa i sjellë asnji dobí Vendit, me veprën e tij, për aqë kohë sa ndejti në krye të detyrës së tij.

* * *

Lidhja e Kombevet, ku rëndom u drejtue Shqipnija, nuk e muer asnji herë konkretisht, parasysh themelimin e bankës. U mjaftue me hartimin e projektit të saj nga Komiteti financiar i kryesuem nga Albert Jansson drejtor i Banque Nationale de Belgique. Gjithashtu, nuk na përkrahi për nji hua ndërkombtare qi na duhej për të vû dorë në vepra ndërtese të domosdoshme për Vendin tonë, mbetun mbrapa nga kombet tjera, edhë të Ballkanit, në të gjitha lamijet e përparimit qytetës.

Greqís dhe Bullgarís s'iu kursyen ndihmat e Genëve-s dhe të kryegjânave (kapitaleve) ndërkombtare, e jo me fjalë të bukura, si për né: *"L'Albanie fera bien de compter d'avantage sur ses propres forces que sur l'aide des capitaux étrangers"*, shqip: "Shqipnija ban mirë të mbështetet mâ fort mbi fuqít e veta se sa mbi ndihmat e kryegjânave të hueja".

Këto fjalë qi na mbyllën derën e ndihmës financjare të Lidhjes së Kombeve dhe ndezën fjalimin e huás së mohueme të Kryetarit të Qeverís, Fan Noli, në mbledhjen e përgjithshme të saj, bâne qi Qeverija e Qershorit, të vijojë rrugën e nisun, e mbështetun mbi besimin e popullit, qi e përkrahi, qysh në ditët e para të

revolucionit, i cili përmbysi një Shqipëri të qeverimit feudal për një Shqipëri të qeverimit demokratik, të lirë e mvehte.

* * *

N'ekonomi shkëmbimet me jashtë zënë një vend të parë, e askush nuk mjaftohet me prodhimet e shërbimet e veta e të bënë, pa nevojën e tyre, është kurdoherë ai "quid medium" si quhet monedha dhe krediti monetar. Prandaj, themelimi i Bankës është kusht i domosdoshëm: të kësaj ngrehine rregulluese të shkëmbimeve mbrenda dhe jashtë Vendi, të mënjanimi të përdorimit të monedhave metalike ari, me zavendsimin e tyre me ato karte të garantueme për vleftën e tyre. Si edhe të daljes së monedhave metalike të çmueshme, në pagesat, kur importi tejkalon eksportin, i cili në Vendi tonë është vijimisht nën të parin e me një shpresë jo aq t'afërme për t'arrijtun njëfarë bilancimi, sado i kujdesshëm të jetë qeverimi i ekonomisë kombtare.

Nuk mjafton që monedha kombtare e qitun nga Banka, e themelueme kjoftë mbi baza kombtare, të ketë një mbulesë metalike për një të shkuem (kurs) në Vend, barazi me monedhat e çmueshme. Por duhet që kjo monedhë edhe Jashtë, të ketë po atë besim që ka në Vend, në ndërrimet me monedhën a monedhat, të cilat, në tregtimet (transakcionet) ndërkombtare, kanë mbizotnimin, për atë besim ndërkombtar që kanë gëzue dhe kanë sigurue, në çdo kohë, paqje e lufte.

Kështu sterlina dhe kështu dollari, për monedhat tjera të rrethit të tyre, dhe me ndryshimet në mes të monedhave të një rrethi me ato të rrethit tjetër, simbas ngritjes e uljes të monedhave mbizotnuese të rrethit përkatës, në qendrat e vlerave të Londrës dhe të New York-ut.

Qeverija e Qrshorit, me atë politikë financiare, që qysh në fillim të jetës së saj të shkurtë, i vuni vetes si detyrë: me drejtue t'ardhunat buxhetore në shpenzimet po aq, për një qeverim të kufizuem me nevojat administrative e të mbajtjes së qetësisë së Vendi; një përdorim sa më të frytshëm të tyre për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit e të përparimit qytetës të tij; rifitoi, në pak kohë, besimin aq të trandun nga qeverimi despotik e prishës të një oligarkije mbrapanike, tue përfundue barasimin e buxhetit.

Në fjalimin që Luigj Gurakuqi, Ministër i Financave, i mbajti më 9 dhetuer 1924, Odës së Tregtisë së Shkodrës, e mbledhun në selin e Bashkisë, simbas dëshirës së tij, gjendjen financjare të trashigueme dhe atë të qeverisë në fuqi, e pasqyroi në mënyrën më bindëse.

«Arkën e Shtetit, a më mirë të thomi, shtoj, të Qeverisë së Ahmet Zogut, e kemi gjetë bosh e me një borxh, ndër sa tjerë, vetëm nëpunësive, nandë

muej rroga të papagueme.

Kemi mbërrijtë të paguejmë rrogët rregullisht në fund të çdo moji, dhe të lajmë edhe 7 muej nga 9 muejt e mbrapambetun. Do të kishim mujtë me pague edhe atë mbetje, por duem të kemi të holla në arkë, për ndo'j ngatresë të papritun në kufi.

Jemi në marrëveshje me një grup financiar anglez, i përfaqësuar nga Dr. Gottlieb, për themelimin e Bankës Kombtare të Shqipnis dhe njiheri të Korporatës për Zhvillimin Ekonomik të Shqipnis (*The Albanian Development Corporation Ltd.*)».

Për themelimin e Bankës do të marrim pjesë me një kryegjâ 5.000.000 fr.ari e Banka do të qesi monedha karte për një vleftë 15.000.000 franga shqiptarë të njoftun prej të gjitha shteteve europiane si edhe prej Amerikës.

Për shembull, Elez Muka (tregtar në landë ndërtimi, këshilltar i Odës së Tregtis dhe deputet në Parlament), nënshkruen akcione për 500 napoljona flori. Ketë shumë, Elez Muka do ta derdhë mbrenda 50 muejve, nga 10 napoljona në muej. Por, njikohësisht, me derdhjen mujore, do të ketë të drejtën e kredis për napoljona $7\frac{1}{2}$, tue pague një kamatë $2\frac{1}{2}\%$. Në fund t'afatit, Elez Muka do të ketë në xhep 500 napoljona akcione të derdhuna, qi do t'i sjellin deri 15% fitim ndasish (dividenda), e në tjetër anë kredin e 375 napoljonave me një kamatë $2\frac{1}{2}\%$. Në këtë mënyrë, kryegjâja e tregtis s'Elez Mukës nuk do të pakësohet ose do të pakësohet fare lehtë.

Më 10 dhetuer 1924, financjerët e Londrës mbërrijtën në Tiranë për të nënshkrue marrëveshjen e projektueme^{*)}.

Por, po ashtu si në vjetin 1913, Esad Pashë Toptani krijoi ato trazime qi penguen mëkambjen e Shtetit Shqiptar, shkretnuen Vendin dhe përçanë popullin, edhe në vjetin 1924, më 24 dhetuer, Ahmet bej Zagolli, ky nip stërnip i Esad Pashë Toptanit, në krye të një urdije mercenarësh jugoslavë, hyni në Tiranë, rimbëkambi po si ai, qeveris despotike dhe të nënshtrimit lakmimevet të të huejve, përçau popullin dhe shkatroi mvehtësín e Vendit. Mbas një kohe të shkurtë, nga krahët e Belgradit qi e sollí në fuqí, rá në krahët e Romës, qi e mbajti në fuqí.

Më 15 mars 1925, u nënshkrue në Romë, Konventa për themelimin e Bankës Kombtare të Shqipnis, në mes të grupit financiar italian, i përfaqësuar nga Mario Alberti dhe të Ministrit të Financavet Mufid bej Libohova, n'ëmën të Qeveris së Tiranës.

*) Nr. 1703 TELEGRAM 10.12.1924 LUIGJ GURAKUQI SHKODRË

Financjerët e Londrës ardhë këtu dhe presin që çështja e tyre të bisedohet në Kshillë stop Ejani sa më shpejt pse dhe disa shokë duan të nisen për kampanje elektorale stop Lajmeroni nisjen – NOLI.

Nga kryegjâja në Fr.ari 12,5 miljona, një e katërta e derdhun, pat cilësi ndërkombtare, pse në themelimin e saj muerën pjesë: Belgjika me anë të “*Banque Belge pour l’Etranger*”; Svicra me “*Banque Commerciale de Bâle*”; Jugosllavija me “*Beogradska Zadruga*”, “*Banque Serbe de Zagreb*”, “*Banque Adriatique Danubienne*”; Italijsa me sasîn mâ të madhe t’akcioneve dhe krejt ato themeltare, përfaqësohej prej “*Credito Italiano*”, “*Banca Commerciale Italiana*”, “*Banco di Roma*”, dhe banka të tjera të vogla. Por, nga drejtimi dhe organizimi ishte në duer italgjane qi kishin atësin e themelimit të saj, simbas konventës së nënshkrueme në Romë.

Ngjitas me kuvendimin e themelimit të Bankës, u kuvendue edhë themelimi i një Shoqnie për Zhvillimin Ekonomik të Shqipnis e quejtun për shkurt SVEA. Këto kuvendime, të dyja të nënshkrueme në Romë më datën 15 mars 1925 e të botueme në Fletoren Zyrtare Nr. 15 datë 18 prill 1925, janë që të dyja një gjasim të Kuvendimeve, qi Qeverija e Qershorit ishte në marrëveshje të baje me grupin financjar anglez, por me një ndryshim në mes tyne, pamvarësisht nga emërtimet e njajta qi njëni i mori tjetrit. Dhe, për sa i përket pjesëmarrjes së financimit të huej, kje për Qeverin e Qershorit, kusht i parë, të mos bijë financimi i ekonomis së Vendit “*në duer t’atyne njerësve qi Shtetet e tyne kanë në Shqipëni veshtrime politike*”^{*)}. Dhe së dyti, qi Shqipnija, në rastin e Bankës, të ketë pjesën e vet të sigurueme në shumë, në drejtimin dhe kontrollin me anën e inspektorave të kombësis së saj, si edhë nga kombësit e tjera kjoftshin, por t’ëmuem prej saj.

Të gjithë këta, përkundrazi, nuk ndodhi, si rrjedhim të konventës me grupin financjar italgjan të Mario Albertit. Në sajimin e kryegjâs e njajtë për shumë Fr.ari 12.500.000, me atë të konventës të projektue me grupin financjar anglez L.st. 500.000, pjesëmarrja shqiptare mbeti një dishir i shkruem, kjoftë për faj të Qeveris së Tiranës e të mashtrimit të saj me anë të njëj dekrete qi as nuk u vû në zbatim, as nuk iu paraqit Parlamentit për aprovim^{**)}; kjoftë për faj të vetë shqiptarëve, të cilët nuk e çmuen detyrën kombtare të tyne, sikur edhë fitim të pakët të pritëshin me marrë, tue kërkue me ngulm, pjesëmarrjen në kryegjânë e Bankës.

*) Luigj Gurakuqi, në Mbledhjen e XXXVIII të Legjislaturës së parë të Këshillit Kombtar: Z. L. Gurakuqi. Ditën e parë kur kemi llafosun mbi ketë çeshtje u tha se ka dhe arësye politike. Deri tash biseduem në pikëpamje ekonomike, tani do t’a bisedojmë dhe politikisht. Qysh do të ruhen aksjonet që të mos venë në duert të shteteve që kanë këtu qellime politike, si në Greqí, Serbí dhe Itali.

Z. Ali Këlcyra. Mos i shëmbëlloni Italgjanët në Grekerit dhe në Sllëvrit.

Z. L. Gurakuqi. Unë them të mos bijën në duart të atyne njerësve qi shtetet e tyne kanë në Shqipëni veshtrime politike. (Duartrokitje).

**) Dekret-ligjë dt. 18.5.1925 mbi blemjen e aksjoneve të Bankës Kombtare.

Në drejtimin e Bankës, si rrjedhim të mungesës së pjesëmarrjes në sajimin e kryegjâs, nuk mund të mtojshin të drejta qi s’iu parashifshin në Konventën as bankave të hueja, të shoqueme me ato italjane në kryegjân e Bankës.

Goldstandard-i kje tipi monetar ase të regjimit të arit të Bankës, me një qarkullim karte të shkëmbyeshëm pa kufizime me ar dhe i eksportueshëm pa asnjë pengesë.

Frangu shqiptar me një përmbajtje ari në gram o, 290, kje i barasuem me frangun sviceran, dhe u quejt monedhë ligjore, me ligjën mbi sistemin monetar, e miratueme ajo ligjë nga Parlamenti më 23 qershuer 1925 dhe nga Senati më 5 korrik 1925.

Simbas nenit 2 t’asaj ligje, Banka do të priste monedhat:

A r i: copa 100, 20 e 10 frangështa ; A r g j a n t i : 5, 2, 1 dhe 0,50 fr.; N i k e l i: të monedhave të quejtuna “lekë”: copa 1 leku barazi me fr. 0,20, copa 0,50 leku barazi me fr. 0,10; B r o n x i: nëndamje leku: copa 0,25 leku barazi me fr. 0,05, copa 0,05 leku barazi me fr. 0,01

Dhe, simbas privilegjës qi i ishte dhanë, monedhat karte të qituna, ishin të përgjasueme me monedhën metalike, për të gjitha efektet e neneve t’asaj ligje mbi monedhat metalike.

Mandej, simbas nenit 9, në të gjitha kontratat e aktet publike, në regjistrat llogarije t’administratave e tjerë libra ose dokumenta t’interesit publik, si edhe në të gjitha llogarít e privatëve, vlerat duhet të llogariteshin e të shpreheshin në franga e qindarë të monedhës shqiptare, tue parapamë gjoba prej 5 deri në 50 fr. për shkelësit.

Urdhënohej edhe, qi regjistrat e llogarive t’administratave dhe tjerë dokumenta t’interesit publik, t’ishin të shprehun me franga e qindarë. Por kjo s’ishte një gjâ e ré, mbasi po ashtu kjenë, qysh në fillim të qeverimit kombtar të Vendit, mbas zbrazjes nga pushtimet e hueja: austro-hungareze në korona; italjane në lira; franceze në franga.

Por, ajo qi mbet një çështje e pazgjidhun dhe e papërmëndun në ligjë, kje monedha koronë argjanti, qi ishte monedha njehsimi në tregun mâ të gjanë të Shqipnis dhe shprehës i regjistrimeve private, qi pat ardhë e marrë përhapje edhe në viset e tjera të Shqipnis së Jugut deri në Korçë me interesimin e vetë Qeverís s’asaj kohe, për me zavendsue drahmít karte të shvleftësueme e disi me shërue gjendjen monetare tësaj, e dobësueme nga drahmii grek me qarkullim të gjanë aty.

Çështja e rregullimit të koronës, e kërkueme dhe e rrahun në shtypin e Vendit, nuk pat një zgjidhje, kryesisht nga Shteti, qi e kishte në dorë, për hirin e atij privilegji shtetnuer të qitjes së monedhave.

Dhe prof. Albert Calmes, kur të shkuemët e napoljonit ari vërtitej rreth 52 e 54 korona argjanti, pat këshillue me e bâ koronën argjanti të papranueshme n'arkët e shtetit, tue pré monedha të vogla 2, 1 e ½ frangu ari, kështu qi me të shkuemët t'atëhershëm të koronës l i n g o t 50 copë për një napoljon ari 20 franga, shteti mund të préte 2½ herë mâ tepër franga, monedhash të vogla me një dobí për shtetin, mjeft të mirë e tue rregullue njiheri edhe çështjen e koronës argjanti në mes të privatëve, llogarish dhe aktesh me bazë koronën.

Gjatë një kohe pesëmbëdhjetëvjeçare, Banka ndoqi me krejt mvehtësí të gjithë sa i urdhënohej nga Karta e Genëve-s, parimet e Komitetit financiar të së cilës kjenë themelore për të gjitha bankat e qitjes të Ballkanit. Por në mënyrë të posaçme, nga të gjitha monedhat e Ballkanit, monedha shqiptare, frangu shqiptar, gëzoi në tregun ndërkombtar, një besim e çmim mbi të gjitha.

* * *

Në një qeverim të Vendit, si ai i regjimit t'Ahmet bej Zagollit, kufizimi i kreditit dhe qarkullimi i monedhës, si sasi, po të gjykohet me paanësi mendjeje dhe dije të kohës, asnjë tjetër bankë, e krijueme kjoftë ndryshe nga ajo dhe e pavarun nga Shteti, nuk do të kishte veprue ndryshe, në drejtimin e ekonomís monetare. As nuk do t'shte tregue e gjanë në kreditin e ekonomís së Vendit, e rame në duer të paafta, si drejtim t''konomís e qeverim të pares së popullit, prishëse në masën mâ të naltë.

Shembulli u dha, me Dekretin e Qeverís me anën e të cilit u përvetësue, për nevojat e Arkës së Shtetit, shuma e Fr.ari 2.000.000 e grumbullueme nga bashkëpunimi i nëpunësavet, me anën e ndalesave rroge, dhe të popullit me anë të një shtese tagri të sheqerit, për themelimin e Bankës së Bujqësis me kryegjâ thjesht kombtare.

E ai dekret u pranue nga Parlamenti, me të vetmin zâ të kundërt, të deputetit të Korçës, Thoma Orollogaj, i cili mprojtí akcjonistat, të cilët, tha, vetëm ata kanë të drejtë e askush tjetër të ndajnë fatin e kryegjâs.

Kishte, prandej, të drejtë të thote prof. Calmés, se âsht kryesore për Bankën të ruej krejtësisht karakterin e saj të një instituti privat, ku Shteti mos të ketë mundësi të përzihet jashtë rrethit të privilegjít të qitjes së monedhës.

Dhe, megjithëse i çmote mundësit e shqiptarit tregtar të themelojë

me mjete Bankën, me një kryegjâ 10 dhe 15 miljona fr.ari, si edhe mâ shumë t'asaj shume, shtote gjithashtu, se për interesin e Bankës vetë, duhet një pjesë rreth gjyrmë të kryegjâs të nënshkruhet nga të huejt.

Shqipnija, thotë, mandej, ka pasë fatin të lejë me një qarkullim monetar të shëndoshtë, dhe këtë duhet ta rrejë si të mirën mâ të madhe në rendin ekonomik të saj.

* * *

Më 20 prill 1939, në Tiranë, nga Qeverija e Shqipnis, pjellë e pushtimit ushtarak italian, që shndërroi Vendin tonë në gjendje të tillë, qysh mlli 1939, u nënshkruë një onventë ekonomike doganore valutare me Mbretin e Italis.

Me atë Konventë, u quejtën të shfuqizuese dhe të ndryshueme të gjitha ato dispozita të ligjës 12 korrik 1925, rregulluese të monedhës shqiptare, po t'asaj date, që kishte miratue krijimin e Bankës Kombtare të Shqipnis.

Vlehtë e frangu shqiptar u bâ baraz me lire italjane 6,25 (neni 10). Mbulesa e qarkullimit të Bankës Kombtare të Shqipnis, përbâhej prej liresh italjane në bankënota e tjera kredina mbi *Banca d'Italia* (neni 11), tue u shndërrue kështu garancija e mbulesës së arit të vet, që kishte mâ parë, simbas konventës së 20 prillit 1925, n'atë të garancis së mbulesës të lirës italjane, në gjegje të 1 fr.shq. i kthyeshëm në 6,25 lire italjane, simbas konventës së ré.

Monedha shqiptare në tregun e vlerave ndërkombtare, me atë akt të konventës, paraqitej, prandej, jo mâ me garancit e veta të pavarme, por me garancit e varme të lirës italjane e të mbulesës së saj ari. Të një besimi ndërkombtar, mandej, të trandun nga lufta e Abisinis dhe të sakcjoneve të Lidhjes së Kombeve, për atë luftë imperialiste.

Konventat e para, për monedhën dhe Bankën Kombtare të Shqipnis, me gjithë atë ngjyrë ndërkombtare që i jipej, nga bashkëpunimi i kryegjânavet ndërkombtare në përfitimn e kryegjâs së saj, Kjenë që të dyja pjellë e një mendjeje, e një drejtimi dhe e një qëllimi: me e lidhë regjimin e Ahmet bej Zagollit, i ngritun në Shqipni më 24 dhetuer 1924 me fuq1=n e armëve të Jugoslavis, sa mâ ngusht e mâ fort me Qeverin e Romës e të varësis së saj financjare, kundrejt lëkundjevet politike të diktatorit matjan. Si e forcoi, mâ vonë, ardhja e aventurjerit svedez, i ashtuquejtuni mbret i shkrepçavet, John Dekey, me atë qëllim me zavendsue

financimin e Romës me atë të tij; qi talli qeverí e mashtroi Bankën me çeçe pa bulesë që thei, tragtues me të cilin kje caktue Mehdi bej Frashëri. Ngjarje qi zbloi edhe mâ mirë fëtyrën e aventurjerit matjan e të klikës së tij, në krye të Qeverís së Shqipnís e kthyeme prej tij, në një treg të feudit të tij.

Por konventa e dytë i hoqi Shqipnís edhe atë maskë mvehtësije qi kishte pasë deri më 7 prill 1939, tue e futë nën sipranín e drejtpërdrejtë të Shtetit Italjan, në kuadrin perandorak të krijuem me pushtimin e Abisinís: politik, ekonomik e financjar.

Monedha shqiptare ndërroi fëtyrë, jo vetëm nga mungesa e vlerës së saj në qarkullim, edhe nga përfëtyrimet e saja, me premjet e reja metalike dhe me shtypjet e reja karte, të një vargu dekretesh mëkambësore, prej monedhave mâ të vogla deri n'ato mâ të mëdhá.

Bankënotat, të kthyeshme me të pamë, kjoftë me anë çeqesh ose urdhnash derdhjeje në lire italjane, u bâne të përdorueshme n'Italí. Të kthyeshme në vlefte të tjera të hueja, i nënshtroheshin urdhnave të monopolit të tregtis së këmbimit qi i ishte besuem me atë Konventë Bankës Kombtare të Shqipnís. Por, simbas atyne urdhnave në fuqí në Italí qi rregullojshin kthimet e lirës italjane në vlefte të hueja (neni 12 e 13 i konventës doganore valutare).

* * *

Pushtimin italjan të Vendit e ndoqi, në vjetin 1943, ardhja e Ushttris gjermane, pushtuese e gjithë Ballkanit. E me ardhjen e saj la Vendin të gjithë aparati shtetnuer i Italís, qi ndodhej në Shqipni, qysh më 7 prill 1939. Organizimi i përkohshëm i Shtetit shqiptar, qi u ngreh në ato rrethana ushtarake gjermane, desht të dëftejë interesimin e posaçëm të tij për Bankën Kombtare të Shqipnís, tue sjellë aparatin mbarështues sa mâ të plotë në atë veshje kombtare qi duhet të kishte qysh në zanafillen e saj, të vjetit 1925.

Më Urdhnesë nr. 32 të datës 19.10.1943, të Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm në qeverimin e Vendit, u caktuen bazat e këtij shndërrimi organizues të Bankës Kombtare të Shqipnís, si institut qitës dhe krediti, me organikë kombtare, në njerëz dhe vend ndejeje të Komitetit Mbarështues, jo mâ Roma, kryeqytet i Italís, por Tirana, kryeqytet i Shqipnís.

Marrëveshjes së vjetit 1925, të krijimit të Bankës Kombtare të Shqipnís iu dhanë ndryshime themelore në qarkullimin e monedhës, kû ato të premjes së vogël u sollën për llogarí e dobí kryekëput të Shtetit Shqiptar,

si edhë krejt t'ardhunat e rrjedhuna nga fitimet për humbje e zhdukje të bankënotave. Ndërsa për konçesjonin e dhânun, Banka detyrohej të derdhë 20% të fitimeve të dlipta të saja, nga mbylljet e bilancit. Dhe i shtrohej, pa përjashtim, pagesës së tatimeve e taksave shtetnore.

Në këtë kohë u nisën marrëdhajet ekonomike e për rrjedhim monetare me Gjermanín, qi kishte ushtrín në Shqipní.

Me marrëveshje të posaçme, të datës 27 dhetuer 1943, u rregulluen pagesat në mes të Shqipnis dhe Gjermanís, tue mëkambë zyren e “clearing”-ut (kompensimit) e ushtrueme nga ana gjermane prej *Deutsche-Verrechnungskasse*, dhe nga ana shqiptare prej *Bankës Kombtare të Shqipnis* për detyrues e kreditorë të të dý palëve, në bazë të markut gjerman dhe të frangut shqiptar, simbas nji të shkuemi (kursi) të kuvenduem simbas atij të Bursës së Berlinit^{*)}.

Me anën e kësaj marrëveshje e me kredina të lëshueme n'ëmnin e Konsullatës së Përgjithshme të Gjermanís në Tiranë, u rrit qarkullimi i frangut shqiptar, qi erdh t'i shtohet, nga shpenzimet qi bâte në Vend ushtrijs gjermane.

Clearing-u i krijuem me marrëveshjen e sipërme ishte mâ fort detyrues, nga ana gjermane kundrejt anës shqiptare, dhe asfare nuk mund t'ishte kreditor, mbasi shkëmbimet ishin të kufizueme shumë, nga gjendja e luftës, e damshme për lundrimet në detin Adriatik, ku mbizotnote fuqija detare ushtarake anglo-amerikane, qi kishte pushtue gjithë bregun juguer t'Italís.

*) Dekret-Ligjë Nr. 468, dt. 31.5.1944: *Rregullimi i llogarinave midis Shqipnis dhe Gjermanís.*

Neni 3 – Debitorët që simbas nenit 2 të këtij Akordi kanë për të bâ pagesa në Shqipni, duhet t'i paguejnë në reichsmark-a shumat e detyrueshme për skadencat e tyne në llogarinë e reichsmark-ave tue i kthye simbas kursit mesatar të shenimit zyrtar të Berlinit ose simbas kursit të llogarimit të mbrendshëm gjerman për valutën përkatëse, kurs i cili do të jetë i ditës së kalueme të Bursës para ditës së pagesës.

Deutsche-Verrechnungskasse do t'i kreditojë *Bankës Kombtare të Shqipnis* shumat në RM vazhdimisht simbas pagesave që do t'i bâhen. *Banka Kombtare e Shqipnis* do t'i paguejë kronologjikisht keditorëve shqiptarë kundravleftën mbasi të kenë arrijtun lajmerimet e akreditimit mbrenda kufinit të disponibilitetit në franga shqiptarë.

Neni 4 – Debitorët që simbas nenit 2 do të kenë për të bâ pagesa në Gjermani duhet të derdhin në franga shqiptarë, në skadencë në *Bankën Kombtare të Shqipnis*, shumat e detyrueshme në llogarinë e frangave shqiptarë do të bâhet përherë simbas kursit mesatar të shenimit zyrtar të Berlinit ose simbas kursit të llogarimit të mbrendshëm gjerman për valutën përkatëse, kurs i cili do të jetë i ditës së kalueme të Bursës para ditës së pagesës.

Banka Kombtare e Shqipnis do t'i kreditojë *Deutsche-Verrechnungskasse* shumat në franga shqiptarë vazhdimisht simbas pagesave që do t'i bâhen.

Deutsche-Verrechnungskasse do t'i paguejë kronologjikisht kreditorëve gjermanë kundravleftën mbasi të kenë arrijtun lajmerimet e akreditimit mbrenda kufinit të disponibilitetit në reichsmark-a.

Nga ana gjermane, për sigurimin e vlerës së frangut shqiptar, me kthimin e mvehtësisë së Bankës, si para 7 prillit, u tërhoq nga thesari i *Banca d'Italia*, ari i depozituej nga *Banka Kombtare e Shqipnis*, qysh më 1 maj 1939, qi hyni në fuqí konventa ekonomike doganore valuttare me atë të grumbulluem nga Banka, mbas asaj date e që kapte shumë franga ari 8.462.826,90 gjithsejt.

Për shpenzimet e ushtrís, Komanda gjermane solli shumë e 800.000 napoljona ari (fr.ari 16.000.000) dhe ia dorëzoi Bankës Kombtare kundrejt një këmbimi, në bankënota shqiptare, me një të shkuem të ditës rreth 380 deri në 400 fr. për një napoljon ari, 20 fr.

Banka Kombtare nga ana e saj, tue mos dashtë të mbajë ajo vetë n'arkët e saja një sasi aq të madhe ari bëni shitjen në popull, si në tregun e Vendit, gjithashtu n'atë të Tokëve të Liruejme, të Kosovës, me një këmbim qi vertitej simbas ditës në 420 fr. e tej.

Populli e bleu krejt atë sasi ari, me atë këmbim aq të naltë, tue pasë bjerrë besimin në bankënotat, të mbetuna pa asnjë mbështetje ligjore të krijimit të saj ndërkombar, të konventës së Romës të 15 marsit 1925, as t'asaj të mbrame ekonomike doganore e valutare me Mbretin e Italis, të 20 prillit 1939, kur ajo e la qeverimin e Vendit, qi e pat marrë me forcë më 7 prill, me dëbimin e Ahmet bej Zagollit, krijesë e saj Mbret.

* * *

Qysh në zanafillen, në vjetin 1925, frangu shqiptar kartë, qarkulloi me një ritëm të ndikuej nga përshkimet ekonomike, politike e psikologjike të Vendit. Shoqnija për Zhvillimin Ekonomik të Shqipnis (SVEA), me ndërtimin e veprave botore, ndezi një valë pune dhe rritje të qarkullimit të monedhës e të vrullit të saj qarkullues.

Por mbasi veprat botore u kryen me anën e një huaje të kontraktuejme Jashtë e jo me anë të financimit të tyne pranë Bankës, monedha u mbajt në vlerën e vet të plotë, pa tronditje shvleftësimi.

Kalimi prej një kohe aktiviteti të dendun veprash botore në atë të pushimit të tyne, për arsye të shterrjes së financimit nga SVEA, solli një vlerësim më të madh të monedhës, tue mbërritë me pasë edhe një mbivlerë të monedhës kartë me atë t'arit (fr.shq. 19,80 = fr. ari 20,00).

Kjo gjendje monetare qi u krijue, u dha shkas importimeve të prodhimeve industriale, nga shtete me monedha të shvleftësueme, tue gjetë tregu shqiptar leverti të madhe importimi të mallnavet të tyne. Si ndodhi edhe me Japoni qi, me çmime *dumping*-u, qiti kryet, për herë të parë, në rrethin ekonomik të Mesdheut, për t'i fitue tregje të reja industrís së përparuejme të saj.

Ky cikël euforie pune, qi nisi me huanë SVEA dhe u mbyll me pushimin e saj, pat si përfundim, me ngritjen e vlerës së monedhës, zbritjen e çmimeve të mallnave, ngadalësimin përherë e më të madh t'aktivitetet ekonomike, papunësin dhe, financjarisht, një zbritje të ndieshme të t'ardhunavet kundrejt shpenzimeve buxhetore, me një deficit buxhetor pa burime të mbulesës së tij, ose me huana lëmoshe nga Jashtë (Itali).

Është thanë, e me të drejtë, se vende të reja, qi kanë një vullndet kombtar përparimi e zhvillimi t'ekonomis së Vendit, nuk duhet t'u trembën kryegjânave nga Jashtë. Pse aty, ku ata ndërhyjnë me përvojën edhe të teknikëve të jashtëm, rrisin fuqin ekonomike të Vendit, janë të dobishme. Ndryshe ndodh, kur ato përdoren keq, bijnë në durr të pazoja ose drejtohen nga njerëz me qëllime jokombtare, por politike e të dobis së tyne.

Ngjau kështu edhe me huan SVEA, qi nësa me atë emërtim që kishte, duhet të ndjekte ato qëllime t'objektit të saj, zhvillimin e ekonomis së Vendit, përkundrazi asgjâ s'u arrit për vepra ekonomike prodhuese, tue u kufizue financimi i saj në vepra joprodhuese, si ura, rruga, skele të Durrësit dhe ndërtesa qeveritare të kryeqytetit.

Gjendja politike e ré qi u krijue në prillin e vjetit 1939, me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Shtetit Italjan, me ndryshimet themelore qi solli edhe n'ekonomín monetare të Vendit tonë, me atë akt të Konventës valutare, kje një valë e ré pune; një ringjallje e tregtis mbrenda e jashtë Vendi, e kufizue me tash vetëm me Italin; krijoi një rritje përherë e më të madhe të qarkullimit të monedhës, qi u shkaktue edhe nga krizat politike ndërkombtare e nga luftat qi plasën në Ballkan dhe në mbarë Europën e Botën. Shqipnija, për arsye t'atij bashkimi me Italin, ngjau të bâhet, pa dashtë, shesh lufte, si me Greqí ashtu me Jugoslaví dhe Aleatët e tyne.

Banco di Napoli dhe *Banca Nazionale del Lavoro*, të cilat iu vûnë për krah Bankës Kombtare të Shqipnis, me kredinat e tyne, e trifishuen vëllimin e kreditit, rritën qarkullimin e monedhës, i dhanë shtymje edhe më të madhe spekulimeve.

* * *

Popujt, në gëzimet e shqetësimet e jetës, politike dhe ekonomike të Vendit, e gjykojnë gjendjen e tij, jo vetëm nga ana financjare, por edhe nga aftësis e cilësis e qeveritarëve e të qeveris, të qendrueshmënis ose jo të saj; të kushteve politike e shoqnore dhe të gjendjes ndërkombtare në gjithësis. Monedha është barometri qi pasqyron gjendjen shpirtnore të popullit nga ndryshimet e ngjarjeve politike dhe ekonomike, vepruese në shpirtin e mendjen e tij.

Jo ndryshe ndodhi në Vendin tonë, me ndryshimet në vlerën e monedhës sonë, e cila qysh prej 7 prillit 1939 nisi të lëkundet në një tatpjetë përherë e më të theksueme.

Në tregin e lír të vleravet në Vendin tonë, frangu shqiptar kartë i barasuem me frangun ar, tregtohej në bazë të 20 franga ari.

Para 7 prillit 20 fr.ari shkëmbehej në tregun e lír dhe atë zyrtar të Bankës me 20, 35 - 20,60 franga shqiptarë karte.

Mbas 7 prillit u ngrit përnjherë në 29 fr.shq. tue mbërrijtë në qershuer të vjetit 1940, qi Franca lëshoi armët, në 60 fr.shq. Dhe, në tetuer të vjetit 1940, me luftën qi plasi me Greqín, në 65 fr.shq.

Kjo pikë me ndryshime në ngritje e zbritje, u mbajt për një kohë nga monedhat ari qi italianët siellshin nga Svicëra, të tërhjekun nga levertija e tregut shqiptar blés, me kthimet në lira italjane, të realizueshme simbas konventës valutare, në 6,25 për një fr.shq. e pa asnji kufizim.

Vazhdoi të ngritet vlera e arit, ase më mirë të thomi, të bijë vlera e frangut shqiptar kundrejt frangut ari, simbas ernave qi nisën të fryjnë në kryeqytetin e Italis. Të një pesimizmi përherë e më të rritshëm për fatet e luftës së Boshtit, mbas ndërhymsjes të fuqís ekonomike-financjare dhe ushtarake t' Amerikës n' atë Luftë të Dytë Botnore, qi i kujtote popullit, atë të Parën të vjetëve 1914-1918, kur ndërhymsja e saj vendosi fitoren e anës shoqnuese të saj në luftë.

Ky shvletësim i frangut shqiptar mbërrijti diapazonin e tij në Fr.shq. 525 = Fr.ari 20,00 në mojin shtatuer të vjetit 1943, kur Italia u përça në dy ballna lufte, me kapitullimin e saj para fuqive anglo-amerikane, në njenë anë monarkist, me kryetar qeverie mareshalin Pietro Badoglio, e n'anë tjetër fashist republikan i Republikës së Salò, me kryetar të saj Benito Mussolini-n, vazhdoi luftën deri sa mund t'u përmbajt nga fuqija ushtarake gjermane.

* * *

Populli shqiptar, me atë zgjuetësi të pjekun nga përshkimet historike luftash të lashta e të vona të Vendit tonë, gjatë shekujsh të sundimeve të hueja, me një njohuní të thellë të vlerave ekonomike monetare të lanuna nga luftat në jetën ekonomike të Vendit, dijtí, si në Luftën e Parë Botnore, ashtu në këtë të Dytën, të mprohet n'ekonomín e tij, me masat t'instinktit të tij tregtar largpás.

Si grumbulloi arin, për sa ia lejoi tregu i tij, nga çdo skaj të dyndjeve të tija tregtare, gjithnji edhë më tepër shndërroi monedhat karte

të qarkullimit në vend, në gjâna të tregtis qi solli nga tregjet e Italis. Sidomos nga ai treg i madh industrial të saj, si âsht *Milani*, qi u bâ treg i zakonshëm i blemjeve të tija dhe t'investimeve të tija, pa asnji vleftë shkëmbimi të frangut shqiptar letër me vlerat e çmueshme monetare të jashtme të Vendit tonë në Botë. Pse ari me tjera vlera monetare të barasueme me të, të cilat përbâjshin dorëzanin e qarkullimit të frangut shqiptar në Vend dhe Jashtë, mbaheshin në Qendrën e Bankës Kombtare të Shqipnis, në Romë. Nga e cila u shkëput Shteti i ri shqiptar i Republikës Popullore, qi erdhi në fuqi në vjetin 1944, tue pré çdo marrëdhanie ligjore me krijimin qi bâni të Bankës së Shtetit Shqiptar, e hodhi poshtë konventën e krijimit të Bankës Kombtare të Shqipnis më 15 mars në Romë me pjesëmarrjen e Bankave të shteteve Belgjikë, Svicër, Jugoslaví dhe t'Italis qi e kryesoi me bankat e saja të para si *Banca Commerciale Italiana*, *Credito Italiano* e *Banco di Roma*.

Shqipnija u shndërrue në një "entrepôt" me randësi në Ballkan, si asnji vend tjetër, të prodhimeve industriale, për sasí e cilësi, qi përfshijshin në tanësin e tyne lloje të ndryshme e të çmueshme për ekonomin dhe tregtin.

Por monedha shqiptare, nga ajo krizë pushtetesh dhe regjimi, nga ai kaos fuqinash, në të cilat rá qeverimi i Vendit, qi po jetote një luftë të mbrendshme me pushtimet ushtarake të hueja, e humbi drejtimin e organit të vet mbarështues dhe besimin e popullit në vlerën e saj.

Na nanduer të vjetit 1944, nanduer i fateve të Shqipnis, Banka Kombtare uli qepengat. Mbylli veprimtarin e vet, tue u largue me kthimin n'Itali të të gjithë aparatit drejtues e tue lanë monedhën e qitjes së saj, në pikën mâ të naltë të shvleftësimit:

Fr.shq. 800 = 20 Fr.ari

Dhe një shumë monetare bankënotash prej 397.800.000 Fr.shq.

BANKA E SHTETIT SHQIPTAR

zavendsoi Bankën Kombëtare të Shqipnisë në fillim të vjetit 1945, tue trashigue prej saj të gjithë banknotat karte të gjetuna n'arkën e qendrës dhe n'ato të degëve të saja në gjithë Shqipninë: Shkodër, Tiranë, Durrës, Vlonë, Gjinokastër, Sarandë, Korçë, Berat etj. Me to edhe të gjitha ato qi ndodheshin pranë shqiptarëve nënshtetas, në qytetet, katundet e malcinat të Vendit. Tue u pré çdo lidhje me atë institut bankar të parë, qi kje ndërkombëtar në fillim

të krijimit me Kuventën e 15 marc 1925 dhe ligjës organike të botueme që të dyja në Fletoren Zyrtare Nr. 40 dt.31 korrik 1925. Me këtë ndërrim me themel, të këtij instituti bankar, i quejtun *Banka Kombëtare e Shqipërisë*, banknotat e qituna prej saj, pësuen ndryshime në vleftën e tyre, simbas ndërrimeve qi vijuen nji mbas tjetri, e janë:

i pari : fr.shq. të vjetër 100 u banë baras me fr.shq. të rij 20 (5x1)

i dyti : “ “ rij 20 “ “ “ lekë 180 (1 me 9)

i treti : lekë të përparshëm 180 “ “ “ “ të rij 18 (10 për 1)

dhe me fytyra të reja në to, qi u shtypën.

Pa asnji mbulesë të garancis së qarkullimit të tyre, pse fondi ari i themelimit me atë të mbledhun gjatë kohës së funksionimit, gjindej i depozituem në *Banca d'Italia* simbas Kuventës të 20 prillit 1939 (neni 10 e 11). Me pushimin e pushtimit italjane ardhjes në vend të tij të gjermanëve, u tërhoq nga Gjermanija të gjithë fondi ar i depozituem në *Banca d'Italia*, me qellim qi garancija e monedhës shqiptare të mos jetë mâ e varun nga fondi i garancis italjane, por të ketë njetë garanci qi kishte pasë mvehte. Por në fund të luftës 1945, mbi atë fond u krijuen të drejta me ato të damshpërblimit ingliz të rrjedhuna nga mbytyja anijesh lufte inglize n'ujnat e Sarandës për shkaqe të qeveris shqiptare, së cilës iu ngarkue faji e për rrjedhim shdamtimi.

NDËRRIMET E MONEDHËS SHQIPTARE

PREJ 1944 DERI MË 1965

Ndërrimet e fr.shq. të vjetit 1944, fundi i *Bankës Kombëtare të Shqipërisë* qi u zavendsue nga *Banka e Shtetit Shqiptar*: p.sh. Fr.shq. 3000 (vlerë e vjetit 1944) u kthyen në fr.shq. të rij barazi me 600, par ne raportin 5:1

Ndërrimi **I** u pasue nga ndërrimi **II** më 1947, si vijon: Fr.shq. të rij 600 u kthyen në Lekë 5400, d.m.th.: 1 fr.shq. i ri barasi me 9 lekë.

Ndërrimi **III** u bâ për thjeshtësim, si thohej, llogarije: p.sh. Lekë 5400 u kthyen në 540, d.m.th. 10 lekë të vjetër për 1 të ri.

ARI: prej 213 doll. qi ka kenë tash së mbrami 1 once ari gr. 30.59 ka mbërrijtë sot 10 shtatuer 1979 në 374 dollarë e âsht çmimi maksimum kur dikur ka kenë 35 dollarë.

▪Drejtshkrimet e shqipes▪

ORTOGRAFIJA E GJUHËS SHQIPE (1964)^{*)}

-vijon nga numri i kaluar-

1. MËNYRA DËFTORE

Koha e tashme

1. Të gjitha foljet që mbarojnë me temë në zanore a në diftong në vetën e parë të njajsit prezentit t'indikativit do të shkruhen me j në fund; p.sh.: bāj, punoj, laj, fshij, fryj, shkruiej, lyej etj.

2. Foljet e kësaj kategorije, si edhe deri tash, në vetën e parë dhe të tretë shumës shkruhen me ë në fund: shkruejmë, shkruajnë blejmë, blejnë, ziejmë, ziejnë, etj.

3. Foljet që tema u mbaron me një nga bashkëtingëlloret, në vetën e parë, të dytë dhe të tretë të njajsit s'do të marrin asnjë mbaresë, pra: unë prek, ti prek, ai prek; unë hyp, ti hyp, ai hyp, unë mbyll, ti mbyll, ai mbyll etj.

4. Folja e parregullt me ardhë në të tashmen do të zgjedhohet kështu: (unë) vij, (ti) vjen, (ai) vjen, (na) vijmë, (ju) vini, (ata) vijnë. Foljet me dijtë dhe me pi zgjedhohen kështu: (unë) dij a di, (ti) din a di, (ai) din a di, na dijmë a dimë, (ju) dini, (ata) dinjë a dinë. (unë) pij a pi, (ti) pin a pi, (ai) pin a pi, (na) pijmë a pimë, (ju) pini, (ata) pijnjë a pinë.

Foljet me pre e me pritë duhet me i dallue në zgjedhim për arsye se kuptimi i tyne është krejtësisht i kundërt. Do të zgjedhohmë kështu:

Me pre:

e tash. dëf.: prej, pren, pren, prejme, preni, prejnë,

e kr. thj.: preva, preve, preu, preme, pretë, prenë,

e pakr.: prejsha, prejshe, prente, prejshim, prejshit, prejshin

e tash. dësh.: prefsha, prefsh, preftë, prefshim, prefshit, prefshin,

e tash. hab.: prekam, preke, preka, prekemi, prekeni, prekan.

Me pritë:

e tash. dëft.: pres, pret, pret, presim, pritni, presin,

^{*)} Enti për botimin e teksteve i Republikës Socialiste të Serbisë, Beograd 1964.

e kr. thj.: prita, prite, priti, pritëm, pritët, pritën,
 e pakr.: pritsha, pritshe, pritte, pritshim, pritshit, pritshin,
 e tash. Dësh.: pritsha, pritsh, prittë, pritshim, pritshit, pritshin,
 e tash. hab.: pritkam, pritke, pritka, pritkemi, pritkeni, pritkan.

E pakryemja

1. Trajta pësore ruhesh, rritesh (veta e III nj. e së pakryemes) do të shkruhet ruhej, rritej, punohej, i flihej etj.

2. a) N'imperfekt lejohen të dy trajtat: punojsha, a ponoja, punojshë a punoje, punjshim a punonim, punojshit a punonit, punojshin² a punonin; hapsha a hapja, hapshe a hapje, hapshim a hapnim, hapshit a hapnit; hapshin a hapnin etj.

b) Foljet që participi u mbaron me të, si p.sh. shitë, shetitë, përgatitë, lllomotitë etj. vetën e III njajës të së pakryemes do ta bajnë me tt (dy t) ose me st. p.sh.: shitte, shetitte, përgatitte etj. ose shiste, shetiste, përgatiste etj.

E kryemja e thjeshtë

1. Si dihet, veta e tretë e aoristit të foljeve që në të tashmen e dëftores (veta I) dalin me -oj, -uej, shkruhet me oi: p.sh.: ngarkoi, lexoi, etj. kurse foljet në të tashmen e dëftores (veta I) që mbarojnë me -aj (çaj), -ej (blej), -ij (fshij), -iej (ziej), -yej (lyej), aoristi i tyne do të shkruhet me u: çau, bleu, fshiu, zjeu, leu, (prej lyej) etj.

2. Foljet që në të tashmen e dëftores (veta I) dalin me yj, âj, ij aoristin në vetën e tretë njajës, rregullisht, e bajnë me -ni ose -u:

a) shtyj - shtyni, fryj - fryni, pështyj - pështyni, hyj - hyni etj.

b) bâj - bani, shâj - shani, fâj - fani, prâj - prani, etj.

c) mbij - mbini, mpij - mpini, lëpij - lëpini, gdhij - gdhini, grij - grini, nxij - nxini ose mbiu, mpiu, lëpiu, gdhIU, griu, nxIU

2. MËNYRA LIDHORE

1. Foljet, që në të tashmen e dëftores tema u mbaron në zanore a diftong, në vetën e dytë të njajës të lidhores do të shkruhen me -jsh; p.sh.: të punojsh, të shkrujesh, të vijsh, të lyejsh, të blejsh, të bâjsh, të lajsh, të fshijsh, të hyjsh etj.

2. Si dihet, veta e tretë e njajës të lidhores te foljet me -aj, -ej, -âj, -oj, -uej, -vej, -yj, -ij shkruhen me ë në fund: të lajë, të blejë, të bâjë, të fshijë, të hyjë, të punojë, të shkrujë, të lyejë etj.

3. Të gjitha foljet që mbarojnë me bashkëtingollore, në vetën e tretë njajës të lidhores dalin me i: p.sh.: ai të flasi, të lidhi, të prishi, të lagi, të mbylli, të rrisi etj. Po kështu do të formohet (prej

kësaj trajte) edhe futuri, natyrisht, tue i shtue pjesëzën do: ai do të lidhi, do të flasi, do të prishi, do të shetisi, do të mbylli, do të lagi etj.

3. MËNYRA HABITORE

1. Foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore, mënyrën habitore e bajnë nga pjesorja e tyne, tue nxjerrë jashtë ë-në; kështu do të shkruhet: shitkam, ardhkam, folkam (e jo shitëkam etj). Po kështu formohet edhe habitorja e foljevet ndihmëtare me pasë e me qenë: paskam, qenkam. Veta e III shumës shkruhet: shitkan, ardhkan, folkan, etj.

4. MËNYRA DËSHIRORE

1. Foljet që tema u mbaron me zanore ose diftong, trajta e dëshirores

u del me mbaresën -fsha: shkofsha, prifsha, bafsha, kthefsha etj.

2. Veta e tretë e prezentit të dëshirores do të mbarojë me të: punoftë, rroftë, u prishtë, ardhhtë etj.

3. Foljet me dhanë e me thanë për vetën e tretë njajës të së tashmes së dëshirores kanë dy trajta: dhashtë dhe dhantë, thashtë dhe thantë.

4. Foljet që në trup kanë togun -je dhe që fill mbas këtij togu pason një bashkëtingëllore e langët (si: me mbjellë, me mjellë etj.) në kohën e pakryeme veprorë, n'urdhnoren si edhe në kohën e tashme pësore, në mënyrën kushtore dhe lidhore e mbledhin togun -je në -i, pra: mbillsha, milsha; mbill, mil; mbillem, mbillesh, mbillet, millet; të mbillet, të millet; do të mbillej, do të milej, etj.

5. Foljet me -iej në temë, rëndom, nuk e mbledhin kët grup në i. Kështu do të shkruiejmë: përzijshta, ziejshta, etj.

5. MËNYRA URDHNORE

1. Foljet enklitike (përemnat vetorë etj.) që i ngjiten në fund trajtës s'urdhnores së një foljeje, shkruhen bashkë me te: bleje, kërkomë, thueji, ndëgjojeni, jepmëni, kapeni etj.

2. Urdhnorja e foljes me ikë ban ik e jo ikë; po kështu urdhnojmë - shkruiejmë: hyn, fol, zen etj.

3. Foljet që në temë kanë togun je të pasuem me një konsonant të langët n'urdhnore kët tog e mbledhin më i: nxirr - nxirrni, sill, mil, vil, mbill etj.

6. MËNYRA PJESORE

Foljet me ikë,, me ecë, - do të shkruhen: ikë, ecë (e jo: hikë, hecë), ecin, ecshin, t'ikni, ikëm, ikën, etj.

7. TRAJTA PËSORE E VETVETORE

1. Folejt që në trajtën veprare dalin me diftongun ue, ye, ie (je), në trajtën pësore a vetvetore shqiptohen e shkruhen me zanore të thjeshtë; p.sh.: shkruiej - shkruhem, lyej - lyhem, ziej - zihem, ndjek - ndiqem, nxjerr - nxirrem (e jo: shkruiehem, lyehem, ziehem, etj.)

2. Pjesëza ue e trajtës pësore e vetvetore shkruhet e ndame prej foljeve, pa vizë: u pendova, u lidh, u pastrue, u prishë etj.

VII. NDAJFOLJET

1. Ndajfolje vendi

a) Ndajfoljet e thjeshta të vendit do të shkruhen kështu: mbrenda, drejt, jashtë, nalt, larg.

b) Këto ndajfolje të përngjituna të vendit do të shkruhen me një fjalë: askund, gjithandej, kudo, kurrkund, mënjane, matane, përbri, përdhe, përposh, përtej, përkëtej, përjashta, përmbrenda, përballë, përqark, përpjetë, përsipër, pranë, tatëpjetë, tekdo, anembanë.

c) Këto ndajfolje të përngjituna të vendit a lokucione ndajfoljore do të shkruhen kështu: me këtë anë, së largu, për së largu, së nalti, mepërmes a mes për mes, tejpertej a tej për tej, aty këtu, rreth e përqark, përreth a për rreth, rreth e rrotull, atypari a aty pari, matej a ma tej, matutje a ma tutje.

2. Ndajfolje kohe

a) Këto ndajfolje kohe do të shkruhen kështu: dje, vonë, kurr a kurrë, sonte, mbramë, shpesh, prap.

b) Këto ndajfolje të përngjituna të kohës do të shkruhen me një fjalë: përsëri, mbasnesër, pardje, parvjet, parmbamë, njiditëzaj, njinatëzaj, ngahera, aqhera, përherë, përnjiherë, nganjihërë, kurdoherë, sakaq, sakaqherë, qëpari, qëmoti, sivjet, atëherë, atëbotë, gjithmonë, gjithherë, njëkohësisht, doradorën, hepërhe, paradreke, mbasdreke, shpeshherë, rrallëherë, s'afërmi, për s'afërmi, që me natë, prapsepap, sotpërsot a sot për sot, tashpërtash a tash për tash etj.

Qëkur e qyshkur shkruhen me një fjalë kur janë ndajfolje; me dy fjalë që kur, qysh kur, atëherë kur janë lidhza. P.sh. qëkur që po rri këtu. Ka qyshkur kjo punë. Që kur kam ardhë unë, s'kam pa njeri.

3. Ndajfolje mënyre

a) Nga ndajfoljet e mënyrës që u përgjigjen mbiemname me -të e disa mbiemname të tjerë, shumica shkruhen me ë në fund e vetëm dia pa ë. Kështu: (i butë) butë, (i gjatë) gjatë, (i gjanë) gjanë, (i fshehtë) fshetë, (i lehtë) lehtë, (i mirë) mirë, (i ngushtë) ngushtë, (i qartë) qartë, (i trashë) trashë, (i mbarë) mbarë, (i rrallë) rrallë, (i urtë) urtë. Por shkruhen pa ë: drejt (i drejtë), shpejt (i shpejtë), thjesht (i thjeshtë), ligisht (i ligishtë), fort (i fortë), kot (i kotë), plot (i plotë), nalt (i naltë), mjaft (i mjaftë), vërtet (i vërtetë). Po ashtu shkurt (nga i shkurtë).

b) Këto ndajfolje mënyre të përngjituna do të shkruhen me një fjalë: përsëri, kësodore, gjithashtu, (marr) ngrykë, (zâ) ngoje, (më vjen) ndore, përmbys, sidokudo, dosido, thuejse, pothuej, pothuejse, ngadalë, dalngadalë, doemos, domosdo, përndryshe, mezi, domethanë, assesi, kurrsesi, kryekreje, kryekëput, mirëfilli, bashkangjitur.

c) Këto lokucione ndajfoljore e ndajfolje mënyre të përngjituna do të shkruhen kështu: drejtpërdrejt, me të mirë, me të keq, me të butë, me të shpejtë, me të vërtetë, më kot, parasysht, së pari, pikësëpari, së dyti, së treti, së katërti, etj. së bashku, së fundi, së rish, së rithi, ma së fundi, ma në fund, për së shpejti, së shpejti, për së gjati, për së gjani, veç e veç etj. ma së miri, njizani. Po kështu do të shkruhen edhe shprehjet numrore katër për qind, pesë për qind.

d) Ndajfoljet që formohen nga përsëritja e së njëjtës fjalë do të shkruhen me vizë; p.sh.: copa-copa, duer-duer, herë-herë, tufatufa, vende-vende. Po kështu do të shkruhen edhe lokucionet³ ndajfoljore si kamba-kambës, dita-ditës etj.

e) Ndajfoljet e formueme prej dy emnash a prej një emni e një pjesorje do të shkruhen me një fjalë, p.sh.: kambëkryq, duerkryq, fjalëkryq, duerlidhun, shtatzanë etj.

ë) Nga ndajfoljet e mënyrës me dy trajta -as dhe -azi, trajtat që mbarojnë me -i shkruhen me z, kurse trajtat që mbarojnë me bashkëtingëllore shkruhen me s. Pra: barkas, djathtas, haptas, rishtas, por: barkazi, djathtazi, haptazi.

f) Ndajfolja sasiye shumë do të shkruhet pa ë në fund.

VIII. LIDHZAT

Këto fjalë do të shkruhen kështu: mbasi, ose, apo, kurse, sepse, ndonse, kinse, veçse, edhepse, sikurse, se si, se sa, derisa, ndërsa,

që kur, sikundër që, sadoqë, sidoqë, sado, sido, porsa, porse, mirëpo, para se, megjithate, nëqoftëse, megjithëqë, meqenëse, poqë, poqese, ngaqë, meqë, sidoqoftë

C. TË NDRYSHME

PËRDORIMI I SHKRONJAVE TË MËDHA

1. Emnat e popujve. - Emnat e popujve dhe të banorëve të një vendi do të shkruhen me shkronjë të madhe; p.sh.: Bullgar, Çekoslllovak, Gjerman, Hungarez, Rus, Shqiptar, Elbasanas, Korçar, Shkodran etj. Ndërsa do të shkruhen me shkronjë të vogël mbiemnat përkatës; P.sh.: populli shqiptar, letërsija jugosllave, industria e randë çekosllovake, darsma gjakovare, vajzë korçare.

2. Emnat e stinëvet, të muejvet e të ditëvevet të javës. - Emnat e stinëvet, të muejvet e të ditëvevet të javës do të shkruhen me shkronjë të vogël; p. sh.: pranverë, verë, vjeshtë, dimën, kallnor, fror, mars, e hanë, e martë, e mërkurë, e ejte, e premtë, e shtunë, e dielë.

3. Titujt e institucioneve etj. - Në titujt dhe emnat e institucioneve, organizatave etj., do të shkruhet me shkronjë të madhe vetëm fjala e parë. P. sh.: Akademia serbe e shkencave, Ministria e arsimit, Partija komuniste e Jugosllavisë, Sekretariati i punëve të jashtme, Kuvendi popullor, Armata popullore e Jugosllavisë, Biblioteka universitare, Muzeumi arkeologjik e etnografik, Lidhja e komunistëve të Jugosllavisë, Shkolla normale e Prishtinës, Arsimi popullor (titull reviste), Fakulteti filozofik i Prishtinës, Këshilli krahinor i kulturës, Pleqsija e arsimit dhe kulturës (e jo: Pleqsija për arsim e kulturë).

Në titujt e veprave, artikujve e kapitujve po ashtu do të shkruhet me shkronjë të madhe vetëm fjala e parë. P.sh.: "Bagëti e bujqësia", "Lulet e verës", "Vargjet e lira", "Valët e detit", "Bleta shqiptare", "Sëmundja foshnjore e majtizmit në komunizëm" etj.

4. Emnat gjeografikë të përbamë prej dy a ma shumë fjalësh, do të shkruhen me shkronja të mëdha: Maja e Hekuravet, Deti i Zi, Oqeani Indian, Strellci i Poshtëm, Deti i Ngrimë i Veriut etj.

5. Emnat gjeografikë shkruhen me shkronjë të madhe, qoftë kur përdoren si emna; p.sh.: Adriatiku, Sharri, Kopaoniku, qoftë kur përdoren si përcaktues të një emni të përgjithshëm; p.sh.: Deti Adriatik, në Detin Adriatik.

6. Emnat e shteteve do të shkruhen me shkronjë të madhe; p. sh. Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë; Shtetet e Bashkueme t' Amerikës.

Emnat e përveçëm të huej

1. Emnat e përveçëm të huej në një pjesë të madhe shkruhen simbas shqiptimit që kanë në gjuhën, nga e cila janë marrë. Kështu shkruhen emnat e përveçëm nga gjuhët e Europës Perëndimore. Për herë të parë mund të shënohet në parantezë edhe shkrimi simbas ortografisë së gjuhës s' origjinës. P.sh.: Bajron (Byron), Gëte (Goethe), Monteskje (Montesquieu), Shekspir (Shakespeare), Shiler (Schiler, Zhan Zhak Ruso (Jean Jeacques Rousseau).

Në studimet e punimet shkencore të specialitetit emnat e përveçëm të huej mund të shkruhen me grafinë e gjuhës së origjinës, tue shënue në parantezë herën e parë shkrimin simbas shqiptimit.

2. N' emnat e përveçëm të gjuhëve sllave që kanë alfabet jolatin, ortografija shqipe në përgjithësi shkon mbas grafisë e jo mbas shqiptimit të këtyne gjuhëve. Kështu në shkrimin e fjalëve rusishte nuk shkruhet i-ja e shkurtë fundore mbas një i-je: Gorki, Majakovski.

3. Emnat e përveçëm të huej në shqipet do të lakohen e do t'i marrin nyjet e mbrapme përkatëse, dmth. mbaresat rasore tue iu ngjitë kjo temës pa vizë, p.sh.: Ciceroni, Ciceronit, Gëteja, Gëten; Lermontovi, Lermontovit, Lermontovin; Makarenkoja, Makarenkos; Moska, Moskës; Odesa, Odesën; Shekspiri, Shekspirit, Shekspirin; Vuk Karaxhiqi, i Vuk Karaxhiqit; Gjura, poezija e Gjures, tregimet e Petër Koçiqit, arti i Petrit etj.

Datat

Datat që shkruhen me shifra, pa pasë pranë emnat vit e ditë, kur lakohen, marrin nyjën e mbrapme, që shkruhet e ndame me vizë; p.sh.: (maji) i 1918-s, ngjarjet e 1923-s.

Ndamja e fjalëve në rrokje

Fjalët ndahen në rrokje në kët mënyrë:

1. Fjalët njirroshe nuk ndahen në mbarim të rreshtit.
2. Togjet zanore dhe diftongjet nuk ndahen: die-lli, bue-lli, fye-lli; ai, ia, iu, shkoi etj.
3. Kur një bashkëtingëllore ndodhet në mes dy zanoresh, atëherë ajo shkon me zanoren e dytë: a-ra, pu-la, de-ty-ra etj.
4. Kur dy bashkëtingëllore ndodhen në mes dy zanoresh, atëherë njana shkon me zanoren e parë, kurse tjetra me zanoren e dytë: pup-la, dësh-mi, bleg-to-ri etj.
5. Kur tri bashkëtingëllore ndodhen në mes dy zanoresh, atëherë

njana shkon me zanoren e parë, kurse dy të tjerat me zanoren e dytë: kop-shti, dësh-prim, kon-flikt etj.

6. Kur një bashkëtingëllore dhe l ose r ndodhen në mes dy zanoresh, atëherë shkojnë me zanoren e dytë: go-gla; pu-pla; bu-kla; li-bri; Pe-tri-ti; de-mo-kra-ci etj.

7. Kur togjet bashkëtingëllore mb, nd, ng, e ngj ndodhen në mes dy zanoresh, atëherë shkojnë me zanoren e dytë: ka-mba, mbrenda, ka-nga, tru-ngjet etj.

8. Kur togjet bashkëtingëllore mb, nd, e ng dhe bashkëtingëllorja r ndodhen në mes dy zanoresh, atëherë shkojnë me zanoren e dytë: the-mbra, thu-ndra, ci-ngrim etj.

9. Kur togu bashkëtingëllor sht dhe r ose j ndodhen në mes dy zanoresh, atëherë shkojnë me zanoren e dytë: mje-shtri, thje-shtra, kë-shtjella etj.

10. Fjalët e prejardhuna dhe të përngjituna ndahen në rrokje simbas pjesëve të tyre: derdh-ka, flit-ka, flit-te, trim-ni, shpirt-nor, krye-ngrit-je, gjith-a-shtu etj.

-Fund-

▪Nekrologji▪

KOLEC TOPALLI (1938-2018)



Më 24 maj të këtij viti pas një sëmundjeje të rëndë u nda nga jeta në moshën 80-vjeçare Prof.dr. Kolec Topalli Ai u lind në Shkodër më 1938. I prejardhur nga një familje me tradita patriotike, por fatkeqësisht mjaft e përndjekur gjatë rregjimit komunist, iu desht shumë punë, mund dhe djersë në rrugën e gjatë të të qënurit së pari njeri, dhe më pas personalitet i shquar në fushën e arsimit dhe të shkencës shqiptare.

Kolec Topalli pasi mbaroi shkollën e mesme në vendlindje; filloi studimet e larta në ILP të Shkodrës dhe i përfundoi ata në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në UT (1964). Ka punuar si mësues në rrethet Kukës, Lezhë, Gramsh e Krujë. Sekretar i përgjithshëm i Presidentit të Republikës (1992-1997), punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë (1997-2005), këshilltar në ambasadën e Shqipërisë në Romë (2006), koordinator shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike (2007-2014). Gjatë viteve të shërbimit në arsim u mor me studime gjuhësore dhe përgatiti dy disertacione (1986, 1991). Ka trajtuar kryesisht probleme të fonetikës e gramatikës historike dhe të etimologjisë së shqipes. Ka botuar më shumë se 250 tituj me rreth 10.000 faqe: monografi, artikuj e kumtesa, si bashkëpunëtor i 30 revistave shkencore brenda e jashtë vendit, me botime në 5 gjuhë të huaja. Ka marrë pjesë me kumtesa në 120 konferenca shkencore kombëtare e 58 ndërkombëtare dhe ka ligjëruar për historinë e gjuhës shqipe në universitete e qendra shkencore brenda e jashtë vendit. Pedagog i fonetikës historike në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës; anëtar i komisionit për gjuhën shqipe në institucionin ndërkombëtar të ALE-së (Atlas Linguarium Europae). Në vitin 2008 është zgjedhur anëtar

i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe më 2012 anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është autor i shumë monografive. Në fushën e fonetikës historike ka botuar: “Theksi në gjuhën shqipe” (1995), “Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe” (1996), “Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes” (1998), “Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe” (2000), “Sonantet e gjuhës shqipe” (2001), “Mbylltoret e gjuhës shqipe” (2002), “Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe” (2003), “Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe” (2004), “Fonetika historike e gjuhës shqipe” (2005), (nderuar me çmimet “Ekselencia Shqiptare 2007” dhe “Çmimi i Albanologjisë 2008”), “Ricerche sulla storia dell’accento in albanese” (“Kërkime mbi historinë e theksit në shqipe”), (Kozencë, 2007). Në fushën e gramatikës historike ka botuar monografitë: “Evolucioni historik i përemrave të shqipes” (2008), “Nyjat e shqipes” (2009), Sistemi rator i emrave të shqipes” (2009), “Sistemi foljor i gjuhës shqipe” (2010), “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” (2011), (nderuar me çmimin e revistës “Kult” 2012”, si vepra shkencore më e mirë e vitit), Fjalori Etimologjik të Gjuhës shqipe (2017) (fitues i Çmimit “Çabej”, Edicioni II, si vepra më e mirë shkencore e vitit 2017 në fushën albanologjike). Senati Akademik i Qendrës së Studimeve Albanologjike i ka dhënë titullin “Profesor Nderi i Studimeve Shqiptare”. Presidenti i Republikës e ka nderuar me urdhrin “Mjeshtër i Madh”.

Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe, cilësohet të jetë vepra ma e çmueshme, kunorëzim i të tana përpjekjeve të tija studimore në fushën e historisë së shqipes.

Kolec Topalli prehet në varrezat e Rrmajit në Shkodër. Në prani të shumë qytetarëve shkodranë, por jo vetëm dhe personaliteteve të shquara akademike, zotërinjtë Valter Memishaj, Drejtor i Institutit të Gjuhësisë, në Tiranë dhe Alfred Çapaliku, nga Instituti i Albanologjisë, Universiteti të Shkodrës duke shprehur ngushëllimet për ndarjen nga jeta, përcollën edhe një herë vlerat njëjësore, por edhe shkencore të krijuara ndër vite nga i ndjeri.

